monumentet

DO NOT COPY



1, 1971

MINISTRIA E ARËSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 8658

1, 1971

REDAKSIA:

Gani Strazimiri (Kryeredaktor)
Aleksandër Meksi, Apollon Baçe, Emin Riza, Gjerak Karaiskaj, Neritan Ceka, Selim Islami (Zëv. Kryeredaktor), Stilian Adhami.

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës

Adresa e Redaksisë **Rruga Alqi Kondi Nr. 7.**

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

1 — G. STRAZIMIRI — Rezultatet dhe perspektivat e punës kërkimore restauruese 11

2 — S. ISLAMI — Qyteti ilir në Zgërdhesh 23

3 — N. ÇEKA — LL. PAPAJANI — Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike .. 43

4 — GJ. KARAISKAJ — Kalaja e Elbasanit 61

5 — K. ZHEKU — Restaurimi i Portës së Luanit Butrint 79

6 — S. ADHAMI — Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës 87

7 — A. MEKSI — Arkitektura dhe datimi i kishës së manastirit të Apollonisë. 103

8 — H. NALLBANI — Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasi .. 119

9 — E. RIZA — Banesa e fortifikuar gjirokastrite. 127

10 — B. STRAZIMIRI — P. THOMO — Kulla e Matit 149

MATERIALE DHE KUMTESA

1 — V. KAMSI — Kështjella e Shkodrës dhe restaurimi i saj 165

2 — G. SAMIMI — Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës beratase. 173

3 — P. LERA — Gjurmë të reja të lashtësisë në rrethin e Korçës .. 177

4 — T. FRASHËRI — Të dhëna të reja arkeologjike nga lugina e Vjosës 185

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

1 — A. MEKSI — Arkitektura e Kullës si banesë. 193

KRONIKË

1 — Puna konservuese restauruese dhe kërkimore në Institutin e Monumenteve të Kulturës gjatë vitit 1969. 199

DO NOT COPY

TABLE DES MATIERES

Page

Gani STRAZIMIRI
Résultats et perspectives du travail de recherche et de restauration .. 11

Selim ISLAMI
La cité illyrienne de Zgërdhesh 23

Neritan CEKA – LL. PAPAJANI
La route antique longeant la vallée du Shkumbini 43

Gjerark KARAISKAJ
La citadelle d'Elbasan 61

Koço ZHEKU
La restauration de la Porte du Lion à Butrint 79

Stilian ADHAMI
La fondation de la citadelle de Kruje et ses principales reconstructions 97

Aleksandër MEKSI
L'église du monastère d'Apollonie, son architecture et le problème de sa datation 103

Hasan NALLBANI
De l'oeuvre du peintre David Selenicasi 119

Emin RIZA
L'habitation fortifiée de Gjirokastër 127

Burhan STRAZIMIRI – Pirro THOMO
La «kulla» de la région du Mat 149

COMMUNICATIONS ET DIVERS

Vili KAMSI
La citadelle de Shkodër et sa restauration 165

Genc SAMIMI
Indications sur les procédés de construction de l'habitation type de Berat 173

Petrika LERA
Nouveaux vestiges antiques découverts dans la région de Korçë. . . 177

Tanush FRASHËRI
Nouvelles données archéologiques sur la vallée de la Vjose 185

CRITIQUE ET BIBLIOGRAPHIE

A. MEKSI
L'architecture de la «kulla» en tant qu'habitation. 193

CHRONIQUE

Le travail de conservation, de restauration et de recherche à l'Institut des Monuments Culturels en 1969. 199

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Vëllimi «Monumentet», që po i jepet sot në dorë lexuesit, është një përmbledhje studimesh dhe materialesh mbi monumentet e kulturës të vendit tonë. Ai përfaqëson numrin e parë të një serie, që do të botohet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Nëpërmjet botimeve tona, rrethet e gjera të lexuesve, do të njihen me rezultatet e punës që bëhet për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e monumenteve. Ata do të ndihmohen për të thelluar dijenitë mbi traditat kulturale të popullit tonë, gjë, që do t'i shërbejë edukimit klasor-revolucionar dhe patriotik të tyre.

Botimi i rezultateve të punës me monumentet është bërë i nevojshëm nga vetë zhvillimi socialist i vendit tonë. Specialistë të degëve të ndryshme ndeshen në punën e tyre me probleme që lidhen me monumentet e kulturës. Ndërtuesit interesohen për traditat në teknikën e ndërtimit, arkitektët për zhvillimin e arkitekturës kombëtare, urbanistët për formimin urbanistik të qyteteve, mësuesit për historinë e monumenteve të krahinave ku punojnë etj.

Studimet dhe materialet e botuara do të pasqyrojnë punën kërkimore — — restauruese me monumentet e kulturës. Ato do të përbëjnë bazën mbi të cilën do të mbështetet sot dhe në të ardhmen veprimtaria në këtë fushë dhe njëkohësisht do të jenë një kontribut në fondin e shkencave albanologjike.

Në këtë vëllim përfaqësohen me punimet e tyre një numur bashkëpuntorësh të jashtëm të Institutit të Monumenteve të Kulturës. Edhe për numrat e ardhshëm redaksia do të mirëpresë çdo bashkëpunim që do të ketë si temë monumentet e kulturës. Gjithashtu presim nga lexuesit vërejtje dhe sugjerime për të na ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të botimeve tona.

REDAKSIA

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Le volume «Les Monuments» que nous offrons aujourd'hui au lecteur est un recueil d'études et de matériaux sur les monuments de culture de notre pays. Il représente le premier numéro d'une série qui sera publiée par l'Institut des Monuments de Culture.

Nos publications feront connaître à de larges cercles de lecteurs les résultats des travaux qui se font chez nous pour la protection, la conservation et la restauration des monuments. Elles leur permettront d'approfondir leurs connaissances sur les traditions culturelles de notre peuple, contribuant ainsi à leur éducation classiste-révolutionnaire et patriotique.

Dans notre pays, c'est le développement socialiste lui-même qui a rendu nécessaire, la publication des résultats de nos activités dans le domaine des monuments. Au cours de leurs travaux, des spécialistes de différentes branches rencontrent des problèmes en relation avec les monuments de culture. Les constructeurs sont intéressés par les traditions dans la technique de construction, les architectes par l'évolution de l'architecture nationale, les urbanistes par l'aménagement des villes, les instituteurs par l'histoire des monuments des lieux où ils travaillent, etc.

Les études et les matériaux publiés reflèteront nos travaux de recherche et de restauration relatifs aux monuments de culture. Ces publications assureront la base sur laquelle s'appuiera notre activité présente et future dans ce domaine, et en même temps constitueront une contribution pour le fonds des sciences albanologique.

A ce volume participent avec leurs travaux un nombre de membres correspondants de l'Institut des Monuments de Culture. Pour les volumes successifs aussi, la Rédaction accueillera volontiers toute collaboration portant sur des thèmes de monuments de culture. Nous attendons également de la part de nos lecteurs des remarques et des suggestions susceptibles de concourir à l'amélioration continue de nos publications.

Rédaction

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gani STRAZIMIRI

REZUITATET DHE PERSPEKTIVAT E PUNËS KËRKIMORE RESTAURUSE

Si në të gjitha fushat e jetës së popullit tonë, ashtu dhe në fushën e mbrojtjes, të konservimit, të restaurimit dhe të popullarizimit të monumenteve, gjatë këtij çerek shekulli janë arritur rezultate të rëndësishme. Të gjitha këto suksese janë të lidhura me fitoren e revolucionit popullor dhe me kujdesin e Partisë për trashëgiminë kulturale të popullit shqiptar. Në këto 25 vjet jete të lirë e plot përpjekje, krahas punës për lulëzimin dhe mbrojtjen e Atdheut, monumentet e kulturës janë vlerësuar si asnjë herë më parë. Janë Partia dhe udhëzimet e mësuesit tonë të dashur, shokut Enver, që na kanë ndihmuar dhe na ndihmojnë të vlerësojmë sa duhet e si duhet këtë thesar të popullit, për popullin. Duke u nisur nga mësimet e marksizëm - leninizmit, Partia e përcaktoi drejt rolin e trashëgimisë kulturale të popullit tonë si një nga burimet kryesore për edukimin e masave të gjera punonjëse dhe e bashkërenditi këtë problem krahas problemeve të tjera të rëndësishme të ndërtimit socialist. Pikërisht kjo bëri që monumentet e kulturës të zënë sot në Shqipërinë socialiste vendin e merituar.

Veprimtarinë në fushën e mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të monumenteve, mund ta ndajmë në dy etapa të rëndësishme:

a) Etapa e parë, që kap periudhën prej vitit 1948 deri në 1965, lidhet me veprimtarinë fillestare, të organizuar në këtë fushë.

b) Etapa e dytë, që fillon pas vitit 1965, lidhet me krijimin e Institutit të monumenteve të kulturës dhe me ngritjen e veprimtarisë në këtë fushë në një nivel më të lartë shkencor.

Organizmat fillestare të etapës së parë kanë qenë sektorë pune e atelje të vogla me personel teknik-shkencor të pakët dhe pa eksperiencë, që zhvilluan veprimtarinë e tyre, në fillim në kuadrin e Institutit të Shkencave dhe pastaj në atë të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Puna e vlefshme e kryer gjatë kësaj periudhe hodhi bazat e një veprimtarie të panjohur më parë në vendin tonë. Në këtë periudhë u vu dorë mbi monumentet e kulturës që kishin mbetur të pambrojtura gjatë regjimeve antipopullore të së kaluarës dhe që çlirimi i atdheut i gjeti në një gjendje të keqe, të dëmtuara nga koha, luftrat shkatërrimtare, grabitësit e huaj, injoranca dhe keqbërësit.

Ashtu si gjithë populli ynë edhe pionierët e kësaj pune, të frymëzuar nga idetë e mëdha të Partisë, ju përveshën punës me dashuri e pasion për të shpëtuar pasuritë kulturale që kishte krijuar gjenia e popullit gjatë shekujve dhe për t'i kthyer ato në mjete të fuqishme të edukimit patriotik e revolucionar të masave. Gjatë kësaj etape u shtruan dhe u zgjidhën me sukses një varg detyrash të rëndësishme, që luajtën një rol vendimtar për fatin e monumenteve të kulturës.

Detyra e parë që u shtrua dhe u zgjidh me sukses, qe *vënia e monumenteve të kulturës nën mbrojtjen e ligjit*. Bazat e kësaj pune u hodhën që në maj të vitit 1944. Akoma në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare, Kongresi i Përmetit anulloi të gjitha koncesionet e huaja dhe bashkë me to edhe koncesionet arkeologjike që kishin misionet italiane dhe franceze në Shqipëri. Me daljen në vitin 1948 të dekretit «Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës...» Partia dhe pushteti popullor i dhanë fund një herë e mirë dëmtimit dhe grabitjes së monumenteve të kulturës. Pas kësaj, ato u vunë nën mbrojtjen e shtetit dhe u shpallën pasuri e përbashkët e popullit. Në mbështetje të

këtij dekreti në vitin 1955 vendimi i Këshillit të Ministrave «Mbi masat për mbrojtjen e monumenteve të kulturës», përcaktoi në mënyrë më të hollësishme parimet e përgjithëshme për shpalljen dhe mbrojtjen e monumenteve të kulturës, caktoi organet përgjegjëse për ruajtjen e restaurimin e tyre dhe dha orientime për shfrytëzimin më të mirë të tyre. Në vitin 1961, me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave Berati e Gjirokastra u shpallën qytete muze ndërsa nëntoka e Durrësit dhe pjesa e vjetër e tij si dhe Pazari i vjetër i Krujës u quajtën qëndra historike që ruajnë vlera të mëdha kulturale me karakter kompleks.

Këto akte të rëndësishme shtetërore formuan bazën ligjore, mbi të cilën mbështetet sot e gjithë puna e jonë për mbrojtjen e monumenteve të kulturës. Edhe pse dekreti dhe vendimet e mësipërme mund të kenë nevojë për plotësime e saktësime, që i ka diktuar jeta dhe praktika e mëvonëshme e ndërtimit socialist të vendit tonë, ato kanë plotësuar në përgjithësi të gjitha kërkesat themelore në këtë fushë.

Njohja, evidentimi i monumenteve të kulturës dhe grumbullimi i materialit dokumentar mbi gjendjen e tyre qe detyra e dytë e rëndësishme e kësaj etape. Ekspedita të shumta me synime të ndryshme përshkuan të katër anët e Atdheut tonë. Ato u njohën me gjendjen e monumenteve dhe grumbulluan një material të pasur dokumentar, në bazë të të cilit u hartua lista e parë e monumenteve, që u vunë nën mbrojtjen e shtetit dhe u përpunuan plane reale për mbrojtjen e tyre, në përputhje me gjendjen dhe nevojat, që ato paraqitnin për ndërhyrje. Këto ekspedita zbuluan gjithashtu një numër të madh monumentesh të panjohura më parë. Mbi bazën e këtyre të dhënave u ngrit sektori i dokumentacionit që u pajis me një material të pasur e të çmueshëm mbi monumentet e vendit tonë. Rilevimet topografike, fiksimet grafike dhe materiali i madh fotografik bashkë me shënimet e raportet formuan kështu fondet e para shkencore për nevojat e studimeve dhe punimeve të ardhshme restauruese.

Krahas këtyre dy detyrave në këtë etapë u zgjidh në mënyrë të kënaqëshme edhe një detyrë e tretë shumë e rëndësishme: ajo e *ndërhyrjes urgjente për të shpëtuar monumentet nga degradimi i tyre i mëtejshëm*. Në bazë të një pune të programuar, ateljetë e qendrës dhe të rretheve morën një varg masash që siguronin kryesisht mënjanimin e degradimit dhe konservimin e monumenteve. Këto masa u vunë në jetë në mënyrë të shkallëzuar, në përputhje me gjendjen konkrete të çdo monumenti.

Në këtë etapë ju kushtua gjithashtu vëmendje e posaçme *pregatitjes së kuadrit*, në mënyrë që ai të fitonte njohuritë e domosdoshme elementare dhe parimet e përgjithshme të punës konservuese e restauruese. Duhet thënë se në këtë drejtim puna u fillua nga hiçi. Në vendin tonë kuadro të tilla nuk ekzistonin më parë. Ato i lindi jeta, nevoja për të përballuar detyrat që shtronte Partia dhe ndërtimi socialist i vendit. Ato u pregatitën kryesisht në vend, duke zbatuar mësimin e Partisë: *«Të mësojmë duke punuar dhe të punojmë duke mësuar»*, duke kombinuar drejt punën për mbrojtjen e monumenteve me pregatitjen ideologjike, teorike dhe tekniko-profesionale.

Nuk munguan gjatë kësaj periudhe dhe përpjekjet për të bërë hapat e para drejt punës konservuese e restauruese. Por për faktin që ajo kërkonte një pregatitje më të kualifikuar të kuadrit me njohuri të thella shkencore për epokat e ndryshme historike, puna nuk mundi të zhvillohej në këtë drejtim veçse brenda caqeve të kufizuara. Monumentet në të cilat u ndërhy në këtë drejtim gjatë kësaj periudhe qenë të pakta. Në përgjithësi mund të themi se e gjithë puna e kryer në këtë etapë në dobi të mbrojtjes të konservimit dhe restaurimit të monumenteve është zhvilluar më tepër mbi bazën e njohurive të përgjithëshme, shpesh empirike, se sa në njohjen konkrete e të thellë shkencore të problemeve që janë paraqitur. Vetëm kështu mund të shpjegohet që, krahas punimeve të mira që kemi bërë në monumente të veçanta si në Portën e Ludnit në Butrint, në kishën e Shën Kollit në Voskopojë, apo në xhaminë e Beqarit në Berat, ka pasur edhe punime të cilat lanë për të dëshiruar. Shembuj negativë në këtë drejtim kanë qenë disa punime të kryera në kalanë e Durrësit, në kalanë e Elbasanit, në qytetet muze, në mbrojtjen e pikturës murale etj.

Ishte kujdesi i pandërprerë i Partisë, që na ndriçoi rrugën tonë gjatë kësaj etape. Vendimi i K.Q. i vitit 1959 *«Mbi traditat patriotike e revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm»* përcaktoi parimet themelore të punës sonë dhe u bë baza e saj orientuese dhe programatike. Ky vendim vinte në dukje rëndësinë e *«zbulimit dhe studimit, mbrojtjes dhe popullarizimit të monumenteve historike dhe kulturalo-artistike, për edukimin dhe ndriçimin më të thellë të historisë së vendit tonë»*, duke i përcaktuar këto si detyra të larta patriotike. Ai përcaktoi gjithashtu problemet kyçe në fushën e mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të monumenteve, duke theksuar lidhur me këtë, nevojën e zhvillimit të punës kërkimore shkencore, si bazë e domosdoshme për punën konservuese e restauruese.

Zgjidhja dhe vënja në jetë e gjithë këtyre detyrave që shtronte Partia, kërkonte të gjendeshin rrugë dhe forma të reja organizimi për mbarëvajtjen e punës. Përpjekjet që ishin bërë deri atëhere në Grupin e Kulturës Materiale dhe në ateljetë e shkëputura në rrethe nuk kishin dhënë rezultate të kënaqshme. Për këtë arësye u vendos krijimi i një institucioni të ve-

BOTIMOR

çantë, të cilit do t'i besohej kjo punë. Kështu në vitin 1965 lindi Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe me krijimin e tij filloi një etapë e re – etapa e dytë në historinë e përpjekjeve për të ngritur në këmbë dhe çuar përpara punën për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës në Shqipëri.

Problemet, detyrat dhe kërkesat që ju vunë përpara institutit të ri, qenë shumë më komplekse dhe më të gjera. Të gjitha problemet e etapës së parë kërkonin zhvillimin dhe thellimin e tyre të mëtejshëm. Nuk mbaronte me kaq as detyra e dokumentimit të monumenteve dhe as ajo e konservimit dhe restaurimit të tyre. Instituti do të vazhdonte ta çonte përpara këtë punë, duke e ngritur në një nivel më të lartë shkencor. Ai do të pasuronte arkivin e dokumentacionit, në mënyrë që të krijonte një bazë të shëndoshë shkencore për punën konservuese e restauruese dhe të përsoste metodën e punës në këto drejtime. Por mbi të gjitha, Institutit i duhej të kalonte përfundimisht e pa lëkundje në një punë të vërtetë konservuese e restauruese të mbështetur mbi baza shkencore. Hapat e para, që ishin bërë, treguan se ishte e nevojshme të krijohej një bazë e shëndoshë teorike mbi të cilën do të mbështetej kjo veprimtari; ishte e nevojshme të studiohej në themel pasuria kulturale e trashëguar dhe vetëm pas kësaj të vihej dorë mbi të. Nga e kaluara nuk trashëgonim asgjë të vlefshme në këtë drejtim. Studimet e të huajve për monumentet tona ishin të përcipta, të njëanshme dhe përshkoheshin në shumicën e rasteve nga një frymë tendencioze, që nuk ngjallte besim, prandaj nuk mund të shërbenin si mbështetje serioze. Ishte detyrë, pra, e punonjësve tanë shkencorë që, të armatosur me metodologjinë marksiste - leniniste dhe me një njohje të thellë të materialit konkret, t'u jepnin përgjigjen e duhur shkencore problemeve që do të shtronte praktika e punës konservuese e restauruese. Në kushtet kur kuadri ishte rritur e kualifikuar në punë e sipër, Instituti i vuri vetes si detyrë të zhvillojë një punë të dëndur kërkimore, jo si qëllim në vetëvete, por si pjesë e domosdoshme organike e punës për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e monumenteve.

Në sajë të një pune të mbështetur në kritere të drejta shkencore, në vitin 1966 u shënua një hap i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të punës restauruese. Që prej kësaj kohe, punimet në çdo objekt u paraprinë nga studimi i objektit dhe nga hartimi i projektit të tij. Sigurisht, në fillim këto projekte nuk mund të pasqyronin të gjitha kërkesat e nevojshme, kryesisht për mungesë eksperience, por me kalimin e kohës ato erdhën duke u përmirësuar dhe duke u bërë më të plota. Projektet ishin rezultat i vrojtimeve të kujdesshme të monumentit dhe fryt i njohjes së gjerë, jo vetëm të një monumenti të shkëputur, por edhe i monumenteve të tjerë, fryt i një përgjithësimi shkencor. Kjo bëri të mundur që të ngrihej cilësia e punimeve dhe të kalohej në restaurime të vërteta, siç është rasti në Nymfeun e Apollonisë, Vendvarrimin e Skënderbeut, kishën e Marmiroit, shtëpinë e Zekateve në Gjirokastër etj. Të gjitha këto krijuan kushtet për të kaluar në punime më të ndërlikuara dhe komplekse, siç janë konservimi dhe restaurimi i ansambleve historike e arkitektonike. Hapat e para në këtë drejtim u bënë në qytetin muze të Beratit, në lagjen Kala. Pas një studimi të hollësishëm, u arrit t'i jepet këtij ansambli me vlerë të madhe për larminë e monumenteve të tij një pamje e tillë, e cila bën të ndjehet ndërhyrja shkencore e restauratorit.

Këto punime treguan se ishte fituar një eksperiencë e mirë që lejonte zgjidhjen e detyrave të vështira nga ana tekniko-profesionale. Kjo praktikë u vazhdua në pazarin e Krujës si dhe në pazarin dhe në kalanë e Gjirokastrës. Si rezultat i tyre në Krujë u rimëkëmb një ambient i vjetër, kurse në Gjirokastër dolën më në pah vlerat e dy kompleksëve të mëdha arkitektonike të këtij qyteti muze: pazarit ju vlerësua pamja e dikurshme, kurse në kala dolën në dritë një sërë ambientesh të rëndësishme, që nuk njiheshin dhe që, pas punimeve konservuese, do të kthehen në salla ekspozimi.

Punime të rëndësishme u kryen edhe në një varg qendrash antike. Vlejnë të përmenden punimet me karakter konservues e restaurues në muret rrethuese të Lisit dhe Zgërdheshit, si dhe në Nymfeun e Apollonisë e në Bradashesh. Si rezultat i punës së kujdesshme dhe bashkëpunimit të ngushtë e të frytshëm midis restauratorëve dhe arkeologëve në këto objekte, u arrit që pjesë të tyre të rimëkëmben në atë masë, që e lejonin të dhënat konkrete shkencore dhe u ndriçuan kështu mjaft aspekte të rëndësishme arkeologjike dhe arkitektonike.

Eksperienca e këtyre viteve të fundit ka treguar se në të ardhmen duhet të zhvillohen punime konservuese e restauruese me karakter kompleks si në qendrat antike ashtu dhe ato mesjetare, duke ndërhyrë në front të gjerë, me qëllim që të arrihet një vlerësim dhe perceptim sa më i plotë i kompleksit, i monumenteve të veçanta dhe i ambientit që i rrethon.

Vitet e fundit, Instituti ka grumbulluar të dhëna të shumta për të marrë nën mbrojtje objekte të reja me rëndësi. Ai ka përfshirë në sferën e veprimtarisë së vet një numër gjithmonë më të madhe monumentesh historike dhe ka zgjeruar punimet në to. Për të ruajtur dhe zhvilluar traditat revolucionare të popullit tonë, në mënyrë të veçantë ato të Luftës nacional çlirimtare, Instituti ka kryer një sërë punimesh në monumente që lidhen me këtë periudhë të lavdishme të histo-

BOTIMOR

risë së popullit tonë. Të tilla janë punimet në shtëpinë muze ku u themelua Partia Komuniste Shqiptare, në shtëpinë muze të Rinisë Komuniste Shqiptare, në shtëpinë muze të Labinotit, në sallën ku u mblodh Kongresi i Përmetit, në selinë e Qeverisë Demokratike në Berat, në shtëpinë ku u mbajt Kongresi i Lushnjës, etj.

Nën kujdesin e Partisë dhe të pushtetit popullor, vëllimi i punimeve është rritur me ritme të mëdha e të shpejta, sidomos që nga krijimi i Institutit. Për t'u bindur, mjafton të përmendim se vetëm brënda vitit 1968 është bërë një vëllim pune katër herë më i madh se sa gjatë dhjetëvjeçarit 1950-1960. Është rritur gjithashtu në mënyrë të konsiderueshme kuadri, pajisjet dhe cilësia e punimeve.

— II —

Duke bërë bilançin e punës sonë gjatë këtyre viteve, që janë një periudhë shkurtër për jetën e një instituti, vërejmë me kënaqësi një radhë ndryshimesh sasiore dhe cilësore që na japin mundësi për ta çuar më përpara punën tonë. Të ndihmuar nga fjalimet e shokut Enver dhe dokumentat e Partisë ne kemi synuar dhe do të synojmë, që të ndryshojmë konceptet e dikurshme mbi punën në lëmin e mbrojtjes së monumenteve të kulturës.

Në të arthmen Instituti do ta dëndësojë veprimtarinë e tij kërkimore. Është e qartë se pa një bazë teorike nuk mund të zhvillohet një praktikë e shëndoshë konservuese e restauruese dhe të realizohen detyrat e ruajtjes dhe vlerësimit të pasurive kulturale. Veprimtaria e Institutit në lëmin e konservimit, restaurimit dhe vlerësimit të mëtejshëm të monumenteve të kulturës do të shërbejë edhe për ndriçimin e shumë problemeve të historisë së popullit tonë në përgjithësi dhe të historisë së kulturës materiale në veçanti. Në këtë drejtim Instituti do të japë një kontribut të çmueshëm, sidomos në studimin e historisë së arkitekturës shqiptare.

Objektivat kryesore të veprimtarisë konservuese-restauruese të Institutit do të jenë:

a) Në monumentet antike punimet do të kenë si drejtim kryesor qytetet ilire, me synimin që disa prej tyre të kthehen në qendra të tilla të vizitueshme, që nga paraqitja të mund të qëndrojnë denjësisht krahas qendrave të njohura antike të vendit tonë: Dyrrahut, Apollonisë e Butrintit, dhe ku studjuesi dhe vizitori të krijojë një ide sa të jetë e mundur më të qartë për qytetin dhe jetën qytetare ilire. Të tilla qendra të rëndësishme Instituti ka zgjedhur Zgërdheshin, Lisin e Persqopin. Punimet e kryera vitet e fundit në këto qendra përfaqësojnë vetëm hapat e para në këtë drejtim. Instituti do të shtrijë punimet edhe në qendra të tjera ilire dhe në radhë të parë në Amantia e Antigonea dhe do t'u kushtojë gjithë vëmendjen e duhur qendrave klasike duke vazhduar punimet në amfiteatrin e Durrësit, në nymfeun e Apollonisë dhe në monumentet e Butrintit.

b) Do të dëndësohen punimet në monumentet mesjetare duke u nisur, në radhë të parë, nga roli që kanë luajtur ato në historinë e popullit tonë. Do t'u jepet prioritet ndërtimeve mbrojtëse të periudhës së principatave feudale shqiptare, atyre që lidhen me luftën e lavdishme të popullit tonë kundër pushtuesve turq nën udhëheqjen e Skënderbeut dhe ndërtimeve të kohës së pashallëqeve të pavarura shqiptare. Do të vazhdojnë punimet në kalatë e rëndësishme të Gjirokastrës dhe të Beratit, me perspektivën për t'i kthyer ato në qendra të vizitueshme muzeale. Do të ndërmerren gjithashtu punime komplekse edhe në kala të tjera mesjetare. Kalaja e Krujës dhe e Shkodrës, në të ardhmen, do të vihen në një radhë me kalanë e Gjirokastrës dhe të Beratit. Punime në shkallë të gjerë do të ndërmerren edhe në kalatë e Ali Pashës në Tepelenë e Butrint. Midis monumenteve të shumta mesjetare të kultit, Instituti do t'u japë preferencë atyre që paraqesin vlera më të mëdha historiko — arkitektonike dhe atyre që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente.

c) Qytetet muze të Gjirokastrës dhe Beratit janë sot qendrat më të rëndësishme, ku zhvillimi i qytetit mesjetar shqiptar dhe i arkitekturës së mesjetës të vonë na paraqiten në mënyrën më të plotë. Për këtë arësye ato kanë qenë dhe do të mbeten në qendër të vëmendjes së Institutit.

Duke qenë se këto dy qytete ruajnë në tërësinë e tyre më mirë se çdo qendër tjetër pamjen e dikurshme, Instituti do të kujdeset për konservimin dhe restaurimin e tyre sa më autentik. Por ndryshe nga qendrat e tjera, këtu problemi paraqitet më i nderlikuar. Së pari, kemi të bëjmë me komplekse të rëndësishme urbane në të cilat numri i monumenteve në mbrojtje është më i madh se në çdo rast tjetër, së dyti këto qytete vazhdojnë të jetojnë dhe të zhvillohen në përputhje me kushtet e reja të realitetit socialist. Kërkesa e banorëve, që jetojnë dhe punojnë në këto qendra urbane, për të gëzuar komoditetet e kohës është e drejtë dhe merr një rëndësi të veçantë për trajtimin e këtij problemi. Në këto rrethana për mbrojtjen dhe konservimin e qendrave historike rol vendimtar luan adaptimi dhe shfrytëzimi i monumenteve të tyre në përputhje me dinamikën e jetës, pa cënuar vlerat historike dhe kulturalo-artistike që këto monumente kanë. Instituti gjithashtu duhet të orientojë dhe të ndjekë çdo ndërhyrje në këto qendra në mënyrë që ndërtimet e reja të mos errësojnë vlerat e lagjeve muze, ansambleve dhe monumenteve dhe të kontribuojë njëko-

DOWNLOADED

hësisht në zgjidhjen e disa problemeve të karakterit utilitar që i kërkon jeta.

Përvoja ka treguar se rezultatet më të mira janë arritur në ato raste kur ndërhyrja ka qenë frontale në një kompleks urban apo ansambël arkitektonik. Restaurimi i plotë do të shtrihet në të ardhmen në shkallë lagjeje siç është vepruar në lagjen Kala në Berat. Vetëm kështu puna e jonë do të japë rezultate të dukshme. Disa ndër punimet e kryera në fasadat e ansambleve arkitektonike nuk hyjnë në kategorinë e punimeve konservuese, por kanë vetëm karakter të përkohshëm për t'i u përgjegjur nevojave urgjente lidhur me pamjen e jashtme të këtyre qyteteve, prandaj, ato në të ardhmen nuk do të përbëjnë një objekt pune për Institutin tonë.

Duke u nisur nga përvoja e deritanishme në lidhje me punimet në qytetet-muze, kemi arritur në përfundimin se me ritmet me të cilat punojmë, kur akoma ka monumente që rrezikohen, do të duhet një kohë e gjatë për të arritur që vlerat e këtyre qyteteve të jenë në gjendje të kënaqshme. Prandaj ky ritëm duhet shpejtuar.

Krahas punimeve në qytetet — muze, do të kryhen edhe punime në monumentet e veçanta të arkitekturës qytetare në Tiranë, Korçë, Shkodër, etj.

d) Instituti nuk ka dalë ende nga gjendja e prapambetur në lidhje me studimin dhe mbrojtjen e arkitekturës fshatare. Dihet se ky problem është preokupues dhe urgjent, aq më tepër se transformimi socialist i fshatit po e zhduk këtë trashëgimi me ritme të shpejta, pa lënë gjurmë. Në këtë drejtim do t'i kushtohet një vemendje e veçantë evidentimit, grumbullimit të dokumentacionit shkencor dhe vënjes nën mbrojtje të ndërtimeve më me vlerë të kësaj gjinie, në mënyrë që në të ardhmen me ekzemplarët më tipikë e më karakteristikë të ngrihet, në bazë të vendimit të KQ të PPSH «Mbi traditat», *Muzeu në Natyrë*.

e) Në kuadrin e veprimtarisë sonë do të zërë një vend me rëndësi puna konservuese e restauruese në monumentet me karakter historik, të cilët, në shumicën e rasteve, nuk shquhen për vlerën e tyre arkitektonike, por për rëndësinë e ngjarjeve historike që përfaqësojnë. Në këtë gjini monumentesh, puna e jonë më e ngutshme është vënja nën mbrojtjen e shtetit dhe konservimi i të gjithë atyre vendeve apo ndërtimeve që janë të lidhura me ngjarje dhe figura të një rëndësie kombëtare. Vemendje e veçantë do t'u kushtohet monumenteve apo vendeve historike të periudhës më të ndritur të historisë sonë, Luftës nacional çlirimtare. Për monumentet e kësaj gjinie duhet që në të ardhmen të përsosen më tej kriteret e ndërhyrjes konservuese e restauruese.

Për kryerjen e këtyre detyrave Instituti do të mbështetet kryesisht në forcat e veta duke bashkëpunuar njëkohësisht me institucionet e afërta. Problematika e Institutit është e tillë që nuk mund të zgjidhet në mënyrë të plotë e të gjithanëshme, në rast se puna jonë shkencore nuk masivizohet gjerësisht. Thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kultural shtron para nesh detyra të mëdha. Kudo është përshëndetur dhe përkrahur inisiativa e arësimtarëve të Mirditës e të Kolonjës, për ta çuar përpara zhvillimin kultural të fshatit, inisiativë që u vlerësua edhe në raportin e mbajtur nga shoku Enver në Kongresin V të PPSH. Një inisiativë e tillë e vetdijshme dhe e përhershme është njëkohësisht një kontribut i çmuar dhe në lëmin e njohjes, popullarizimit dhe mbrojtjes së monumenteve të kulturës. Instituti ynë në këtë drejtim ka bërë dhe po bën përpjekje për të aktivizuar në fushën e monumenteve të kulturës një numur sa më të madh bashkëpuntorësh të jashtëm, rrjeti i të cilve, ndonëse sot është i kufizuar, po rritet dita-ditës. Zgjerimi i numurit të bashkëpuntorëve të jashtëm do të ndihmojë për realizimin e detyrave në të ardhmen.

Që monumenti të luajë një rol edukimi aktiv, të ngjallë admirim për paraardhësit tanë liridashës e të talentuar, të ngjallë krenarinë kombëtare dhe t'i shërbejë edukimit patriotik, revolucionar dhe estetik të popullit, është e nevojshme që të njihet mirë nga shtresat e gjera të popullit. Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet botimeve shkencore, artikujve me karakter studimi e publiçistik, foto-ekspozitave, albumeve, etj. Duhet të pranojmë se në këtë drejtim deri më sot kemi bërë fare pak. Materialet e botuara janë të kufizuara në krahasim me punën e madhe kërkimore që ka zhvilluar Instituti dhe nuk plotësojnë boshllëkun e ndijshëm në këtë fushë. Duke ndjerë këtë përgjegjësi, Instituti është mobilizuar me të gjitha forcat që të kapërcejë këtë gjendje. Botimi i vëllimeve të para që përmbajnë rezultatet e punës shkencore të viteve të fundit, ka për qëllim të plotësojë këtë detyrë të rëndësishme ndaj vendit dhe popullit tonë.

Detyrat që shtrojmë janë plotësisht të realizueshme dhe kemi të gjitha mundësitë për t'i përballuar ato me sukses. Ndihma dhe kujdesi i Partisë dhe patriotizmi i punonjësve tanë, të brumosur me idetë dhe mësimet e shokut Enver, janë faktorët vendimtarë mbi të cilët do të mbështetemi vazhdimisht edhe në të ardhshmen.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gani STRAZIMIRI

RESULTATS ET PERSPECTIVES DU TRAVAIL DE RECHERCHE ET DU RESTAURATION.

Dans le domaine de l'étude, de la restauration et de la popularisation de nos monuments, comme dans tous les domaines de la vie de notre peuple, ce dernier quart de siècle a été marqué par des succès considérables. Ces succès se rattachent tous à la victoire de la révolution populaire et à la sollicitude du Parti pour l'héritage culturel du peuple albanais. Au cours de ces 25 années de vie libre, caractérisées par un labeur intense et des efforts constants, notre peuple, en même temps qu'il oeuvrait pour l'épanouissement et la défense de la patrie, a vu accorder à ses monuments culturels une importance qui ne leur avait jamais été reconnue jusqu'alors. C'est le Parti et les directives de notre éducateur bien-aimé, le camarade Enver Hoxha, qui nous ont aidés à valoriser autant qu'il convient, et comme il convient, ce trésor du peuple, pour le peuple. Partant des enseignements du marxisme-léninisme, le Parti a défini correctement le rôle du patrimoine culturel de notre peuple en tant qu'une des principales sources auxquelles devrait s'abreuver l'éducation des larges masses laborieuses, et il a coordonné ce problème avec les autres problèmes importants de l'édification socialiste. C'est grâce à son action que les monuments culturels se sont vu reconnaître aujourd'hui dans l'Albanie socialiste l'importance qu'ils méritent.

Dans le domaine de la protection, de la conservation et de la restauration des monuments, notre activité peut se diviser en deux étapes principales:

a) La première, qui embrasse la période allant de 1948 à 1965, se rattache à l'organisation initiale des services de protection et de restauration des monuments culturels dans notre pays.

b) La seconde étape, qui commence en 1965, est marquée par la création de l'Institut des Monuments Culturels et la promotion de ce travail à un stade plus élevé.

Les organismes initiaux de la première étape consistaient en des secteurs de travail et des ateliers, dotés d'un personnel technico-scientifique restreint et inexpérimenté. Ces organismes, au début, déployèrent leur activité dans le cadre de l'Institut des Sciences puis de l'Université d'Etat de Tirana. Ils accomplirent au cours de cette période un travail appréciable qui a jeté les fondements d'une activité jusqu'alors inconnue dans notre pays. Ils prirent en charge les monuments culturels, qui n'avaient pas connu la moindre protection sous les régimes antipopulaires du passé, et que la libération de la Patrie avait trouvés dans un état lamentable, endommagés par le temps, les guerres dévastatrices, et aussi par l'incurie due à l'ignorance et le mauvais usage d'éléments malfaisants.

De même que notre peuple tout entier, les pionniers de ce travail, inspirés par les grandes idées du Parti, se mirent à la tâche avec ferveur pour sauver ce patrimoine culturel créé par le génie de notre peuple à travers les âges et pour en faire un puissant moyen d'éducation patriotique et révolutionnaire des masses. C'est alors que furent posées toute

DO NOT COPY

une série d'importantes tâches dont l'heureuse réalisation joua un rôle déterminant pour le sort des monuments culturels dans notre pays.

La première tâche fixée et menée à bien fut la mise des monuments culturels sous la protection de la loi. Les fondements de ce travail avaient été jetés dès le mois de mai 1944. Encore dans le feu de la Lutte de Libération Nationale, le Congrès de Përmet avait annulé, en même temps que toutes les concessions étrangères dans notre pays, les concessions archéologiques accordées aux missions italienne et française en Albanie. Par le décret de 1948 «Sur la protection des monuments culturels...» le Parti et le Pouvoir Populaire ont une fois pour toutes mis fin à la dégradation et au pillage de nos monuments. Par la suite, ceux-ci furent placés sous la protection de l'Etat et proclamés patrimoine commun du peuple tout entier. Ce décret fut suivi, en 1955, d'une décision du Conseil des ministres «Sur les mesures visant à protéger les monuments culturels», qui définissait plus profondément les principes généraux devant présider à la détermination de ces monuments et à leur protection, désignait les organismes responsables de leur conservation et de leur restauration, et donnait des directives pour leur mise en valeur optimale. En 1961, par décision spéciale du Conseil des ministres, Berat et Gjirokastër, le sous-sol de Durrës et l'antique partie de cette ville ainsi que le vieux marché de Kruje, furent proclamés villes-musées, en tant que centres historiques qui contiennent de précieux vestiges culturels.

Ces importants actes administratifs constituèrent les fondements légaux sur lesquels s'appuie aujourd'hui encore tout notre travail de protection des monuments. Ces actes pourront, certes, être complétés ou précisés par des mesures dictées par la vie et la pratique ultérieure de l'édification socialiste du pays, mais ils n'en ont pas moins déjà satisfait, en général, à toutes les exigences essentielles de ce secteur.

La seconde tâche importante de cette étape consistait dans l'étude et l'inventaire des monuments culturels ainsi que dans le rassemblement des matériaux documentaires sur leur état. De nombreuses missions ayant des objectifs divers parcoururent le pays en tous sens et prirent connaissance de l'état des monuments. Elles recueillirent de riches matériaux, sur la base desquels il a été passible de dresser la première liste de monuments placés sous la protection de l'Etat, et d'élaborer des plans concrets pour leur défense, en fonction de leur état et des besoins d'intervention qu'ils présentent. Ces missions ont également découvert un grand nombre de nouveaux monuments auparavant inconnus, et enrichi ainsi nos connaissances de nouvelles données scientifiques. Sur la base des matériaux rassemblés, fut mis sur pied notre secteur de documentation, qui a amplifié ce travail. Les relevés topographiques, la documentation graphique et l'abondant matériel photographique, en même temps que les notes et les rapports de nos collaborateurs, constituèrent ainsi les premiers fonds scientifiques appelés à satisfaire aux besoins des études et des travaux de restauration future.

De pair avec ces deux tâches, il en a également été mené à bien, au cours de cette étape, une troisième, très importante, celle qui consistait à intervenir d'urgence pour sauver nos monuments d'une dégradation ultérieure. Grâce à un travail programmé, nos ateliers ont mis en oeuvre une série de mesures pour assurer la survie de nos monuments. Ces mesures furent appliquées de façon échelonnée, conformément à l'état effectif de chaque monument.

Une attention particulière a également été consacrée, durant cette étape, à la formation des cadres, de manière qu'ils acquièrent les connaissances élémentaires indispensables et assimilent les principes généraux du travail de conservation et de restauration. Il n'existait pas de tels cadres dans notre pays. C'est la vie même, le besoin de faire face aux tâches qu'assignaient le Parti et l'édification socialiste du pays, qui les ont engendrés. Leur formation a été principalement assurée dans le pays même, en appliquant le précepte du Parti: «Joignons le travail à l'étude, et l'étude au travail!» et en alliant judicieusement le travail effectif de protection des monuments à la formation idéologique, théorique et technique – professionnelle.

Des efforts n'ont pas manqué d'être également faits au cours de cette période pour accomplir les premiers pas en matière de restauration. Toutefois, du fait que ce travail re-

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
Nr INV. 4595

DO NOT COPY

quérait une formation plus qualifiée des cadres, et des connaissances scientifiques plus approfondies sur les diverses époques historiques, cette activité a été nécessairement limitée. Les monuments sur lesquels on intervint alors dans cet esprit furent peu nombreux. Dans l'ensemble, l'on peut afirmer que tout le travail accompli au cours de cette étape pour la protection et la conservation des monuments, a été mené plutôt sur la base de notions générales, souvent empiriques, que d'une connaissance scientifique, concrète et approfondie, des problèmes qui se posaient.

C'est le Parti, avec sa sollicitude constante, qui a éclairé notre voie au cours de cette étape. La décision du CC de 1959 «Sur les traditions patriotiques et révolutionnaires de notre peuple et les mesures à prendre pour mieux les connaître et les développer», définit les principes fondamentaux de notre travail et lui servit d'orientation et de programme. Cette décision faisait ressortir l'importance «de la découverte, de l'étude, de la protection et de la popularisation des monuments historiques et culturels-artistiques, pour l'éducation de notre peuple et une plus parfaite illustration de l'histoire de notre pays», les définissant comme de hauts devoirs patriotiques. Elle fixa les problèmes-clés qui se posaient dans le domaine de la protection, de la conservation et de la restauration des monuments et mit l'accent sur la nécessité de développer le travail de recherche en tant que base du travail de restauration.

La réalisation de toutes ces tâches posées par le Parti, exigeait à l'époque que fussent définies des voies et des formes d'organisation nouvelles, qui assurent la bonne marche du travail. Les efforts qui avaient été faits jusque-là par le Groupe de la culture matérielle et par des ateliers en province, n'avaient pas donné de résultats satisfaisants. Il fut jugé nécessaire de créer un organisme particulier auquel ce travail serait confié. Et c'est ainsi que, en 1965, l'Institut des Monuments Culturels vit le jour. Sa création marque le début d'une nouvelle étape dans l'histoire des efforts pour mettre sur pied et promouvoir le travail de protection et de restauration des monuments culturels en Albanie.

Les problèmes, les tâches et les exigences qui furent posées au jeune Institut, étaient très vastes et complexes. Tous les problèmes de la première étape demandaient à être ultérieurement développés et approfondis. Le travail visant à rassembler une documentation sur les monuments et celui de conservation et de restauration devaient être poussés plus avant. L'Institut était appelé à faire progresser ce travail, en le portant à un stade supérieur. Il devait enrichir les archives de la documentation, de manière à créer une base scientifique solide pour le travail de conservation et de restauration, et perfectionner les méthodes de travail dans ces directions. Mais avant tout, l'Institut devait passer définitivement et sans hésitation à un véritable travail de restauration, fondé sur des bases scientifiques. Les premiers pas accomplis avaient indiqué qu'il était préalablement nécessaire d'établir une solide base théorique sur laquelle appuyer ce travail, qu'il était nécessaire d'étudier à fond le patrimoine culturel qui nous a été légué, avant d'y porter la main. En ce domaine, le passé ne nous offrait absolument rien qui méritat d'être noté. Les études sur nos monuments faites par certains étrangers étaient superficielles, unilatérales et, en tant que telles, généralement pénétrées d'un esprit souvent tendancieux, qui inspirait la défiance. On ne pouvait sérieusement s'y appuyer. Notre Institut, armé de la méthodologie marxiste-léniniste et d'une connaissance approfondie des matériaux concrets, avait donc pour premier devoir de donner une réponse scientifique satisfaisante aux problèmes que poserait le travail de conservation et de restauration. Les cadres ayant maintenant grandi et s'étant qualifiés au travail, l'Institut se fixa pour tâche de mener un intense travail de recherche, non pas en tant que but en soi, mais comme partie organique indispensable de notre activité de protection et de restauration des monuments.

Le travail était maintenant guidé par de justes critères scientifiques et l'année 1966 marqua un pas important en avant dans le travail de restauration. Depuis lors, les travaux sur chaque objet ont été précédés d'une étude de l'objet et de la mise au point d'un projet, consécutif à cette étude. Certes, au début, ces projets ne pouvaient traduire toutes les exigences, principalement par suite du défaut d'expérience, mais ils ne cessèrent de s'amélio-

DO NOT COPY

rer et de se compléter. Ils étaient le résultat d'une observation attentive du monument et le fruit d'une connaissance plus vaste non seulement d'un monument donné, mais aussi d'autres monuments analogues, le fruit d'une synthèse scientifique. Cela permit d'élever la qualité du travail et d'entreprendre des restaurations véritables, notamment pour la Nymphée d'Apollonie, le tombeau de Skanderbeg, l'église de Marmiro, la maison des Zeka à Gjirokastër, etc. Il était possible maintenant d'entreprendre des travaux plus vastes et plus complexes. C'est ainsi qu'on s'attaqua à la conservation et à la restauration d'ensembles historiques et architecturaux. Les premières pas dans ce sens a été inaugurée dans la ville-musée de Berat, dans le quartier de la «Kala», où, à la suite d'une étude minutieuse, on a réussi à donner à cet ensemble, remarquable par la variété des monuments qu'il comporte, un aspect où l'on devine l'intervention du restaurateur.

Ces travaux ont montré qu'une expérience satisfaisante avait été acquise en ce domaine et qu'elle permettait de mener à bien des tâches assez ardues sur le plan technique et professionnel. Ainsi donc cette pratique a été poursuivie au marché de Kruje, ainsi qu'au marché et à la citadelle de Gjirokastër. A Kruje, on a réussi à mieux mettre en évidence les éléments les plus intéressants des deux grands ensembles architecturaux de cette ville-musée; on a rendu au marché son aspect d'antan et on a découvert dans la citadelle plusieurs pièces importantes jusque-là inconnues, qui, à l'issue des travaux de conservation, seront transformées en salles d'exposition.

D'importants travaux ont également été effectués dans plusieurs centres antiques de notre pays. Il convient de citer ceux menés sur les murs d'enceinte de Lis et de Zgërdhesh, ainsi qu'au Nymphée d'Apollonie et à Bradashesh. Grâce au soin et à la collaboration étroite et féconde des archéologues et des restaurateurs, on a remis en état certaines parties de ces ouvrages dans la mesure où l'autorisaient les données concrètes, ce qui a permis d'éclairer maints importants aspects archéologiques et architecturaux.

L'expérience de ces dernières années a montré qu'à l'avenir des travaux complexes de conservation et de restauration devront être menés dans les centres antiques ainsi que médiévaux, en intervenant sur un vaste front, de manière à donner une idée aussi juste et complète de l'ensemble et de chaque monument distinct, et ce en relation étroite avec l'environnement.

Ces dernières années, l'Institut a rassemblé des données qui lui ont permis de prendre sous sa protection quelque 250 nouveaux objets importants. Il a englobé dans ses activités un nombre toujours croissant de monuments historiques et élargi les travaux qui y sont menés.

Afin de préserver et de développer les traditions révolutionnaires de notre peuple et en particulier celles de la Lutte de Libération Nationale, cet Institut a conduit une série de travaux sur les monuments qui se rattachent à cette glorieuse période de l'histoire de notre peuple. Tels sont ceux effectués dans les maisons-musées où furent respectivement fondés le Parti Communiste Albanais et la Jeunesse Communiste Albanaise, dans la maison où s'est tenue la Conférence de Labinot, dans la salle du Congrès de Përmet, dans la construction qui servit de siège au Gouvernement Provisoire à Berat, dans celle où s'est tenu le Congrès de Lushnjë, etc.

Grâce à l'appui du Parti et du Pouvoir populaire, le volume de nos travaux s'est accru à des rythmes exceptionnels, principalement depuis la création de notre Institut. Il n'est, pour s'en convaincre, que de rappeler certains chiffres. C'est ainsi que, par exemple, rien qu'en 1968, le volume du travail accompli a été quatre fois plus considérable que celui effectué au cours de la décennie 1950-1960. En particulier, le nombre des cadres, les équipements et la qualité des travaux se sont considérablement accrus.

II

Faisant le bilan de la courte période que constituent ces quelques années pour la vie d'un Institut, nous relevons avec satisfaction dans notre travail une série de transforma-

DO NOT COPY

tions quantitatives et qualitatives, qui nous permettront d'aller encore de l'avant. Nous inspirant des discours du camarade Enver Hoxha et des documents du Parti, nous nous sommes attachés à rénover les anciennes conceptions qui avaient cours en ce domaine et nous poursuivrons notre effort dans ce sens.

A l'avenir, notre Institut intensifiera son travail de recherche scientifique. Il est évident que faute d'une base théorique, on ne saurait envisager une solide pratique de conservation et de restauration, ni mener à bien les tâches qu'impliquent la sauvegarde et la mise en valeur des richesses culturelles. L'activité de notre Institut dans le domaine de la conservation, de la restauration et de la mise en valeur des monuments culturels servira également à élucider de nombreux problèmes de l'histoire de notre peuple en général et de celle de sa culture matérielle en particulier. Dans cet ordre d'idées, notre Institut apportera une contribution précieuse notamment à l'étude de l'histoire de l'architecture albanaise.

Les principaux objectifs de l'activité conservatrice et restauratrice future de notre Institut seront donc les suivants:

a) En ce qui concerne les monuments antiques, nos travaux porteront avant tout sur les cités illyriennes, afin d'en faire des sites archéologiques, qui, au même titre que les grands centres antiques, tels que Dyrrah, Apollonie et Butrint, donnent aux visiteurs une idée aussi claire que possible de la cité et de la vie citadine illyrienne. L'Institut a choisi comme principaux centres illyriens Zgërdhesh, Lis et Persqop. Les travaux menés ces dernières années dans ces centres ne représentent que des premiers pas en ce domaine. L'Institut étendra également ses travaux à d'autres centres illyriens et en premier lieu à Amantia et Antigona. Il accordera toute l'attention requise aux centres classiques et poursuivra notamment les travaux à l'amphithéâtre de Durrës, au nymphée d'Apollonie et aux monuments de Butrint.

b) Les travaux à mener sur les monuments du Moyen Age seront intensifiés, avant tout en fonction du rôle que ceux-ci ont joué dans l'histoire de notre peuple. La priorité sera accordée aux constructions défensives de la période des principautés féodales albanaises, à celles qui se rattachent à la glorieuse lutte que notre peuple, conduit par Skanderbeg, mena contre l'envahisseur ottoman, ainsi qu'aux constructions de l'époque des pachaliks indépendants albanais. Le plus grand soin sera consacré aux importantes citadelles de Gjirokastër et de Berat, avec la perspective d'en faire des centres présentant pour les visiteurs l'intérêt de véritables musées. Des travaux seront également entrepris sur d'autres citadelles médiévales, à Durrës, Elbasan et Kanine, ainsi que sur les citadelles d'Ali pacha, à Tepelenet et Butrint. Parmi les nombreux monuments du culte datant du Moyen Age, l'Institut s'occupera en priorité de ceux qui présentent les plus grandes valeurs historiques et architecturales et de ceux qui nécessitent une intervention urgente.

c) Les villes-musées de Gjirokastër et de Berat sont aujourd'hui les centres où l'essor de la cité médiévale albanaise et l'architecture du bas Moyen Age apparaissent avec la plus grande richesse. C'est pour cette raison que cet Institut leur a consacré et leur consacre toujours le meilleur de son attention.

Ces deux villes gardant, mieux que toute autre, leur aspect d'ensemble de jadis, L'Institut veillera à ce qu'elles soient conservées et restaurées avec le plus grand souci d'authenticité. Toutefois, à la différence des autres centres, le problème, ici, est plus complexe. D'abord, parce qu'on a affaire à d'importants ensembles urbains où le nombre des monuments pris en protection est plus élevé que dans n'importe quel autre cas. Ensuite, parce que ces villes continuent de vivre et de se développer conformément aux conditions nouvelles de notre réalité socialiste. Le désir des habitants qui vivent et travaillent dans ces centres urbains, de jouir des commodités de notre temps est parfaitement légitime, et pour le règlement une importance particulière doit y être accordée. Cela étant, la condition première de la protection et de la conservation des centres historiques doit donc être l'adaptation et l'utilisation des monuments qu'ils comportent conformément à la dynamique de la vie, sans porter atteinte aux valeurs historiques, culturelles et artistiques de ceux-ci. Cet Institut devra également orienter et contrôler toute intervention dans ces centres, de ma-

nières que les nouvelles constructions ne viennent pas ternir les éléments de grand intérêt des quartiers-musées, des ensembles et des monuments, et il lui faudra en même temps, dans le cadre de ses travaux, contribuer à la solution de certains problèmes utilitaires soulevés par la vie quotidienne.

L'expérience a montré que les meilleurs résultats dans ce sens ont été obtenus quand le travail a été mené de front sur tout un ensemble architectural. La restauration complète de monuments donnés et la restauration intégrale d'ensembles architecturaux devront être portés, dans l'avenir, à l'échelle du quartier, comme cela a déjà été fait dans celui de la «Kala» à Berat. Ce n'est qu'ainsi que notre travail pourra donner des résultats apparents. Les travaux menés jusqu'à ce jour sur les façades des ensembles architecturaux ne peuvent être considérés comme des travaux de conservation et de restauration proprement dits. Ils n'ont qu'un caractère provisoire et répondent à des besoins urgents touchant surtout l'aspect extérieur de ces villes. Aussi l'Institut n'en entreprendra-t-il point à l'avenir.

Se fondant sur son expérience de plusieurs années en matière de travaux dans les villes-musées et alors que de nombreux monuments sont en danger de dégradation. l'Institut, faisant le point des réalisations dans ce domaine, estime que, au rythme actuel du travail, il faudra un long temps pour que les valeurs architecturales de ces villes puissent être rétablies dans un état satisfaisant. Aussi juge-t-il que ce rythme doit être accéléré.

De pair avec ceux effectués dans les villes-musées, des travaux seront menés sur certains monuments d'architecture urbaine à Tirana, Korçë, Shkodër, etc.

d) En ce qui concerne l'étude et la protection de l'architecture rurale, le travail de cet Institut n'est pas encore à la hauteur voulue. On connaît le caractère préoccupant et l'urgence de ce problème, d'autant plus que la transformation socialiste des campagnes tend à supprimer cet héritage rapidement, sans en laisser de vestiges. En ce domaine, on devra veiller avec un soin particulier à rassembler toute la documentation requise sur les constructions les plus intéressantes de ce genre architectural et à en assumer la protection, en sorte qu'avec leurs exemplaires les plus caractéristiques soit mis sur pied, conformément à la décision du CC du PTA «Sur les traditions», un musée du village.

e) Dans le cadre de notre activité, une place importante reviendra au travail de conservation et de restauration des monuments de caractère historique, qui, dans la plupart des cas, se signalent à l'attention non pas tant par leur valeur architecturale, que par l'importance des événements qui s'y rattachent. En cette matière, notre première tâche est de placer sous la protection de l'Etat tous les lieux ou constructions liés à des faits ou à des figures d'importance nationale et d'en assurer la conservation. Une attention particulière sera accordée à la période la plus éclatante de notre histoire millénaire, à la Lutte de Libération Nationale. Il importera ici de perfectionner les critères de notre travail de conservation et de restauration.

Pour mener à bien ces tâches notre Institut s'appuiera principalement sur ses propres forces, non sans collaborer en même temps avec les institutions apparentées. L'éventail des problèmes qui se posent à notre Institut est si vaste que ceux-ci ne peuvent être pleinement el largement résolus que si nous conférons à notre travail scientifique un caractère de masse. Le Parti nous enseigne que la science, chez nous, n'est pas l'apanage de quelques spécialistes, mais le bien du peuple tout entier. L'approfondissement ulterieur de la révolution idéologique et culturelle nous assigne de grandes tâches. Partout on a salué et soutenu l'initiative des enseignants de Mirdite et de Kolonje en vue de la promotion culturelle du village. Le camarade Enver Hoxha, au Ve Congrès du Parti du Travail d'Albanie, y a notamment rendu hommage. Une telle initiative consciente, et qui doit se traduire par une action permanente, constitue une précieuse contribution apportée à la connaissance, à la popularisation et à la protection des monuments culturels. Dans cet ordre d'idées notre Institut n'épargne pas ses efforts pour accroître le nombre de ses collaborateurs extérieurs. Leur réseau, encore peu étendu, s'élargit de jour en jour, ce qui ne manquera pas de contribuer à l'heureuse réalisation de nos tâches futures.

DO NOT COPY

Afin de remplir la fonction d'éducation active qui doit être la leur, susciter l'admiration pour le talent de nos ancêtres épris de liberté, exalter le sentiment de fierté nationale et servir l'éducation patriotique, révolutionnaire et esthétique du peuple, il importe que les monuments soient connus des larges masses populaires. Ce but ne pourra être atteint qu'en multipliant les publications scientifiques, articles, photos, expositions, albums, etc. Il nous faut cependant admettre que ce qui a été fait jusqu'à ce jour dans ce domaine est insuffisant. Les publications parues sont restreintes en regard du vaste travail de recherche mené par notre Institut et ne comblent pas la lacune sensible existant dans ce domaine. Conscients de cette responsabilité, notre Institut a mobilisé toutes ses forces pour éliminer cette insuffisance. En publiant les premiers volumes qui contiennent les résultats du travail scientifique de ces dernières années, nous nous acquittons d'un important devoir envers notre pays et notre peuple.

Les tâches que nous nous fixons sont pleinement réalisables. Toutes les conditions sont remplies pour nous permettre de les mener à bien. Le soutien et la sollicitude du Parti, ainsi que le patriotisme de nos travailleurs pénétrés de la pensée et des enseignements du camarade Enver Hoxha, demeurent les facteurs dêterminants sur lesquels se fondera notre travail à l'avenir également.

DO NOT COPY

Selim ISLAMI

QYTETI ILIR NË ZGËRDHESH

DO NOT COPY

Kanë kaluar pak më shumë se 100 vjet qëkurse dijetari austriak J.G. Han vizitoi kalanë ilire në Zgërdhesh dhe hodhi mendimin se në këtë vend duhej kërkuar Albanopoli i vjetër. [1]) Këtë qendër e vizitoi edhe një herë gjatë luftës së parë botërore arkeologu tjetër austriak K. Prashniker. Një përshkrim i shkurtër dhe një plan-skicë, që trashëgojmë prej tij, përbëjnë kontributin që ka mundur të na japë, pas vizitës së tij të shkurtër në këtë qendër, ky gjurmues, i njohur në raste të tjera, për vrojtime të kujdesshme. [2]) Në krahasim me dy autorët e përmendur, shënimet e arkeologut italian P. Sestieri nuk sjellin ndonjë gjë të re. [3])

Gjatë verës së vitit 1969, në Zgërdhesh, zhvilloi punimet një ekspeditë e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Ekspedita përbëhej nga arkeologë, restauratorë e topografë+). Rezultateve historiko-arkeologjike të arritura prej saj i kushtohet ky punim.

* *

Rrënojat e Zgërdheshit gjenden në jugperëndim të Krujës, një orë e gjysëm më këmbë larg saj dhe gjysëm orë prej fshatit Zgërdhesh, në vendin e quajtur Kakariq. Një rrugë automobilistike fshati, që kthen në gjysmën e rrugës Fushë-Krujë – Krujë, të çon, pas pak minutash, mu në rrëzë të qytetit antik.

Faqja e kodrës mbi të cilën shtrihej qyteti, ka formën e një trekëndëshi dybrinjënjishëm me kulmin nga lindja (fig. 1). Me anë të qafës së Fierzës, ajo lidhet nga kjo anë me vargun e kodrave, që zbresin nga mali i Krujës. Nga veriu, kodra kufizohet prej përroit të Çinarit, kurse, nga jugu, prej atij të Lanës. Të dy këta, përrenj të vegjël, kanë krijuar nga këto anë pjerrësi dhe buzë të thepisura shkëmbore, të cilat formojnë një mbrojtje të mirë natyrore. Kjo kodër, që ka strukturë gëlqerore, përbëhet prej një pjese më të lartë, me një lemë të vogël në majë, dhe faqes, që zbret ëmbël drejt perëndimit, duke përfunduar r.ga kjo anë me një terren të sheshtë.

Vëndi i zgjedhur kishte të gjitha kushtet e përshtatshme për ngritjen dhe zhvillimin e një qyteti antik. Kodra mbi të cilën ai u ngrit, kishte një pozitë dominuese mbi të gjithë hapësirën që shtrihej para saj; ajo u përgjegjej, në një farë mase, kërkesave të mbrojtjes dhe kishte në vend gurin për nevojat e fortifikimit dhe ndërtimet e qytetit. Nga ana tjetër, pika e zgjedhur kishte përpara një fushë pjellore dhe rrethohej nga kodra të buta me kullota shumë të mira. Së fundi ajo

---

1) J.G. Hahn, **Albanesische Studien,** Jena 1854, IV **Archaeologische Notitzen,** fq. 120-121, nr. 18; po ky autor, **Reise durch die Gebiete des Drin und Wardor** në «Denkschriften des Kaiserlichen Akademie der wissenschaften,» Philos, – Hist, Classe, XV Band, Wien 1867, Zweite Abteilung fq. 14.

2) G. Praschniker – A. Schober, **Archaeologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1919, fq. 28-30.

3) P.C. Sestieri, **Esplorazioni archeologiche in Albania nel 1941-42,** në «Revista d'Albania» An. III, fasc. III sett. 1942 Milano, fq. 152-53

+) Ekspedita drejtohej nga autori. Merrnin pjesë arkeologët L. Papajani e Gj. Karaiskaj, grupi i restauratorëve i drejtuar nga F. Miraj, grupi i topografëve i drejtuar nga P. Maraçi, fotograf R. Veseli, skicograf F. Guralumi, si dhe studenta të fakultetit Histori Filologji të USHT.



Figura 1 Pamje e përgjithëshme e kodrës mbi të cilën shtrihej qyteti.

DO NOT COPY

ishte pranë rrugëve që përshkonin krahinën nga bregdeti në thellësi të vëndit dhe nga jugu në veri e anasjelltas. Ishin këta faktorë që përcaktuan zgjedhjen e vendit dhe, midis tyre, ata të karakterit gjeografik - - ekonomik që luajtën rolin vendimtar në lindjen dhe zhvillimin e këtij qyteti antik.

Planimetria e Prashniker-it për Zgërdheshin nuk është as e saktë as e plotë. Ajo e le jashtë qytetin e poshtëm. Edhe pse autori i saj konstaton ekzistencën e një vije të dytë fortifikimi të pajisur me kulla dhe hedh hipotezën e një zgjerimi eventual të qytetit, ai heziton ta pranojë atë përfundimisht [4]). Është për t'u besuar që Prashnikeri ka qenë i penguar në punën e tij nga pylli i dendur, i cili mbulonte sipërfaqen e qytetit, por skica e tij përmban të meta të konsiderueshme, deri në vendosjen e gabuar të pikave të horizontit, duke na e paraqitur Veriun nga Lindja. Për këtë shkak, është vështirë të ndiqen përshkrimet e tij, të cilat, edhe kështu, vuajnë nga pasaktësia.

Qyteti antik zinte një sipërfaqe rreth 10 ha. (shih planimetrinë fig. 2). Mure të fuqishme me një gjatësi rreth 1400 m. e mbronin nga të gjitha anët e sidomos nga ana perëndimore e lindore, që ishin më të kërcënuara nga rreziqet e jashtëme. Në anën perëndimore, muri rrethues i qytetit mbyllte bazën e trekëndëshit, me sa duket prej buzës së përroit të Çinarit deri te buza e përroit të Lanës. Prej këtij muri është ruajtur vetëm një trakt i gjatë rreth 90 m. midis pikave A–A'', i përforcuar nga tri kulla katërkëndëshe të vendosura në intervale të barabarta njera prej tjetrës (kullat nr. 1, 2 e 3). Më tej muri zgjatej, i forcuar, besoj, me të njëjtin sistem kullash deri tek pika U. Pastaj gjurmët e tij humbasin, por konfiguracioni i terrenit lejon të mendohet se ka ndjekur vijën e shenuar midis pikave U–T'–T.

Prej pikës A, që shënon skajin veriperëndimor të murit rrethues, deri në pikën B, mund të ndiqen me ndërprerje, në një gjatësi prej 80 m., gjurmët e murit që ngjitej përpjetë kodrës për të mbrojtur anën veriore të qytetit. Ndonjë gjurmë të zbehtë shihet edhe buzë greminës deri te pika C. Pas kësaj, gjurmët ndërpriten deri në pikën E, por nënkuptohet se në këtë pjesë muri ka ndjekur buzën e shkëmbit për ta kthyer atë në pjesë përbërëse të sistemit mbrojtës të qytetit. Prej pikës E deri te pika K traseja e murit ka kaluar buzë rrëpirës dhe gjurmët e tij ndiqen thuajse pa vështirësi.

4) C. Praschniker – A. Schober, po aty fq. 28

DO NOT COPY



Fig. 2

Në një gjendje relativisht të mirë na është ruajtur muri rrethues në anën lindore, te Qafa e Fierzës, midis pikave K – L. Nga kjo anë ai është përforcuar me dy kulla, njera e rrumbullakët (nr. 13) dhe tjetra katërkëndëshe (nr. 14). Prej pikës L. muri kthen në drejtim të jugperëndimit për të mbrojtur anën jugore të qytetit. Gjurmët e tij duken qartë deri te pika O, megjithë shëmbjen e fortë që ka pësuar nga kjo anë. Prej pikës O gjurmët e murit humbasin përsëri, por shkëmbi që zbret me dy kreshta buzë përroit kufizues të Lanës, formon atë gardh natyral dhe atë bazament mbi të cilin u mbështet muri mbrojtës. Edhe sot vërejmë buzë shkëmbit bloqe të murit rrethues që lartësohej mbi të dhe herë të tjera gjurmë kullash katërkëndëshe (nr. 10 e 11), që e përforconin këtë mbrojtje. Poshtë pikës T, gjurmët e murit mbrojtës, siç thamë, nuk mund t'i ndjekim; duket se ndërtimet fshatare e kanë dëmtuar rëndë. Vija T–T'–U, që paraqesim në plan, është e supozuar.

Një mur i tërthortë, që fillon te pika F dhe përfundon te pika Q, ndante qytetin e sipërm, akropolin, nga qyteti i poshtëm. Muri është përforcuar me një varg kullash, prej të cilave duken qartë tri (nr. 5, 8, 9) dhe deri diku dhe një e katërt (nr. 7). Por midis kullave nr. 5 e 6 ka vend dhe për një kullë tjetër (nr. 6). Prej tyre, kulla nr. 5 është e rrumbullakët, sikurse edhe ajo nr. 13. Ka të ngjarë që qyteti të ketë pasur edhe një mur mbrojtës të dytë të brendshëm, që kalonte nëpër vijën R–R'–D'–D. Në këtë rast ne do të kishim një ndarje të qytetit në tri pjesë dhe vija e përshkruar do të kufizonte qytetin e mesëm. Megjithatë duhet të themi se gjendja në këtë zonë nuk është e qartë dhe një fjalë më e sigurtë do të mund të thuhet vetëm pas gërmimeve.

Deri tani njohim tri porta të qytetit. Njëra prej tyre gjendet në pikën Q dhe shërbente si hyrje në akropol nga ana jugperëndimore (shih planin dhe TAB. II, 2 2). Kjo është një portë e vogël me një koridor të harkuar, e të gjerë 1,80 m., dhe mbrohej nga një kullë e jashtme katërkëndëshe (Nr. 10). Porta e dytë TAB, II, 3 gjendet nga ana veriore, nën murin e brendshëm të akropolit, te pika E. Në anën e majtë të saj ndërtuesit kanë shfrytëzuar si mur shkëmbin, të cilin e kanë skalitur vertikalisht kurse në anën e djathtë na është ruajtur muri anësor dhe gjurmët e një kulle katërkëndëshe (nr. 4). Gjatë pastrimit u gjet edhe njëri prej bloqeve të pragut me dy gropëza për fiksimin e kasave të portës. Kjo portë, me koridorin 2.90 m. të gjerë dhe rreth 6 m. të gjatë, duhet të ketë qenë një nga portat e mëdha të qytetit. Tek ajo të çonte, me sa duket, një rrugë, që kalonte buzë murit të anës veriore. Traseja e kësaj rruge përdoret edhe sot nga fshatarët dhe përshkon gjithë brinjën veriore të kodrës. Porta e tretë gjendet në anën perëndimore, pranë kullës nr. 2 (Tab. II, 4). Atë e ka parë edhe Hani [5]), por ne na u desh t'a rizbulojmë për shkak se ishte mbuluar krejtësisht prej dheut. Kjo portë e vogël, gjithsejt 1.30 m. e gjerë, me një koridor sa gjerësia e murit rrethues, është shtruar me rrasa guri. Nuk dimë ende portën kryesore të qytetit, por ka të ngjarë që ajo të ketë qenë nga ana perëndimore te pika U', ose ndoshta aty ku sot gjendet një shtëpi fshatare. Këtë mendim, që na e sugjeron konfiguracioni i terrenit, e përforcojnë edhe shkallët e gdhëndura në shkëmb (shih në plan nr. 15 dhe Tab. II, 5), të cilat me drejtimin e tyre të çojnë pikërisht në hapësirën e përmendur. Në të dy anët e kësaj porte duhen pritur edhe dy kulla që në plan i kemi shënuar me nr. 20 e 21. Një portë tjetër e rëndësishme duhet të ketë qenë midis kullës nr. 5 dhe asaj nr. 6 të supozuar. Ajo përshkonte murin e akropolit diku para rrënojave të kishës mesjetare në F', për të lidhur qytetin e sipërm me të poshtmin. Porta e supozuar prej Prashnikerit te kulla katërkëndshe (nr. 14) e murit lindor [6]) dhe prej Sestierit, midis kullave po të këtij muri (nr. 13 e 14) [7]) nuk ekziston, gjë kjo që u vërtetua nga punimet e pastrimit.

Brenda mureve rrethuese qyteti është zhvilluar në përputhje me kushtet e terrenit. Një radhë muresh tarracimi kanë shërbyer për përshtatjen e këtij terreni të pjerrët nevojave të ndërtimeve private e publike të qytetit. Të tilla janë muret në P–P', ato në S – S' –S'' dhe të tjerë më të vegjël. Gjurmët e një rruge që fillon te porta veriore në E të çojnë me njërin drejtim tek porta e supozuar e akropolit dhe me tjetrin, duke zbritur poshtë, lidhen me shkallët e përmendura më lartë për të arritur te porta kryesore e qytetit. Sheshi që shtrihet prapa mureve rrethuese të anës perëndimore, të le përshtypjen se ka shërbyer si vend për mbledhjet publike dhe për tregun kryesor të qytetit. Burime brenda teritorit të rrethuar duket se nuk ka pasur; besojmë se furnizimi me ujë është bërë me anë të sterave, në gjurmët e të cilave nuk kemi rënë ende. Mure godinash vërehen rreth pikave 12 e 16 dhe në 17 e 18. Pranë godinës 17 është ruajtur edhe rrethi i poshtëm i një mokre gdhëndur në shkëmb.

Gjetjet arkeologjike tregojnë nga ana tjetër se qyteti ka qenë shtrirë edhe jashtë mureve rrethuese. Në një kodër të vogël nga ana jugore, që gjendet për-

5) J.G. Hahn, **Albanesische Studien,** fq. 121.
6) C. Praschniker – A. Schober, Vep. e cit. fq. 29.
7) P.C. Sestieri, vep. e cit. fq. 152-153.

BOZTIQE

tej përroit të Lanës, pak a shumë në një vijë me murin rrethues të anës perëndimore, duken gjurmët e një godine, ka shumë të ngjarë, të një tempulli, kurse gjatë punimeve të ndërtimit në zonën përfund qytetit në vitin 1961, janë gjetur mbeturinat e mureve të një godine, një sasi tjegullash dhe një kokë luani pjesë e një sime (Tab. V, 4).

Elementet topografike, që përmëndëm, jemi munduar t'i pasqyrojmë në planin tonë të ri të qytetit, i cili pa dyshim do të ketë nevojë për plotësime e korigjime të mëtejshme.

* * *

Ajo që trashëgojmë nga studjuesit e mëparshëm për teknikën e ndërtimit të mureve rrethuese të Zgërdheshit ka karakter të përgjithshëm ose nuk i përgjegjet së vërtetës. Kështu nuk mund të quhet i plotë vlerësimi që u bëri atyre Hani, ndërsa Prashniker, duke mos arritur të bëjë dallimin midis mureve të Zgërdheshit dhe atyre të Lisit, jo vetëm nuk pruri ndonjë gjë të re në krahasim me Hanin, por përkundrazi krijoi një konfuzion në lidhje me këtë çështje. I gabuar është edhe pohimi i tij se muret e Zgërdheshit janë ndërtuar në të njëjtën kohë. [8])

Duke gjurmuar murin rrethues dhe gjithë sistemin e fortifikimit të këtij qyteti ne mundëm të dallojmë disa duar ndërtimi, që u përgjegjen periudhave të ndryshme të veprimtarisë ndërtuese dhe të historisë së qytetit.

Gjurmët më të hershme të ndërtimit i ndeshim në akropol. Si të tilla janë: dy trakte të murit rrethues nga krahu verior te pikat G–H dhe I–K; një trakt me gjurmët e një kulle katërkëndëshe para murit lindor, që e kemi shënuar me gërmat K'–L'; një të tretë tek pikat M–N; ndërtimet tek porta jugore në Q dhe te kulla e saj nr. 10; së fundi trakti në të majtë të kullës nr. 8, të cilin Prashnikeri e ka quajtur pseudo-poligonal [9]). Këto mure janë ndërtuar me bloqe të papunuara ose paksa të punuara. (Tab. III, 1). Te porta jugore dhe te trakti pranë kullës nr. 8, bloqet janë të papunuara, me forma të parregullta dhe ndonjëherë masivë. Në pikat e tjera, përkundrazi, vihet re një përpjekje për t'u dhënë faqeve të bloqeve forma pak a shumë kuadratike, por pa u kujdesur për të skuadruar anët apo latuar faqet e tyre: vihet re gjithashtu prirja për t'i vendosur ato në radhë horizontale. Nga pikëpamja tipologjike këto mure të kujtojnë Gajtanin, Dorsin I e II [10]) dhe Lisin I e II [11]); me interes është këtu prania e kullave (në K' dhe nr. 10) të cilat mungojnë në vendbanimet e njohura të këtij tipi.

Periudha e dytë e ndërtimit përfaqësohet më mirë tek muri rrethues i anës perëndimore dhe pikërisht në pjesën që shtrihet prej pikës A deri A' bashkë me kullat nr. 1 e 2 që lidhen me të (Tab. I, 1). Ky mur, i trashë 2,70 m. (Tab. II, 1), formohet nga dy parete dhe mbushja midis tyre. Si themel për të është përdorur shkëmbi ose një blok që del 15-20 cm. jashtë murit, por ka raste kur muri është vendosur mbi një shtresë çakëlli të rrahur. Paretet janë të ndërtuara me bloqe kuadrate, të punuara me faqe të rrafshta dhe të skuadruara me shumë kujdes (Tab. III, 2). Bloqet janë vendosur në radhë horizontale të rregullta me një përputhje të përsosur të fugaturave. Në disa raste vërejmë dhe bloqe të shkallëzuara. Kjo ndodh kur këto bloqe qëllojnë më të mëdha se gurët e tjerë të radhës së tyre ose kur janë përdorur në radhën e fundit, në një terren të thyer. Në këto raste, sistemi i shkallëzimit është përdorur për të kursyer materialin ose për të zgjidhur çështjen e pjerrësisë së terrenit. Përdorimi i tyre nuk prish aspak harmoninë e radhëve të rregullta dhe krijon mundësinë për një lidhje më të mirë të murit. Bërthama e murit është mbushur me gurë të mëdhenj e të vegjël të papunuar. Në hapësirën midis dy kullave ky mur është ruajtur në tri-katër radhë. Kullat janë katërkëndëshe dhe janë vendosur në largësinë 29.5 m. njëra prej tjetrës. Ato dalin 7 m. jashtë vijës së murit. Gjerësia e ballit të kullës nr. 1 është 10.60 m., kurse ajo e së dytës 9 m. Muri i tyre me gjerësi 1.80 m. formohej prej dy radhë bloqesh dhe prej mbushjes. Kulla nr. 1 është ruajtur në 3 radhë nga balli, 6 nga krahu jugor dhe 7 nga ai verior, duke arritur nga kjo anë lartësinë 2.40 m. Po të qe se kjo radhë do të na ishte ruajtur nga balli, kulla do të arrinte këndej lartësinë 3.55 m. Kulla nr. 2, në gjendjen e sotme, ka 3 dhe 6 radhë në krahët dhe 1 radhë të vetme në ball. Bloqet që janë përdorur për ndërtimin e kullave nr. 1 e 2 dhe të murit midis tyre janë masive me përmasa që lëvizin në gjatësi prej 0.80-2,15 m. Lartësia e radhëve nuk është e njëjtë; për thjeshtim po ja-

8) C. Praschniker, A. Schober, Vep. e cit. fq. 29
9) C. Praschniker, A. Schober, Vep. e cit, fq. 30
10) S. Islami – H. Ceka, **Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilire në teritorin e Shqipërisë,** «Konferenca e parë e studimeve Albanologjike (15-21 nëndor 1962)», Tiranë 1965, fq. 448; po këta autorë, **Nouvelles données sur l'antiquité illyrienne dans le territoire albanais»;** «Studia Albanica» Tiranë 1964, I. fq. 9.
11) F. Prendi – K. Zheku, **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike,** artikull në këtë botim. (vëll. II).

DO NOT COPY

pim matjet në kullën nr. 1: 0,65, 0,55, 0,50, 0,35, 0,45, 0,50, 0,50 m., që tregojnë për një ndërtim të tipit kuadrat pseudo-isodomik.

Te muri i akropolit periudha e dytë na çfaqet tek kullat nr. 5, 8, 9 dhe pranë hyrjes së supozuar në F'. Duket se edhe këtu muri është 2.70 i gjerë; në ndonjë vend matjet japin një gjerësi prej 3 m., por kjo mund të jetë rezultat i rrëshqitjes. Më e qartë është gjendja te kulla nr. 9. Kjo është një kullë katërkëndëshe me ballin 7 m. të gjerë. Nga krahu verior ajo del prej vijës së murit 6.30 m. kurse nga ai jugor vetëm 4.35 m. Ky ndryshim në krahët vjen sepse nga ana jugore kulla lidhet me një ambient që bën pjesë në kompleksin e portës në Q. Krahët e kullës janë ruajtur në 2-3 radhë, kurse balli në një radhë të vetme. Bloqet e këndeve janë pajisur me vijat apo lugjet e peshimit, element që nuk e kemi te kullat nr. 1 e 2. Kulla nr. 8 ndodhet 20 m. larg prej asaj nr. 9 dhe duket se kjo ka qenë largësia midis gjithë kullave të këtij muri. Ajo është e futur në murin e periudhës së parë të tipit të Gajtanit pa u lidhur me të. Përmasat e dhëna nga Praschnikeri për ballin (6.50) m. dhe krahun (8.20 m.) janë të sakta, por dalja përpara nga vija e murit është 5.50 m. e jo 6.30 sikurse thotë ai [12]). Rreshtat e fundit të mureve anësore janë me bloqe kuadratike me faqe të rrafshta dhe këta përbëjnë të vetmet gjurmë, që lidhin këtë kullë me periudhën e dytë të ndërtimit. Më tej, mbeturina të kësaj periudhe kemi tek një trakt dhe tek disa bloqe të shtrirë para kishës e në afërsi të hyrjes së supozuar F', kurse për kullën nr. 5 gjykojmë vetëm nga bloqet kuadrate me faqe të rrafshta që shohim në sipërfaqe.

Gjurmë të tjera të kësaj periudhe ndërtimi ndeshen gjatë gjithë vijës së murit rrethues. Më qartë i shohim këto te trakti midis pikave A-B, që zë fill mbas kullës nr. 1 për t'u ngjitur përpjetë kodrës dhe te muri i portës veriore. Tek i fundit na është ruajtur edhe një element konstruktiv shumë i rëndësishëm, ai i bloqeve transversale, që lidhin paretet me bërthamën e murit, element të cilin nuk e vërejmë te muri i anës perëndimore. Më tej, bloqe të veçanta in situ dëshmojnë se periudhës së dytë të ndërtimit i takon edhe pjesa më e madhe e murit midis pikave E–K. Nga ana jugore gjurmat e këtij tipi i vërejmë te bloqet e rrëzuara nën L–O dhe S–T. Me këtë periudhë duhet të lidhet edhe kulla nr. 11 dhe ndërtimet në R–R'. Brenda qytetit me këtë periudhë lidhen mbeturinat e disa godinave të rëndësishme dhe në radhë të parë ato rreth pikës 16.

Të gjitha këto të dhëna tregojnë se mbeturinat e tipit të murit të përshkruar zënë vendin më të rëndësishëm midis rrënojave të qytetit; duket se ato lidhen me një periudhë të lulëzuar ndërtimi, gjatë së cilës u ndërmorën punime të mëdha fortifikimi dhe u ndërtuan godinat kryesore të qytetit.

Periudhën e tretë të ndërtimit e vërejmë qartë te pjesa e murit perëndimor, prej A' në A'' dhe te kulla e tij nr. 3 shih planin dhe (Tab, I, 1). Kjo pjesë e murit perëndimor është vijim i murit A–A' të fazës së mëparshme dhe ka të njëjtën gjërësi me të. Kulla e tij ndodhet gjithashtu 29.5 m. larg së dytës, d.m.th. ka baraslargësi me kullat e fazës së mëparshme; muret paretale të saj janë ndërtuar me trashësinë 1.80 m. si dhe te kullat e tjera. Vetëm balli i kësaj kulle është pak më i vogël (8.75 m.) se i dy kullave fqinjë. Duke ruajtur në përgjithësi zgjidhjet konstruktive të murit të mëparshëm dhe parimet e vjetra të sistemit të fortifikimit, ndërtuesit e këtij muri të ripërtëritur e kanë veshur atë me elemente të reja stilistike, që e dallojnë prej murit të mëparshëm. Kështu, duke realizuar ndërtimin e tij përsëri me bloqe kuadrate të vendosura në radhë të rregullta horizontale, kësaj here ata i kanë punuar bloqet me faqe të gufmuara (rustika) dhe rrethuar anash me një shirit 7-8 cm, të ngushtë, Sipërfaqja e gufmuar del mjaft në reliev (5-8 cm.) dhe nuk paraqitet uniforme; ajo ka gropëzime dhe të dalura të theksuara, të krijuara vetiu, gjatë skalitjes, për shkak të natyrës së gurit konglomerat. Është për t'u shënuar se te një blok i qoshes jugore të kullës, njëra faqe e ka shiritin anësor, kurse tjetrës i mungon. Kjo mungesë vihet re edhe në ndonjë blok tjetër, gjë që flet për një punë jo aq të kujdesshme. Përmasat e bloqeve lëvizin në gjatësi prej 0.60-1.10 m. Katër radhët e para në qoshen jugore kanë një lartësi të barabarta 0.40 m. kurse në atë veriore ajo rritet në 0.50 m., duke zgjidhur kështu çeshtjen e disnivelit nëpërmjet të rritjes graduale të bloqeve dhe jo nëpërmjet të shkallëzimeve. Radha e pestë është 0.50 m. e lartë. Në tërësi muri paraqet një kuadrat isodomik. Ndryshe prej murit të periudhës së dytë (A–A'), ku bloqet e pareteve janë punuar me të njëjtin kujdes, në ndërtimin e këtij muri bloqet e paretit të brendshëm janë lënë pothuajse të papunuara. Më pak kujdes është treguar edhe në hedhjen e themeleve, kështuqë nga shumë pikëpamje, ky mur nuk mund të matet, nga cilësia, me fqinjin e tij më të hershëm.

Në të njëjtën mënyrë është ndërtuar edhe muri i anës lindore bashkë me kullën e rrumbullaktë nr. 13 (Tab. I, 2) dhe (Tab. III, 3). Ky mur si dhe kulla e tij kanë trashësinë e njohur prej 1.80 m. Një trajtim i tillë duket se ka rrjedhur nga fakti se ai është një mur i shkurtër, gjithsej 17 m., midis kullave nr. 13 e 14. Për t'u

12) C. Praschniker – A. Schober; vep. e cit. fq. 30.

shënuar është se te ky mur vërejmë aty këtu edhe bloqe të shkallëzuara dhe ngandonjëherë bloqe me brinjët anësore paksa të pjerrëta, të cilat megjithatë nuk e ndryshojnë fizionominë e përgjithshme të tij. Ndërtimi është bërë me gurë gëlqerore të një cilësie më të mirë se sa te kulla nr. 3, është punuar me kujdes dhe lidhja e bloqeve është e përsosur, por sipërfaqja e gufmuar është po ashtu e theksuar dhe shiriti anësor ka po atë gjerësi si te kulla nr. 3. Radhët ruajnë lartësinë 0.40-0.45 m. me bloqe të madhësive të ndryshme që arrijnë gjatësinë 1.80 m. Në të dy rastet kemi të bëjmë me mure të tipit kuadrat izodomik, zbatuar në stilin rustika me shirit, por i fundit i punuar më me kujdes.

E lindur në periudhën e dytë të ndërtimit, kulla nr. 8, ashtu siç na është ruajtur sot, dëshmon se i ka qenë nënshtruar një rindërtimi rrënjësor në periudhën e tretë. Balli i saj është ndërtuar rrishtas që nga themelet. Prashnikeri e ka gjetur në katër radhë; sot janë ruajtur vetëm tri. Lartësitë e rradhëve që jep ai (0.50, 0.62, 0.53, 0.37 m.) janë të sakta; gjatësia e bloqeve lëviz nga 0,45-1.30 m. Ndërtimi është i tipit kuadrat pseudo-isodomik në stilin rustika me shirit anësor, por, ndryshe nga kulla nr. 3 dhe muri lindor, faqja e gufmuar këtu është më e ulët dhe uniforme. (Tab. III, 4 e 5). Në të shumtën e rasteve kufiri i shiritit anësor nuk është aq i theksuar dhe me vështirësi veçohet prej sipërfaqes së gufmuar. Ashtu siç e ka vënë në dukje edhe Prashnikeri, ka bloqe ku ky shirit mungon [13]), këtë gjë e vumë re edhe tek kulla nr. 3. Kjo e metë, e cila në vështrimin e parë nuk e dobëson efektin që bën balli i kullës si ndërtim solid, tregon, edhe këtu, se nga ana stilistike ai nuk është zbatuar me aq kujdes. Tabloja nuk do të ishte as e plotë dhe as e qartë për këtë kullë, po të mjaftoheshim vetëm me vlerësimin e ballit të saj. Muret e krahëve dhe ai i anës së prapme nuk kanë të njëjtën pamje me ballin. Në muret e krahëve, vetëm bloqet e qosheve dhe ndonjë blok i dytë janë vijim i ballit; midis tyre kemi një rast interesant kur shiriti anësor i një bloku nuk është punuar i plotë por vetëm në dy anët, duke na përsëritur këtu atë të metë që vumë re si në ballin e kësaj kulle ashtu edhe në kullën nr. 3. Më tej, muret e krahëve mbështeten mbi bloqe të periudhës së dytë, dhe mbi ta janë vendosur bloqe të ngushta e të gjata, (0.28 x 1.10; 0.36 x 1.23 m.) herë me faqe të rrafshtë e herë të gufmuara, duke patur midis tyre, në të rrallë, edhe bloqe të vogla. Po kështu është ndërtuar edhe pareti i prapëm. E gjithë kjo pamje tregon se kulla është ndërtuar me ngut, me material që kanë patur përdore, duke u kujdesur më shumë për anën funksionale se sa për anën stilistike të ndërtimit. Është balli i kësaj kulle, me pamjen e parë mashtruese, që e ka shtyrë Prashnikerin të krahasojë Zgërdheshin me Lisin. [14]) Duke qenë një ndërtim me bloqe kuadrate, zbatuar në stilin rustika me shirit anësor, të cilin nuk e ndeshim në asnjë rast në Lis, balli i kësaj kulle lidhet tipologjikisht, dhe besoj edhe kronologjikisht, me kullën nr. 3 dhe murin lindor.

Bloqe të shkëputura të punuara me stilin rustika me shirit anësor vërejmë edhe tek kulla nr. 1 dhe tek rrënojat e murit midis pikave L – O. Por në qoftë se muri i anës perëndimore midis pikave A′ – A″ me kullën nr. 3, ai i anës lindore me kullën e rrumbullaktë nr. 13 dhe kulla nr. 8 e murit të brendshëm të akropolit janë rindërtuar që nga themelet, në pikat e tjera, që përmendëm, këto bloqe dëshmojnë vetëm për riparime të pjesshme.

Ndërtimet e periudhës së tretë zënë në vetëvete një vend të rëndësishëm në vëllimin e përgjithshëm të ndërtimeve të qytetit, por si nga kjo pikëpamje, ashtu dhe nga cilësia, ato nuk mund të maten me ndërtimet e fazës që i paraprin. Këto ndërtime duket se janë bërë pas një dëmtimi të rëndë që kanë pësuar muret rrethuese të qytetit duke prekur sidomos pikat më nevralgjike të sistemit mbrojtës: në qendër të murit perëndimor, me sa duket pranë portës kryesore, te muri i anës lindore që rrezikohej nga kodrat mbivehte dhe tek muri i brendshëm i akropolit.

Kulla e rrumbullakët e murit lindor duket se ruan edhe gjurmët e një periudhe të katërtë ndërtimi (Tab. I, 6). Hani, me të drejtë, ve në dukje se bloqet e saj janë më masive, të punuara më trashë dhe me një lidhje më të keqe se sa ato të murit lindor. Duke pranuar si të drejtë këtë dallim dhe përfundimin e nxjerrë prej tij, se kjo kullë dhe muri lindor i takojnë dy periudhave të ndryshme [15]), duhet të shtojmë se në qoshet e saj ajo ruan fare të qarta, gjurmët që e lidhin me murin lindor edhe me periudhën e tretë të ndërtimit.

Nga sa përshkruam, në qytet dallojmë katër periudha të ndryshme ndërtimi: të parën me bloqe të papunuara ose paksa të punuara të tipit të Gajtanit dhe të Dorsit I e II, (tab III, 1) të dytën me bloqe kuadrate e faqe të rrafshta (tab III, 2), të tretën me bloqe kuadrate, zbatuar në stilin rustika me shirit anësor (tab III, 3, 4 e 5) dhe të katërtën me bloqe kuadrate masive të punuara trashë, herë herë të ripërdorur, dhe me lidhje të keqe. (tab III, 6)

13) C. Praschniker – A. Schober, vep. e cit. fq. 30, foto 41.
14) I njëjti autor, po aty, fq. 29.
15) J.G. Hahn, Albanesische Studien, fq. 121.

ZVICTOR

Klasifikimin, që u bëmë mureve rrethuese, nuk e quajmë përfundimtar, por, sot për sot, ky na duket si më i besueshmi. Nuk përjashtojmë mundësinë që, në të ardhmen, gërmimet arkeologjike të bijen korigjime ose plotësime të rëndësishme.

* * *

Pasi kemi caktuar një kronologji relative lidhur me tipet e ndryshme të konstruksioneve, që ndeshëm në Zgërdhesh, do të mundohemi tani, për aq sa na lejojnë materialet që kemi përdore, t'i vendosim ato në kohë, me fjalë të tjera të caktojmë edhe kronologjinë e mundshme absolute të tyre dhe lidhur me këtë të veçojmë disa etapa të rëndësishme të historisë së këtij qyteti.

Të dhënat stratigrafike, që u përftuan gjatë gërmimeve sistematike buzë murit rrethues të anës perëndimore (Gërmimi a), na ndihmojnë të japim një mendim më të mbështetur rreth themelimit të këtij qyteti dhe historisë së tij. Gërmimet vërtetuan këtu ekzistencën e tri shtresave kulturale (shih profilin fig. 3): njërën që i referohet një vendbanimi të hershëm në këtë qendër dhe dy të tjerat që lidhen me zhvillimin e mëtejshëm të këtij vendbanimi, me transformimin e tij në një qendër urbane dhe me periudhën e fundit të jetës së tij.

Keramika ilire formon përmbajtjen kryesore të shtresës I, e cila në përgjithësi është shumë e varfër. Të gjitha të dhënat tregojnë se kjo shtresë nuk është formuar në vend. Keramika, e cila është e fërkuar dhe shumë e coptuar, duket se është e depozituar këtu, pasi ka bërë një rrugë të gjatë duke u rrokullisur nga



Fig. 3

Duhet të vëmë në dukje më parë se lidhur me këtë çështje deri vonë ka qënë pranuar mendimi i Prashniker-it, i cili, duke i quajtur, pa të drejtë, muret e Zgërdheshit të ngjashme me ato të Lisit, i konsideron ato të njëkohshme dhe i daton në shek. e IV p.e. sonë [16]). Tani së fundi Garashanini, duke u nisur nga mbishkrimi i Lambesas, mundohet të rektifikojë Prashniker-in dhe e daton Zgërdheshin, bashkë me një varg qendrash të tjera, me të cilat, sipas mendimit të tij, lidhet Zgërdheshi, si një themelim të kohës së Agronit, në atë periudhë kur ai ishte në marrëdhënje miqësore me Demetrin II të Maqedonisë. [17])

një pikë më e lartë. Atë mund ta ndajmë në dy grupe: grupin e parë e përbën keramika e njohur ilire me ngjyrën e saj gri të errët apo të kuqërreme, punuar me dorë prej një balte të ashpër e të përzier me kokërriza rëre. Ajo përfaqësohet në këtë shtresë nga fragmente tasash e kupash me vegjat e tyre veshore ose në formë gjuhe dhe fragmente enësh me vegja të larta, midis të cilave më dëndur përsëriten vegjet brinore. Grupin e dytë e formon një numër më i vogël fragmentesh, që dallojnë prej keramikës së përmendur më lart për baltën e imët në ngjyrë gri të çelët, me të cilën janë punuar enët. Fragmentet nuk na japin gjith-

16) C. Praschniker — A. Schober, Vep. cit., fq. 30; C. P. Sestieri, vep. e cit., fq. 152-153 e daton në mezin e shek. IV.
17) M. Garasanin, **Moenia Aeacia,** Starinar XVII, 1966, Beograd 1967, fq. 27-34, për çështjen që na intereson fq. 34.

PO NJ COPY

monë forma të qarta dhe tani për tani kemi mundur të dallojmë vetëm disa buzë tasash; ato nuk na flasin qartë edhe për teknikën e punimit, megjithse duket se janë punuar me dorë. Por pavarësisht nga këto hollësi, të cilat me siguri do të mund të saktësohen në të ardhmen, ne drejtojmë vëmendjen tek lënda e parë, lloji i baltës, që dallon këto enë prej prodhimeve të tjera të keramikës ilire, sepse siç do ta shohim më vonë, ky element i rëndësishëm do të na çfaqet përsëri, por në forma më të zhvilluara, në keramikën e shtresave pasonjëse.

Në këtë shtresë u gjetën edhe dy copë zgjyrash, të cilat, edhe pse të pakta, paraqesin interes të veçantë, sepse dëshmojnë për prezencën e ndonjë punishteje metalesh.

Ashtu siç na paraqitet sot materiali i shtresës I do të mund të datohej si i periudhës së parë të hekurit. Do të mjaftohemi, tani për tani, me këtë datim të përgjithshëm, me që materiali është akoma i pakët dhe përpjekja për një datim më të imët do të mbetej e varfër në argumentime. Megjithatë do të shënojmë se përsëritja identike e formave të keramikës së kësaj shtrese në shtresën pasuese e lejon mbase edhe mundësinë e zbritjes së këtij datimi drejt shekujve të fundit (VI-V p.e. sonë) të periudhës së parë të hekurit.

Prania e kësaj shtrese, që i referohet një vendbanimi të hershëm në këtë qendër, nuk mund të mos e çojë mendimin tonë tek muret e hershme që pak më parë vumë në dukje se i ndeshëm në akropol. Midis tyre ne shohim një lidhje të drejtpërdrejtë, që gjen përputhje edhe nga pikëpamja kohore. Këto mure, të cilat nga pikëpamja tipologjike na kujtojnë Gajtanin apo na paraqiten pak më të përparuara se ai, si në Dorës II apo Lis II, gjejnë një mbështetje të re edhe në të dhënat stratigrafike, që na fal shtresa e parë e Zgërdheshit. Kështu ajo që, në Dorës apo Lis, na paraqitej si hipotezë, këtu duket se gjen vërtetimin e saj të parë. Pa ngulur këmbë për një përcaktim të sigurt të hapësirës që zinte ky vendbanim i parë i fortifikuar në Zgërdhesh, na duket më e besueshme se ai zinte majën e kodrës, atë që më vonë do ta zerë akropoli i qytetit.

Shtresa e dytë përmban materiale të kohës helenistike. Ajo veçohet prej së parës me një shtresë të hollë çakëlli, rreth 20-25 cm. (në profil II A), që është formuar këtu nga mbeturinat e grumbulluara gjatë punimeve për ndërtimin e murit rrethues. Kjo shtresë, e cila ka të ngjarë se mbulonte gjithë sheshin mbrapa murit rrethues të anës perëndimore, është sterile. Shtresa me materiale të kohës helenistike, që vjen mbi të, është gjithashtu rreth 20-30 cm. dhe me përmbajtje të varfër (II B). Duke shërbyer si shesh publik, kjo pjesë e qytetit duket se u mbajt gjithmonë e pastër, prandaj edhe nuk u krijuan depozitime të pasura. Si element datues për fillimin e saj na shërben keramika apule e fundit të shek. IV dhe fillimit të shek. III p.e.sonë, të cilën e ndeshim menjëherë pasi mbaron shtresa sterile e çakëllit.

Me tërë larminë e saj jeta e qytetit na paraqitet në shtresën III, që përmban material të përzier helenistiko-romak. Kjo shtresë, që është krijuar nga depozitimet e bëra në të dy anët e murit rrethues dhe, në mënyrë të veçantë nga ana e jashtme e tij, pas rënjes dhe braktisjes së qytetit, na lejon të krijojmë një ide më të qartë për historinë e kësaj qendre. Me elementet e saj ajo përcakton më mirë fizionominë e shtresës së dytë, cakton si kufi të fundit të saj shek. II p.e. sonë dhe zbulon para nesh, në mënyrë më të qartë, faktin se në shek. III-II p.e. sonë qyteti ka jetuar periudhën e tij të lulëzimit. Një veprimtari e gjerë ndërtuese, si dhe një jetë e gjallë dhe e pasur ekonomike e kulturale, karakterizojnë këtë periudhë lulëzimi. Me fillimet e saj lidhen muret rrethuese të fazës së dytë të ndërtimit, të cilat zbresin tani tatëpjetë kodrës dhe pushtojnë gjithë hapësirën maksimale të përfshirë ndonjëherë nga qyteti brenda sistemit të fortifikimit të vet. Kësaj periudhe i përkasin edhe ndërtimet kryesore brenda qytetit. Edhe pse nuk njohim mirë strukturën e brendshme të tij, ato pak elemente që përmendëm ose supozuam, na lejojnë të mendojmë se që nga kjo kohë ndërtimet kryesore të qytetit i janë nënshtruar një ideje urbanistike.

Në fushën e prodhimit kjo kohë shënon një hop cilësor të tillë që e dallon krejtësisht qendrën e re të zmadhuar nga vendbanimi i fortifikuar i mëparshëm i majës së kodrës. Të paktën tri punishte keramike, po të gjykojmë nga vulat që gjejmë mbi tjegullat, e furnizonin qytetin me këtë material të rëndësishëm ndërtimi. Në solenet kemi dalluar gjer tani monogramet *BÆ* në 5 raste, TI në 12 raste dhe A në 7 raste. (Tab. IV, 1-3), kurse në kalipteret gjejmë grafoset TI . . PI, A (Tab. IV, 4-6). Punishte të tjera prodhonin enë të shumta balte, duke filluar që nga pytosat e amforat e deri tek enët e luksit dhe të përdorimit të gjerë. Në buzën e një pytosi, gjejmë grafosin AP (tab. IV, 7). Enët e tjera janë po ato që kemi përshkruar në grupin e dytë të Xibrit [18]). Veçanti e tyre është se ato janë punuar me një baltë gri të çelët që ndryshon nga balta ngjyrë okër e nuancave të ndryshme të enëve të importuara. Në enët e luksit dhe të tryezës të këtij grupi, brumi është pregatitur prej një balte të imët që jep prodhime me parete të ho-

18) S. Islami, **Kalaja e Xibrit,** Konferenca e II e Studimeve Albanologjike (12-18 janar 1968), vëll. II. Tiranë 1969, fq. 317

lla dhe të një cilësie shumë të mirë. Një pjesë janë të mbuluara me vernik të zi të dobët që shkëputet lehtë, kurse shumica e tyre janë lyer me një lymë që, pas pjekjes, i jep faqes së enës një ngjyrë okër ose të kuqe të çelët. Tek enët e mëdha, pytosa e amfora, kjo baltë është më e ashpër dhe e përzier me një sasi rëre. Midis këtyre prodhimeve bien në sy amforat me vegje në trajtë kurrizore që kanë në fund si vulë një palmetë. Këtu në Zgërdhesh kjo vulë na përsëritet shumë herë dhe në një rast mbi palmete kemi të shtuar germën A (Tab. IV, 8 e 9).

Përveç Xibrit, Gajtanit dhe Rosujës, tani së fundi kjo keramikë është vërtetuar përsëri në veri, në Lis dhe në tumat e Çinamakut (Rrethi i Kukësit), por me gjetje të pakta. Si pika më jugore të shtrirjes së saj janë Selca e Poshtme (Rrethi i Pogradecit), që besohet të jetë Pelioni i vjetër [19]), dhe Apollonia. Në Selcë kam mundur të vërej, midis gjetjeve të tjera keramike, një numur të konsiderueshëm enësh tryeze të këtij llooji, kurse në Apolloni ajo përfaqësohet në mënyrë sporadike) me disa ekzemplarë amforash që mbajnë në vegjë vulën me palmetë. Po të përjashtojmë këtë qendër të fundit, ku kjo keramikë përfaqësohet në një numur të kufizuar vetëm me njërin nga prodhimet e saj, amforën, atëhere të gjitha pikat e tjera i takojnë zonës në Veri të Shkumbinit.

Duke bërë fjalë për këtë keramikë me rastin e Xibrit shtrova, në atë kohë, problemin e identifikimit të kësaj punishteje, prodhimet e së cilës na përsëriteshin në disa nga qendrat ku ishin zhvilluar kërkime, deri më atëhere, në Veri të vendit tonë. Sot zona e saj është zgjeruar, por megjithatë duket se ajo po gjen një kufi në Jug. Ndërkaq problemi i identifikimit të punishtes ku prodhohej kjo keramikë fiton një interes gjithnjë më të madh. Prej prodhimeve të importit ajo ndryshon krejtësisht; nuk përputhet grupi në fjalë me sa jam në dijeni, as me prodhimet keramike të Dyrrahut e Apollonis, dhe as me të ndonjë qendre tjetër në Jug të Shkumbinit, kështuqë vetvetiu, këto përjashtohen. Lisi si qytet i rëndësishëm në Veri, që mund të pritej të ishte qendra e një punishteje të tillë, me sa kanë treguar kërkimet e deritanishme, nuk duket ta ketë të vetën këtë lloj keramike. Shkodra, nga ana e saj, me gjithëse ishte kryeqendra e kësaj zone, vazhdon të heshtë nga pikëpamja arkeologjike. Vetëm Zgërdheshi na jep një përgjegje, deri tani, mbi këtë çështje. Me baltën gri të çelët që dallon grupin tonë keramik, siç e pamë, është punuar në Zgërdhesh një pjesë e keramikës ilire të shtresës së parë. Në shtresën e dytë kjo keramikë paraqitet me prodhime të një cilësie të lartë e me format më të zhvilluara të kohës, duke zenë vendin më të rëndësishëm midis gjetjeve të llojit të vet. Ajo vijon të na dalë, por më e kufizuar, edhe midis materialeve të shtresës së tretë duke u përfaqësuar këtu, ndër të tjera, edhe me një kallëp terrakote (Tab. V, 2 e 3) të kohës së Antonineve (fundi shek. I – fillim shek. II i e. sonë). Në këto rrethana, kemi arësye të mendojmë se Zgërdheshi, duke na dhënë elemente të zanafillës së kësaj keramike dhe të vazhdimësisë së saj, mund të konsiderohet edhe si qendra e punishteve që prodhonin enët me baltën karakteristike gri dhe amforat që mbajnë në vegje vulën me palmetë, së cilës, me kohë, i shtohet edhe gërma A. Megjithatë problemi kërkon gjurmim të mëtejshëm dhe ne nuk e përjashtojmë mundësinë e ekzistencës së punishteve të tilla edhe në ndonjë qendër tjetër. Në këtë rast do të ishte vetëm balta si lëndë e parë e përbashkët për një zonë të gjerë që e lidh këtë grup keramik, por një koincidencë e tillë duket më pak e besueshme.

Gjurmët e shumta të zgjyrave na flasin nga ana tjetër se qyteti kishte edhe një numër të konsiderueshëm punishtesh të metaleve, të cilat farkëtonin veglat e punës dhe armët e qytetarëve. Një ekzemplar i një përkrenareje ilire (Tab. V, 6), gjetur gjatë punimeve bujqësore në një tumë poshtë qytetit, ka të ngjarë të jetë gjithashtu prodhimi i një punishteje lokale.

Qyteti ka pasur marëdhënje të dendura tregëtare me qendrat e tjera ilire. Më lart ne pamë se prodhimet e punishteve keramike të Zgërdheshit arrinin në veri deri në Gajtan, Rosuje e Çimanak, në Lindje në Xibër e Selce të Poshtme kurse në jugë zbresin deri në Apolloni. Ndër prodhimet që vijnë në Zgërdhesh, nga qendrat e tjera ilire, nuk janë të rralla gjetjet që përfaqësojnë keramikën e Dyrrahut dhe Lisit. Ndërsa i pari përfaqësohet me enët e tavolinës të stolisura me breza dhe të lyera me vernik të zi ose kafe, i dyti me një tip amfore, që, sipas bindjes sime, është karakteristik për atë qendër. [20]) Nga mallrat e importit që vinin në Zgërdhesh nëpërmjet Dyrrahut, mbizotërojnë prodhimet apule të fundit të shek. IV dhe sidomos ato të shek. III-II, para e. sonë, midis të cilave duhet të shënojmë enët që kanë të aplikuara figurat me reliev. Ndeshen dhe fragmente të enëve të Megarës, por duket se tregëtia e Italisë jugore kishte dëbuar në këtë kohë nga Iliria gjithë konkurentët e tjerë.

19) N. Ceka – L. Papajani, **Rrugët antike në luginën e Shkumbinit,** artikull në këtë botim.

20) Falenderoj për të dhënat që permenda më lart lidhur me Dyrrahun, Apolloninë, Lisin, Rosujen dhe Çimanakun, kolegët e mi, gjurmuesit e palodhur të këtyre qendrave: V. Toçi, H. e N. Ceka, F. Prendi, K. Zheku, dhe B. Jubani të cilët patën mirësinë të më konsultojnë e të më bëjnë të njohur materialin që më interesoi.

NON-COPY

Monedhat që qarkullonin në këtë periudhë në Zgërdhesh janë kryesisht të Dyrrahut. Midis tyre, gjejmë të tilla me Herakli-armë, që Dyrrahu i hedh në qarkullim qysh nga gjysma e dytë e shek. IV p.e.s. dhe të tjera me Zeus – trekëmbësh dhe Helios-anije, që i përkasin shekujve III e II p.e.sonë. Duket se Zgërdheshi kishte me këtë qytet të madh lidhje të forta ekonomike. Nga monedhat e huaja deri tani njohim vetëm një ekzemplar të Demetrit II të Maqedhonisë me mburojë-përkrenare.

Për jetën kulturale të qytetit tani për tani na flasin terakotat që kemi gjetur gjatë gërmimit dhe një shtat i vogël mermeri i Artemisit, i gjetur në arat poshtë qytetit (Tab. V, 1 e 5).

Por gjatë kësaj periudhe, Zgërdheshi ka jetuar edhe çaste të rënda të historisë së vet. Muret e periudhës së tretë të ndërtimit me bloqet kuadrate, të punuara në stilin rustika me shirit anësor, sikurse e kemi thënë më lart, janë dëshmi e një shkatërrimi të rëndë që ka pësuar qyteti. Është vështirë të caktohet koha e saktë e kësaj ngjarjeje, por asnjë rast tjetër nuk do të vinte në konsideratë më tepër se sa periudha e luftrave iliro-romake. Sigurisht këtu duhet të kemi parasysh jo luftën e fundit, por të parën, ndryshe nuk mund të shpjegohej një veprimtari e tillë rindërtuese. Me periudhën para luftës së fundit ndoshta do të mund të lidhej rindërtimi i kullës së rrumbullaktë nr. 13. Kjo periudhë e dytë e historisë së Zgërdheshit merr fund me pushtimin romak.

Materialet që lidhen me shtresën e tretë të kohës romake, në përgjithësi janë të varfëra. Në keramikë çfaqen elementet e reja të kohës dhe në tjegullat romake gjejmë një vulë të re MIM. Ajo që tërheq vemendjen tonë, në këtë rast, është keramika helenistike, e cila vazhdon të përsëritet, megjithëse në një masë më të kufizuar. Serisë së prodhimeve keramike me baltën gri të çelët i shtohen këtu edhe terrakotat, bashkë me kallëpin për prodhimin e tyre, të cilin e përmendëm pak më lart. Sa vazhdon të jetojë kjo keramikë tani për tani është vështirë të thuhet. Interes të veçantë paraqesin nga kjo pikëpamje tjegullat solene të tipit helenistik që mbajnë në shpinë shenjën . Një ekzemplar të këtij lloji e gjetëm të plotë, të shtruar në një varr të shek. IV të e. sonë, krahas tjegullave të tjera romake. Duke ruajtur format dhe përmasat e zakonshme të tjegullave helenistike, këto tjegulla kanë vazhduar të prodhohen, me sa duket, krahas atyre të tipit romak deri në kohën e vonë antike. Ky fenomen i ruajtjes me këmbëngulje të formave të vjetra në prodhimet keramike fiton një rëndësi të madhe lidhur me problemin e ruajtjes dhe vazhdimësisë së traditave të vjetra në kohën romake.

Përsa i përket qytetit në tërësi, ai, gjatë kësaj kohe, duket se humbet rëndësinë e dikurshme. Nuk vërejmë më asnjë ndërtim të rëndësishëm dhe as ndonjë jetë ekonomike të gjallë. Gjetjet që u bënë në nekropolin buzë murit rrethues të anës perëndimore te kulla nr. 2 dhe porta bri saj, (Gërmimi b) tregojnë se, aty nga shek. IV i e. sonë, muret rrethuese kanë humbur rëndësinë dhe funksionet e dikurshme, përderisa buzë tyre vendoset një varrezë. Që nga kjo kohë, qyteti fillon të braktiset dhe banorët e tij duket se shpërngulen në një qendër tjetër. Ka shumë të ngjarë që kjo të ketë qenë Kruja e ardhshme, por ne nuk do të shtyhemi në këtë çështje, që nuk është objekt i këtij punimi.

* * *

Thamë më lart se Hanit i takon merita të ketë hedhur i pari mendimin se te rrënojat e Zgërdheshit duhet të kërkohet Albanopoli i vjetër. Interesi për këtë qytet u lidh kështu edhe me emrin kombëtar të shqiptarëve. Që nga kjo kohë argumenta të reja bindëse në favor të këtij mendimi nuk kanë dalë, megjithatë, hipoteza e Hanit mbetet gjithmonë një hipotezë pune me shumë vlerë, që ka nxitur dhe do të nxitë edhe në të ardhmen kërkimet shkencore në këtë drejtim. Fakti që në zonën midis Matit dhe Shkumbinit, në të cilën Ptolemeu vendos Albanapolin [21]) si qytetin më të shënuar, nuk njohim një qendër tjetër më të madhe antike se sa Zgërdheshin, e bën këtë hipotezë të qëndrojë ende e fortë. Përpjekjet e posa filluara për t'a hetuar këtë çështje duhet dhe ka të ngjarë që të shtrihen edhe në qendra të tjera, por besojmë se Zgërdheshi, si i tillë, do të mbetet në qendër të vëmendjes.

Duhet të mos harrojmë nga ana tjetër se tek rrënojat e Zgërdheshit kemi mbeturinat e një qyteti të rëndësishëm ilir, që u ngrit e lulëzoi në afërsitë e një qyteti të madh si Dyrrahu, prandaj edhe për këtë fakt meriton të gjurmohet posaçërisht.

Motivet e përmendura më lart kanë nxitur autorin e këtij punimi t'i hyjë gjurmimit të kësaj qendre me shpresë se do të mund të kontribuojë, sadopak, në ndriçimin e çështjeve të veçanta, që lidhen me të dhe nëpërmjet saj dhe në studimin e qytetit ilir në përgjithësi.

21) Ptolem. – III, 12,20

BOTIMET SHTETËRORE

TAB. I



1



2

DO NOT COPY











DO NOT COPY













DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. V



DO NOT COPY

Selim ISLAMI

LA CITE ILLYRIENNE DE ZGËRDHESH

RESUME

Il y a plus de cent ans, le savant autrichien, J.G. Hahn, ayant visité la forteresse illyrienne de Zgërdhesh, proche de Kruje, émit l'opinion que c'était sur ces lieux qu'il convenait de rechercher l'Albanopolis antique. Ce centre fut visité à nouveau durant la première guerre mondiale par un autre archéologue autrichien C. Praschniker. Une brève description et un ébauche de plan, qu'il nous a léguées, constituent la contribution qu'a été en mesure de nous fournir, après sa courte visite, ce chercheur, par ailleurs connu pour ses observations attentives. Comparées à celles des deux auteurs précités, les notes de l'archéologue italien, P. Sestieri, n'apportent rien de nouveau.

Durant l'été 1969, une mission de l'Institut des monuments culturels, composée d'archéologues, de restaurateurs et de topographes, y a entrepris des travaux. Ce travail se propose de retracer les résultats historico-archéologiques qu'elle a obtenus.

Les ruines de Zgërdhesh s'étendent au sud-ouest de Kruje, en un site appelé Kakariq. Une route carrossable de village qui bifurque à mi-chemin de la route Fushë-Krujë-Krujë, conduit en qelques minutes d'auto juste au pied de la forteresse. La cité se dressait sur le versant d'une petite colline, qui revêt sur cette face la forme d'un triangle isocèle. Le site choisi remplissait toutes les conditions requises pour la création et l'essor d'une cité antique. A ses pieds, s'étalaient une vaste plaine fertile et de riches pâturages; d'importantes voies de communication sillonnaient la région du nord au sud et de l'ouest à l'est, reliant notamment le littoral aux contrées reculées de l'intérieur.

Le relevé planimétrique de Zgërdhesh, que nous a laissé Praschniker n'est ni précis, ni complet. Il ne comprend par la ville basse. Bien que cet auteur constate l'existence d'une seconde ligne de fortification et avance l'hypothèse d'une extension éventuelle de la ville, il hésite à y souscrire définitivement.

La ville occupait une superficie d'environ 10 ha. De puissants remparts, d'une longueur totale de quelque 1400 m. en assuraient la défense de toutes parts et principalement sur les côtés ouest et est, les plus exposés aux attaques de l'extérieur. Un mur transversal séparait la ville haute, l'acropole, de la ville basse (voir la planimétrie, fig. 2).

On a pu situer jusqu'à ce jour trois portes de la ville. La porte principale devait s'ouvrir au point U', à un endroit qu'occupe aujourd'hui une maison villageoise. Une autre porte, qui faisait communiquer la ville basse avec l'acropole, devait vraisemblablement se trouver au point F'.

Le territoire sur lequel s'étendait la ville avait été aménagé en terrasses, soutenues par des murs, pour permettre la construction d'édifices publics et privés. Les traces d'une rue qui traverse la porte nord au point E, conduisent, dans un sens, vers la porte présumée de l'acropole et, dans l'autre, vers le bas, à un escalier taillé dans le roc, pour aboutir, apparemment, à la porte principale de la ville. L'espace qui s'étend devant les remparts à l'est semble avoir servi pour les réunions publiques et le marché principal de la cité. En de nombreux points, on relève des murs en ruine de bâtiments.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Les trouvailles archéologiques témoignent que la ville s'étendait également hors des murs d'enceinte.

Les éléments topographiques relevés sont reproduits dans le nouveau plan dressé, plan qui, bien entendu, nécessitera des corrections et des précisions complémentaires.

Les indications que nous ont laissées les chercheurs antérieurs sur la technique de construction des murs d'enceinte ont un caractère général et ne répondent pas exactement à la réalité. L'examen de ces murs et du système de fortifications dans son ensemble, nous a permis de déterminer plusieurs phases de construction qui correspondent aux divers périodes constructives et historiques de cette ville.

Les murs les plus anciens, construits en blocs de pierre, bruts ou grossièrement taillés, comme le sont ceux de Gajtan et de Dors, entouraient le sommet de la colline, où par la suite, fut créée la ville, formant ainsi un lieu fortifié pour les premiers habitants qui s'y fixèrent. A cette agglomération correspond la plus ancienne couche culturelle découverte au cours des fouilles archéologiques, et qui remonte à la première période du fer (VIe et Ve siècles avant notre ère).

La seconde période constructive est représentée par des murs, faits de blocs parallélépipèdes, à la face extérieure rectangulaire, toutes les faces étant par ailleurs parfaitement polies et les blocs équarris de manière à en assurer l'ajustement parfait.

Les vestiges du type de mur que nous venons de décrire sont ceux que l'on retrouve en plus grande quantité parmi les ruines de la ville; il apparait qu'ils se rattachent à une période d'épanouissement de la construction, marquée par de grands travaux de fortification et l'érection des principaux édifices de la ville.

A la troisième période constructive appartiennent les murs faits de blocs parallélépipèdes isodomiques, de style rustica, bordés d'un liséré. Les constructions de cette période constituent une part considérable dans le volume général des constructions de la ville, mais, tant par leur aspect extérieur que par leur qualité, ils ne soutiennent pas la comparaison avec ceux de la période antérieure. Ces constructions semblent avoir été entreprises à la suite de graves dommages subis par les remparts aux points névralgiques du système de défense; au milieu du mur ouest, apparemment à proximité de la porte principale, au mur est et au mur intérieur de l'acropole.

La tour ronde donnant à l'est (nr. 13) paraît présenter des vestiges d'une quatrième période constructive où les murs sont faits de blocs parallélépipèdes, grossièrement travaillés, remis en usage et mal liés.

Ce classement des murs d'enceinte que nous ne tenons pas pour definitif, nous paraît pour le moment répondre le mieux à la réalité.

Les données stratigraphiques recueillies au cours des fouilles, ont permis d'élucider les circonstances dans lesquelles ces constructions ont été réalisées. Aux premiers temps de la seconde couche, qui doit dater de la période allant de la fin du IVe au début du IIIe s. av. n. è., appartiennent les murs d'enceinte de la deuxième phase de construction; ils descendent maintenant vers le bas de la colline et englobent la plus grande étendue que la ville ait jamais couverte à l'intérieur de son système de fortification. Aux IIIe et IIe siècles, la ville a connu son plus grand épanouissement. Cette période se caractérise par une activité constructive intense ainsi que par une floraison économique et culturelle. C'est de cette période que datent également les principales constructions à l'intérieur de la ville. Bien que nous ne connaissions pas encore bien sa structure intérieure, le peu d'éléments que nous venons d'évoquer ainsi que ceux que nous avons lieu de déduire, nous incitent à croire que les principales constructions de la ville obéissaient à une idée directrice d'urbanisme.

Dans le domaine de la production, cette époque marque un bond qualitatif tel, que le nouveau centre agrandi se distingue très nettement de l'agglomération fortifiée antérieure au sommet de la colline. Au moins trois ateliers de céramique, à en juger par les timbres portent les tuiles, approvisionnaient la ville en cet important matériau de construction. D'autres ateliers fabriquaient de grandes quantités de vases en terre cuite, depuis

DO NOT COPY

des amphores jusqu'à des vases de luxe. Nous avons des raisons de penser que la céramique, ainsi que les amphores portant, empreinte, une palmette, sur laquelle s'inscrit partois la lettre A, sont des productions de la Zgërdhesh antique.

Les abondantes traces de scories de minerai de fer, indiquent par ailleurs que la ville possédait un bon nombre d'ateliers où étaient les instruments de travail et les armes des citadins. Un exemplaire de casque illyrien, trouvé au cours de travaux agricoles dans un tertre funéraire en dehors de la ville, est, selon toute vraisemblance, la production d'un atelier local.

La ville entretenait des relations commerciales suivies avec les autres centres illyriens. Ses ateliers, comme l'attestent les trouvailles archéologiques, approvisionnaient en produits céramiques une vaste zone au nord du Shkumbin. Des trouvailles sporadiques d'objets de cette provenance, se relèvent dans le sud jusqu'à Apollonie. Il n'est pas rare de trouver à Zgërdhesh des objets de céramique portant la marque de Dyrrah et de Lis. Parmi les marchandises importées de l'étranger, prédominent les produits d'Apulie de la fin du IVe siècle et surtout des IIIe et IIe siècles avant notre ère. On trouve aussi des fragments de vases de Mégare, mais à cette époque, semble-t-il, le commerce de l'Italie méridionale avait évincé d'Illyrie tous ses concurrents.

Les monnaies qui circulent alors à Zgërdhesh proviennent principalement de Dyrrah. On en trouve, émises dès la seconde moitié du IVe siècle avant notre ère, qui portent sur l'avers la représentation d'Héraclès, et sur le revers, des armes, et d'autres avec Zeus et un trépied ou Hélios et un navire, qui datent des IIIe-II siècles avant notre ère. Il en ressort que Zgërdhesh entretenait d'étroites relations économiques avec cette grande cité. En ce qui concerne les monnaies étrangères, nous disposons à ce jour d'un exemplaire portant le monogramme de Démètre II de Macédoine, avec un bouclier sur l'avers et un casque sur le revers.

Les témoignages de la vie culturelle de la ville, recueillis jusqu'à présent, consistent dans des terres cuites, trouvées au cours de fouilles faites hors de la ville.

Mais, durant cette même période, Zgërdhesh a connu aussi de graves moments de son histoire. Les constructions de la troisième période donnent à penser que la cité a été entraînée dans un conflit. Il est malaisé de fixer la date exacte de ces événements, mais aucune période ne semble plus vraisemblable que celle de la première guerre illyrienne de Rome.

La conquête romaine marqua aussi le déclin de la cité. On ne trouve, de cette époque, aucune construction importante ni aucun signe de vie économique intense.

Au IVe siècle avant notre ère, les remparts ont totalement perdu leur ancien rôle, au point que les lieux qui s'étendent à leur pied, sont utilisés comme cimetière. Dès lors, la ville est peu à peu abandonnée, et ses habitants doivent s'être transplantés dans une autre agglomération, très probablement dans la future Kruje.

J.G. Hahn a le mérite, comme nous l'avons dit, d'avoir émis le premier l'opinion que c'est sur les ruines de Zgërdhesh qu'il faut rechercher l'Albanopolis antique. L'intérêt pour cette cité se rattache donc aussi à l'appellation nationale des Albanais. Depuis lors, aucun argument convaincant n'est venu appuyer cette hypothèse. Elle n'en demeure pas moins très valable et elle a stimulé et continuera de stimuler les recherches scientifiques dans ce sens. Cette hypothèse est encore mieux étayée par le fait que, dans la zone comprise entre le Mat et le Shkumbin, où Ptolémée situe précisément Albanopolis, la citant par ailleurs comme la ville la plus importante de cette contrée, on ne connaît pas de centre antique plus important que Zgërdhesh. Il se peut et il est également souhaitable que les efforts à peine entrepris pour élucider cette question portent aussi sur d'autres centres. En tout état de cause, Zgërdhesh, en tant que grand centre antique, continuera d'attirer le meilleur de l'attention des chercheurs.

Il faut avoir en vue d'autre part que ces ruines sont celles d'une importante ville illyrienne qui fut fondée et fleurit non loin d'une grande cité comme Dyrrah, et qu'elles méritent de ce fait d'être l'objet de recherches particulières.

DO NOT COPY

Neritan CEKA — Lazër PAPAJANI

DO NOT COPY

RRUGA NË LUGINËN E SHKUMBINIT NË KOHËN ANTIKE

Nga pikëpamja gjeografike lugina e Shkumbinit (Tab. I) ka qenë që në kohën e lashtë një nga rrugët më të përshtatshme natyrale për komunikimin ndërmjet pjesës bregdetare të Ilirisë së Jugut dhe brendësisë së Ballkanit.

Gjatë gjithë rrjedhjes së poshtme, deri në Elbasan, të dy brigjet e lumit përshkohen lehtë dhe nga ana tjetër s'ka asnjë pengesë natyrale, për rrugët që vinin për t'u bashkuar aty nga veriu dhe jugu. Më tutje, deri në Xibrrakë, ku fillojnë grykat e ngushta të Shkumbinit, është preferuar për kalim bregu i djathtë i lumit. Këtu rruga ka qënë e detyruar të hedhë lumin dhe t'i ngjitej malit të Polisit për tek Qafa e Gajorit, nga ku, në drejtim pothuaj horizontal, kalonte në një terracë në lartësinë 600 m. mbi nivelin e detit për të zbritur, pas 20 km, përsëri në shtratin e lumit, pranë Quksit. Duke ndjekur luginën e Shkumbinit dhe pastaj një kurriz kodrash, nga Selca e Poshtme në grykën e Çervenakës, dilej në Pogradec, ndërsa vazhdimi i rrugës drejt lindjes, për në Qafën e Thanës, nxirrte në Ohër.

Lugina e Shkumbinit në këtë distancë komunikon nëpërmjet rrugëve natyrale me zonat në veri dhe në jug të saj. Nga lugina e Erzenit, shtratet e përrenjve dhe qafat e ulëta të malësisë së Krrabës, Cacabezës dhe Peqinit, paraqesin disa mundësi kalimi për në luginën e mesme të Shkumbinit: nëpër përroin e Pezës, në Gjozaj e Sinametaj, del midis Rogozhinës dhe Peqinit; nga Pezë-Helmës, nëpër kurrizin e kodrave, kalon pranë Dorëzit, Vrapit, Garunjës së madhe dhe nëpër Progër zbret në Peqin; nga Arbana futesh në luginën e Zhullimës, e cila të çon pranë Bodinit dhe që këtej Përroi i Paprit të nxjerr në Shkumbin; duke u nisur nga Petrela mund të ndiqet faqja perëndimore e vargut të Krrabës nëpër Durisht e Tërbaç, për të zbritur nëpër Fikas në luginën e Shkumbinit, ose faqja lindore për në qafën e Krrabës, Mamël, Shinjon, për të dalë pothuaj në të njëjtin vend. Për nga jugu rrugët nuk kishin asnjë pengesë natyrale, por sidoqoftë ekzistojnë disa rezultante tradicionale të tyre. Buzë kodrave të Lushnjës një rrugë që vinte nga Myzeqeja e takonte Shkumbinin përballë Rogozhinës. Po nga Lushnja kishte dy degëzime, që dilnin përballë Peqinit përmes kodrave të Darsisë, duke kaluar njëra nëpër Çelhakaj dhe tjetra nëpër Ballagat. Udhëtarët që kalonin Semanin pranë Kuçit, mund të kalonin përmes Dumresë deri në Gradishtë, ku rruga ndahej në dy degë: e para, nëpër luginën e Përroit të Zi, dilte përballë Bishqemit, ndërsa tjetra kthehej nga lindja për në Shalës dhe përmes fushës, apo buzë kodrave të Shpatit, hynte në Elbasan nga ura e Topçiasit. Me këtë degë bashkoheshin edhe rrugët që vinin nga luginat e poshtme të Osumit dhe Devollit. Lidhja me luginën e mesme të këtij të fundit vendosej duke kaluar nëpër luginën e Holtës, në Galigat, Valësh e Shelcan. Në luginën e mesme të Shkumbinit, në Malin e Gajorit, nga arteri kryesor i rrugës shkëputej një degë, që zbriste tek ura e Kamares, futej në luginën e Rapunit dhe, nëpër Fushë Studën dhe Steblevë, dilte në Dibër.

Në studimet e deritanishme historia e rrugës nëpër luginën e Shkumbinit është identifikuar pa të drejtë me historinë e *via Egnatia*, të ndërtuar nga pushtonjësit romakë për qëllimet e tyre ushtarake e politike. Që këtej rrjedh prirja e këtyre punimeve, për t'u marrë kryesisht në përcaktimin e stacioneve dhe të largësive midis tyre, duke e parë rrugën Egnatia si një trup të huaj në jetën dhe historinë e vendit që përshkon.

Në konceptin tonë *via Egnatia*, si rrugë romake, përbën vetëm një etapë në historinë e komunikacionit në luginën e Shkumbinit. Shumë kohë përpara pushtimit romak ka patur në luginën e Shkumbinit një ar-

ter të vërtetë ekonomik, të lidhur ngushtë me një numur vendbanimesh, të ngritura pranë saj. Kjo lidhje del qartë në të gjitha etapat historike, gjatë të cilave, funksionoi rruga. Për lehtësi të paraqitjes së materialit ne po i grupojmë ato në:

I. Periudhën pararomake — Rruga e Kandavisë; (Tab. I)

II. Periudhën e pushtimit romak — Rruga Egnatia. (Tab. II)

Nga pikëpamja metodike ne jemi udhëhequr nga ideja se rruga, më tepër se trase, kalldrame dhe ura, është një komponente e lëvizjeve ekonomike, politike dhe kulturale. Si rrjedhim, jemi munduar të krijojmë një tabllo sa më të qartë të këtij fenomeni kompleks, duke studiuar gjurmët materiale të këtyre lëvizjeve, siç janë në radhë të parë vendbanimet, pastaj mbeturinat e traseve dhe urave, stacionet, materiali numizmatik, gjetjet e veçuara arkeologjike etj. Ne do të përqëndrohemi kryesisht në historinë e periudhës pararomake të rrugës, duke u mbështetur në rezultatet e kërkimeve arkeologjike të pasçlirimit dhe në vrojtimet në terren gjatë disa ekspeditave të organizuara nga Instituti i monumenteve të kulturës në gjurmët e rrugëve të vjetra në luginën e Shkumbinit.

* * *

Të dhënat arkeologjike janë pothuajse të vetmet burime që flasin për periudhën pararomake, që është më e gjata në historinë e rrugës. Në fillim të rralla, në formën e gjetjeve të shkëputura, ato bëhen më të shpeshta dhe bindëse gjatë periudhës së parë të hekurit dhe periudhës së qyteteve ilire.

Për periudhën e bronxit, gjetja në tumat e Pazhokut e një ene të importuar nga Mikena, e cila datohet në heladikun e vonë [1]), na jep të kuptojmë, se lugina e poshtme e Shkumbinit shërbente si rrugë tregëtare, për të lidhur bregdetin me krahinat e brendshme të vëndit dhe anasjelltas. Dy gjetje, që i takojnë fundit të kësaj periudhe, e plotësojnë më qartë kuadrin. Një sopatë bronxi e tipit Shkodran, e gjetur veças në fshatin Tërbaç [2]), në një qafë ku kalonte rruga tradicionale për në Tiranë, tregon për lashtësinë e rrugës që përshkonte faqen perëndimore të vargut të Krrabës. Një sopatë e të njëjtit tip, e gjetur në Shelcan [3]), dëshmon për një rrugë tjetër, që lidhte luginën e Shkumbinit me atë të Devollit, duke kaluar nëpër Shpat.

Natyrisht gjetjet e sipërpërmendura janë mjaft të kufizuara, por kuptimi i tyre është i qartë, sidomos në qoftë se kemi parasysh se periudha e bronxit është koha kur vendoset uniteti kultural i ilirëve [4]), (ku përfshihen edhe maqedonët). Kjo presupozon marrëdhënje të ngushta ekonomike dhe kulturale midis trevave perëndimore dhe lindore. Për këtë një rol me rëndësi kanë luajtur pa dyshim luginat e lumenjve, midis të cilëve edhe lugina e Shkumbinit.

Historia e vërtetë e rrugës që kalon nëpër luginën e Shkumbinit fillon me periudhën e hekurit. Zhvillimi i forcave prodhuese dhe çthurja e mëtejshme e bashkësisë primitive, nxitën zgjerimin e shkëmbimit midis krahinave. Vendbanimet e fortifikuara, që lindin në këtë periudhë, janë produkt i këtyre fenomeneve ekonomike shoqërorë dhe nuk është e rastit vendosja e tyre pranë rrugëve natyrale.

Gjatë rrugës së Shkumbinit kemi dy vendbanime të tilla. Njëri në shkëmbin e Shënlliut, [5]) pranë Elbasanit, i vendosur mbi një lartësi, që paraqet një fortesë natyrale. Prej aty kontrollohet nga afër lugina e Shkumbinit, si dhe rrugët që kalonin nga fusha e Tiranës për në këtë luginë nëpër të dy anët e vargut të Krrabës. Gjetja e keramikës së pikturuar gjatë sondazheve në këtë vend [6]), jo vetëm që na vlen për datimin e vend-banimit në periudhën e parë të hekurit, por dëshmon nga ana tjetër për lidhje kulturale me pellgun e Korçës, ku kjo keramikë u prodhua më herët. Në bazë të këtyre lidhjeve qëndronin sigurisht marrëdhënjet ekonomike.

Qyteza tjetër, në Qukës-Skënderbej, gjendet në thellësi të rrugës, atje ku lugina hapet përsëri, pranë Qukësit. E vendosur mbi një shkëmb në bregun e majtë të Shkumbinit, ajo kontrollonte rrugën nëpër tarracën e Shkumbinit dhe atë nëpër lugjet e maleve [7]). Qyteza ka qenë e rrethuar me një mur gurësh të palatuar, me lidhje të thatë vetëm në pjesët ku afrimi nuk pengohet nga shkëmbenjtë e thiktë. Ky lloj muri dhe

1) S. Islami, H. Ceka, **Nouvelles données sur l'antiquitê illyrienne en Albanie.** Studia Albanica. I. 1964, fq. 97. Tab. VII. 1.
2) N. Ceka, **Gjurmime arkeologjike** në krahinën e **Elbasanit. Materiale të sesionit arkeologjik,** Tiranë 1968, fq. 106.
3) F. Prendi, **Sopata të pabotueme të epokës së bronxit të zbulueme në Shqipni,** B.SH.SH. 1, 1958, fq. 208.
4) S. Islami, H. Ceka, **Po aty,** fq. 95.
5) N. Ceka, **Po aty,** fq. 110
6) Sondazhet u kryen në gusht të vitit 1968 nga N. Ceka. Rezultatet nuk janë botuar.
7) Kjo rrugë fillonte në Qafën e Gajorit mbi Polis dhe duke kaluar në lugjet e maleve dilte në luginën e sipërme të Shkumbinit, pranë Bërzeshtës.

DOKUMENT

gjetje të rralla të keramikës lokale të punuara pa çark e datojnë vendbanimin në periudhën e parë të hekurit.

Vendbanime të të njejtit tip lindën edhe në degëzimet veriore dhe jugore të rrugës. Në degën që lidhte luginën e Shkumbinit me atë të Devollit të mesëm, kemi në këtë kohë kalanë e Lleshanit [8]), të vendosur mbi një grup shkëmbinjsh, buzë të cilëve kalon edhe sot rruga tradicionale. Mbi njërin prej tyre ka qenë ndërtuar një akropol, rrethuar me një mur me bllloqe të papunuara. Gjetja e keramikës ilire, e periudhës së parë të hekurit, tregon për kohën e ngritjes së vendbanimit. Po të njëjtin tip muresh dhe keramike të ngjashme kemi edhe në kalanë e Valshit [9]), në vazhdim të kësaj rruge për nga jugu.

Në rrugën, që vinte nga fusha e Myzeqesë, përmes Dumresë në luginën e Shkumbinit, lindi vendbanimi i Gradishtës. Ai pat si nisje një vendbanim të hapur në fushën pranë tij, fillimet e të cilit janë që nga koha e bronxit [10]). Është interesante të vihet në dukje se ky i fundit vazhdon të ekzistojë gjatë gjithë periudhës së parë të hekurit dhe pikërisht aty gjendet keramikë e shek. VII - VI p.e.s. e importuar nga Greqia.

Nga veriu, në rrugën që vinte nga lugina e Erzenit dhe që ndiqte kurrizin e kodrave, për të dalë në Vrap e pastaj në zonën e Peqinit, kemi kalanë e Dorsit [11]), një nga vedbanimet më karakteristike të periudhës së parë të hekurit.

Në drejtim të luginës së Zhullimës kishte një degëzim tjetër të kësaj rruge, që të çonte buzë kalasë së Bodinit [12]), një vendbanim tjetër i periudhës së parë të hekurit, i rrethuar ashtu si Dorsi me mure prej gurësh të mëdhenj, të palatuar. Që këtu rruga të çonte nëpër shtratin e përroit të Papërit për në luginën e Shkumbinit.

Fundi i periudhës së parë të hekurit karakterizohet nga fenomene ekonomike, shoqërore, që ndikuan gjerësisht në historinë e rrugës nëpër luginën e Shkumbinit. Shkëmbimi ishte zgjeruar shumë si rezultat i thellimit të shthurjes së marrëdhënjeve fisnore. Nga kjo u favorizua edhe tregëtia greke, që filloi të depërtojë në Iliri nëpërmjet kolonive të bregdetit, Epidamnit dhe Apollonisë.

Duke ndjekur rrugën e Shkumbinit, prodhimet korintike prej bronxi, keramike ose qelqi, arrinin deri në zonën e liqenjve Linkeste. Studjonjësit e nekropolit të Trebenishtit [13]) kanë shprehur mendimin se një pjesë e prodhimeve të importuara të këtij nekropoli të shek. VI-IV p.e. sonë, duhet të kenë ardhur nga Dyrrahu dhe Apollonia, pra në një rrugë që mund të kalonte vetëm në luginën e Shkumbinit.

Do të ishte gabim të mendonim se rruga i shërbente tani vetëm qarkullimit të mallrave greke, siç shprehet në hipotezën e tij Stadtmyler [14]). Me të vërtetë eksporti grek në shek. VI-IV p.e. re zë një vënd me rëndësi në volumin e mallrave të lëvruara në këto zona, por kjo, sigurisht, është e lidhur me interesin e veçantë që kanë paraqitur minierat e pasura me hekur në zonën e Pishkashit.

Në shek. IV - III p.e. sonë një pjesë e vendbanimeve të fortifikuara buzë rrugës së Shkumbinit kthehen në qendra qytetare. Krijohen gjithashtu qendra të reja me karakter zejtar dhe tregëtar. Duke patur në bazë të jetës së tyre ekonomike shkëmbimin e mallrave, ato ishin të lidhura ngushtë me rrugët tregëtare.

Shkëmbi i Shënlliut në këtë kohë rrethohet me një mur prej gurësh të punuar të tipit të Lisit (fig. 1). Po kështu, në rrugën që vinte nga Dyrrahu nëpër bregun e djathtë të Shkumbinit, në zonën e Peqinit, ngrihet nga fillimi një kala ilire. Kodra e Saragut, pranë fshatit Pajovë, që u zgjodh për këtë qëllim, nuk i kishte të tëra cilësitë, që kërkonin ndërtonjësit ilirë të kështjellave: faqet jugore dhe lindore të saj nuk ishin mjaft të rrëpinta dhe lejonin afrimin e armikut; gjithashtu guri ishte i një cilësie të dobët dhe fare pak i përshtatshëm për ngritje muresh. Duket qartë se kemi një ndërtim me plan të përcaktuar, për të cilin është shfrytëzuar kryesisht pozita e mirë e kodrës mbi luginën e Shkumbinit, atje ku ajo ngushtohet pranë Bishqemit dhe ku takohet me rrugën që vjen nga zona e Tiranës nëpër luginën e përroit të Pajovës, si dhe me atë, që vjen nga Gradishta nëpër Përroin e Zi. Muri i ngjashëm me Irmajn (fig. 2) dhe tipet e keramikës me vernik të zi e datojnë ndërtimin e kësaj kështjelle në fillim të shek. III p.e. sonë.

---

8) N. Ceka, Vep. cit, fq. 107.
9) Po aty, fq. 108.
10) Në verën e vitit 1969 u kryen në këtë vendbanim gërmime shpëtimi nga autorët. Rezultatet nuk janë botuar.
11) H. Ceka, **Zbulimi i një qyteti antik ilir në rrethin e Tiranës,** B.I.SH. 1, 1951, fq. 86-89.
12) N. Ceka, **Po aty,** fq. 111.
13) V. Lahtov, **Problem Trebeniske kulture,** Ohrid, 1965, fq. 120-121.
14) G. Standtmüller, **Forschungen zur albanischen Frühgeschichte. Archivum Europae Centro-Orientalis,** 1941, VII, fq. 100.

DOKUMENTI



Fig. 1 — Muri i kullës në shkëmbin e Shënlliut.

Në grykën e Shkumbinit pranë fshatit Xibrakë, gjetëm gjurmët e një vendbanimi ilir të periudhës së dytë të hekurit. Ai është vendosur mbi një shkëmb, që ngrihet në bregun e djathtë të Shkumbinit. Vetë pozita e paafrueshme e këtij shkëmbi e ka bërë të panevojshëm ndërtimin e mureve rrethuese. Keramika karakteristike për fillimin e periudhës së dytë të hekurit përzihet aty me keramikën e periudhës qytetare ilire.

Në Selcën e Poshtme [15]), në rrugën që të çonte nëpër Çervenakë, Pogradec dhe fushën e Korçës për në Maqedoni, krijohet një tjetër vendbanim qytetar, më i madhi në luginën e Shkumbinit. Sot nuk ruhen më mure mbi tokë, por nga gjurmët e guroreve antike dhe bloqeve të rrëzuar duket qartë se ato rrethonin një territor mjaft të gjerë, një qytet të vërtetë (fig. 3). Varret monumentale të zbuluara aty dëshmojnë për një fuqi ekonomike dhe një nivel të lartë kulture. Me këtë rrugë lidhet sigurisht edhe kalaja e Pogradecit, që në këtë kohë rrethohet me mure gurësh të punuar [16]).



Fig. 2 — Faqe e një kulle në murin rrethues Sarag.

15) Vrojtimet e para janë bërë në këtë qendër nga H. Ceka. **Zbulimi i dy qendrave antike në Shqipëri,** B.I.SH., 1., 1948, fq. 64-67.
16) V. Manastirliu, **Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Pogradecit,** Materiale të sesionit arkeologjik, Tiranë 1968, fq. 118.

DO NOT COPY

Qendra të fortifikuara me karakter qytetar formohen edhe në degëzimet e rrugës kryesore. Në rrugën që vinte nga lugina e Erzenit, nëpër faqen perëndimore të Krrabës, ishte krijuar qendra qytetare në malin e Vilës, pranë Petrelës [17]), e rrethuar me mure karakteristike të shek. IV p.e.sonë. Në vazhdim të kësaj rruge gjejmë një pikë të fortifikuar ilire në kullën e Gracenit [18]), ku mure prej gurësh të punuar përciptas, rrethojnë një territor mjaft të vogël, që mund të vlente vetëm si post vrojtimi.

Një qendër qytetare krijohet edhe në kalanë e Dorsit, ku muret e herëshme ilire, duke filluar nga shek. V p.e. sonë, zëvendësohen në pjesën më të madhe të sistemit të fortifikimit nga mure me gurë të punuar. [19]).

Në Gradishtë, gjithashtu, zhvillohet jeta qytetare, por vendbanimi mbetet i parrethuar me mure, duke e mbështetur mbrojtjen në faqet e thikta dhe të pafrueshme të kodrës.

Në rrugën që kalonte nëpër Sulovë, në bregun e majtë të Devollit, kemi një vendbanim të ri qytetar, kullën e Kamunahut, të rrethuar me mure krejt të ngjashme me ato të Irmajt. [20])

Më së fundi, tiparet e jetës qytetare i gjejmë edhe në Lleshan dhe Valsh, ku vazhdojnë të ruhen muret e tipit ilir, pa futur teknikën e re të ndërtimit.

Midis gjithë këtyre qendrave ka një ngjashmëri funksionale dhe një unitet kultural. Ky i fundit del qartë nga krahasimi i keramikës së përdorimit të gjerë, që gjendet në to, dhe që është në përgjithësi prodhim i vetë këtyre qendrave qytetare. Nga ky krahasim kuptohet, gjithashtu, se keramika ishte një nga mallrat kryesore, që qarkullonte në rrugën e luginës së Shkumbinit.

Eksporti grek është kufizuar me enët luksoze me figura ose me vernik të zi, të Dyrrahit, të Apollonisë dhe të Italisë së Jugut. Gjejmë edhe amfora, që dëshmojnë për eksportimin e verës, mbi të cilën bëhet fjalë edhe në një nga pasazhet e Aristotelit (De mir. ausc. 839 b, 104), ku përmendet shitja e verës në krahinat e brendshme ilire me amfora të Korkyrës.

Ndeshja e shpeshtë e monedhave që nga shek. IV p.e. sonë tregon se tregëtia mbështetej jo vetëm në shkëmbimet mall me mall, por edhe mall para. E vështruar në këtë prizëm, ajo përbën një tregues të sigurtë për të përcaktuar lëvizjen e mallrave në rrugët tregëtare.



Fig. 3 — Selcë. Njëri prej varreve monumentale.

Në shkëmbin e Shënlliut janë gjetur monedha argjendi të Maqedonisë, të Dyrrahut dhe të Athinës të shek. IV p.e. sonë, në Shalës një thesar monedhash argjendi dhe bronxi të fundit të shek. IV p.e. sonë, të Dyrrahit, të Maqedonisë dhe të Korkyrës [21]). Në Selcën e Poshtme dhe në Sllabinje [22]) janë gjetur monedha maqedonase të shek. IV p.e. sonë. Ky është një tregues i thjeshtë për të kuptuar se importuesit kryesorë të mallrave ilire në luginën e Shkumbinit ishin Dyrrahi dhe Maqedonia.

Për shek. e III-të dhe të II-të p.e. sonë sasia e monedhave, të gjetura në luginën e Shkumbinit, shtohet mjaft. Një statistikë e monedhave të gjetura në Lleshan na tregon qartë për lidhjet tregëtare në luginën e mesme të Shkumbinit. Nga rreth 200 monedha, 80% i përkasin Dyrrahut, 10% Apollonisë dhe pjesa tjetër Epirit e Orikut. Në luginën e sipërme mbizotëron ende tregëtia maqedonase siç del nga raporti 4 : 1 i monedhave maqedonase me ato të Dyrrahit.

Të dhënat që rreshtuam më lart, na japin mundësi të krijojmë koncepcin për rrugën nëpër luginën e Shkumbinit gjatë periudhës qytetare ilire. Nuk kemi të bëjmë më me një lëvizje të thjeshtë mallërash si në periudhat e mëparshme, por me një arter ekonomik që lidh qendrat qytetare ilire, ku vazhdojnë të derdhen edhe prodhimet e kolonive të bregdetit. Në

17) I.G. von Hahn, **Albanesische Studien,** Wien 1853, fq. 78.
18) N. Ceka, **Vep. e cit.,** fq. 112.
19) S. Islami, **Kalaja e Dorsit,** Dorëshkrim.
20) N. Ceka, **Po aty,** fq. 109.
21) Ruhen të gjitha në Muzeun e Elbasanit.
22) V. Manastirliu, **Po aty,** fq. 121.

BOTIMI

këtë të fundit rolin kryesor e luan Dyrrahi, i cili e përdor luginën e Shkumbinit edhe për eksportin e vet në Maqedoni, në një kohë kur Apollonia përdorte për këtë qëllim luginën e Devollit.

Është për t'u vënë në dukje se tregëtia maqedonase, e cila ruan tregun e vet në luginën e sipërme të Shkumbinit të shek. IV - III p.e. sonë siç dëshmojnë monedhat e gjetura në Selcën e Poshtme, e ka shumë të vështirë të depërtojë në luginën e mesme dhe të poshtme të Shkumbinit, ku zotërojnë qytetet e Ilirisë dhe sidomos Dyrrahi.

Përdorimi i luginës së Shkumbinit për veprimet luftarake lidhet me kryengritjen ilire kundër sundimit maqedonas me 335 p.e. sonë. Kemi arritur në përfundim për ta kërkuar Pelionin antik në gërmadhat e qytetit ilir në Selcën e Poshtme. Përshkrimi që i bën Kurt Rufi dhe Arriani [23]) fushatës së Aleksandrit, përputhet me topografinë e vendit, në qoftë se mendojmë se maqedonasit erdhën nga fusha e Korçës, nëpër një rrugë që përdoret edhe sot buzë Gurit të Kamjes, nëpër luginën e sipërme të Shkumbinit. Glaukia, nga ana tjetër, vjen në ndihmë të Pelionit nëpër një rrugë, që kalonte në pjesën e poshtme të kësaj lugine. E vetmja gjë që nuk përputhet këtu, është vendosja e qytetit buzë Eordaikut, por kjo mund të shpjegohet me njohuritë e kufizuara që kishin historianët grekë për Ilirinë. Është e natyrshme që identifikimi përfundimtar të pritet nga burimet epigrafike. Rasti i dytë, që mund të mendojmë, për përdorimin e kësaj lugine për të njëjtat qëllime, është viti 199 p.e. sonë. Konsulli Sulpici, pasi ka bërë një rreth me ekspeditën e tij në Eorde dhe Orestidë, kthehet në tokat e dasaretëve, ku merr qytetin Pelion (Liv. XXXI 40,4). Që këtej ai kthehet me ushtrinë e tij në Apolloni. Edhe në këtë rast përshkrimi i rrugës që ndjek konsulli është i qartë, në qoftë se pranojmë se Pelioni është kalaja ilire në Selcën e Poshtme.

II. **Periudha e pushtimit romak**

Interesi i romakëve për rrugët nëpër luginën e Shkumbinit çfaqet gjatë luftrave të tyre me Filipin e V-të të Maqedonisë, Në vitin 198 p.e. sonë ata i japin Pleuratit zotërimin mbi qytetet Lyhnid dhe Partha. Kështu ata i mbyllin atij me forca ilire rrugën e depërtimit në bregdet nëpërmjet Kandavisë maqedonasve. [24])

Në vitin 170, p.e. sonë kur marrëdhëniet midis Romës dhe shtetit Ilir janë acaruar dhe kur ky i fundit bën përpjekje për t'u afruar me Maqedoninë, romakët marrin në dorë kontrollin mbi luginën e Shkumbinit, në mënyrë që të izolojnë kontaktin iliro-maqedonas [25]). Për këtë dërgohet tribuni ushtarak Ap Klaudi, i cili grumbullon një forcë 8000 vetash në zonën e parthinëve, në luginën e mesme të Shkumbinit dhe e çon atë në Lyhnid. (Liv, XLIII 9,6 e 7). Përdorimi i kësaj rruge për qëllime ushtarake përmendet edhe një vit më vonë. M. Trebel Fregelani me një injësi të madhe kthehet nga Lyhnidi në krahinat e parthinëve, diku në luginën e mesme të Shkumbinit, dhe, që këtu, nis pengjet e penestëve për në Apolloni dhe të parthinëve për në Dyrrah. (Liv. XLIII 21,2 e 3).

Lëvizja e forcave kaq të mëdha presupozon një rrugë mjaft të rrahur nga përdorimi i gjatë. Natyrisht kjo ishte rruga ilire, sepse nuk mund të bëhet fjalë ende për ndërtimin e një rruge nga romakët në këtë kohë. Me sa duket ajo ka qënë një rrugë e thjeshtë, pa trase dhe shtroje gurësh.

Rruga e rregullt romake duhet të ketë filluar së ndërtuari midis viteve 168 dhe 146, p.e. sonë kur Polibi (XXXIV, 12) përmend për herë të parë një rrugë nga Apollonia në Selanik. Duket qartë se emërtimi i saj si rruga Egnatia është futur në tekstin e Polibit, më vonë nga kopjonjësit. Ende në burimet e mesit të shek. I p.e. sonë (Cicero. Ad. Atic. 3,7; Caes. Bell. Civ. 11, 1 e 2 etj.) ajo përmendet si rruga e Kandavisë dhe ky duhet të ketë qenë emri i lashtë ilir i kësaj rruge. Emërtimi via Egnatia del shprehimisht tek Straboni (VII 323, 327; fr. VII 329,10), pra, nga fundi i shek. I p.e. sonë. Megjithatë, edhe më vonë, gjejmë të përdorur emrin e vjetër ilir për pjesën perëndimore të rrugës Egnatia (Malch. 18, fq. 418). Ndërtimi i rrugës, nga romakët, ishte një proçes i gjatë dhe vazhdoi gjatë gjithë kohës së sundimit të tyre. Në fillim u shtruan me gurë pjesë të veçanta të rrugës ilire dhe u sistemua ajo. Gjurmë të kësaj periudhe ndërtimi kemi gjetur në Gurat e Zeza të Dardhës, ku një shtrojë prej pllocash të lëmuara me gjerësi vetëm 1.20 m., zbret me zikzake faqen e përroit (fig. 4). Shpejt pas kësaj është ndërtuar një shtrojë tjetër me gjerësi 4.30 m., gjithashtu prej pllocash të mëdha të vendosura

23) Të dy autorët kanë çfrytëzuar pa dyshim të njëjtin burim, bashkëkohës të ngjarjeve, ndoshta Ptolemeun (Arr. Anab. I, 7).
24) N. Ceka, **Vendi dhe roli i parthinëve në Ilirinë e Jugut.** Kumtesë në Konf. II albanologjike.
25) N. Ceka, **Disa çështje të Historisë së Lashtë të Shqipërisë,** Studime Historike. 3. 1964, fq. 177.

DOKUMENTOZ



Fig. 4 — Trakt i rrugës së hershme romake tek Gurrat e Zeza. Dardhë (Librazhd).



Fig. 5 — Trakt i rrugës romake midis Dardhës e Xhyrës.

drejt mbi dhe, pjesë të ruajtura të së cilës ndeshen në rrugën midis Dardhës dhe Xhyrës (fig. 5).

Prashniker [26]) ka konstatuar të njëjtën teknikë ndërtimi në rrugën nga Apollonia dhe Durrësi për në luginën e Shkumbinit. Rruga përshkruhet si një trase me gjerësi 5.70 m. me bordura anësh, të shtruar me plloça mbi të cilat ishte hedhur çakëll. Ajo ndiqte vija të drejta dhe rrallë herë merrte kthesa, pra kishte tipare të qarta të një rruge të hershme romake. Është vështirë të përcaktosh urat, që i takojnë në kohë kësaj rruge. Sidoqoftë tipi më i vjetër i tyre është ai me këmbët prej guri të derdhur midis fasadave prej gurësh të punuar, si ura e Darçit, e Gurave të Zeza dhe e Topçiasit. Kjo e fundit, me gurë të punuar me rustika dhe të lidhur me hekur, është shembulli më i qartë ku dallohet teknika e hershme romake.

Një periudhë të tretë ndërtimi i takojnë shtrojet me gjerësi 4-5 m, prej gurësh të mëdhenj, të mbuluar me çakëll. Në ngjitjen e kodrave ajo karakterizohet nga një linjë gjarpëruese. Pjesë të ruajtura mirë të saj takohen në zonën midis Dardhës dhe Xhyrës.

Rruga romake e kësaj kohe kishte qëllime ushtarake dhe s'kishte ende stacione. Edhe urat qenë ndërtuar vetëm në vendet e domosdoshme. Kështu Çezari detyrohet të kalojë Apsin në vah, në afërsi të Kuçit (Caes B. Civ. III 30) dhe Genusin në afërsi të Rogozhinës (III 76,1), pra në nyje rrugore ku duhet të kishte ura.

Tregëtia që zhvillohet në këtë rrugë në shekujt e parë të sundimit romak, është ende në duart e Dyrrahut, të Apollonisë dhe të qëndrave qytetare ilire. Një pjesë e mirë e këtyre të fundit nuk shuhen me pushtimin romak, por vazhdojnë të zhvillojnë aktivite-

26) C. Praschniker. **Muzakhia und Malakastra Jahreshefte** d. Oest. Arch. Inst. XXI-XXX) Wien 1920, kol. 106-125. C. Praschniker und A. Schober. **Archaeologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1919. fq. 59-61.

DO NOT COPY

tin e tyre ekonomik. Në kodrën e Saragut gjetëm gjurmët e një punishteje keramike të shek. të I p.e. sonë. Sondazhet e bëra në shkëmbin e Shënlliut tregojnë se vendbanimi ishte në këtë kohë në një territor të gjerë jashtë mureve dhe fundi i tij lidhet me kryengritjen parthine të vitit 39 p.e. sonë. E gjithë keramika që gjendet aty i takon prodhimit qytetar ilir dhe atij të kolonive. Vazhdimi i jetës qytetare del qartë nga sondazhet në Gradishtën e Belshit, ku keramika e tipeve romake duket vetëm në shek. I të erës sonë. Gjithashtu monedhat romake republikane, të gjetura në këto qendra, përbëjnë një numur të pakonsiderueshëm. Fakti më i qartë që provon se në dorë të kujt qendronte tregëtia në rrugën e Shkumbinit, është gjetja e thesareve. Në thesarin e Gjonmit [27]), që i takon kohës së luftrave civile, ka vetëm një monedhë romake, ndërsa të tjerat ndahen pothuajse në mënyrë të barabartë midis Dyrrahit dhe Apollonisë. Rruga Egnatia dhe pushtimet romake u japin mundësi këtyre qyteteve të depërtojnë me tregëtinë e tyre deri thellë në zonën e Danubit. Këtë e tregojnë thesaret e monedhave të gjetura në Rumani e në Bullgari [28]).



Fig. 6 — Rruga midis Dardhës dhe Xhyrës I — trakt i rindërtuar i rrugës së Kandavisë II-III — rruga Egnatia IV-V- rrugë bizantine; VI — rrugë turke e shek. XIX.

*
* *

Formën e saj të plotë me trase, ura dhe stacione, rruga Egnatia e merr në shekujt e parë të perandorisë. Literatura ekzistuese historike dhe arkeologjike kufizohet kryesisht me përcaktimin e stacioneve të kësaj rruge dhe të distancave midis tyre. I pari punim i plotë mbi rrugën Egnatia është disertacioni i T. Tafel [29]), vepër që sot mund të quhet e vjetruar për pjesën e rrugës që kalonte në luginën e Shkumbinit. Hani, më 1863, e përshkoi rrugën e vjetër romake dhe, duke krahasuar e korigjuar distancat e itinerarëve, identifikoi disa nga stacionet kryesore të rrugës, si Klodianën e Skampinin [30]). Po këtë gjë, por me më pak sukses, e bënë Hezei — Domé [31]) për stacionet më të vogla. Në bazë të vrojtimeve në terren, Fait [32]) përcaktoi itinerarin e degës së Apollonisë të rrugës Egnatia. Tek Prashniker gjejmë për herë të parë përshkrime të plota të rrugës dhe të urave të saj [33]). Studimi i J. Adamit [34]) për rrugët e Shqipërisë përmban një vlerësim kritik të studimeve të deri atëhershme për rrugën Egnatia, të plotësuar me vrojtimet në terren që pat bërë vetë autori.

Gjurmët më të qarta të trasesë së rrugës romake i ndeshim sot në pjesën malore nga Miraka në Qukës (fig. 6), pasi në zonën fushore traseja është prishur nga punimet bujqësore ose është mbuluar nga rrugët më të vona. Vrojtimet e bëra nga J. Adam dhe L. Vidman, të cilët kanë kaluar nëpër trasenë malore të rrugës, nuk janë të plota. [35])

27) Ruhet në Muzeun e Elbasanit.
28) H. Ceka, **La datation des drachmes de Dyrrachion et d'Apollonie et l'époque de leur pénétration massive vers les côtes de la Mer Noire,** Studia Albanica 1.1966, fq. 222.
29) T.L.F. Tafel. **De via militari romanorum Egnatia, qua Illyricum, Macedonia et Thracia iungebatur,** Tubinge 1842.
30) I.G. von Hahn, **Reise durch die Gebiete der Drin und Wardar,** Në Denkschriften der Kais. Akad. der Wischensch. Bd. XVI. Wien 1869, fq. 156-159.
31) L. Heuzey. H. Daumet **Mission archéologique de Macedoine,** Paris 1876, fq. 345-348.
32) G. Veith, **Der Feldzug von Dyrrachium zwischen Caesar und Pompejus,** Wien 1920, fq. 53.
33) Shif shënimin Nr. 26.
34) **Historia e rrugëve të Shqipërisë,** B.I.SH. 1.1953, fq. 36-48. Për një studim përmbledhës shif edhe Oberhummer. Via Egnatia, në Pauly-Wissowa Realencyclopaedie.
35) **Voyage épigraphique à Elbasan.** Ne Listy Filologicke. 85 (1962), fq. 61.

PROTOTIP

DO NOT COPY



Fig. 7 — Trakt i rrugës Egnatia. Dardhë.



Fig. 8 — Trakt i rrugës Egnatia.

Përveç shtrojeve që përmendëm më lart, ne konstatuam një periudhë radikale ndërtimi, si rezultat i së cilës u krijua një trase deri në 6,70 m. e gjerë, e llogaritur për kalimin e qerreve. Në zonat e sheshta ajo është shtruar vetëm me çakëll (fig. 7) ndërsa në pjerrësitë dhe qafat janë përdorur shtrojat me gurë të mëdhenj (fig. 8) mbi të cilët është hedhur çakëll. Ngjitjet e pjerrëta janë evituar, duke i dhënë rrugës një linjë gjarpëruese dhe në një periudhë më të vonë duke i shkallëzuar shtrojat në këto pjesë.

Urat e kësaj periudhe dallohen si ndërtime të fuqishme të teknikës së derdhjes. Ne zbuluam këmbët e një ure të panjohur më parë, që kalonte Shkumbinin rreth 500 m më poshtë se ura e Haxhi Beqarit dhe quhet nga vendasit Ura e Keçit. Nga ura janë ruajtur shtatë këmbë në bazë katërkëndëshe, me bërthamën e derdhur me gurë zalli e llaç-shamot midis faqeve prej gurësh të punuar. Ndërsa bërthama përshkohet nga breza tullash prej dy rreshtash, në fasadë janë vendosur breza me pesë rreshta tullash. Nga harqet e urës, që kanë qenë derdhur mbi qemerë guri, duken sot vetëm thembrat. Ura nuk është përdorur për një kohë të gjatë, sepse Shkumbini ka çvendosur shtratin e vet në drejtim të veriut dhe e ka lënë atë në zall. Me teknikë dhe material ndërtimi të njëllojtë (gurë zalli, llaç shamot, tulla 35 x 28 x 4,5 cm.) u ndërtua një urë e re duke përdorur si bazament shkëmbinjtë tek grykat e Mirakës. Sot ruhet vetëm thembra e një harku në bregun e djathtë të Shkumbinit, mbi të cilin ka qenë vendosur më vonë një urë mesjetare dhe, më në fund, ura turke e Haxhi Beqarit [36]).

Për ekzistencën e një shërbimi të organizuar (të paktën me mutationes) në rrugën e Kandavisë, të le të kuptosh një pasazh i Cezarit (Bell. Civ. III 11,1 e 2), ku thuhet se komandanti i Pompeut, Bibuli «. . .udhëtoi ditë e natë dhe *pasi ndërroi gjatë rrugës shpesh herë kafshët*, shpejtoi të arrinte tek Pompeu dhe e lajmëroi se Cezari po afrohej. Në këtë kohë Pompeu ndodhej në Kandavi dhe prej Maqedonisë po udhëtonte për në Apolloni dhe Dyrrah për dimërim.» Sidoqoftë vrojtimet tona treguan se stacionet e rregullta gjatë rrugës krijohen në shek. I-II të e. sonë.

Punimet e pastrimit në kompleksin tenma - nymfe në Bradashesh [37]) na dhanë një shtresë të shek. I të e. sonë, të formuar nga veprimtaria në një vendqëndrim të vogël pranë rrugës. Në fillim të shek. II të e.

36) J. Adam (fq. 44) dhe L. Vidman (fq. 61) nuk i kanë parë këto gjurmë dhe e konsiderojnë urën e Haxhi Beqarit si një ndërtim turk **ex novo**. Nga ana tjetër ata shohin themele urash romake në Qukës, ku nuk ka veçse ndërtime mesjetare (resp. fq. 45. dhe 62). Thembra e urës romake tek ura e Haxhi Beqarit mendojmë është mbeturinë e urës, që u prish nga gotët në vitin 479 (Malch. 18, fq. 418).

37) Punimet u kryen në vitin 1968 nën drejtimin e autorëve. Rezultatet nuk janë botuar.



Fig. 9 — Bradashesh — Kamare e nymfeut të stacionit Ad Quintum.

sonë ndërtohet këtu stacioni i vërtetë me termat dhe nymfeun në funksion të rrugës Egnatia, që na jepet në itinerarin e Burdigalës (IB Cuntz 608,3) me emrin Ad Quintum. (fig. 9)

Edhe nga Elbasani kemi materiale [38]) që e datojnë fillimin e jetës në Skampinin e lashtë që në shek. I të e. sonë, por në një stacion të tipit *mansio* ai kthehet, me sa duket, gjatë shek. II të e. sonë. Deri atëherë këtë rol duhet ta ketë luajtur një vendbanim i hapur në grykën e Krastës, tek Rrapi i Mansit.

Gjithashtu edhe Klodiana, ku ne nuk gjetëm gjurmë më të hershme se të shek. III - IV të e. sonë [39]), ka marrë rolin, që i takonte një shekull më parë një vendbanimi të madh të hapur në fshatin Fatishë. Një vendbanim tjetër të hapur të shek. II - III konstatuam edhe në perëndim të Peqinit, në kodrat buzë rrugës, pranë fshatit Karinë. Në pjesën fushore të rrugës ndeshëm gjurmët e një stacioni pranë fshatit Papër dhe të një furre tjegullash në fshatin Jagodinë.

Në pjesën malore të rrugës stacionet kanë qënë më të rralla. Pa hyrë në Babie ne gjetëm gjurmët e një stacioni të vogël të kohës romake. Stacioni më i madh në këtë pjesë ka qënë në Rrafjet e Spatharit, ku gjetëm gjurmë banesash të shpërndara në një sipërfaqe prej disa hektarësh. Këtu mendojmë se duhet identifikuar stacioni Grandavia dhe jo në Babie [40]), pasi Spathara ndodhet në mesin e distancës nga stacionet In Tabernas (Qukës) dhe Treiecto (Ura e Haxhi Beqarit), siç e jep itinerari i Burdigalës (607,7,8; 608,1). Gjithashtu gjurmët e shumta arkeologjike flasin për një stacion të tipit *mansio* [41]). Keramika dhe një monedhë e Julia Mameas [42]) dëshmojnë se stacioni ekzistonte që në shek. I të e. sonë. Ky stacion është i ndryshëm nga In Candabia, me të cilin ka të ngjashëm emrin, dhe, me sa duket, identik me Ad Dianam, për korespondimin e distancave [43]). Gjurmë vendbanimesh të kohës së pushtimit romak gjetëm në Qukës ku është identifikuar stacioni In Candabia ose Tres Tabernas. Më në fund, pranë Urakës, ku është identifikuar, sipas distancave, stacioni Pons Servili (Miller, IR, col. 516-517), gjetëm gjurmë të një vendbanimi të hapur, gjë që argumenton edhe materialisht këtë identifikim.

Drejtimi kryesor i rrugës në kohën e pushtimit romak ishte nëpër fushën e Domosdovës për në Qafën e Thanës. Megjithatë nuk e humb rëndësinë edhe dega që kalonte në luginën e sipërme të Shkumbinit nëpër Selcën e Poshtme. Për këtë dëshmon gjetja e

38) Një monedhë e Vespasianit dhe keramikë terra sigillata të gjendura brenda territorit të kalasë. Ruhen në Muzeun e Elbasanit.
39) Gjurmët e një vendbanimi të hapur i konstatuam në një arë në pjesën perëndimore të qytetit, prapa maternitetit.
40) Cuntz. I.R. fq. 99-100.
41) Karvanet e fillimit të shek. XX, që niseshin nga Elbasani, i bënin pushimet zakonisht në Babie ose në Dardhë, sipas shpejtësisë së ecjes. Spathara që gjendet midis tyre arrihet brenda një dite rrugë me ecje të zakonshme.
42) Ruhet në Muzeun e Librazhdit.
43) Miller I.R. col. 516-527. Largësia e stacionit Ad Dianam nga kalimet e lumit (Genesis flumen dhe In Candabia) janë afërsisht të barabarta, si për stacionin Grandavia tek itinerari i Burdigalës. Për këtë identifikim është edhe L. Vidman, vep. e cit. fq. 62. Nga banorët ne dëgjuam për një ndërtesë antike, sot të zhdukur, që konsiderohej si vend i shenjtë, dhe që mund të jetë një ruajtje e traditës së Dianës së Kandavisë.

DO NOT COPY

një statuje të Mërkurit [44]) në Selcën e Poshtme dhe e një stacioni termesh në Memelisht, pranë Pogradecit. [45])

Kriza e rendit skllavopronar dhe dyndjet e barbarëve nga fundi i shek. IV p.e. sonë u reflektuan me një periudhë të re ndërtimi gjatë rrugës së Shkumbinit, kësaj here fortifikimesh. Qendër e këtij sistemi fortifikatash ishte Skampini. Si pararojë e tij ngrihet kalaja e Menglit [46]), (fig. 10) ndërsa në vazhdim të grykave të Shkumbinit kalaja në Shkambin, Mbret. Në Kandavi e mbronin rrugën kalaja në Gurin e Skënderbeut, pranë fshatit Dardhë, ku gjurmët më të hershme janë që nga shek. IV-VI i e. sonë dhe kalaja në Gurin e Qytezës, midis Dardhës e Xhyrës (fig. 11). Kjo e fundit kontrollonte një rrugë paralele me Egnatian, që shkëputej nga arteri kryesor në Qafën e Gajorit dhe ngjitej në bjeshkët e maleve, larg qendrave të banuara, për të zbritur përsëri në luginën e Shkumbinit pranë Berzeshtës. Ne gjetëm pjesë të kësaj rruge të shtruara me kalldrëm vetëm 1 m. të gjerë dhe një vendqëndrim të vogël, të njohur nga vëndasit me emrin hanet e Porosekut.

Në vazhdimin e rrugës në drejtim të luginës së Shkumbinit, të njëjtës kohë i përkasin Gradishta e Manastirecit dhe një rrethim muresh me llaç në Gradishtën e Selcës së Poshtme. Në vazhdim të Egnatias drejt Ohrit, rruga kontrollohej nga kalaja në Sofrën e Skënderbeut.

Edhe në degëzimet e rrugës rindërtohen kalatë e vjetra. Kështu rindërtohet sistemi i fortifikimit në Dorës, Bodin [47]) dhe në kullën e Gracenit [48]) në degët veriore; në Gradishtë dhe Valesh [49]) në degët jugore.

Në këtë mënyrë, në kushtet e shthurjes së sistemit skllavopronar dhe të sulmeve barbare, në shek. IV - VI, rruga e humbet gradualisht rëndësinë e saj ekonomike dhe shikohet më tepër roli strategjik i saj. Sidoqoftë, deri në gjysmën e dytë të shek. V, rruga ruhet ende në formën e saj të plotë. Në vitin 478, Theudimundi lëviz me një numër të madh njerëzish dhe karrosh nëpër Kandavi dhe, për t'i shpëtuar ndjekjes së romakëve, prish urën kryesore të rrugës. (Malch. 18, fq. 418).

Rruga nëpër luginën e Shkumbinit, qoftë në formën natyrale të saj, apo si rrugë e sistemuar, ka qenë në



Fig. 10 — Mengel. Kullë në anën perëndimore të kalasë.

Fig. 11 — Dardhë. Guri i Qytezës.



DO NOT COPY

44) V. Manastirliu — **Vep. e cit.**, fq. 120. Statujat prej bronxi të Merkurit janë një tregues i sigurtë për drejtimin e rrugëve në kohën romake. Ato janë gjetur gjithashtu në pjesën fushore të rrugës Egnatia. Shih S.Anamali — **Figura bronxi të Hermesit,** B.SH.SH. 2. 1957 fq. 131-134, si dhe në degëzimet e saj në liqenin e Ohrit (Tushemisht, Peshkëpi, shih: V. Manastirliu, po aty, fq. 122) dhe në fushën e Korçës (Malavec. Shih; Zh. Andrea, **Rezultatet e kërkimeve informative në rrethin e Korçës,** Mat. të ses ark. Tiranë 1968, fq. 131)
45) Konstatimi është bërë nga drejtori i muzeut të Pogradecit V. Manastirliu.
46-49) N. Ceka, **Gjurmime arkeologjike...** fq. 109-112.

radhë të parë një arter i jetës ekonomike dhe politike të Ilirisë, që duhet vënë nën mbrojtjen në pjesët e ruajtura si një kompleks: vendbanime, trase dhe ura.

Ne tërheqim vërejtjen edhe për rolin e rrugëve të tjera, që përshkonin vendin tonë në kohën e lashtë. Të njëjtën rëndësi me rrugën e Shkumbinit ka pasur edhe rruga fqinjë, nëpër luginën e Devollit. Shtrirja e keramikës së pikturuar nga pellgu i Korçës në drejtim të perëndimit (Bulçar, Tervol, Gradishtë e Belshit) u bë sigurisht nëpër këtë rrugë. Gjithashtu në periudhën e qyteteve ilire takojmë aty të njëjtat fenomene si në luginën e Shkumbinit. Studimi sistematik i rrugëve në të ardhmen do të hidhte dritën e nevojshme mbi problemin e lidhjeve që kanë ekzistuar ndërmjet krahinave, qyteteve dhe qytezave të Ilirisë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Legjenda

- VEND-BANIM I FORTIFIKUAR
- VEND-BANIM I HAPUR
- TUME
- VARREZE E SHESHTE
- SOPATE
- THESAR

TAB. II



DO NOT COPY

DO NOT COPY

N. CEKA — L. PAPAJANI

LA ROUTE ANTIQUE LONGEANT LA VALLEE DU SHKUMBIN

RESUME

Du point de vue géographique, la vallée du Shkumbin a offert dès l'époque antique l'une des voies naturelles de communication les plus faciles entre la partie littorale de l'Illyrie du Sud et l'intérieur des Balkans. Sur tout le cours inférieur du fleuve jusqu'à Elbasan, les deux rives peuvent être aisément longées, et aucun obstacle naturel n'y empêche la jonction des routes venant du sud et du nord. A Xibrrake, la route, qui suivait la rive droite du cours d'eau, devait passer sur la rive opposée et s'élever à 600 mètres d'altitude sur le versant du mont de Babie pour éviter les défilés du fleuve et de profonds ravins, et redescendre ensuite, à Qukës, vers le lit du fleuve où s'offraient à elle deux passages: par Qafë e Thanës vers Ohri, ou par la gorge de Çervenake en direction de Pogradec et Korçë.

Dans les études faites jusqu'à ce jour, l'histoire de la route qui suit la vallée de Shkumbin est injustement indentifiée avec la celle de via Egnatia, construite par les envahisseurs romains à leurs fins militaires et politiques et cette dernière voie est généralement traitée comme un corps étranger à la vie et à l'histoire du pays qu'elle traverse. En réalité, la via Egnatia, en tant que route romaine, constitue seulement une étape dans l'histoire de la voie de passage que constituait la vallée du Shkumbin. Bien avant l'occupation romaine, cette vallée était parcourue par une artère économique étroitement liée à un bon nombre d'agglomérations édifiées à ses abords. Cette liaison est claire pour toute l'histoire de cette voie, histoire qui peut se diviser en deux périodes, préromaine et romaine. Du point de vue méthodique, en en étudiant l'histoire, nous l'avons considérée non pas tant comme un ensemble de tracés, de revêtements et de ponts que comme une composante du mouvements économiques, politiques et militaires. Il s'ensuit qu'un tableau clair de ce phénomène peut être brossé en étudiant les vestiges matériels de ces mouvements, et en premier lieu les agglomérations qui jalonnent la route et ses ramifications, puis les vestiges des tracés et des ponts, les stations, les matériaux numismatiques, les trouvailles archéologiques isolées, etc.

*
* *

En ce qui concerne la période préromaine, les données archéologiques constituent pour ainsi dire la seule source. Assez rares pour les origines, et recueillies sous forme de trouvailles sporadiques, elles deviennent plus fréquentes et convaincantes, pour la première période du fer et la période des villes illyriennes;

Pour l'époque du bronze, l'existence de la voie longeant la vallée du Shkumbin est prouvée par la découverte dans les tumuli de Pazhok, d'un vase provenant de Mycène. La mise au jour de haches du type shkodran à Tërbaç et Shelcan aux environs d'Elbasan, témoigne de l'activité des ramifications nord et sud de cette voie.

DO NOT COPY

La véritable histoire de la route qui suit la vallée du Shkumbin commence avec la période du fer. Le développement des forces productives et la désagrégation ultérieure de la communauté primitive eurent pour conséquence l'expansion des échanges entre les diverses régions. Les agglomérations fortifiées qui virent le jour dans la première période du fer, sont le produit de ces phénomènes économiques et sociaux, et le fait qu'elles sont situées aux abords des routes naturelles n'a rien de fortuit. Dans la vallée du Shkumbin, des agglomérations de ce genre se trouvent à Shkamb i Shënlliut à proximité d'Elbasan et à Qukës – Skanderbeg, sur le cours supérieur du fleuve. Sur les ramifications sud, on trouve des agglomérations fortifiées à Lleshan, Valësh et à Gradishte dans la région de Beish; sur les ramifications sud, à Bodin et à Dorës. L'expansion des échanges chez les Illyriens favorisa aussi le commerce grec qui commença à pénétrer en Illyrie par les colonies du littoral, Epidamne et Apollonie. Suivant la voie du Shkumbin, les produits corinthiens de bronze, de céramique au de verre, des VIe au IVe siècles, atteignirent la zone des lacs Lychnides.

Aux IVe et IIIe siècles avant notre ère, une partie des agglomérations situées sur la voie du Shkumbin et sur ses ramifications se transformèrent en centres urbains. En même temps, se créèrent de nouveaux centres, principalement artisanaux et marchands. Leur vie économique étant principalement fondée sur l'échange des marchandises, ils dépendaient étroitement des routes marchandes. Shkambi i Shënlliut qui commandait directement la route du Shkumbin était enceint de murs de pierres du type Lis II. La cité illyrienne de Sarag, proche de Pegin, où subsistent les vestiges d'une construction défensive, avait la même fonction de contrôle. A Selcë e Poshtme, sur le cours supérieur du Shkumbin, se situe la plus importante des agglomérations se trouvant sur la route même. Il s'agit vraisemblablement de la Pelion antique. Des centres fortifiés de caractère urbain s'étaient également développés sur les ramifications de la voie: au nord, au mont de Vile près de Petrele, à la tour de Gracen et à Dores; au sud, à Lleshan, à la tour de Kamunah et à Gradishte. Ces centres fortifiés présentent tous une similitude fonctionnelle et une unité de culture matérielle, qui ressort clairement de la comparaison de la céramique d'usage courant, produite sur ces lieux. Une telle confrontation fait également apparaître que cette céramique était l'une des principales marchandises transportées sur la voie de la vallée du Shkumbin. Les exportations de Grèce se composaient principalement de vases de luxe décorés de motifs, ou vernissés en noir.

Les fréquentes trouvailles de monnaies postérieures au IVe siècle avant notre ère, attestent que le commerce ne se faisait plus seulement sous forme de troc, mais qu'on avait déjà recours à la monnaie. Considérés sous cet aspect, les matériaux numismatiques constituent un indice sûr permettant de déterminer le mouvement des marchandises sur la voie du Shkumbin. Ces matériaux indiquent qu'au IVe siècle les marchandises transportées le long de la vallée du Shkumbin étaient principalement destinées à Dyrrah et à la Macédoine. Aux IIIe et IIe siècles, le commerce macédonien se bornait au cours supérieur du lit, alors que Dyrrah, Apollonie, Orik, etc. absorbaient la plus grande part des marchandises transportées sur le tronçon inférieur de la vallée.

Ainsi, dans la période des cités illyriennes, la route naturelle qui longeait le Shkumbin constitue une artère économique reliant les centres urbains illyriens entre eux et desservant en même temps les colonies du littoral et de la Macédoine.

On a tout lieu de penser que cette route a été utilisée à des fins militaires lors du siège de Pelion par Alexandre en l'an 335 et par le consul romain Sulpicius en l'an 200 avant notre ère.

*
* *

L'intérêt des Romains pour la route qui suit la vallée du Shkumbin se manifeste au cours de leurs guerres contre la Macédoine. Les mouvements de troupes de grande envergure, dont cette région fut le théâtre en 170 et 169 avant notre ère, impliquent que cette

route avait été longuement fréquentée, avant même l'occupation romaine. Dans l'antiquité, elle se dénommait route de Candavie, l'appellation de via Egnatia n'apparaissant en effet que dans les dernières sources du Ier siècle avant notre ère. La route romaine du trafic courant a vraisemblablement commencé à être construite entre les années 168 et 146 avant notre ère, lorsque Polybe fait état pour la première fois d'une route menant d'Apollonie à Thessalonique, et elle a continué d'être en service durant toute l'époque antique. Au début, seuls quelques tronçons de la route illyrienne furent pavés. Bien vite, suivirent deux périodes au moins de construction, caractérisées par des revêtements de grandes dalles et de grands ponts à maçonnerie jetée dans l'intervalle de deux murs parallèles en pierres appareillées. Le commerce qui se développe sur cette route dans les deux premiers siècles de l'occupation romaine, était encore entre les mains de Dyrrah, Apollonie et des autres cités illyriennes. On en a un clair témoignage dans les matériaux numismatiques recueillis. Apollonie et Dyrrah profitèrent de la construction de la voie Egnatia pour commercer avec les zones reculées des Balkans.

La voie Egnatia qui suit la vallée du Shkumbin a pris sa configuration complète avec son tracé définitif, ses ponts et ses postes, dans les premiers siècles de l'Empire. A la suite d'une période de construction intensive, la route atteignit une largeur de 6.70 m, calculée pour le passage des chariots. Dans les zones planes, elles n'est revêtue que de gravier; dans les côtes et les cols elle est pavée de grosses pierres recouvertes de gravier. Les ponts sont construits selon la technique opus mixtum, Les stations régulières jalonnant la route se constituent aux Ier et IIe siècles de notre ère. Outre Elbasan, on en rencontre les vestiges à Fatishe à proximité de Peqin, à Paper, à Bradashesh, l'antique Ad Quintum, à Rapi Mansit, à Babie, à Spathare, probablement l'ancienne Grandavia ou Ad Dianam, à Qukës et à Urake.

La crise du régime esclavagiste et les migrations des barbares qui eurent lieu vers la fin du IVe siècle de notre ère se reflétèrent dans une nouvelle période de construction le long de la voie Egnatia, mais maintenant d'ouvrages fortifiés. Ils avaient pour centre Scampini, alors que, sur le prolongement de la vallée vers l'est, des forteresses furent élevées à Mengel, Shkambi i Mbretit, Guri i Skënderbeut, Guri i Qytezës, Monastirec et Selcë e Poshtem. Sur les ramifications de la route, des forteresses furent reconstruites à Dorës, Bodin, Kullë e Gracenit, Gradishte, Valësh, etc. Ainsi du IVe au VIe siècle, cette route perd peu à peu son importance économique et revêt surtout une fonction stratégique.

La route qui, sous sa forme naturelle ou aménagée par l'homme, suit la vallée du Shkumbin, a été une artère de la vie économique et politique de l'Illyrie et elle doit être protégée dans les parties qui en subsistent, agglomérations, tracé, ponts, etc. D'autre part, une étude systématique des routes antiques de notre pays éclairerait d'un nouveau jour les liens qui unissaient entre elles les régions, les villes et les cités d'Illyrie.

DOKUMENT

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

KALAJA E ELBASANIT

Kalaja e Elbasanit përmendet për herë të parë nga Kritobuli, historian i Mehmetit II, i cili ja kushton ndërtimin e saj që nga themelet këtij të fundit, duke injoruar faktin e ekzistencës së mbeturinave dhe të trakteve të mureve të një fortifikimi më të vjetër. [1]) Të njëjtin fakt na e jep edhe një dokument venedikas. [2])

Në shek. XVII Elbasanin e vizitoi udhëtari turk Evlia Çelebiu, i cili, për herë të parë, bën një përshkrim të kalasë, nga ku mund të nxirren vetëm pak të dhëna për shkak të ekzagjerimit të madhësisë dhe deformimit të trajtës së saj. [3])

Kalaja e Elbasanit u vizitua edhe nga Hani në mezin e shek. XIX, por ai nuk mundi të konstatojë substruksione më të vjetra, dhe e konsideroi atë krejt mesjetare [4]).

Por objekt i një studimi më të plotë kalaja u bë vetëm nga arkeologët austriakë K. Prashniker dhe A. Shober [5]), të cilët e vizituan atë në periudhën e luftës së parë botërore. Ata i kushtojnë kalasë një studim të veçantë, në të cilin japin planimetrinë, përshkruajnë monumentin dhe botojnë fragmente arkitektonike. Atyre u takon merita që, për herë të parë, konstatuan, nën muret mesjetare, substruksione të një fortifikimi më të vjetër, që i përket kohës së vonë antike.

Disa të meta e zbrazëti të këtij studimi (autorët e tij patën shumë pak kohë në dispozicion) na nxitën t'i vihemi edhe një herë kësaj pune.

Qëllimi i ynë do të jetë: dhënja e një rikonstruksioni të planimetrisë më të plotë nga ai i autorëve që përmendëm, në bazë të një vrojtimi më të kujdesshëm të mbeturinave të monumentit, përshkrimi i mureve me fazat kryesore të ndërtimit, si dhe përpjekja për një datim më të saktë. Kjo sprovë për një rishqyrtim arkeologjiko-historik të monumentit do t'i shërbejë restaurimeve të ardhme të këtij monumenti.

Qyteti i Elbasanit, brenda të cilit ndodhet kalaja, është i vendosur mbi një fushë pjellore në luginën e Shkumbinit, e cila është një nga rrugët transversale më të përshtatshme, që lidh bregdetin me brendësinë, duke zënë kështu një pozitë të favorshme ekonomike dhe strategjike. Ky vend është identifikuar prej kohësh me një nga stacionet e rrugës Egnatia [6]), emri i të ci-

---

+) Në këtë punim kemi pasur parasysh dhe materialin që na kanë ofruar dy sondazhe të bëra nga K. Zheku, në faqen e brendshme të murit lindor dhe nga N. Ceka pranë Muzeut të qytetit, të cilat po i shënojmë në planimetri respektivisht me gërmat A dhe B. Me këtë rast falenderojmë autorët e këtyre sondazheve, që patën mirësinë të na i vinin në dispozicion vrojtimet e tyre.

Rilevimi topografik është bërë nga P. Maraci, fotografitë nga R. Veseli dhe skicat nga R. Aliaj.

1) **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë**, Vol. II, Tiranë, 1962, fq. 345.

2) **«Vendimi i Senatit të Venedikut në lidhje me ndërtimin e kalasë Valmit (Elbasan) nga turqit 16 gusht 1466»**. Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, Vol. II, fq. 346.

3) Evlia Çelebiu, Tiranë 1930, fq. 101. (Përkthim shqip).

4) J.G. Hahn, **Albanesische Studien**, Vol. I, Wien 1853, fq. 80-113.

5) C. Praschniker, A. Schober, **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro**, Wien 1919, fq. 50.

6) Hani e identifikoi Elbasanin me Skampën duke u mbështetur në distancat që jep «Tabula Peutingeriana», vep. cit., fq. 80.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

lit sipas H. Cekës, duhet të lexohet Skampin dhe jo Skampa, siç është quajtur tradicionalisht. [7])

Kalaja e Elbasanit ka formën e një katërkëndëshi kënddrejtë me dimensione 308 x 348 m. e orientuar me anët më të ngushta në drejtimin VL-JP. Të katër qoshet forcohen nga kulla të fuqishme, që dalin me faqe të drejta nga muret dhe pastaj rrumbullakosen (TAB III, 2). Kullat ndërmjetëse, me përjashtim të dy prej tyre që kanë patur trajtë katërkëndëshe, kanë formën planimetrike të germës U. Ato dalin jashtë mureve 8-9 m. dhe janë të vendosura 40-50 m. larg njëra tjetrës. Me përjashtim të murit jugor dhe një pjesë të atij perëndimor, të cilët ruhen më mirë, muret e tjera janë rrënuar, pothuajse, krejtsisht. Nga 26 kulla, që ka patur kalaja, sot ruhen vetëm 8, nga të cilat 6 në numrin jugor dhe 2 në atë perëndimor. Ndërsa nga të tri hyrjet, të cilat kanë qenë vendosur në mes të mureve jugor, perëndimor dhe lindor, ruhet sot, në gjendje gjysmë të rrënuar, vetëm hyrja jugore. [8]) I gjithë ndërtimi ka qenë i rrethuar nga një hendek i thellë, gjurmët e të cilit nuk diktohen më, por ekzistencën e tij na e informon Çelebiu, i cili thotë se ishte dy bojë njeriu i thellë, [9]) më vonë na e konfirmojnë dhe Hahni [10]) e Ami Bue. [11]) Gjurmë të një thellimi pati dalluar edhe Prashnikeri, sidomos në anën veriore të kalasë, pranë një përroi. Siç duket ky kanal mbushej nga ujët e Zaranikës. Po të vësh re planimetrinë e kalasë të bie menjëherë në sy simetria e rreptë e këtij ndërtimi.

Nga egzaminimi i mureve kemi konstatuar tri periudha kryesore ndërtimi, përveç riparimeve të tjera më pak të rëndësishme. Këto periudha u përkasin: 1) kohës së vonë antike, 2) bizantine të hershme dhe 3) mesjetës turke.

I. PËRSHKRIMI I PERIUDHAVE TË NDËRTIMIT

Periudha e vonë antike. Skampini, që e nisi jetën e vet si një qendër e vogël banimi pranë rrugës Egnatia [12]), duke ndjekur rrugën e një zhvillimi gradual,

7) Hasan Ceka, **Nga Historia e Iashtë e Skampinit,** (Kumtesë mbajtur në Elbasan në vitin 1966 (dorëshkrim).
8) Portat e kalasë së Elbasanit quheshin: jugorja, Porta e Pazarit, perëndimorja, Porta e Jeniçerëve dhe lindorja, Porta e Ahmedajt, Shif: J. Adami, Historia e rrugëve të Shqipërisë, BSHSH 1953, nr. 1, fq. 38.
9) E. Çelebiu, **Vep. e cit.,** fq. 101.
10) J.G. Hahn, **Vep e cit.,** fq. 79.
11) A. Boué, **La Turquie d'Europe,** Vol. II, Paris, 1840, fq. 377. Shih dhe **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** Vol. III, Tiranë, 1962, fq. 164. (Relacioni anonim mbi Shqipërinë).
12) Deri nga mezi i shek. II Skampini ishte një «Vicus», lokalitet që varej administrativisht nga Durrësi. Shih. A. Betz, **Eine neue inschrift aus Elbasan in Albanien,** në Jahrh. d. Osterr. arch. Institutes Bd. XXX, 1936, fq. 101.

DO NOT COPY

arrin, me sa duket, aty nga shek. IV të marrë trajtën e një qendre të madhe banimi të urbanizuar. Për këtë na e forcon bindjen një bazilikë [13]) e madhe e ndërtuar në këtë shekull si dhe ekzistenca e një legjioni të tipit pseudokomitatens që mbante emrin e qytetit[14])që tregon se Skampini ishte qendër e rekrutimit të krahinës. Shek. IV koincidon dhe me një farë zhvillimi që patën qytetet e Ilirisë, veçanërisht në disa degë të prodhimit zejtar që ishin të lidhura me nevojat e ushtrive. [15])
Premisë e këtij zhvillimi ishte dendësimi i lëvizjeve me karakter tregëtar e ushtarak nëpër rrugën Egnatia si dhe krahina pjellore dhe e populluar dëndur nga fshatarësia ilire.

Vetëm një zhvillim i tillë i qytetit bëri nevojë të domosdoshme rrethimin e tij me mure në kohën kur rrezikohej nga sulmet barbare.

Muret e kohës së vonë antike i gjejmë kudo në shtresën e poshtme (TAB IV, 1). Ato arrijnë lartësinë maksimale 3 m. në kullën nr. 3 dhe përshkojnë gjithë planimetrinë. Teknika e ndërtimit është *opus nixtum* me katër rreshta tullash në brez. Trashësia e murit në nivelin e brezit është 3 m. Faqet e mureve janë punuar me gurë lumi të madhësisë mesatare të vendosur në rreshta deridiku të rregulltë, ndërsa brendësia me gurë lumi të vegjël ose të thyer të hedhur në llaç të bollshëm. Largësia ndërmjet brezave, siç na u vërtetua në faqen e brendshme të murit lindor nga sondazhi i bërë nga K. Zheku në vitin 1960, është 1,7 dhe 1,90 m. (fig. 1). Masa e dytë përputhet me largësinë e dy brezave në kullën nr. 7, të cilët janë të spostuar nga brezi i kurtinës perëndimore. [16]) Lartësia e brezave është rreth 30 cm. me trashësi llaçi të barabartë me atë të tullave, 4-5 cm., dhe përshkojnë gjithë trashësinë e murit. Tullat e brezit janë të dimensioneve 36 x 24 x 4-5 cm. Llaçi është i një kualiteti të mirë, gëlqerja është e përzier me rërë të ashpër me pak guralecë të vegjël. Lidhja e mureve me kullat bëhet me rreshta tulle, që vazhdojnë pa u ndërprerë gjatë gjithë lartësisë së murit. Me të njëjtën teknikë kanë qenë punuar edhe qoshet e kullave, siç dallojmë sot akoma në kullën nr. 7, si dhe shpatullat dhe qemerët e portave.

Themeli përbëhet nga tre shkallëzime me dalje të pabarabarta. Niveli i sotëm i terrenit në anën e brendshme të murit, në vendin ku është bërë sondazhi «A», arrin lartësinë 4,5 m. nga bazamenti i themelit (fig. 1).

Po të kësaj kohe janë edhe portat e të gjitha kullave, të cilat, në gjendjen e sotme, i kemi të mbuluara nga dheu në të shumtën e rasteve deri tek thembra e harkut (fig. 2)

Portat e kullave të qosheve janë 2,63 m. të gjera (sipas matjes së bërë tek kulla nr. 20). Ndërsa portat e kullave ndërmjetëse janë 1,50 m. të gjera dhe 3,30 të larta. Me përjashtim të portës së kullës nr. 20, e cila e ka harkun me një rresht tullash me gjatësi 40 cm. dhe trashësi 5 cm., harqet e tjera të portave janë me nga dy rreshta tullash të dimensioneve 43 x 29 x 5 cm. Gjerësia e fugës së llaçit është 3 cm.

Nga një sondazh që bëmë në kullën 18 nga ana e brendshme e murit mundëm të nxjerrim të plotë portën e kullës e cila ishte e mbuluar nga dheu në një lartësi prej 2,50 m. Porta (TAB. II) është e gjerë 1,50 m. dhe e lartë 3,30 m. e mbuluar me një qemer prej dy rradhë tullash 43 cm. të gjata. Shpatullat e portës janë të ndërtuara po me tulla, të cilat janë të rrumbullakosura në cepat nga ana e jashtme e portës, ndërsa pragu dhe pjesa e poshtme e shpatullave janë prej gurësh të punuar mirë. Pragu ka lartësi 20 cm., ndërsa në të dy anët e tij vendosen dy gurë njëri me lartësi 60 cm. dhe tjetri 80 cm. Porta ka një paturë 80 cm. të gjerë e cila në këtë pjesë e ngushton gjerësinë e hapësirës së portës 35 cm. nga baza e qemerit. Patura, në të dy anët, ka nga një thyerje që fillon 40 cm. nën thembrën e harkut dhe rakordohet në pjesën e sipërme me këtë të fundit. Mbrapa paturës, në një lartësi 2,50 m. nga praku, në të dyja shpatullat ndodhen dy vrima katërkëndëshe 30 x 40 cm. me thellësi 40 cm., ku vendosej trari për mbështetjen e dyerve. Fusha e harkut me sa duket qendronte e hapur dhe shërbente për ndriçim. Kjo portë ka qenë e mbyllur me mur dy herë, në kohë të ndryshme. Herën e dytë niveli i terenit ishte 1,10 m. mbi prakun.

E ndërtimit të parë është dhe një pjesë e harkut të hyrjes jugore, i cili dallon nga pjesa turke e tij, që është më e ngushtë dhe e kufizuar nga një bordurë tullash. Kjo portë ka një gjerësi prej 3,60 m. në bazën e harkut, ndërsa lartësia e plotë nuk mund të matet për shkak të ngritjes së nivelit të terenit. Nga elementet e tjera të kësaj kohe, ruhen mbeturinat e shkallëve dhe gjurmët e disa kontraforteve të vendosura pranë portave të kullave. Ato dalin 40 cm. nga muret dhe kanë gjerësi 4 m.

13) Bazilika është gërmuar dhe datuar nga A. Meksi dhe N. Ceka. Shih: raportin e gërmimeve (Ark. Inst. Mon. Kult.).
14) **Contributi alla cronologia Albanese,** Vol. I, Roma, 1942, fq. 202.
15) **Historia e Shqipërisë,** Vol. I., Tiranë, 1959, fq. 135.
16) Me përjashtim të kullës nr. 7 në të cilën dallohen dy breza, në muret e tjerë ruhet mbi sipërfaqe vetëm një brez. Nga sondazhi u zbuluan dhe dy breza të tjerë, nën sipërfaqe.

DOKTORATURA

Në portën e kullës 18 nuk e gjetëm kontrafortin; ana e djathtë ku duhej të ndodhej ai, me sa duket, është e rindërtuar, sepse edhe brezi me tulla, ndryshe nga vendet e tjera, këtu është prej gjashtë rreshtash. Nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar lartësinë e plotë të kullave dhe mureve të kësaj periudhe. Vetëm se mund të themi me siguri se lartësia e katit të parë të kullave ndërmjetëse ka qenë mbi 4 m. po kështu edhe lartësia e mureve të rrethimit deri tek trapi. Shkallët janë vendosur në një sistem të caktuar: drejtohen në kullat tek qoshet dhe hyrjet, dhe në të kundërt të tyre në kullat ndërmjetëse. Në vendet ku janë shkallët muri vjen i lakuar duke zvogëluar në këtë mënyrë trashësinë (TAB. I). (Në planimetri kemi shënuar me shigjeta vendet ku kemi gjetur gjurmët e shkallëve dhe drejtimet e tyre). Muret e shkallëve, siç konstatohet nga sondazhi «B», kanë në pjesën e poshtme të tyre një boshllëk të harkuar, të cilin nuk e gjejmë të plotë në asnjë vend dhe është vështirë të themi se çfarë destinimi ka patur. Tullat e harkut të shkallëve kanë dimensione 30 x 19 x 4 cm.

Nga sa mund të gjykojmë në mënyrë indirekte nga gjurmët e pakta që kemi në dispozicion, komunikimi i katit të dytë të kullave ndërmjetëse me trapin bëhej me anën e portave anësore, ndërsa te kullat e qosheve komunikimi bëhej me anën e një porte të vendosur mbi portën e katit të parë. Në përfundimin e parë arritëm nga arësyet e mëposhtme: Muri i mbrapëm i kullës nga ana e brendshme e kalasë vjen në të njejtin rrafsh me murin e rrethimit, po nga kjo anë nuk dallojmë gjurmë konstruksionesh për të krijuar një platformë të nevojshme përpara portës së katit të dytë nëqoftëse kjo do të ishte në këtë vend, d.m.th. mbi portën e katit të parë. Duke qenë se muri i mbrapshëm i kullës është më i ngushtë nga muri i rrethimit, kjo diferencë shkon në favor të zgjerimit të hapësirës së brendshme të kullës, dhe jep mundësi që të hapen porta në të dy anët e saj, duke e bërë më të lehtë komunikimin e kullës ndërmjetëse me muret. Kjo shpjegon dhe arësyen që shkallët pranë kullave ndërmjetëse drejtohen në të kundërt të tyre mbasi pjesa e trapit pranë kullës mund të furnizohej lehtë me luftëtarë, nëpërmjet dy portave anësore. Ndërsa në përfundimin se, në kullat e qosheve porta e katit të dytë ndodhej mbi atë të të parit, arritëm nga vrojtimet e bëra në kullën 20. Nga ana e brendshme e kalasë, në të dy anët e portës së katit të parë, dallohen gjurmët e një qemeri 1,20 m. i gjerë, që shërbente për të krijuar një platformë para portës së katit të dytë. Po kështu, muri i mbrapëm i kullave të qosheve është i gjerë njëlloj me murin e rrethimit duke mos favorizuar kështu hapjen e portave anësore. Shkallët pranë kullave të qosheve janë të destinuara kryesisht për furnizimin e këtyre kullave që zakonisht janë trekatëshe si dhe të asaj pjese të trapit prej 12 m. që mbetet nga shkallët deri tek kulla.

Në prerjet e mureve kemi vërejtur se bërthama antike fshihet shpesh herë nga një veshje turke e murit. Kjo duket qartë në murin jugor në vendin ku ai ndërpritet nga një rrugicë e qytetit.

Që nga koha kur e vizitoi kalanë Prashnikeri kanë humbur shumë gjurmë. Vetëm muri jugor, me përjashtim të kullës së hyrjes e cila u prish nga tërmeti i vitit 1920, dhe një pjesë e murit perëndimor ruhen në gjendjen e parë. Aty ne korigjuam në planimetri formën e kullave të qosheve. Në murin lindor përveç kullave të njohura më parë përcaktuam pozicionin e kullës nr. 10 që na rezulton në jugë të rrugicës, ku më parë, siç na e vë në dukje edhe Prashnikeri, ka patur një portë TAB. I

Por ne do të mundohemi të sqarojmë trajtën e saj. Aksi i kalasë korespondon me mesin e rrugicës, ndërsa kulla nr. 10, e cila nga gjurmët duket të ketë qenë në formë U-je, si dhe kullat e tjera ndërmjetëse, ndodhet e spostuar në jugë të aksit. Vetë forma e kësaj kulle përjashton mundësinë e përshkimit nga një portë. Prandaj kjo hyrje ka qënë e vendosur ndërmjet dy kullave të tilla. Për këtë na bindin dhe gjurmët e një shpatulle, si dhe pragu prej guri i një porte, konstatuar në anën veriore të rrugicës. Po ashtu ndërtimi i një banese mbi një vend të ngritur, që është i barazlarguar nga rrugica me kullën nr. 10. Për simetri edhe porta perëndimore ka qënë identike. Këto dy porta të mbrojtura nga dy kulla kanë qenë hyrjet kryesore të qytetit.

Në murin verior përcaktuam pozicionin e kullave nr. 18 dhe nr. 19 të pazbuluara nga Prashnikeri. Të parën, nëpërmjet gjetjes së hyrjes, dhe të dytën nëpërmjet zbulimit të skajit lindor të kontrafortit, pozicionin e të cilit në raport me kullat e kemi përcaktuar. Gjurmët e kullës nr. 17, që ekzistonte deri në lartësinë 7 m. në kohën kur e vizitoi Prashnikeri, i gjetëm në murin e kishës katolike. Ajo bie në aksin e kalasë duke përjashtuar mundësinë e ekzistencës së një kulle tjetër katërkëndëshe, e cila është futur gabimisht në planimetrinë e tij. Në murin perëndimor gjetëm gjurmët e kullës nr. 21 pranë një banese, por nuk dalluam dot qartë konturet e saj. Në këtë mënyrë, mundëm të bëjmë një rikonstruksion të planimetrisë duke u mbështetur jo vetëm në simetrinë e ndërtimit po dhe në përcaktimin me saktësi të pozicionit të disa kullave, në bazë të zbulimit të elementeve të tyre.

Periudha bizantine e hershme. Për këtë periudhë burimet na ofrojnë më pak material. Dimë vetëm se në vitin 479 qyteti, të cilin banorët e kishin braktisur me kohë, u pushtua nga gotët. Malhu, që na e përshkruan këtë pushtim, e vendos Skampinin, si qendrën kryesore të rrugës Egnatia, ndërmjet Lyhnidit dhe

NO COPY

Dyrrahut. [17]) Në prag të sundimit të perandorit Justinian, qyteti, me sa duket, pati një lulëzim të ri. Në vitin 519 ai përmendet si qytet, qendër ushtarake e peshkopate, që kishte një katedrale, përveç bazilikës paleokristiane që përmendëm më parë. [18]) Fakti i mospërmendjes së Skampinit pas vitit 519 tregon së paku për një degradim të qytetit, një nga shkaqet e të cilit duhet ta kërkojmë në ndërprerjen e lëvizjeve në rrugën Egnatia nga barbarët. [19]) Por ka shumë të ngjarë që dyndjet sllavo-bullgare, që u bënë shkak i shkatërrimit dhe i braktisjes së dhjetëra qyteteve dhe kështjellave të Ilirisë, i dhanë fund jetës edhe në këtë qytet, të cilin turqit e gjetën të braktisur, të rrënuar dhe pa emër. [20])

Nga vrojtimi i mureve kemi konstatuar se kalaja u është nënshtruar riparimeve dhe rindërtimeve edhe në periudhën bizantine të hershme. Nga këto, kryesoret janë disa trakte në murin jugor e perëndimor, të cilat do t'i analizojmë në këtë punim.

Ndërmjet kullave nr. 4 e nr. 5 me lartësi 1 m. nga toka dallojmë një riparim, që është i vendosur mbi murin e periudhës së parë të ndërtimit dhe dallohet nga teknika si nga ky mur ashtu edhe nga ai turk i vendosur mbi të. Lartësia e këtij trakti është 1 m., por si gjatësi ai zë, pothuajse, gjysmën e kurtinës ndërmjet dy kullave. Është ndërtuar me rreshta gurësh lumi të vendosur horizontalisht. Fugat janë të lyera rreth e qark me llaç, i cili është i përzierë me guralecë të vegjël; ka ngjyrë gri të hapur dhe është i një kualiteti të lartë (TAB IV, 2). Një riparim tjetër të vogël të punuar me të njejtën teknikë e dallojmë në kullën nr. 7. Ky ndodhet në anën perëndimore të kullës dhe shtrihet në një gjatësi prej rreth 3 m. dhe me lartësi 0,5 m. Është i vendosur mbi murin e periudhës së parë të ndërtimit dhe nën murin turk të vitit 1466. Të njëjtën dorë ndërtimi e dallojmë edhe në anën e brendshme të kullës nr. 1.

Një tjetër trakt të kësaj periudhe kemi po në murin jugor, ndërmjet kullave 1 dhe 2. Ai përbëhet nga një brez tullash prej tre rreshtash, i vendosur në lartësi 2,2 m. nga toka dhe përshkon një gjatësi prej 11 m. Një brez të njëllojtë me këtë konstatojmë në murin perëndimor midis kullave Nr. 24 dhe Nr. 25 (TAB IV, 3). Gjatësia e këtij të fundit është 6,7 m. dhe ndodhet në lartësinë 1 m. nga toka. Lartësia e brezave është 37 cm. Trashësia e tullave është 4-5 cm. dhe gjerësia 30 cm. Trashësia e fugës së llaçit është 6-8 cm. Llaçi është i një cilësie të dobët me ngjyrë gri të hapët i përzierë me pak guralecë të vegjël.

Një riparim tjetër që dallohet nga dy të parët, e kemi në faqen e brendshme të murit jugor, pranë muzeut lokal të qytetit. Ky trakt ndodhet në lartësi 5 m. nga toka dhe përbëhet nga një brez tullash prej 3 rreshtash. Tullat janë të dimensioneve 30 x 40 x 5 cm, të profiluara në anët [21]). Trashësia e fugës është 7-8 cm. Llaçi është i një cilësie shumë të mirë dhe është i përzjerë me grimca të vogla tullash. Në të tre brezat që përshkruam, nën rreshtin e parë të tullave, për nivelimin e murit është vendosur një shtresë e trashë llaçi që arrin 7-8 cm.

Periudha turke e ndërtimit. Kjo është periudha e tretë e ndërtimit. Rindërtimi i kësaj kalaje nga turqit lidhet me rrethana të caktuara historike. Në vitin 1466, Sulltan Mehmeti II, pasi dështoi në fushatën e madhe për pushtimin e Krujës, la aty një ushtri rrethimi nën komandën e Ballaban Pashës, dhe ndërtoi, si pikëmbështetje për një kohë shumë të shkurtër, mbi gërmadhat e një qyteti të vjetër, kalanë që e quajti el-basan [22]).

Ndryshe nga shumë qytete, që para okupacionit turk u shpërndanë duke krijuar qendra të vogla, fshatra apo paralagje, Elbasani u krijua si rezultat i grumbullimit të banorëve të disa qendrave të vogla, që ndodheshin në rrethet e tij, të përmendura nga Barleti [23]). Këtë na e vërteton edhe kronisti turk Tursun [24]) si dhe bizantinasi Kritobul, i cili thotë se (Sulltani) e populloi këtë (vend) mirë, duke grumbulluar shumë banorë prej fshatrave, krahinave dhe qyteteve për-

17) Malchi, **Byzantiaca,** fq. 413. **(Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë** Vol. I, Tiranë 1965, fq. 407).
18) Talloczy — Jireček — Šufflay, **Acta et diplomata res Albaniae,** fq. 451.
19) M. Šuflay, **Städte und Bürgen Albaniens hauptsächtlich während des Mittelalters,** Wien und Leipzig 1924, fq. 17.
20) Barleti na thotë se qyteti ishte rrënuar nga themelet shumë kohë përpara. (Historia e Skënderbeut, Tiranë 1967, fq. 485)
21) Ato janë të ngjashme me tullat me delfin të gjetura nga N. Ceka gjatë sondazhit të përmendur, pranë muzeut. (fig. 3)
22) F. Babingeri nuk e vë në dyshim origjinën turke të emrit el-basan dhe e shpjegon atë me landberzwingend (sundues i vendit). **«Die Grundung von Elbasan»,** Berlin, 1931, fq 1; V. Buharaja e lexon Ijlbasan **(Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit),** Studime Historike Nr. 1, 1967, fq. 101).
23) M. Barleti, **Vep. e cit.** fq. 485.
24) **Studime Historike,** Nr. 2, 1967, fq. 178.



Fig. 3



Fig. 4

rreth [25]). Me të drejtë F. Babingeri këtë datë e quan si datën e themelimit të qytetit të Elbasanit [26]).

Rindërtimi i kalasë së Elbasanit nuk ishte një ndodhi e rastit. Sulltani, me sa duket, kishte ardhur me një plan të parapregatitur për ndërtim kështjellash, që tregon se sa pak shpresë kishte të thyente, me një goditje, rezistencën e shqiptarëve.

Vetëm me një plan të tillë dhe duke patur avantazh mbeturinat e kalasë së vjetër mund të arrihej rindërtimi i kësaj kalaje brenda një kohe kaq të shkurtër. [27])

Rindërtimi i kalasë së Elbasanit nga turqit pati një rëndësi të madhe strategjike për ta, sepse ishte në zemër të Shqipërisë, mbi rrugën ushtarako-tregëtare, që kalonte nëpër luginën e Shkumbinit dhe pranë Krujës e Durrësit, që ishin pikësynimet e tyre më të afërta.

Muret e vitit 1466 ne mund t'i dallojmë jo vetëm nga ato të periudhës së vonë antike dhe bizantine të hershme, por edhe nga riadaptimet e mëvonshme. Ato janë të mbushura me copa tullash antike dhe nga ndonjë herë edhe me fragmente arkitektonike të gjetura në vend nga rrënimet e qytetit të vjetër (TAB. IV, 4). Turqit ju përshtatën fortesës së vjetër duke bërë vetëm adaptime që lidheshin me përdorimin e armëve të zjarrit.

Muri turk i vitit 1466 është ndërtuar me teknikën e mbushjes. Ai ndryshon nga muri romak se në bërthamë të tij janë përdorur gurë më të mëdhenj dhe me më pak llaç, ndërsa veshja përbëhet nga rreshta gurësh lumi të çrregullt me shumë copa tullash. Veçori tjetër është përdorimi i brezave të drurit në mure dhe në kulla. Gjithashtu muri vjen duke u ngushtuar nga posht-lart me pjerrësi në të dyja faqet.

Siç përmendëm edhe më lart, veshja turke fsheh në shumë raste bërthamën antike apo bizantine të murit. Mjaft qartë vërehet kjo në fragmentin bizantin të hershëm pranë muzeut, i cili ndodhet në lartësinë maksimale të murit të ruajtur në 5 m, ndërsa nga ja-

25) **Burime të zgjedhura...** fq. 345.
26) F. Babinger – **Vepër e cit.,** fq. 3; kundra V. Buharaja, **Vep. e cit.** fq. 101.
27) Vështirësia kryesore qëndron në pregatitjen e gëlqeres.
F. Babingeri përcakton 30 ditë kohën e rindërtimit të kalasë. (Mehmet der Eroberer und seine Zeit, Munchen, 1953, fq. 271). E njëjta gjë vërtetohet edhe nga burimet perëndimore. Humanisti Wolfgang Drechsler, shkrues i librit «Chronicon Saracenicum et Turcicum» Strassburg, 1550, fq. 29, shkruan se ndërtimi i kalasë u krye brenda 30 ditëve. Vep. e cit. nga Babingeri në «Die Grundung von Elbasan», fq. 4. V. Buharaja në një përmirësim që i bën deshifrimit të Babingerit përcakton në 25 ditë kohën e rindërtimit të kalasë brenda periudhës prej 17 qershorit deri në 17 korrik të vitit 1466. (Vep. e cit. fq. 99).

DO NOT COPY

shtë ky mur është veshur me një shtresë turke, që shkon deri nën nivelin e sotëm të terrenit. Ky fakt na bën të mos habitemi tepër për kohën e shkurtër, në të cilën e rindërtoi kalanë Mehmeti II.

Gjurmë të murit të bedenave kemi konstatuar në të dy anët e kullës Nr. 7 (TAB III, 1) dhe në anën veriore të kullës Nr. 1, trashësia e tij është 60 cm. Forma më e plotë e bedenave mund të dallohet në të dy anët e kullës Nr. 26.

Kullat e qosheve në kohën turke kanë qenë dykatëshe. Këtë na e vërteton, jo vetëm shkallëzimi i murit në nivelin e katit të dytë, por edhe ndërtimi i një bazamenti të madh katërkëndësh me muraturë guri 2,10 x 2,10 cm. për mbështetjen e dyshemesë. Hyrja në katin e dytë bëhej edhe direkt nga muret (TAB III, 1).

Portat e kullave ndërmjetëse i gjejmë të mbyllura me mur. Kjo mund të ketë ndodhur në një kohë më të vonë. Kemi një dëshmi që na vërteton se të paktën portat e vjetra të kullave të qosheve janë përdorur edhe nga turqit. Në kullën Nr. 20 nga pastrimet dolën tre dritare që i përkasin periudhës turke të ndërtimit. Ato kanë nga ana e jashtme gjerësi 17-20 cm. dhe lartësinë 1,17 cm. ndërsa nga ana e brendshme gjerësia e tyre është 90-100 cm. (TAB, II). Pragu i këtyre dritareve vjen me pjerrësi nga brenda për të realizuar një shpërndarje më të mirë të dritës. Këto kanë në një disnivel prej *vetëm 8 cm.* nga pjesa e sipërme e hapësirës së portës së periudhës romake. Duke qenë të destinuara për ndriçimin e shkallëve ato nuk justifikohen pa përdorimin e kësaj të fundit.

Nga konstruksionet e mbulesës nuk kemi gjetur asnjë gjurmë. Kullat e qosheve ka më tepër mundësi të kenë qenë mbuluar me tjegulla mbi konstruksione druri [28]) Ndërsa për kullat ndërmjetëse jemi të mendimit se kanë qenë të pambuluara me çati. Në këtë konkluzion arritëm nga gjetja e një hyrje nga lart, në kullën Nr. 2, në trajtën e disa shkallëve që zbresin nga muri në trapin e kullës.

Kullat kanë në përgjithësi nga 3 frengji me ngushtim nga ana e jashtme 62-70 cm. dhe me gjerësi të brendshme 80-100 cm. Frëngjitë janë ruajtur më mirë në kullën nr. 7 (fig. 4). Atje ato janë 3 dhe drejtohen nga JL, J dhe JP; vinë duke u ngushtuar nga brenda jashtë dhe janë të mbuluara me harqe tullash. Nën harqet kanë disa zbukurime gurësh me kënde të mprehta, të cilat varen poshtë dhe të kujtojnë elementet stalaktite të xhamive. Në anën e jashtme të kësaj kulle kemi dy dritare të verbëta të vendosura njëra mbi tjetrën, të cilat janë të mbuluara me harqe tullash, njëri i rrumbullakët dhe tjetri me majë lundre (fig. 5). Në këto harqe imitohet teknika bizantine e ndërtimit. Zbukurime të tjera karakteristike për periudhën e vonë bizantine kemi edhe në murin perëndimor, por ato janë të inkastruara në murin turk të vitit 1466 dhe nuk kemi dyshim se i përkasin kësaj periudhe (TAB IV, 5).

Nga ndërtimet pas vitit 1466 vlen të përmendim veshjen nga brenda me mur të kurtinës ndërmjet kullave nr. 1 dhe nr. 2 si dhe rindërtimin e kullave nr. 3 (TAB III, 3) dhe nr. 5, të cilat u pajisën me frëngji të mëdha topash me hapje nga jashtë, që siguronin një kryqëzim më të mirë zjarri. Dimensionet e këtyre frëngjive janë 225-285 cm. nga ana e jashtme dhe 25 cm. nga brënda.

II. PROBLEME TË DATIMIT

Fazën e parë të ndërtimit Prashnikeri e daton në vitet 300-530 të e.r. Për të arritur në këtë konkluzion ai niset nga tipi «Kastra» i këtij ndërtimi dhe, pasi e krahason me dhjetëra kështjella të përhapura në territorin e perandorisë romake, cakton si një «terminus post quem» periudhën e kalimit nga shek. III tek IV. Ndërsa si «terminus ante quem» i ka shërbyer periudha e sundimit të Justinianit, kohë pas së cilës sipas tij, kalaja nuk luan më ndonjë rol, nga sa mund të kuptohet nga mospërmendja më e Skampinit në burimet historike. Ndërsa Hasan Ceka [29]) është i mendimit se kalaja është ndërtuar nga themelet në kohën e Justinianit, duke e indentifikuar me Skeminites që përmendet në listën e Prokopit. [30]).

Nga sa shihet në krahasimet që bën Prashnikeri për të caktuar si terminus post quem periudhën kalimtare nga shek. III tek IV, ai ka pasur parasysh formën drejtkëndëshe të këtyre kështjellave me kullat që dalin jashtë mureve.

Nga grupi i kështjellave analoge të Ballkanit të përmendura nga Prashnikeri, për mendimin tonë, Elbasani ka ngjashmëri të madhe me kështjellën e Vigut, planimetria e të cilës ndryshon krejtësisht nga ajo e dhënë prej Prashnikerit. [31]) Kullat e qosheve janë të ngjashme me ato të Elbasanit. Ato bashkohen me

28) E.Çelebiu në përshkrimin që i bën qytetit të Elbasanit thekson se vetëm majat e minareve ishin të veshura me plumb. **Vep. e cit.** fq. 102. Rast tjetër të mbulimit të kullave me çati tjegullash nga turqit kemi në kalanë e Bashtovës, gjurmët e të cilave vetëm kohët e fundit janë zhdukur.

29) H. Ceka — **Nga historia e lashtë e Skampinit.**

30) Proc. De Aed. IV, 4 — **(Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** Vol. I, Tiranë 1965, fq. 439).

31) C. Praschniker — A. Schober, **Vep. e cit.,** fq. 13.



Fig. 5

muret me kënde të drejta dhe pastaj rrumbullakosen dhe, ashtu si në Elbasan, hyrjet janë të mbrojtura nga dy kulla në formë U-je. Nga kështjellat e limesit afrikan të përshkruara nga Domazevski na duken të ngjashme me Elbasanin dhe Vigun, Odruh [32]) dhe el-Legun [33]) edhe tek këto kështjella kullat e qosheve dhe ndërmjetëse janë të njëllojta me të parat, po kështu hyrjet e vendosura midis dy kullave në formë U-je. Ndryshimet ndërmjet këtyre kështjellave vërehen vetëm në konstruksionin e brendshëm të kullave dhe në teknikën e ndërtimit. Kulla të qosheve të ngjashme me të Elbasanit, por në një fazë më të zhvilluar, kemi në kështjellën e Drobetës në Rumani [34]), ndërtuar në shek. V të erës sonë, ndërsa kulla ndërmjetëse të ngjashme me ato të Elbasanit, në vendin tonë përveç kështjellës së Vigut i gjejmë në kalanë e Shurdhahut, koha më e mundshme e ndërtimit të së cilës është fundi i shek. IV – fillimi i shek. V. [35]) Teknika e ndërtimit *opus mixtum* me katër rreshta tullash në breza takohet më tepër në ndërtime të shek. IV dhe në gjysmën e parë të shek. V [36]). Të njejtën teknikë e gjejmë të zbatuar në vëndin tonë tek muret e kalasë së Portës në Durrës. Me shek. IV përputhet raporti ndërmjet sasisë së tullave dhe muraturës së përdorur në kala, ndërsa fuga e llaçit që këtu e kemi të barabartë me trashësinë e tullës fillon të kalojë trashësinë e tullës aty nga mezi i shek. V. [37]) Qemerët e portave të Elbasanit janë me dy rreshta tullash si ato të kalasë në VI. të «Portave të hekurta» – Hisarit, Sofjes dhe Nikesë që të gjitha ndërtime të shek. IV. [38]) Një tullë me kryq gjetur në brez të murit, gjatë punimeve restauruese në vitin 1959, nga K. Zheku, përjashton mundësinë e ndërtimit të kalasë së Elbasanit, para vitit 313, kur krishterimi u pranua si fe zyrtare.

32) R. Brünnow, A. Domaszewski, **Die Provincia Arabia,** Strassburg 1904, Vol. I, fq. 433-459.
33) Brünnow – Domaszewski, **Vep. e cit.,** Strassburg 1905, Vol. II, fq. 24.
34) Römer in Rumänien, Köln 1969, fq. 112.
35) Kalaja e Shurdhahut përshkruhet nga H. Spahiu dhe D. Komata në **«Rezultatet e gërmimeve në kalanë e Shurdhahut** (Shkodër)», Buletini Arkeologjik, Tiranë 1969, fq. 103. Material i shaptilografuar. Autorët nuk e datojnë kalanë por nga përshkrimi del se kullave në formë «të ngjashme me patkoin» u është bërë një riadaptim duke i kthyer në kulla me majë të mprehtë. Në këtë punim theksohet gjithashtu se kalaja u ndërtua pas formimit të vendbanimit, gjë që kuptohet nga kalimi i murit mbi themelet e ndërtesave. Duke patur parasysh se riadaptimet e mësipërme janë karakteristike për periudhën që përfshin shek. V-VI dhe se vendbanimit, i cili lindi në shek. IV, ju desh një kohë të zhvillohej aq sa mund të rrethohej me mure, atëhere koha më e mundshme e ndërtimit të kësaj kalaje do të jetë periudha që përmëndëm më lartë.
36) С. Бодчев — Смесената зидария в римските и ранновизантийските строежи. София, 1952. fq. 12-23, tad 1; Shih po këtë autor në Известия на Археологическия Институт при БАН. XXIV София, 1961, fq. 153-202.
37) A.M. Schneider – N. Karnapp, **Byzanz,** Berlin 1936, fq. 13.
38) Д. Цончев, Старините по северните склонове на еленския и сливейския Балкан. Годишник на Народния Археологически музей. Пловдив, кн. 1, 1948, fq. 146.

DO NOT COPY

Rrethanat historike do të na ndihmonin gjithashtu për të caktuar një datë më të sigurtë. Shekulli IV ishte një periudhë trazirash për Ilirinë. Disa herë gotët shpërthyen në tokat e perandorisë bile në vitin 378 ata pushtuan Ilirinë. Disa perandorë që sunduan në këtë shekull si Kostandini, Juliani dhe Teodosi I, ndërmorën punime të mëdha ushtarake për mbrojtjen e tokave të perandorisë.

Duke u mbështetur në faktet e mësipërme, në teknikën e ndërtimit dhe në situatën historike, ne mendojmë si kohën më të mundshme të ndërtimit të kalasë shek. IV, duke qenë të prirur ta lidhim me veprimtarinë ndërtuese, që vihet re gjatë kësaj kohe në perandorinë romake, dhe në mënyrë të veçantë në Iliri, për t'u mbrojtur nga sulmet barbare.

Në favor të mendimit tonë flet edhe një argument i tërthortë. Nga një pasazh i Malhut mësojmë se Teodoriku, pasi kish pushtuar Durrësin, urdhëron dy komandantët e tij ushtarakë Soasin dhe Dagisteun, që shkonin si peng tek Sabiniani në Lyhnid, të qëndronin në Skampin përderisa ky i fundit të betohej për sigurimin e tyre.[39]) Për çdo rast kemi të drejtë të mendojmë se Skampini ishte një vend i mbrojtur.

Gjurmët e ndërtimeve të hershme bizantine i gjejmë në tre duar të ndryshme ndërtimi. Trakti i parë në murin jugor ndërmjet kullave nr. 4 dhe nr. 5, pa breza tullash, nga karakteristikat e teknikës së ndërtimit duket se i përket mesjetës së hershme ose një kohe të vonë romake. Traktet e tjera me breza tullash në murin jugor dhe perëndimor nga teknika e ndërtimit të kujtojnë gjithashtu muret e hershme mesjetare në brezin mbrojtës të Detit të Zi, të përshkruara nga Skorpili,[40]) ndërtime që i përkasin një periudhe para shek. VII. Ngjashmëritë teknike të këtyre ndërtimeve me ato që po analizojmë janë trashësia e madhe e llaçit dhe cilësia e tij, përshkrimi i gjithë trashësisë së murit nga brezi dhe vendosja e një shtrese të trashë llaçi nën rreshtin e parë të tullave. Formatin 30 x 40 x x 5 cm. të tullave e gjejmë të përdoret edhe në muret e Selanikut, të cilat Bobçevi, duke u bazuar në kullat me majë të mprehtë, i daton në fundin e shek. V – shek. VI.[41]) Duke qenë se njohuritë tona për teknikën e ndërtimit të kësaj periudhe janë akoma të pakta për të bërë një datim të sigurtë, nuk do të shtyhemi më tej por do t'i konsiderojmë këto vetëm si ndërtime bizantine të hershme.

Rindërtimi i parë turk i cili nga volumi i punimeve predominon mbi të gjitha fazat e tjera të ndërtimit na datohet nga burimet historike në vitin 1466. Këto mure i dalluam nga riparimet e mëvona nëpërmjet të karakteristikave të mëposhtme:

1. Vendosja e këtyre mureve direkt mbi muret romake dhe mesjetare të hershme;
2. përdorimi i shumë copa tullash nga rrënimet e kalasë së vjetër, të futura në mur në mënyrë të çrregullt.

Nga rindërtimet e mëvona turke na duken më të rëndësishme dy kullat e vendosura në të dy anët e hyrjes jugore (nr. 3 dhe nr. 5), në të cilat vihet re e njëjta mënyrë ndërtimi. Për kohën e rindërtimit të këtyre kullave mund të gjykojmë vetëm në mënyrë indirekte. Mbi njërën nga këto (nr. 5) është vendosur kulla e sahatit, e ndërtuar në vitin 1899 në vendin ku ka qenë sahati i vjetër me konstruksion druri, që ekzistonte, siç mund të gjykojmë nga Çelebiu, qysh prej fillimit të shek. XVII. Po të mendojmë se, me ndërtimin e sahatit, kulla kish humbur funksionin e saj mbrojtës dhe se në vitin 1570, sipas dëshmisë së një anonimi, kalaja ishte lënë pas dore dhe gati e rrënuar,[42]) duhet të pranojmë si kohën më të mundshme të këtij riadaptimi fundin e shek. XV deri në vitin 1506, periudhë në të cilën Shqipëria ziente nga kryengritjet, dhe zotërimet venedikase ishin akoma afër Elbasanit.

39) Malch – **Byzantiaca,** fq. 44 (Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, Vol. I. 1965, fq. 407).
40) K. Skorpil — Стратегически Постройкивъ Черноморскага область на Балканския Полуостровъ Byzantinoslavica, Tome II, Praha, 1941, fq. 215.
41) С. Бодчев — Изв. на Археолог. Инст. при Бан, XXIV, София 1961, fq. 118
42) **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** vol. III, Tiranë 1962, fq. 164 (Relacioni anonim mbi Shqipërinë).

DOKTORATURA

Siç duket, kalaja ka luajtur një rol edhe në fillimin e shek. XIX, nga situata që u krijua me lindjen e pashallëqeve shqiptare. Nga një dokument i vitit 1802 mësojmë se sunduesi i vendit, Abdullah Pasha, vuri fshatarët nga rrethi i Elbasanit për të qëruar hendekun, i cili ishte mbushur. Punimet zgjatën dy vjet. Në të njëjtën kohë u prish një urë dhe u mbyllën dy portat e jeniçerëve. [43]) Dihet gjithashtu se si ky monument arriti në gjendjen e sotme. Në vitin 1832, veziri i madh, Mehmet Reshit Pasha, pasi nënshtroi pashallëkun e Shkodrës, rrënoi muret e kalasë për të mos e lënë këtë në duart e feudalëve shqiptarë, që kishin tendenca separatiste. Tërmeti i vitit 1920 prishi kullën e portës lindore. Një kullë tjetër katërkëndëshe në murin verior që arrinte lartësinë 7 m. u prish kur u ndërtua kisha katolike. Gjithashtu popullsia e qytetit për vite me rradhë përdorte si burim gurësh e tullash muret e kalasë. Jo vetëm rrënimet por edhe mbushja që është krijuar për një kohë të gjatë nga jeta intensive e qytetit, ka bërë që kalaja të humbasë pamjen e dikurshme.

DO NOT COPY

43) Dokument i **Arshivës së Shtetit, Fondi esnafëve,** Dosja nr. 2, Fletore nr. 5176, fq. 178 mbledhur nga Thanas Konomi.



PLANIMETRIA E KALASE Elbasan

TAB I

DO NOT COPY

TAB. II



DO NOT COPY







DO NOT COPY

TAB. IV











1 — Fragment muri dhe harku i kohës së vonë antike.
2 — Mur bizantin i hershëm.
3 — Mur bizantin i hershëm me brez tullash.
4 — Mur i periudhës turke (1466).
5 — Ornament me tulla në murin turk të vitit 1466.

DO NOT COPY

Gj. KARAISKAJ

LA CITADELLE D'ELBASAN

RESUME

La citadelle d'Elbasan a déjà fait l'objet d'études de la part des archéologues autrichiens, C. Praschniker et A. Schober, qui l'ont visitée pendant la Première Guerre mondiale.

Leurs conclusions n'étant pas exemptes de certaines erreurs et lacunes, nous avons été amenés à reprendre ce travail, en nous fixant pour but une reconstitution plus complète du plan de la citadelle, une description des murs aux principales phases de la reconstruction et une datation plus exacte de l'ouvrage.

* * *

La citadelle d'Elbasan a la forme d'un rectangle de 348 mètres sur 308, garni de tours espacées de 40 ou 45 mètres l'une de l'autre et saillant de 8 à 9 mètres par rapport à la face extérieure des murs. A l'exception du mur sud et d'une partie du mur ouest, bien conservés, les murs sont presque complètement en ruine. La citadelle comptait 26 tours dont 8 seulement subsistent à ce jour, 2 sur le mur sud et 6 sur le mur ouest. Des trois entrées ménagées au milieu de chacun des murs, sud, ouest et est, il n'en subsiste aujourd'hui qu'une, à moitié en ruine, celle du côté sud. L'ouvrage était entièrement entouré d'une douve profonde, dont les traces ont complètement disparu, mais son existence est rapportée par Tchélébi et confirmée plus tard par Hahn et Boué.

L'examen des murs révèle trois périodes principales de construction, sans compter les réparations de moindre importance. Ces périodes appartiennent aux époques suivantes: 1) Basse antiquité, 2) Haut empire byzantin et 3) Occupation ottomane.

I. CARACTERISATION DES PERIODES CONSTRUCTIVES BASSE ANTIQUITE

Les murs de la basse antiquité constituent partout la partie inférieure de la maçonnerie. Ils s'élèvent jusqu'à 3 mètres et forment la base de tous les murs du plan. La technique de construction est celle de l'«Opus mixtum» avec quatre rangées de briques. L'épaisseur du mur au niveau de la ceinture est de 3 mètres. Les parements sont formés de pierres du lit du Shkumbini de dimensions moyennes, disposées en rangées plus ou moins horizontales et la partie intérieure de cailloux du fleuve ou de pierres concassées jetés dans un mortier abondant. Les ceintures sont espacées de 137 à 190 centimètres. Chacune d'elles occupe toute l'épaisseur du mur, leur hauteur est de 30 cm. l'épaisseur des joints de mortier est égale à celle des briques, 4 à 5 cm. Les briques de la ceinture ont les dimensions suivantes: 36 x 24 x 4-5 cm. Le mortier est de bonne qualité, la chaux mélangée à du sable grossier avec une petite quantité de cailloux. Les portes des tours

DO NOT COPY

de la même période sont surmontées de deux arcades concentriques de briques de dimensions 43 x 29 x 5 cm, sans bordure.

Parmi les autres éléments de cette époque subsistent des traces d'escaliers et de quelques piliers qui flanquent les portes des tours.

Depuis le temps où Praschniker visita la citadelle, bien des vestiges ont disparu. Seul le mur sud a été préservé presque dans son état initial. Sur le mur est, outre les tours déjà connues, nous avons déterminé la position de la tour 10, ainsi que les traces du seuil et du jambage d'une porte de pierre au nord de la ruelle qui traverse ce mur en son milieu. Ainsi se reconstitue la forme de l'entrée est et aussi, par symétrie, celle de l'entrée ouest. Sur le mur nord, nous avons déterminé la position des tours 18 et 19 non découvertes par Praschniker. Les traces de la tour 17 qui avait 7 m de haut à l'époque de la visite de Praschniker, ont été conservées sous le mur de l'église catholique. Celle-ci est située sur l'axe de la citadelle et exclut la possibilité d'existence d'une autre tour rectangulaire, figurant par erreur sur le plan qu'il a établi. Le mur ouest porte des traces de la tour 21. Ainsi réussit-on à reconstituer le plan de la citadelle en se basant non seulement sur la symétrie de la construction, mais aussi sur la localisation exacte d'un certain nombre de tours.

Haut Empire Byzantin

On trouve des traces des travaux de cette période sur les murs sud et ouest. Entre les tours 4 et 5 (tableau II) on remarque une réparation qui s'étend sur une longueur égale à la moitié de la courtine reliant les deux tours. Elle consiste dans deux rangées de pierres du fleuve disposées horizontalement, les joints qui les cernent étant enduits de mortier, mélangé de menues pierres concassées. Une autre réparation exécutée suivant la même technique se voit à la tour 7 (tab. II).

Un autre tronçon de cette période se trouve entre les tours 1 et 2. Il est constitué d'une ceinture de briques de trois rangées (tab. II). Une ceinture analogue a été ménagée sur le mur ouest entre les tours 24 et 25 (tab. III). Les briques y ont une largeur de 30 cm et une épaisseur de 4 à 5 cm. L'épaisseur du joint de mortier est de 6 à 8 cm.

Une autre réparation qui se distingue des deux premières se note sur le parement intérieur du mur sud à proximité du musée local de la ville. Ce tronçon aussi comprend une ceinture de briques disposées sur trois rangs (tab. II). Les briques ont des dimensions de 30 x 40 x 5 cm., elles sont profilées sur les côtés et portent un dauphin estampé à un coin (fig. 7), l'épaisseur du joint de mortier est de 7 à 8 cm, le mortier lui-même de très bonne qualité, mélangé de débris de briques. Dans les trois ceintures qui viennent d'être décrites, sous le premier rang de briques, il a été étendu une épaisse couche de mortier pour le nivellement du mur.

La période ottomane de construction

La reconstruction de cette citadelle fut réalisée en 1466, sur l'ordre du sultan Mehmet II. Les murs de 1466 sont remplis de morceaux de briques et parfois de fragments architectoniques, trouvés sur place parmi les ruines de la vieille ville. Les Ottomans s'accommodèrent de la vieille forteresse en y effectuant les adaptations nécessaires pour l'emploi des armes à feu.

Le revêtement ottoman cache souvent le noyau antique ou byzantin du mur. Cela apparaît assez clairement dans le fragment datant du haut moyen âge, qui, proche du Musée, émerge à la hauteur maximale du mur conservé, soit 5 mètres. Celui-ci est en effet revêtu à l'extérieur d'une couche de l'époque ottomane qui descend au-dessous du niveau actuel du terrain. Ce fait explique comment Mehmet II reconstruisit la forteresse en un si court laps de temps.

Parmi les travaux postérieurs à 1466, citons le revêtement intérieur en maçonnerie de la courtine reliant les tours 1 et 2, ainsi que la reconstruction des tours 3 et 5, qui furent munies de grandes meurtrières de canons, ouvertes en entonnoir vers l'extérieur, ce qui permettait un plus vaste champ de tir.

DO NOT COPY

II. PROBLEMES DE DATATION

Praschniker fait remonter la première phase de la construction aux années 300-530 de l'ère nouvelle. Pour aboutir à cette conclusion, il se fonde sur le fait que cet ouvrage est du type «castra». H. Ceka, lui, estime que cette forteresse a été construite à partir de ses fondements par Justinien, et l'identifie à Skeminites qui figure sur la liste de Procope. Dans les confrontations que fait Praschniker pour fixer comme «terminus a quo» la période transitoire du IIIe au IVe siècle, il a eu en vue la forme rectangulaire de ces forteresses aux tours saillant hors des remparts. Mais l'on connait aussi des forteresses antérieures de ce type, à savoir Castra Praetoria et la citadelle de Pontes sur le Danube, etc. Toutefois cet auteur, n'ayant pas relevé la similitude réelle de la forme de ces tours avec celles de la citadelle d'Elbasan, a été amené à se tromper également dans la comparaison qu'il en a faite avec les forteresses d'Afrique du Nord.

Pour déterminer l'époque la plus probable d'édification, nous avons surtout pris pour base la technique de la construction et les données historiques.

Nous n'avons pas analysé la période antérieure à 313, époque où le christianisme fut proclamé religion d'Etat, et cela à cause d'une brique empreinte d'une croix, trouvée dans l'ossature et qui exclut la possibilité d'une reconstruction de la citadelle avant cette date. La circonstance historique qui en a déterminé la construction, où il faut voir un mur d'enceinte de ville et non pas une forteresse de garnison, est la situation créée à la suite de la conquête de l'Illyrie par les Goths en 378.

Sur la base des données historiques et des particularités techniques de la construction, nous pensons que l'époque la plus probable de l'érection de cette citadelle est celle comprise entre 380 et le milieu du Ve siècle.

En ce qui concerne les autres constructions dont la date, selon nous, remonte au haut Moyen Age, notre insuffisante connaissance de la technique de construction de cette période, ne nous permet pas d'avancer une datation plus exacte que l'approximation ci-dessus.

La première reconstruction ottomane date, d'après les sources historiques, de 1466. Nous nous sommes efforcés d'en retracer les contours sur notre croquis, cette reconstruction étant, quant au volume, la plus importante (tab. II et III). Nous avons distingué ces murs du fait qu'ils s'élèvent directement sur les remparts de l'époque romaine et du haut Moyen Age et qu'on y a utilisé beaucoup de morceaux de briques prélevés sur les ruines de la vieille forteresse et jetés pêle-mêle dans la maçonnerie.

Quant à l'époque de la construction des deux tours (3 et 5), les données dont on dispose induisent à admettre comme la date la plus probable de cette reconstruction la période allant de la fin du XVe siècle à 1506, lorsque l'Albanie était agitée par des insurrections successives et que les possessions vénitiennes voisinaient encore avec Elbasan.

En 1832, Mehmed Rechid pacha ayant fait abattre une partie des remparts, l'ouvrage fut gravement dégradé. En 1920, la tour rectangulaire de l'entrée sud s'écroula à la suite du tremblement de terre. De plus, c'est aux remparts de la citadelle que la population de la ville s'approvisionnait généralement en pierres et en briques. Non seulement sa dégradation, mais encore son peuplement, entraîné par la vie intense de la ville, ont fait perdre à la citadelle son aspect d'antan.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

RESTAURIMI I PORTËS SË LUANIT – BUTRINT

DO NOT COPY

Në qendrën e rëndësishme arkeologjike të Butrintit, para disa vjetëve u krye restaurimi i njërës nga të shtatë hyrjet e qytetit të lashtë, «Porta e Luanit» [1]). Në këtë punim do të paraqesim shkurtimisht arësyet e ndërhyrjes sonë në këtë monument, metodën e restaurimit dhe rezultatet e arritura në përfundim të punimeve restauruese.

Porta e Luanit (fig. 1) është e hapur në muret rrethuese të qytetit, në anën verilindore të tij, në afërsi të bregut të liqenit të Butrintit.

Sikundër dihet kjo portë doli në dritë nga gërmimet arkeologjike, gjatë viteve 1928-1935 [2]). Ajo u zbulua menjëherë mbas Portës Skea, një hyrje tjetër kjo që u gjet në gjendje shumë të mirë dhe ruan të paprekur pamjen e saj fillestare. Përmasat madhështore i japin kësaj porte pamje monumentale. (fig. 2). Të dy këto porta kanë një zgjidhje arkitektonike dhe konstruktive të përbashkët dhe një planimetri me përmasa të përafërta. Ato janë të ndërtuara, gjithashtu, me materiale dhe teknikë të njëjtë. Këto porta i kanë shërbyer qytetit për një periudhë të gjatë, duke filluar qysh nga shek. IV para erës së re [3]).

Porta e Luanit u gjet shumë e dëmtuar dhe e transformuar (Tab, I–1), sidomos në fasadën e jashtme të hyrjes, ku nuk ruante asnjë gjurmë nga pamja origjinale e saj. Në këtë fasadë duken të qarta gjurmët e një rindërtimi të faqes së jashtme të murit të portës që është bërë në kohën e vonë antike [4]), që, siç duket, do të ketë qenë rrëzuar ose prishur, për arësye të panjohura për ne. Teknika dhe mënyra e vendosjes së faqes së murit të rindërtuar, paksa më jashtë nga fasada origjinale si edhe mungesa e lidhjes së tij me konstruksionin e vjetër të portës, që ruhet në brendësi të saj, na len të dyshojmë për një punë të kryer me të shpejtë. Materiali që është përdo-



Fig. 1

1) Emri që ka marrë kjo portë lidhet me figurën e luanit, që u gjet i gdhëndur në arkitraun e portës së rindërtuar në kohën e vonë antike.
2) Gërmimet u kryen nga misioni arkeologjik italian nën drejtimin e arkeologut L.M. Ugolini.
3) Ugolini L.M. **Albania Antica,** vëll. III, Roma 1942, fq. 49.
4) Ugolini L.M. **Albania Antica,** vëll. III, Roma 1942, fq. 63.



Fig. 2

rur në këtë rast dallohet që është marrë nga ndërtime të tjera ose pjesërisht nga muri i rrëzuar i fasadës së vetë portës.

Zvogëlimi i hapësirës së hyrjes në 1,19 m. gjerësi dhe 1,50 m. lartësi, përmasa këto shumë të vogla në krahasim me hyrjen fillestare, tregon gjithashtu se kjo portë në këtë kohë e ka humbur rëndësinë e saj të mëparshme dhe funksioni i saj ishte bërë i dorës së dytë. Nga ky rindërtim ruhen të paprekura hyrja e portës, disa bloqe gurësh të vendosura në katër radhë mbi arkitraun e portës dhe vetëm dy rreshta nga faqja e murit të rindërtuar në të djathtë të hyrjes.

Gjurmët e ndërtimeve mesjetare, që vihen re si në fasadën e portës ashtu edhe sipër saj, tregojnë se kjo portë, në këtë kohë, nuk ka pas funksionuar fare. Mbeturinat e mureve antike të mbuluara kanë qenë shfrytëzuar si bazament për ndërtimin e një kulle që bënte pjesë në sistemin e fortifikimeve mesjetare.

Nga porta origjinale ruhet në gjendjen fillestare, pa asnjë ndryshim, korridori dhe gjithë fasada e pamjes së brendshme të saj. Korridori i portës, me përmasa 3 m. gjatësi dhe 4,40 m. lartësi, formohet nga ndërprerja dhe spostimi i drejtimit të murit rrethues të qytetit (Tab I-2). Në hyrje ky korridor është i gjerë 2,15 m., kurse në thellësi vjen duke u ngushtuar deri në 1,65 m. Ai mbulohet, në të gjithë gjatësinë, nga një tavan i ndërtuar nga dy arkitrarë monolitë, i hyrjes dhe i daljes së portës, dhe nga tre trarë të gurtë ndërmjet tyre. Si arkitrarët ashtu dhe trarët që mbulojnë hapësirën e korridorit; mbështeten mbi ancakë, që dalin 0,32 m. nga drejtimi vertikal i mureve anësore të korridorit. Trarët janë të gdhendur me daltë në të katër faqet. Përmasat e tyre janë të ndryshme si në gjatësi ashtu edhe në seksion. Arkitrau i hyrjes fillestare në fasadën e jashtme dhe pjesa e murit ndërtuar sipër tij u gjetën të rrëzuar, kurse bërthama e murit që ngrihej mbi tavanin e korridorit ishte shumë i dëmtuar dhe në rrezik shembjeje. Për ruajtjen e këtij monumenti, në gjendjen siç doli nga gërmimet arkeologjike, u morën masa provizore, duke përforcuar gurët e tavanit të korridorit me një konstruksion mbajtës, ndërtuar me shtylla druri. (TAB. I - 3)

Me qëllim që kjo portë të ruhej nga dëmtimet e mëtejshme dhe të përjashtohej njëherë e përgjithmonë rrezikshmëria e shembjes, u vendos që të studjohej mundësia e restaurimit të saj meqenëse për vlerën historike dhe arkeologjike ajo zë një vend të rëndësishëm në rradhën e monumenteve, që ruhen akoma në qytetin e lashtë të Butrintit.

Për zgjidhjen e kësaj detyre u bë një studim i hollësishëm i gjendjes në të cilën na paraqitej konstruksioni i vet portës, si edhe i elementeve arkitektonike që ishin shtuar nga rindërtimet e mëvonshme. Si rezultat i këtij studimi arritëm në përfundim, që ndërhyrja e jonë në këtë monument të kufizohej në rivendosjen e elementeve konstruktive dhe arkitektonike të dëmtuara, dhe në rindërtimin e pjesës së sipërme të murit të fasadës së portës, që, siç thamë, u gjet i rrëzuar që prej kohësh. Pjesa që ruhet nga rindërtimi i fasadës së hyrjes, kryer në kohën antike, do të lihej në atë gjendje që doli nga gërmimet, kurse muri i kullës mesjetare, pjesa që mbështetej mbi tavanin e por-

DO NOT COPY

tës, meqënëse duhej të prishej detyrimisht gjatë punimeve të restaurimit, nuk u gjet me vend që të rindërtohej.

Punimet e restaurimit u kryen gjatë muajve prill-qershor të vitit 1962. Në fazën e parë të punimeve u gërmuan shtresat e dheut të depozituara në pjesën e sipërme të mbulesës së portës. Në këtë shtresë, e cila arrinte rreth 40 cm. trashësi, u gjetën me shumicë fragmente tjegullash në formë lugu, mbeturina këto të çatisë së kullës mesjetare, e cila, siç thamë, ishte ndërtuar mbi konstruksionin e portës antike.

Pas kësaj, prishëm dhe larguam mbeturinat mesjetare në të gjithë sipërfaqen që mbulonte korridorin e portës dhe ramë në gjurmët e murit antik, i cili na u paraqit në pjesën më të madhe i dëmtuar. Nga shtresa e sipërme e murit, që mbulonte korridorin, nuk ruheshin veç gurët e veshjes së murit ndërtuar mbi arkitraun e brëndshëm të portës dhe tre gurë të tjerë me madhësi e formë të ndryshme. Këto të fundit u gjetën të vendosur njeri mbas tjetrit në drejtim të tërthortë në gjerësinë e korridorit. Gurët e tjerë të këtij rreshti duhet të jenë hequr nga vendi në kohën e ndërtimit të kullës mesjetare.

Në vazhdim të punimeve të prishjes së murit nga sipër, në rreshtin e dytë u gjet një gur i madh, i vendosur edhe ky tërthorazi, që zinte një sipërfaqe mjaft të madhe në bërthamën e murit; gurët e tjerë që u gjetën përbri tij ishin me përmasa më të vogla, por kishin të njëjtin funksion, të mbulonin hapësirën që ekzistonte nën to. Me heqjen e këtyre gurëve u pa se ata mbështeteshin vetëm në ekstremet gjatësore të tyre, mbi gurë që ishin vendosur anash, mbi trarët e gurtë të tavanit. Ndërmjet këtyre të fundit dhe rreshtit të mësipërm krijohej një hapësirë, e cila kish për qëllim të shkarkojë peshën e bërthamës së murit, që ngrihej në lartësi, në drejtim të dy mureve anësorë të korridorit. Krijimi i kësaj hapësire në gjithë gjatësinë e bërthamës së murit tregon për një zgjidhje konstruktive karakteristike, sepse, sikundër dihet, në teknikën e ndërtimeve të periudhës arkaike dhe antike, shkarkimi i forcave mbi hapësira që mbuloheshin me arkitrarë arrihej duke krijuar sipër arkitraut një hapësirë në formë trekëndshi dybrinjënjishëm. Në rastin tonë drejtimi i shkarkimit të peshës formon figurën e një trapezi për arësye se muri që ngrihej mbi tavanin e portës nuk ishte shumë i lartë dhe, si rrjedhim, pesha nuk ishte shumë e madhe. Ky sistem është përdorur vetëm në brendësi të murit, kurse në veshjet e murit (faqet e jashtme të tij) pesha shkarkohet direkt mbi arkitrarët.

Me pastrimin e dherave, që kishin mbushur të gjithë hapësirën që përmendëm, u zbuluan gurët e tavanit (Tab I - 4), i cili formohej nga pesë bloqe gurësh të gdhendur në të gjitha faqet, të vendosur në radhë bri njëri tjetrit, duke mbuluar kështu të gjithë sipërfaqen e tavanit të korridorit. Bloqet kishin përmasa të ndryshme; ata mbështeteshin të gjithë mbi ancakët dhe ndonjëri arrinte të mbështetej pjesërisht edhe mbi muret anësorë të korridorit. Bloqet e gurëve të tavanit u gjetën shumë më të dëmtuar se sa dukeshin nga brenda portës. Duke filluar në të majtë të hyrjes kryesore, u gjet një pjesë nga bloku i arkitraut të pamjes së jashtme; kjo pjesë ishte afro sa 1/3-ta e madhësisë dhe gjatësisë fillestare, dhe qe shumë e dëmtuar. Bloqet e tjera u gjetën të dëmtuar, pjesërisht të thyer në dy ose më shumë pjesë. Vlen të theksohet se bloku i IV mbas arkitraut, ishte shumë i hollë vetëm 0,22 m dhe sipër tij u gjetën të vendosur dy gurë të tjerë, që plotësonin në këtë mënyrë trashësinë 0,44 m. të bloqeve, që kish anash.

Me largimin e bloqeve të tavanit nga vendi, u zbulua e gjithë hapësira e korridorit të portës; në këtë mënyrë arritëm të shohim nga sipër ancakët, të cilët u gjetën gjithashtu shumë të dëmtuar aqë sa pjesa më e madhe e tyre nuk mund të rivendosej në vend.

Këto qenë punimet e fazës së parë. Në fazën e dytë punimet filluan në drejtim të disa proceseve teknike të nevojshëm për punimet restauruese, që do të kryheshin në këtë monument.

Në përputhje me detyrën tonë kryesore, e cila qe ruajtja dhe rivendosja në vend e gjithë materialit dhe e elementeve origjinale, punimet filluan së pari me ngjitjen e bloqeve të thyer. Krahas këtij procesi filloi edhe pregatitja e atyre elementeve të cilat ishin shumë të dëmtuar ose që mungonin. Shtojmë se materiali dhe elementet e reja të shtuara, po të krahasohen me ato origjinale, janë relativisht shumë të paktë dhe janë përdorur vetëm në rastet më të domosdoshme.

Elementet, që u ribënë janë shtatë nga të nëntë ancakët dhe arkitrau kryesor. Ancakët u rigdhendën nga gurë të gjetur në afërsi të monumentit, kurse për arkitraun e ri nuk mundëm të gjenim ndonjë blok guri që të mund të plotësonte përmasat e mëdha që kishte arkitrau. Një blok të tillë nuk mund ta nxirrnim as nga guroret antike, gjurmët e të cilave ruhen në anën JL (në gjysmën e pjerësisë së kodrës) si edhe në pjesën e sipërme të kodrës (në anën perëndimore të saj) [5]. Këto gurore nuk mund të shfrytëzoheshin, mbasi formacioni shkëmbor i tyre ishte masiv dhe nxjerrja prej tyre e një bloku guri kaq të madh (2.80 x 0.60 x 0.35 m.) ishte për mundësitë tona shumë e vështirë. Për këto arësye u detyruam që të kërkojmë formacione shkëmbore të shtresëzuar. Në kërkim të këtyre shtresave

5) Ugolini L.M. Albania Antica, vëll. III, Roma 1942, fq. 10.

DOKUMENT

arritëm deri në Shkallë të Konispolit, rreth 12 km. larg Butrintit. Në këtë zonë i gjithë formacioni shkëmbor i kodrës ishte në shtresa të palosura, me trashësi të ndryshme. Nga një rikonjicion që bëmë për të gjetur vendin më të përshtatshëm ku mund të nxirrnim blokun që kishim nevojë, ramë në gjurmët e një gurore antike [6]). Në afërsi të kësaj guroreje gjetëm një shkëmb, që plotësonte përmasat e nevojshme për nxjerrjen e blokut, të cilin e pregatitëm për të zëvendësuar arkitraun kryesor.

Pasi përfunduam pregatitjet filluan punimet e rindërtimit. Në radhë të parë u vendosën ancakët ekzistues, si edhe ato që u ribënë. Në vazhdim sipër mensolave u vendos arkitrau i fasadës dhe me radhë bloqet e gjata të tavanit deri tek arkitrau i brendshëm (Tab. II-1). Në vendosjen e bloqeve të gjata, na u desh të bëjmë një çvendosje: në vendin që zinte bloku II, i cili vinte menjëherë mbas arkitraut kryesor, vendosëm blokun III, ndërsa të dytin në vendin e të tretit. Këtë çvendosje u detyruam ta bëjmë sepse, edhe pas ngjitjes, ai nuk plotësonte gjatësinë e nevojshme për vendin që zinte në fillim. Kurse në vendin III (meqënëse hapësira e koridorit vjen duke u ngushtuar) ky bllok mbështetej më mirë mbi ancakët.

Mbas vendosjes së bloqeve të tavanit, filloi rindërtimi i pjesës së murit (me gurë të pregatitur rishtas) në fasadën kryesore, që ngrihej sipër arkitraut të hyrjes së portës. Në të njejtën kohë u bë edhe rivendosja e gurëve të murit të fasadës së brendshme. Hapësirën sipër bloqeve të tavanit ne e rikrijuam disi duke vendosur katër shina hekuri (Tab. II-2) në vend të bloqeve të gurëve të dëmtuar. Këtë ndryshim u detyruam ta bëjmë për arësye se disa nga bloqet e tavanit, tani të ngjitur në disa pjesë, nuk kishin më rezistencën e duhur prandaj na u desh që këto t'i lidhim nga sipër me ganxha hekuri, duke i varur pjesërisht mbi shinat e hekurta. Sipër shinave u bë rindërtimi i pjesës së brendshme të murit, deri në lartësinë e radhëve të faqeve të jashtme të tij. Punimet përfunduan duke hedhur një shtresë betoni në gjithë gjerësinë e murit si masë paraprake për izolimin e mbulesës së portës, nga reshjet.

Si rezultat i punimeve restauruese, që u kryen në këtë monument, u arrit që të mënjanohej dëmtimi i mëtejshëm dhe rrezikshmëria e shembjes. Një përmirësim i dukshëm ju bë gjithashtu dhe pamjes së portës (Tab. II-3). Ajo tashmë e çliruar nga pajandimet e konstruksionit të drurit, qendron në këmbë madhështore ashtu si edhe në të kaluarën e saj të lashtë.

6) K.Zheku. Zbulimi i një guroreje antike në Shkallë të Konispolit, BUSHT Seria Shkencat Shoqërore Nr. 1, 1963, fq 228-232.

DO NOT COPY



1



2



3



4

DO NOT COPY







DO NOT COPY

K. ZHEKU

LA RESTAURATION DE LA PORTE DU LION A BUTRINT

RESUME

La Porte du Lion a été mise au jour, comme on sait, par les fouilles archéologiques effectuées dans les années 1928 - 1935, par la mission italienne conduite par l'archéologue L.M. Ugolini. Cette étude a pour objet d'exposer brièvement les raisons qui ont porté à intervenir pour la conservation du monument, la méthode de restauration employée et les résultats obtenus à la suite de ces travaux.

Bien que partiellement endommagée, la Porte du Lion conserve intacts dans sa partie intérieure la structure et les éléments architectoniques de son état primitif.

Telle qu'elle est apparue à l'issue des fouilles archéologiques, la Porte du Lion est reconstruite sur sa face externe, et des vestiges subsistant encore aujourd'hui témoignent de la reconstruction de la façade principale, travail qui doit dater de la basse époque antique. La réduction de l'ouverture de l'entrée à des dimensions très inférieures à celles de l'entrée initiale, atteste que, à cette période, la porte avait perdu son importance antérieure.

La partie supérieure de la façade reconstruite a été trouvée en ruines, et le plafond de pierre qui en recouvre le couloir intérieur menaçait de s'effondrer. Le mur de la face interne de la porte était assez bien conservé.

Afin de maintenir ce monument dans l'état où les fouilles archéologiques l'ont fait apparaître, des mesures furent prises pour raffermir les pierres du plafond du couloir à l'aide d'une construction de soutien formée de piliers et de contre-fiches en bois. Mais ces mesures, insuffisantes, n'offraient aucune garantie.

En vue de préserver cette porte de détériorations ultérieures et d'écarter définitivement toute menace d'effondrement, il fut décidé d'étudier les possibilités de restauration de ce monument, qui, par sa valeur historique et archéologique, est un des plus importants de ceux qui subsistent aujourd'hui dans la cité antique de Butrint.

A cet effet, il fut procédé à une étude détaillée de l'état de la construction de la porte même, ainsi que des éléments architectoniques qui s'entrelaçaient dans les reconstructions postérieures que nous venons d'évoquer.

A la suite de cette étude, il fut résolu que notre travail devrait se borner à restaurer les éléments de construction et d'architectonique endommagés, et à reconstruire la partie supérieure du mur de façade de la porte, partie qui, comme nous l'avons dit, était depuis longtemps en ruine. La partie qui subsiste de la façade reconstruite à l'époque antique, sera laissée dans l'état où elle a été trouvée au moment des fouilles; quant au mur de la tour médiévale et à la construction reposant alors sur le plafond du couloir de la porte, qui devaient nécessairement être détruits au cours des travaux de restauration, il ne fut pas jugé opportun de les reconstruire.

DO NOT COPY

Les travaux de restauration furent effectués durant les mois d'avril-juin 1962.

Dans leur première phase, ils eurent pour objet d'enlever, d'en haut, tout le mur reposant sur le plafond du couloir de la porte, alors que, dans la seconde, ils portèrent surtout sur certaines opérations techniques nécessitées par la substitution des pierres endommagées ou manquantes. La phase finale des travaux a consisté dans la mise en place de tous les matériaux et éléments architectoniques originaux ainsi que de ceux qui avaient été refaits. On a replacé tour à tour les consoles, puis, au-dessus, les architraves (interne et externe), et enfin entre ceux-ci, les plates-bandes qui formaient le plafond du couloir.

Par la suite, on a reconstruit, (avec des pierres nouvellement appareillées) la partie du mur qui s'élevait sur l'architrave de l'entrée de la porte. En même temps, on a replacé les pierres du mur de la façade intérieure.

Le vide initialement formé par la disposition de grosses pierres sur les plates-bandes du plafond, a été en quelque sorte recréé par l'utilisation de quatre poutres de fer à la place des blocs de pierre, trouvés très endommagés. Une des raisons de cette substitution consistait dans le fait que certaines plates-bandes jointes bout à bout par endroits, n'avaient plus la résistance voulue et l'on dut, pour ce motif, les fixer d'en dessus, en les accrochant partiellement aux poutres de fer. Sur celles-ci la partie intérieure du mur a été reconstruite jusqu'à la hauteur du parement extérieur.

Les travaux de restauration effectués sur ce monument ont eu pour premier résultat d'écarter le danger de détérioration ultérieure et d'écroulement eventuel. Ils ont permis d'acquérir, sur la technique et l'architecture antiques, de nouvelles connaissances qui aideront à mieux accomplir les tâches que pose le travail de restauration en général.

Une amélioration apparente a été également obtenue dans l'aspect de la Porte du Lion, qui, maintenant dépuillée des contre-fiches en bois de la construction de soutien, se dresse, majestueuse, comme en son antique passé.

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

GJURMIME RRETH THEMELIMIT DHE RINDËRTIMEVE KRYESORE TË KALASË SË KRUJËS

Duke folur për rolin historik të Krujës, shoku Enver Hoxha theksoi: «Kush thotë Skënderbej, thotë Krujë. Populli ynë me Skënderbeun në krye e bëni në Shqipërinë dhe Krujën të famshme në historinë e njerëzimit» [1]). Pra, roli që ka luajtur kalaja e Krujës gjatë shekujve dhe veçanërisht gjatë epopesë së madhërishme 25 vjeçare të shek. XV, përcakton rëndësinë shkencore që paraqet studimi i këtij monumenti që është nga më kryesorët në periudhën e mesjetës, në vëndin tonë. Në këtë punim do të analizojmë një nga problemet më kryesore që dalin gjatë studimit të saj atë të datimit të themelimit si dhe rindërtimet e ndryshme më të rëndësishme, që kalaja ka pësuar në kohë.

1. MBI THEMELIMIN E KALASË.

Qyteti i vogël piktoresk i Krujës është ndërtuar në pllajën e faqes perëndimore të malit Sarisalltik, në një lartësi rreth 600 m. mbi nivelin e detit.

Kreshta shkëmbore e Krujës, mbi të cilën është ngritur kalaja (fig. 1), ndodhet e veçuar nga ambienti përreth, në pjesën më të lartë, nga ana juglindore e qytetit. Duke qenë me mbrojtje të favorshme natyrale, e rrethuar thuajse nga të katër anët, sidomos në anën lindore, me shkëmbinj të thepisur, kjo kodër shkëmbore përbën në vetvete një fortesë natyrale. Ajo ka një pozicion që mbizotëron mbi të gjithë fushën dhe malet përqark. Këto na bëjnë të mendojmë që kjo kodër e pazaptueshme duhet të jetë shfrytëzuar prej kohe nga të parët tanë për vendbanim e mbrojtje.

Planimetria e kalasë (Tab. III) ka formën e një elipsoidi me perimetër rreth 800 m. Muret me trashësi 0,8-1,5 m. ndjekin konturet e kreshtës shkëmbore mbi të cilën janë vendosur, duke u ndërprerë në anën lindore, perëndimore e jugore në disa vende. Muret e anës veriore dhe lindore, që ruhen deri diku më mirë, janë të pajisur me frengji për armë zjarri. (TAB. II, 4)

Në ndryshim me tërësinë e mureve të sotme të kalasë, të ndërtuar vetëm me gurë e llaç dhe që i përkasin periudhës së pushtimit turk, nga vrojtimet del se gjenden edhe gjurmë fragmentare muresh që mund t'i antribuohen periudhës para pushtimit turk. Megjithëse teknika nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm, dallohet se kemi të bëjmë me ndërtime jo të një dore me tërësinë e mureve, por të një kohe më të përparshme. Ky dallim vërehet në ndryshimin e trashësisë së mureve si edhe në përdorimin tektuk të tullës. Të tilla janë: një trakt muri pranë kullës katrore të anës perëndimore (fig. 2), disa fragmente të vogla muresh në afërsitë e mureve të sotëm jugperëndimore të kalasë, një trakt muri i jashtëm nga ana lindore.

Muret rrethuese të kalasë janë përforcuar nga 9 kulla me formë të rrumbullakët, katrore ose poligonale. Dy kulla ndodhen në të dy krahët e hyrjes, në mbrojtje të portës kryesore. Kulla në të majtë të hyrjes ka formë poligonale të çrregullt dhe ka qenë përdorur edhe për banim (Tab. I, 1); kulla e krahut të djathtë është e rrumbullakët dhe ka një perimetër 27 m.

---

1) Enver Hoxha, Fjala e mbajtur në aktivin e Partisë të rrethit të Krujës në mars 1967.



Fig. 1 — Pamje e përgjithëshme e kalasë.

(TAB. I, 1). Konstruksioni i saj tregon, se pjesa qendrore e saj përdorej si sterë për depozitimin e ujit të shiut.

Duke ndjekur murin perimetral në drejtimin veriperëndimor, në një distancë prej 41 m. nga kulla e rrumbullakët e hyrjes, gjendet një kullë tjetër e rrumbullakët me perimetër 25 m. Gjatë punimeve të restaurimit më 1967 në këtë kullë u zbulua një trakt muri i një kulle të vjetër. Po e tillë ka qenë dhe kulla katrore e anës perëndimore të kalasë, që ndodhet 56 m. më tej kullës së mësipërme; në të dallohet sot një radhë tullash midis bloqeve të gurëve. Skaji jugperëndimor i kalasë, që përbën pjesën më të ulët, prej nga mund të kalohet në kala, është pajisur me një sistem mbrojtës prej tri kullash, dy të rrumbullakta dhe një në formë segmenti rrethor. (TAB. II, 2) Mbi kullën e rrumbullakët, që vendasit e quajnë «Tabja e Dollmës» dhe që është e mbrojtur me mure të larta e të trasha, ngrihet një faltore e sektit bektashian [2]). Kulla që ka perimetrin më të madh (35 m.), është ajo e skajit jugperëndimor. (TAB. II, 4) Kulla është restauruar pjesërisht. Ajo shërben jo vetëm për ta mbrojtur kalanë nga kjo anë, por edhe për të bërë vrojtime në drejtim të Zaharisë. Në skajin verilindor të mureve rrethuese ndodhet kulla e njohur e sahatit, (TAB. II, 3) me lartësi 16 m. dhe perimetër 32,5 m., edhe kjo e restauruar në vitin 1967. Pjesa e poshtme e anës veriore e perëndimore e kullës së sahatit është ndërtuar me një muraturë prej gurësh të përzier me copa tullash, që, për mendimin tonë, daton para kohës së pushtimit turk [3]).

Përveç hyrjes kryesore, të vendosur në anën veriperëndimore, që e trajtojmë hollësisht më poshtë, ka edhe një hyrje tjetër në skajin jugperëndimor, (fig. 3) që komunikon nëpërmjet një tuneli. Porta e jashtme e hyrjes mbulohet prej një arkitrau, mbi të cilin ngarkesa e mureve shkarkohet me anë të një harku tullash. Mendojmë se kjo teknikë po ashtu i përket kohës para pushtimit turk. Nepërmjet kësaj hyrjeje dilet tek krojet, që burojnë në rrëzë të shkëmbit, jashtë mureve

2) Teqeja e baba Mustafa Dollmës është një godinë 10 x 10 m. me kube e dritare të bukura, ndërtuar në vitin 1789, pikturuar nga brenda me arabeska. (Thuhet se ka qenë kishë).

3) Vlera historike e këtij reliku të çmuar është pasuruar gjatë kohëve edhe nga vetë funksionet e ndryshme që kulla ka ndrruar sipas nevojave që u janë çfaqur përdoruesve të saj. Nga vetë pozicioni i saj, ajo duhet të ketë qenë destinuar si pikë vrojtimi dhe si qendër sinjalizimi. Sipas traditës gojore kjo kullë ka pas qenë kumbanarja e kishës së Skënderbeut. Shih për këtë: Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun, Tiranë 1967, fq. 43.

DO NOT COPY

të kalasë [4]), të cilët dikur mbroheshin me mure të dyta të fuqishme, që i lidhnin me kalanë. Pjesë të këtyre mureve të trasha e të larta dhe mbeturinat e dy kullave ekzistojnë edhe sot.

Gjurmët, që ende ruhen, tregojnë se në hyrjen kryesore të kësaj kalaje, në periudha të ndryshme, kanë qenë vendosur tri porta, në mënyrë që hyrja në kala të ishte e kontrolluar dhe e mbrojtur sa më mirë në rast të një mësymje të armatosur. Porta e parë ka qenë njëfletëshe dhe ulej e ngrihej në drejtimin vertikal, duke rrëshqitur nëpërmjet dy kanaleve të ndërtuar qëllimisht në muret anësore të hyrjes. Gjurmët e këtyre kanaleve i gjejmë edhe sot në murin e krahut të majtë. Po në këtë mur ruhet e dëmtuar pjesa e fillimit të një harku me tulla. Porta e dytë ka qenë vendosur afërsisht aty ku është porta e sotme. Edhe këtu duken pjesë nga muri i vjetër, si edhe një fragment që mbulonte portën. Porta ekzistuese është ndërtuar me gurë të daltuar dhe dallohet si një ndërtim i kohës së vonë. Porta e tretë duhet të ketë qenë në fund të korridorit dhe duhet të nxirrte menjëherë në oborrin e kalasë. Korridori, që ka një gjatësi 22 m., ndahet nga porta e dytë në dy pjesë jo të barabarta. Në të dy anët e korridorit të pjesës së parë janë ndërtuar me tulla, në thellësi të murit, dy kamare të mëdha (nike) të mbuluara me qemere cilindrike, të kufizuara në pjesën e sipërme nga një kornizë tek tulle (Tab. IV, 2). Këto ambiente, të njohura në forma të ndryshme edhe në kala të tjera mesjetare, kanë shërbyer si vendroje. Sot ruhet mjaft mirë kamarja e harkut të majtë, kurse nga ajo e harkut të djathtë ruhen vetëm pjesë të qemerit të saj. Në pjesën e dytë të korridorit ruhen, në gjendjen e tyre fillestare, nga dy galeri të vogla për çdo anë, të mbuluara edhe këto me qemere të ndërtuar me gurë dhe që kanë qenë përdorur për strehimin e trupit të rojes. (TAB. II. 1) Teknika e ndërtimit dhe materiali i përdorur në ndërtimin e pjesës së dytë të korridorit si edhe në ambientin e tij, tregojnë për një shtesë të mëvonshme në krahasim me pjesën e parë të korridorit. Gjurmët që ruhen në pjesën e sipërme të mureve anësore të korridorit tregojnë gjithashtu që të dy pjesët kanë qenë të mbuluara me qemer. Në pjesën e parë qemeri ka qenë ndërtuar me tulla, kurse në pjesën e dytë të mëvonshme me qemer guri.

Në të djathtë të portës së tretë, që siç thamë të nxjerr në oborrin e kalasë, dallohet një ambient që, me sa duket, ka qenë përdorur si depo baruti, dhe për të cilin tradita gojore thotë se përdorej si burg, ka një



Fig. 2 – Gjurmë paraturke pranë murit perëndimor.

planimetri në formë kryqi. Pjesa qendrore e tij mbulohet me një kupole sferike, kurse pjesët e tjera me qemer gjysmë cilindrik. Ai ka vetëm një hyrje të vogël dhe ndriçohet indirekt me anën e një dritareje, që e merr dritën nga një galeri e korridorit, si edhe me anën e një baxhaje të hapur në murin jugperëndimor. Ndërtimi i këtij ambienti, duke gjykuar nga teknika e ndërtimit, len të kuptojmë se është i njëkohshëm me galeritë e pjesës së dytë të korridorit dhe se përbën një kompleks të përbashkët me to.

Në krahun e majtë të hyrjes së këtij ambienti ndodhen gjurmët e një palë shkallëve (TAB. I, 2) që komunikonin me ambientet e katit të dytë. Në gjendjen

4) Fallmerayer thotë se «uria mundet edhe të thyente qëndresën e kësaj kalaje të fortë, në majë të një shkëmbi, por uji nuk do t'i mungonte kurrë, mbasi brenda në kala kish një burim të pashtershëm...» (Fallmerayer J. Ph., **Das albanesische Element in Griechenland.** I, II, III, Abteilung, Munchen 1860, fq. 21.)

DO NOT COPY



Fig. 3 — Hyrja e dytë në skajin jugëperëndimor.

që na paraqitet sot kati i dytë, d.m.th. kati që ishte ndërtuar sipër koridorit të hyrjes, kullës së rrumbullakët dhe depos së barutit, mund të nxjerrim si përfundim se dikur ambientet e shumta të këtij kati kishin lidhje edhe me ambientet e kullës përkundrejt dhe, sëbashku, përbënin një kompleks të rëndësishëm. Në këtë kompleks bënin pjesë ambiente me karakter mbrojtës të hyrjes kryesore të kalasë, si edhe ambiente banimi. Këtij kompleksi duhej t'i shërbente edhe stera, që ka qenë ndërtuar në qendër të kullës së rrumbullakët, e cila u zbulua gjatë punimeve të restaurimit në vitin 1967. Ajo ka një trajtë cilindrike me diametër 3 m. dhe ka qenë mbuluar me një kupolë gjysmë sferike të ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje. Në pjesën e sipërme, aty ku fillon kurbëzimi i kupolës, është murosur një tub keramike, nëpërmjet të cilit furnizohej stera me ujë. Në afërsi të këtij tubi auken shenjat e grykës së sterës nga nxirrej me kovë uji i depozituar në të.

Në pjesën e sipërme, ndërmjet sterës dhe *murit* perimetral të kullës, duket një korridor i ngushtë që përshkon një gjysmë rrethi. Ky korridor lidhej me ambientin e katit të dytë, që përmendëm më lart, me anë shkallësh prej guri dhe, në anën e kundërt, përfundon pak më tej nga gryka e sterës. Përmasat e korridorit tregojnë se përbrenda tij mund të qarkullonte me pak vështirësi një njeri më këmbë. Pjesa lindore e këtij korridori, që ruhet më mirë, tregon se ai ka qenë mbuluar me anën e një qemeri gjysmë cilindrik.

* * *

Për Krujën është shkruar mjaft. Ne trashëgojmë një numër përshkrimesh, që na janë lënë qysh nga shek. XVI prej Barletit dhe Justinianit, në shek. XVII nga Bolica, ndërsa në shekullin e kaluar e këtej nga historianë si Myler, Hani, Ipeni, Paçi, Jireceku, Shuflai etj.[5]) Por burimet historike të deritanishme, që më tepër kanë karakter përshkrimor, shpesh të nisura nga pozita prej vizitori të zakonshëm, ose heshtin rreth themelimit të kalasë ose janë të cekta e kontradiktore.[6]) Të dhëna të sakta, pra, rreth kohës së ndërtimit të kësaj kalaje mungojnë. Ky problem ka ngjallur interes edhe në të kaluarën, por nuk ka gjetur rrugë zgjidhjeje[7]).

Invadimet e shumta, që kanë pasuar njëri-tjetrin, e patën kthyer Krujën në një arenë ngjarjesh e betejash, të cilat kanë lënë gjurmët e tyre shkatërrimtare. Këto e kanë vështirësuar seriozisht problemin që orvatemi të marrim në studim; prandaj, në trajtimin e tij, krahas të dhënave të mundshme që na ofrohen nga vëzhgimi në vend i monumentit, do të na shërbejë edhe shqyrtimi kritik e analizimi i burimeve historike.

Emri i Krujës nuk është i njohur prej gjeografëve dhe historianëve të lashtë. Ka shumë të ngjarë (dhe ky

5) M. Sufflay, **Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters,** Wien-Leipzig 1924, fq. 19.

6) Sipas H. Hecquard **(Histoire et description de la Haute-Albanie Guegaria,** Paris 1858, fq. 248.) «disa autorë mendojnë se Kruja është e ndërtuar në rrënojat e Antigonisë. Fareati e kundërshton dhe mendon të jetë ndërtuar në vendin e Eriboeas; kurse Fr. Tajani **(Le istorie albanesi,** Salerno 1886, Ep. II, fq. 47.) thotë se «ajo ka qenë dikur kalaja e Parthinëve, ajo u shkatërrua nga Cezari, u restaurua nga familja Topia më 1338, u zaptua nga Balshajt, pastaj e humbur në luftë iu shit Kastriotëve.» Nga Degrandi **(Souvenirs de la Haute-Albanie,** Paris 1901, fq. 215, 227.) na kumtohet: «thuhet që Kruja është e themeluar nga Karl Topia... në vendin ku ka qenë Eriboea e vjetër».

7) Lidhur me këtë çështje Ipeni pohon se «historia e kalasë së Krujës është e errët dhe më duket se nuk do të sqarohet kurrë ashtu si duhet». (Ippen Th., **Denkmäler verschiedener altersstufen in Albanien.** Wissen, Mitteil, Bd X, Wien 1927 fq. 59).

DO NOT COPY

është mendimi i përgjithshëm që zotëron deri sot) [8]) të ketë prejardhje nga fjala shqipe «krue» = burim; kjo për arësye se Kruja është vend i pasur me kroje e burime natyrore rreth e përqark, sidomos nën këmbët e kalasë, të cilët kanë lojtur një rol me rëndësi për të.

Në dokumentat historike Kruja përmendet për herë të parë me emrin e saj shqip në aktet kishëtare të shek. IX si një qendër peshkopate [9]). Sipas një tradite të shek. XV, të ruajtur në një letër të Gjon Kastriotit, të dhënat e shpien themelimin e peshkopatës së Krujës qysh nga fillimi i shek. VII [10]), ndërsa në kronologjinë shqiptare që boton Kersopulos jepet me rezervë viti 449 [11]).

Në periudhën bizantine, kalon një kohë e gjatë pa të dhëna dokumentare mbi krahinën e Krujës, ndërsa në shekujt e mëvonshëm ato shtohen.

Në këtë periudhë në Krujë qëndrojnë garnizone dhe guvernatorë bizantinë, nën sundimin e të cilëve ajo ndodhej gjer në fund të shek. XII. Këtu duket se e kishte selinë edhe peshkopi i Arbërisë në shek. XII. Sipas Shuflajt ndoshta në fillim të mesjetës dhe gjer në mesin e shek. XII, qyteti mbante dy emra, duke u quajtur, sidomos nga ana e romakëve, edhe me emrin Arbanum [12]).

Si kala Kruja përmendet për herë të parë në shek. XIII. Gjergj Akropoliti, qeveritari bizantin, që i njihte këto vende për së afërmi, në një kronikë të tij përmend kalanë me emrin Kroas, si posedim të Gulamit, zotëruesit të Albanonit më 1254. Kruja në kohën e mesjetës duhet të ketë qenë një kala e rëndësishme dhe qendra e krahinës Arbanum, bërthama e Arbërit, shtetit të parë feodal shqiptar, që formohet rreth vitit 1190 me në krye sundimtarin vendas, arbëreshin Progon [13]). Në vitin 1253 sunduesi i Epirit, Mihaili II i lëshoi me traktat perandorit bizantin Joan Vataces, ndër të tjera, edhe kalanë e Krojës, që gjendej në Arbëri [14]). Në vitin 1255 perandori bizantin Theodor Laskari i II u njeh banorëve të kalasë së Krujës privilegjin që pasuritë e tyre që kanë ose do të kenë si brënda ashtu dhe jashtë kalasë t'i gëzojnë lirisht [15]), privilegj që u rinjihet më vonë edhe nga Androniku i II [16]). Në shekujt e mëvonshëm Krujën e shohim si kryeqendër të dinastive të fuqishme shqiptare.

Burimet historike të kohës së mesme ripohojnë se Kruja është vazhdimi i një qyteti të hershëm dhe se gjatë gjithë shekujve të kohës së mesme ajo ka qenë lidhur me Durrësin dhe e varur administrativisht prej tij [17]). Kruja duhet të ketë bërë pjesë në sistemin e kalave që sinjalizonin dhe mbronin, në raste rreziku, Durrësin. Është kjo arësyeja që nga fundi i shek. XV senati i Venedikut vendosi të marrë nën sundimin e vet, bashkë me kështjellën e Lezhës, edhe atë të Krujës, që kishte rëndësi shumë të madhe, si pararojë, për Durrësin.

Hani, Prashniker etj. [18]) kanë shfaqur mendimin se qendra e fisit ilir të albanëve duhet kërkuar ndën këmbët e Krujës, mbi shpatullën e një kodrine, në fshatin e sotshëm Zgërdhesh. Në këtë vend ndodhen rrënojat e një qyteti ilir dhe janë zbuluar materiale arkeologjike me vlerë. Ky mendim gjen mbështetje edhe në disa toponime të lashta. Për arësye të ndryshme, që ende janë të paqarta, aty nga shek. IV ky qytet u braktis dhe popullsia e tij duhet të jetë vendosur në një vend më të mbrojtur aty afër; ka shumë mundësi që të jetë shpërngulur në truallin më të afërt e më të mbrojtur të Krujës. Kjo përkon edhe me gojëdhanën që thuhet se «u ngritën gurët e Zgërdheshit dhe zunë vend në Krujë». Ka mundësi që Kruja ta ketë zanafillën e saj në rrethana të tilla.

Siç shihet, pra, burimet kryesore historike rreth themelimit të Krujës dhe kalasë së saj, na çojnë deri në

8) M. Sufflay, **Vep. e cit.,** fq. 18; Fallmarayer, **Vep. e cit.** fq. 21; Jastrebov I.S., **Stara Sërbija i Albanija.** Beograd 1924, fq. 234; Baldaci, Kruja në «Bota Shqiptare» fq. 443. Mbas gojdhanave duket se në Krujë ishin 7 «kroje». Mbretërit e Turqisë e quanin Skënderbeun «cubi i 7 krojeve» (shih: **Tregime e këngë popullore për Skënderbeun,** fq. 104).
9) Në aktet e sinodhit kishëtar, që u mbajt në kishën e Sh. Sofisë në Konstantinopël në nëndor 879, nënshkroi si pjesëmarrës edhe peshkopi David i Krojës (A.Alb. I, 57).
10) A.Alb. I, 48; shih edhe G. Valentini, **Contributi alla cronologia albanese,** Roma 1957, fq. 105.
11) J.G. Chersopoulos, **Chronologie albanaise,** në Rev., Les Balkans, vol. IX, nr. 6-7, 1937.
12) M. Sufflay, Vep. e cit., fq. 19.
13) Që qendra e këtij Arbanumi mesjetar ka qenë Kruja, na vërtetohet nga Ana Komnena. Gjergj Akropoliti. Krahaso për këtë: Thalloczy L., Jirecek K., **Zwei Urkunden aus Nordalbanien,** në Illyrisch Alban. Forschungen, Bd. I, Nr. 4, fq. 125.
14) Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë 1962, fq. 89.
15) A.Alb. I, 238.
16) Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, fq. 164-165.
17) M. Sufflay, **Vep. e cit.,** fq. 7, 23-24, 41-44 (shih edhe literaturën e cituar prej tij).
18) J.G. Hahn, **Albanesische Studien,** vol. I, Wien 1853, fq. 120. M. Sufflay, **Vep. e cit.,** fq. 7; L. Taloci, K. Jirecek, në «Bota Shqiptare», fq. 120.

NOT COPY

fillimet e mesjetës. Me këto burime përkon edhe kultura materiale e pasur, e zbuluar nga gërmimet ose rastësisht para dhe pas çlirimit afër kalasë, nga ana veriore e saj. Këto na dokumentojnë se Kruja ka qenë një vendbanim të paktën që nga shekujt VII dhe VIII të erës sonë [19]), se kemi të bëjmë me një populsi jo të ardhur por vendase dhe se bartësit e kësaj kulture të mesjetës së hershme në Krujë, janë pasardhësit e ilirëve, shqiptarët. Madje, Kruja, duke gjykuar nga lënda arkeologjike e gjetur, del deri tani si një nga qendrat më të rëndësishme të kulturës mesjetare të hershme.

Duhet pranuar se kalaja, si bërthama e qytetit, do të ketë egzistuar në këto kohë; megjithatë ne, tani për tani, nuk jemi në gjendje t'i veshim një lashtësi të tillë kësaj kalaje, me shpresë që ndoshta në të ardhmen do të rikthehemi në këtë çështje. Kjo për shkakun objektiv se, pavarësisht që burimet historike përputhen deridiku me të dhënat arkeologjike të kësaj qendre, vetë monumenti që kemi në shqyrtim, sot për sot, nuk na ofron të dhëna konkrete dhe bindëse për një pohim të tillë. Dëmtimet dhe rindërtimet e shumta që kanë pësuar muret e kalasë, vështirësojnë gjetjen e gjurmëve më të vjetra të ndërtimit të saj. Nuk përjashtohet mundësia që kalaja të ketë qenë ndërtuar në shek. VI në kohën e sundimit të Justinianit I [20]). Duhet theksuar se, në gjendjen e sotme, kur në këtë monument nuk janë zhvilluar gërmime arkeologjike, përveç ndonjë sondazhi të vogël, data e hedhjes së themeleve të para të kësaj kalaje nuk mund të përcaktohet me saktësi. Fjalën e fundit, padyshim, do ta thonë gërmimet arkeologjike që do të kryhen në të ardhmen në vetë monumentin.

Në favor të lashtësisë së kalasë hedh dritë edhe «kroi i pazarit» në të hyrë të kalasë, nga e majta, rreth 25 m. larg nga porta kryesore e saj. Thuhet se kroi dikur përfshihej brenda mureve të kalasë dhe pranë tij ishte vendosur porta e parë e kalasë, por sot për sot këtë nuk e vërtetojmë dot. Në të paraqesin interes disa fragmente arkitektonike, të vendosura në murin e kroit. Përveç dy mbishkrimeve turqisht, që kanë lidhje me çezmën, gjenden edhe tre gurë, mbi të cilët janë punuar shumë trashë disa figura, një si yll me tetë thepa dhe dy luanë. Nga mënyra e punimit të këtyre relieveve dhe nga karakteri i figurave e shenjave të papërdorura nga turqit, mund të gjykojmë se këta janë relike të një kohe përpara pushtimit turk [21]).

II. RRETH RINDËRTIMEVE KRYESORE TË KALASË

Nga literatura historike del se meremetimi i kësaj kalaje dokumentohet vetëm pas vitit 1271, në kohën e sundimit anzhuin të Karlit I [22]), burim ky që na tregon gjithashtu se kalaja i përket një kohe më të lashtë.

Një burim me vlerë, edhe në këtë drejtim, përbën vepra e Barletit. Humanisti ynë, duke pohuar se kalaja e Krujës ishte «më e bukura dhe më e madhja nga të gjitha», shfaq mendimin se është ndërtuar nga Karl Topia [23]), por me këtë, siç vërejnë me të drejtë Jastrebov, [24]) etj. ai do të ketë pasur parasysh punime të mëdha përforcimi të kalasë. Duke u nisur nga kjo, Hani shfaq mendimin se «mbase kalaja e Krujës është ndërtuar prej njërit të shtëpisë së Topiasve» [25]); për një gjë të tillë bëjnë fjalë edhe autorë të tjerë [26]). Sidoqoftë Karl Topia, që nga gjysma e dytë e shek. XIV ishte një sundues i fuqishëm dhe që e bëri Krujën dhe kalanë e saj kryeqendër dhe seli të dinastisë së tij, ka kryer patjetër mjaft meremetime e punime përforcimi në kala dhe në qytet. Mendojmë se këtu duhet të jetë fjala për punime në shkallë të gjerë, për një ri-

19) S. Anamali, H. Spahiu, **Vorreza e hershme mesjetare e Krujës,** në Buletinin e U.SH.T. «Seria e shkenc. shoqr.» Nr. 2, 1963, fq. 3-85 (shih edhe burime të tjera të cituara prej tyre).

20) Nga dëshmia historike që na jepet prej Prokopit të Qezaresë del se në provincat e gadishullit Ballkanik gjatë shek. VI janë ndërtuar dhe rindërtuar mbi 100 kështjella, nga të cilat 58 të tilla në Epirin e Ri, ku përfshihej edhe Shqipëria e Mesme. Ka të ngjarë që pikërisht një nga këto kështjella, të cilat do të qëndronin në mbrojtje të Durrësit, të ishte edhe ajo e Krujës, po të kemi parasysh dhe distancën e Krujës nga Durrësi.

21) Këto fragmente janë vënë re e përshkruar nga Ipeni në: Glasnik, 1902, fq. 7; Jastrebov, **Vep. e cit.,** fq. 234; C. Praschniker, A. Schober **(Arkeologische Forschungen in Albanien u. Montenegro,** Wien 1919, fq. 27-28.

22) M.G. Monti, **Domini e tentativi normanni in Albania,** Bologna 1942, fq. 152; G. Hopf, **Geschichte Griechenlands von Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit,** (1821), Leipzig 1870.

23) M. Barleti — **Historia e jetës dhe e veprave të Gjergj Kastriotit** — Skënderbeut, lib. 7, fq. 292-293.

24) J.S. Jastrebov — Vep. e cit., fq. 234.

25) J.G. Hahn, **Vep. e cit.,** fq. 88.

26) Fr. Tajani, **Le istorie albanesi,** Salerno 1886, Ep. II, fq. 47; A. Degrand, **Souvenirs de la Haute Albanie,** Paris 1901, fq. 215, 227; A. Baldaci, Kruja, në «Bota Shqiptare», fq. 451; A. Gegaj, **L'Albanie et l'invasion turque au XV** e S.. 1937, fq. 8.

TOMORRY

ndërtim rrënjësor që duhet t'i jetë bërë kalasë prej këtij feudali shqiptar.

Siç përmendëm më sipër, nga vrojtimet direkte rreth mureve të kalasë vërehen gjurmë të cilat, nga teknika, materialet e ndërtimit, si dhe nga përmasat, ndryshojnë me tërësinë e mureve të kalasë dhe që, për mendimin tonë, i atribuohen një ndërtimi para pushtimit turk. Këto janë prova të forta që vërtetojnë se muret e sotme të kalasë, që janë të kohës së pushtimit otoman, janë ndërtuar mbi themele muresh më të vjetra. Me që është fjala për gjurmë fragmentare, është vështirë të pohohet nëse këto relike i referohen pikërisht periudhës ndërtimtare të Topiasve apo një kohe më të hershme.

Që prej kohës së Topiasve e deri më 1443, kur Skënderbeu ua mori këtë kala turqve, nuk ka të dhëna që të hedhin dritë për ndonjë rindërtim me rëndësi të saj. Janë shfaqur mendime se kalasë i janë bërë punime meremetimi ose rindërtimi prej Kastriotëve, kur ata morën nën zotrim Krujën. Qyteti, në kohën kur Gjon Kastrioti u detyrua të bëjë paqe me Sulltan Muratin dhe t'u dorëzojë Krujën si qendrën e zotërimeve të tija, ishte i fortifikuar në kulm, sepse, dihet që në këtë shekull luftrash, mbrojtjes së vendit ju kushtua një vëmendje e madhe.

Nga burimet historike na kumtohet se gjatë pranverës së vitit 1444 Skënderbeu mori masa edhe për meremetimin dhe forcimin e kalave. Me këtë rast, duhet t'i jetë bërë ndonjë farë meremetimi edhe kalasë së Krujës, sepse me kthimin nga Kuvendi i Lezhës kujdesi i parë i tij qe të fortifikojë Krujën dhe kalatë e tjera në dorë të tij [27]); megjithatë, deri në rrethimin e parë të Krujës (v. 1450), nuk mund të flitet për ndonjë rindërtim të rëndësishëm. Por që Kruja në këtë kohë ka qënë një nga kalatë më të rëndësishme këtë e vërtetojnë Kritobuli, i cili e konsideron kalanë shumë të fortë dhe mburojë të mbarë vendit, [28]) dhe Barleti.

Dihet se më vonë kalaja, pas çdo luftimi, meremetohej nga Skënderbeu, duke përdorur për këtë qëllim edhe teknikë të huaj [29]). Për shkak të dëmtimeve të rënda që, gjatë rrethimit të parë, iu shkaktuan kalasë nga mjete të fuqishme sulmi, dhe duke parashikuar rrethimet e ardhshme nga turqit, Skënderbeu mori masa për rindërtimin e kalasë, gjë që na kumtohet shprehimisht nga Barleti: «Kastrioti kishte filluar me kujdesin më të madh rindërtimin e Krujës dhe meremetimin e mureve dhe gjithë ditët i harxhonte me atë punë. Ky gjithë forcomat e vjetra, të cilat ishin pjesërisht të prishura, pjesërisht të tronditura, i ripërtriu dhe i shtoi e i bëri më të bukura dhe më të forta nga ç'kishin qenë ndërtuar... Pranë portës së qytetit ngritën një pirg shumë të madh dhe të fuqishëm; megjithkëtë nuk e nxuarrën mbi faqen e murevet përpara, por e lanë si më të ulët, me qëllim që të mos i shtrohej dëmit e t'u shmangej goditjevet të makinavet» [30]). Nga kjo dëshmi e Barletit mund të nxjerrim si përfundim se ndërtimi fillestar i kullës së rrumbullakët, përbri portës kryesore të kalasë, së bashku me kompleksin që përshkruam hollësisht më sipër; (TAB. IV, I) që përfshin galeritë e vendrojeve, rezervuarin e ujit dhe ambientin tjetër ngjitur me to, i përket kësaj periudhe, gjë që vërtetohet nga teknika e njëjtë. I tërë ky ansambël është ndërtuar me gurë gjysmë të punuar të vendosur me një rregullsi që dallohet nga tërësia e mureve të periudhës turke, të cilët janë ndërtuar me materiale të ripërdorura dhe të vendosura në mënyrë të shpregullt.

Këto ndërtime të Skënderbeut janë të lidhura me faktin që, gjatë rrethimit të parë, turqit, me topat e rëndë të tyre, arritën gjatë katër ditëve bombardimi të paprerë kundrejt portës së kalasë dhe përballë mureve rrethuese lindore të qytetit, të shkatërronin muret e portës kryesore dhe një pjesë të mureve rrethuese, kështu që ndjehej nevojë e domosdoshme për një përforcim serioz të kësaj pike me rëndësi të veçantë për kalanë. [31])

27) Gjatë pranverës së vitit 1444 Skënderbeu mori masa edhe për meremetimin dhe forcimin e kalave në të cilat vuri roje të forta, vëzhgoi shtigjet, grykat e luginat e vendit dhe vendosi informatorë për të lajmëruar sa më parë afrimin e armikut (shih: A. Gegaj, **Vep. e cit.,** f. 60, **Gjergj Kastrioti — Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shek. XV,** Tiranë 1967, fq. 8).

28) Ilirët (shqiptarët — S.A.) kishin një kështjellë shumë të fortë që quhej Krujë dhe që ishte si të thuash rojë dhe mbrojtje e gjithë vendit të tyre... Sulltani, kur erdhi afër kësaj kështjelle dhe pa se kjo ishte shumë e fortë dhe se s'ishte e mundur ta shtinte në dorë, e gjeti të udhës të mos niste veprimin kundër saj dhe të mos i përvishej një pune që s'bëhej dot.» (Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, fq. 345.)

29) Fallmerayeri thotë se «Mbreti Alfons i Napolit dërgoi muratorë e mjeshtra të ndryshëm për meremetimin e kalasë së Krujës, të dëmtuar gjatë luftës nga bombardimet e sulltanit». (Fallmerayer I.Ph., **vep. e cit.** fq. 50); shih edhe A. Gegaj, **vep. e cit.** fq. 85-92):

30) M. Barleti, **Vep. e cit.,** fq. 292, 293.

31) Siç dëshmon Barleti, qyteti u dëmtua, fortifikimet u shkatërruan keq dhe gjysma e ledheve u rrafshua përdhe. Pjesa tjetër ishte dobësuar aqë fort sa që mund të shembej me një lëkundje sado të vogël. (M. Barleti, **Vep. e cit.,** f. 205 e vij.). Shih edhe: F. Tajani, **Vep e cit.** fq. 70-72; J. Pisko — Skanderbeg, Wien 1894, fq. 55; A. Gegaj **Vep.** e cit. fq. 77).

DOWNLOAD

Punimet e mësipërme të kalasë duhet të jenë bërë në vitin 1451, për arësye se në këtë kohë Sulltan Mehmeti II, duke qenë i zënë me ekspeditat që kreu në Azinë e Vogël nuk e trazoi Shqipërinë. Por ka mundësi që punime meremetimi të jenë bërë edhe në vitin 1452, para se të ndërmerreshin dy ekspeditat turke të atij viti kundër Krujës, sepse nga burime të shkruara del se në prill të vitit 1452 mbreti i Napolit, Alfonsi, dërgoi ndihma për të fortifikuar pikat e rëndësishme që mund të të shërbenin për t'iu bërë ballë turqve [32]).

Si rezultat i masave që u morën nga ana e Skënderbeut për meremetimin e kalasë, u bë e mundur të përballoheshin rrethimet e mëvonshme të viteve 1466--1467, që u udhëhoqën nga vetë Sulltan Mehmeti II.

Pas vdekjes së Skënderbeut, turqit për të shuar krejtësisht qëndresën shqiptare, rrënuan një numur të madh kalash, ndërmjet tyre edhe atë të Krujës, ndaj të cilës urrejtja ishte aq e madhe sa e shembën menjëherë pas pushtimit më 16 qershor 1478 [33]). Megjithatë turqve iu desh që të rindërtojnë shumë vepra ushtarake me karakter mbrojtës që kishin pësuar dëme të rënda gjatë luftës 35 vjeçare. Midis tyre përmendet edhe rindërtimi i asaj të Krujës. Siç mund të përfundohet nga përshkrimet e vjetra fortifikimet e kalasë aty nga shekujt XVI-XVII kundroheshin si të pazaptueshme [34]). Kjo u bë një qendër me rëndësi armatimesh për perëndimin, një pikëmbështetje e fuqishme e otomanëve në bregdetin e Adriatikut [35]).

Dëmtime të mëdha kalaja e Krujës pati nga një tërmet i fortë që ndodhi më 1617, i cili shkaktoi shkarjen e tokës dhe një vrimë të madhe në muret; si rrjedhim u dëmtua seriozisht një pjesë e mureve të rrethimit të kalasë, që u shkëputën bashkë me shkëmbinjtë e mëdhenj që ndodhen nga ana lindore dhe juglindore e saj dhe që të bindin se kanë qenë pjesë përbërëse e tërë kreshtës shkëmbore të kalasë. Pra kalaja në krahasim me gjendjen e tanishme, në të kaluarën duhet të ketë qenë më e madhe nga ana lindore.

Një rrafshim tjetër të madh kalaja pësoi nga pushtonjësit otomanë më 1832, pas kryengritjes së madhe të shqiptarëve. Për t'i bërë të padobishme dhe që të mos bëheshin mbështetje e kryengritësve, turqit rrëzuan gjithashtu muret e mbetura ende më këmbë të kalasë. [36])

Punimet e dorës së fundit, që spikatin në një pjesë të mirë të mureve rrethuese qoftë si rindërtime apo përforcime, duket se i përkasin fundit të shekullit të kaluar, kur sipas burimeve, [37]) klikat sundonjëse bënë përpjekjet e fundit për të mbajtur ende më këmbë aftësinë mbrojtëse, të kufizuar, të kësaj kalaje, me qëllim që t'u bënin ballë kryengritjeve të ardhshme çlirimtare, që po dukeshin në horizont.

PHOTOCOPY

32) C.Marinesco, **Alphonse V roi d'Aragon et de Naples et l'Albanie de Scanderbeg,** Paris 1923, fq. 38-59.
33) Sipas Historisë së Shqipërisë, I, fq. 248, Kruja u quajt nga turqit Akça-Hisar (kulla e bardhë) qysh nga viti 1415 kur e zaptuan për së dyti herë, duke ia marrë Nikollë Topisë; kurse Jireçeku thotë se Kruja e mori këtë emër më 1478 që u detyrua të dorëzohet. (Jirecek, **«Albanien in der Vergangenheit»,** në Illyrisch-Albanische Forschungen, Bot. I, Nr. 2, fq. 82). Të këtij mendimi janë dhe Taloci, Fallmerayeri, Hopi etj.
34) Në këta shekuj Kruja, si kala, konsiderohej «piazza fortissima et inespugnabile» (Thalloczy L., Jirecek K., **Zwei Urkunden,** nr. 4, fq. 125); Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. III, fq. 112-113.
35) M. Sufflay, **Vep. e cit.,** fq. 19; Hopf, **vep e cit.**
36) M. Sufflay — Vep. e vit., fq. 42; L. Jirecek, Vep. e cit. fq. 72.
37) Ekspedita folklorike e Krujës, në Buletinin e Shkencave Shoqërore, nr. III, 1956, fq. 235-239.



1. – Dy kullat në hyrje të kalasë.



2. – Ambienti në të djathtë të hyrjes (kulla, burgu, shkallët etj.).

DO NOT COPY

TAB. II









1. — Pamje e vëndrojeve nga brënda.
2. — Sistemi mbrojtës në skajin jugëperëndimor.
3. — Kulla e sahatit.
4. — Kulla e skajit jugëlindor me një trakt muri.

DO NOT COPY

KALAJA E KRUJES



DO NOT COPY

DO NOT COPY

KOMPLEKSI NE HYRJE TE KALASE
KRUJES



1. GJURMËT E PORTËS SË PARË TË HYRJES
2. NIKE E KRAHUT TË MAJTË
3. MBETURINAT E NIKES SË KRAHUT TË DJATHTË
4. PORTA E SOTME E HYRJES
5. KULLA POLIGONALE
6-7-8-9. GALERITË E TRUPROJES
10. BURGU (OSE DEPUA E BAROTIT)
11. KULLA E RRUMBULLAKËT
12. STERA



2. — Nike e krahut të majtë para portës së hyrjes.

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

LA FONDATION DE LA CITADELLE DE KRUJE ET SES PRINCIPALES RECONSTRUCTIONS

RESUME

Evoquant le rôle historique de Kruje, le camarade Enver Hoxha a indiqué: «Qui dit Skanderbeg, dit Kruje. Notre peuple, sous la conduite de Skanderbeg, a donné à l'Albanie et à Kruje un brillant renom dans l'histoire de l'humanité.» Poussé par l'intérêt scientifique que présentent la datation de la citadelle de Kruje ainsi que les plus importantes reconstructions dont elle a été l'objet au long des siècles, l'auteur a tenté dans cette étude d'élucider précisément ces deux questions.

La petite ville pittoresque de Kruje étage ses maisons sur le versant du mont Sarisalltik, à quelque 600 mètres d'altitude.

A sa partie la plus élevée, l'éminence rocheuse sur laquelle se dresse la citadelle, se détache nettement de la ville, au sud-ouest de celle-ci, Bien défendue de toutes parts et entourée surtout de rochers escarpés, cette colline rocheuse constitue en soi une forteresse naturelle.

La citadelle a un périmètre polygonal qui épouse la configuration topographique de l'éminence rocheuse. La longueur des murs d'enceinte atteint environ 800 mètres. Ils sont interrompus par endroits, à l'exception de la face nord sur laquelle les remparts sont continus.

Outre l'ensemble des murs actuels de la citadelle, construits simplement en pierres et mortier et qui appartiennent à la période de l'occupation turque, l'observation directe des murailles d'enceinte de cette citadelle permet de distinguer par places des vestiges fragmentaires de murs qui peuvent être attribués à une période antérieure à l'occupation turque.

Les remparts sont garnis de neuf tours à base circulaire, carrée ou polygonale, dont l'auteur donne une description détaillée. Au cours des travaux de restauration effectués en 1967, on a rencontré dans une des tours circulaires de la face nord un pan de mur qui devait appartenir à une tour plus ancienne.

Outre l'entrée principale située sur la face nord-ouest, et qui fait l'objet d'une étude à part, la citadelle possède aussi une autre entrée, à l'angle sud-ouest, qui communique avec l'intérieur de la citadelle par une galerie souterraine. La face extérieure de la voûte et la corniche arquée, d'une brique d'épaisseur, qui la borde, témoignent d'une technique antérieure à la période de l'occupation turque.

Les vestiges qui subsistent encore aujourd'hui révèlent qu'à des périodes successives, trois portes furent ménagées à l'entrée principale, afin d'assurer le meilleur contrôle possible de l'accès à la citadelle. L'auteur décrit et analyse en détail ces vestiges de même que ceux des niches de l'entrée, des galeries ou des postes de guet, et, de façon générale, tout le secteur de l'entrée.

DO NOT COPY

A la droite de la troisième porte (qui devait se situer à l'extrémité du couloir donnant accès à la cour de la citadelle) on distingue une construction qui, apparemment, a dû servir de poudrière ou, à en croire la tradition orale, de prison. A en juger par la technique de la construction, les vestiges de ce bâtiment permettent de supposer qu'il s'agit d'une construction contemporaine des galeries de la seconde porte, et qu'elle devait faire partie du même ensemble que celles-ci. Dans cet ensemble s'intégraient vraisemblablement aussi les constructions qui paraissent avoir eu pour fonction de défendre l'entrée principale de la citadelle, ainsi que les bâtiments d'habitation.

Après en avoir décrit les principales parties constitutives, l'auteur passe brièvement en revue les plus importantes sources historiques dont on dispose à son sujet.

On a beaucoup écrit sur Kruje. Maints auteurs nous en ont laissé une foule de descriptions, notamment l'Albanais Barletius et le Vénitien Giustiniano au XVIe siècle, Bolica de Kotor au XVIIe s., et, pour le siècle passé jusqu'à nos jours, des historiens et albanologues tels que Müller, Hahn, Ippen, Patsch, Jireček, Šufflay, etc. Mais les sources historiques recueillies jusqu'à ce jour, ont plutôt un caractère descriptif et nous viennent souvent de simples visiteurs. De ce fait, elles sont parfois de pures répétitions ou des emprunts. Ces témoignages sont soit muets sur la fondation de la citadelle, soit superficiels et contradictoires. Nous manquons donc de données précises sur l'époque de la construction de cet ouvrage. Dans le passé également, ce problème a éveillé l'intérêt des chercheurs, sans cependant avoir trouvé de solution.

Les nombreuses invasions que connut notre pays firent de Kruje une arène de batailles qui y ont laissé leurs marques dévastatrices. Ces dévastations ont rendu le problème traité extrêmement ardu; aussi, pour l'aborder et essayer de dégager une conclusion, l'auteur s'appuie d'une part sur les quelques données possibles qu'offre l'observation de ce monument sur les lieux, et utilise d'autre part de manière critique une série de facteurs et de sources historiques.

Kruje apparaît pour la première fois sous son nom albanais dans les actes ecclésiastiques du IXe siècle où elle est citée comme évêché. Selon une tradition orale qui nous vient du XVe siècle, la fondation de l'évêché de Kruje remonterait au début du VIIe siècle, alors que la chronologie albanaise publiée par Chersopoulos en fixe, avec réserve cependant, la date à l'an 449.

Kruje abrita des garnisons byzantines et elle fut le siège de gouverneurs qui y exercèrent leur pouvoir jusqu'à la fin du XIIe siècle. A cette époque ce devait être également le siège de l'évêque d'Arberie.

En tant que forteresse, Kruje est citée pour le première fois au XIIIe siècle. Dans les siècles qui suivent nous trouvons Kruje chef-lieu des possessions de puissantes dynasties princières albanaises.

Ainsi les principales sources historiques concernant la date de la fondation de Kruje et de l'érection de sa citadelle nous conduisent aux commencements du moyen âge. Le témoignage de ces sources apparaît confirmé par les vestiges d'une culture matérielle prospère et variée, découverts dans le centre de la ville de Kruje avant comme après la Libération. Ces vestiges viennent prouver que Kruje était une agglomération dès les VIIe et VIIIe siècles au plus tard, qu'il s'agit d'une population autochtone et non pas immigrée, issue des Illyriens, autrement dit des Albanais. Toutefois, nous ne sommes pas en mesure pour le moment de lui attribuer une telle ancienneté, pour la raison objective que le monument même ne nous offre pas aujourd'hui de données concrètes dans ce sens. Il n'est pas à exclure que la citadelle ait été construite en même temps que les ouvrages fortifiés édifiés au VIe siècle par l'empereur byzantin Justinien Ier, qui était d'origine illyrienne, Quoi qu'il en soit, dans la situation actuelle, alors que, à part quelque petit sondage qui n'a rien apporté d'important, des fouilles archéologiques n'ont pas été effectuées sur cet ouvrage, la date des premières fondations de cette citadelle ne peut être déterminée avec exactitude.

En ce qui concerne les travaux postérieurs de reconstruction, les sources à notre connaissance sont muettes pour la période allant de la pose des premiers fondements de la

DO NOT COPY

citadelle jusqu'au XIIe siècle. La reconstruction de cette citadelle n'est historiquement certifiée qu'après 1271, à l'époque du règne de Charles Ier.

Dans ce domaine également, l'ouvrage capital de Barletius constitue une source précieuse. La décrivant comme «la plus belle et la plus imposante de toutes» (les citadelles), il indique qu'elle a été construite par Charles Thopia, ayant certainement en vue par là les importants travaux de renforcement menés par celui-ci, car l'existence en est déjà mentionnée dans des sources historiques antérieures. D'autres sources écrites attestent également que Charles Thopia en fut le reconstructeur. En tout état de cause, ce prince puissant qui, vers la seconde moitié du XIVe siècle, fit de Kruje le chef-lieu de ses possessions et le siège de sa maison, a conduit sur cette place-forte des travaux à grande échelle, ou en a peut-être même entrepris une reconstruction radicale.

Comme on l'a dit plus haut, l'observation directe a permis de relever sur ce monument des indices préturcs, confirmant que les murs actuels de la citadelle datant de l'époque ottomane ont été élevés sur des fondations plus anciennes, mais comme il s'agit de vestiges fragmentaires, il est difficile de préciser si ce sont là des constructions de l'époque des Thopia ou d'une époque antérieure.

Sur la période allant de la domination des Thopia à 1443, date à laquelle Skanderbeg enleva cette citadelle aux Turcs, on ne trouve aucune donnée qui vienne éclairer tant soit peu quelqu'un des importants travaux de reconstruction. Au printemps 1444, Skanderbeg prit des mesures pour remettre en état et renforcer des citadelles, et, en cette occasion, des travaux ont dû également être faits sur la citadelle de Kruje. Néanmoins, jusqu'au premier siège de Kruje, on ne peut parler de reconstruction importante. A la suite des graves dommages causés à la citadelle par les puissants moyens d'attaque des Turcs, Skanderbeg la fit reconstruire, ce qui nous est également dit par Barletius. S'appuyant, entre autres, sur ce témoignage historique, l'auteur conclut que la construction initiale de la tour ronde qui flanque la porte principale de la citadelle, de même que l'ensemble des constructions décrites plus haut, et qui comprend les galeries des postes de guet, la citerne et l'autre bâtiment qui leur est attenant, appartiennent à cette période, ce qui est étayé par le fait que toutes ces constructions sont techniquement de la même période. Ces travaux ont dû être effectués dans les années 1451-1452.

Après la mort de Skanderbeg, les Ottomans détruisirent la citadelle de Kruje aussitôt après s'en être emparés le 16 juin 1478. Néanmoins, l'ouvrage conserva sa fonction de défense même dans les siècles qui suivirent et les fortifications de la citadelle de Kruje étaient considérées imprenables aux XVIe et XVIIe siècles.

Cette citadelle a subi de grands dommages du fait d'un violent tremblement de terre qui se produisit en 1617; une partie des murs d'enceinte s'effondrèrent en même temps que les rochers sur lesquelles ils s'élevaient. On peut donc en déduire que, surtout à l'est, la citadelle devait être anciennement beaucoup plus imposante.

La citadelle subit une nouvelle et importante dégradation de la main même destructrice des envahisseurs ottomans en 1832, à la suite de la révolte des Albanais.

Les plus récents travaux que l'on relève sur une bonne partie des murs d'enceinte paraissent remonter à la fin du siècle passé, lorsque les cliques au pouvoir faisaient d'ultimes efforts pour préserver la capacité défensive de la citadelle et pouvoir s'y appuyer contre les futures insurrections libératrices qui se profilaient à l'horizon.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

ARKITEKTURA DHE DATIMI I KISHËS SË MANASTIRIT TË APOLLONISË

Manastiri i Shën Mërisë së Apollonisë ndodhet në një kodër mbi fshatin Pojan. Për interesin që paraqet, ky monument është përmendur nga vizitorë të huaj krahas rrënojave të Apollonisë edhe pse, gati gjithënjë, ata interesoheshin vetëm për antikitetin [1]).

Brenda rrethimit ndodhen konakët, që, në gjendjen e sotme, janë thuajse krejt të rindërtuara gjatë këtij shekulli, trapezaria tre apsidëshe dhe kisha. Në këtë punim do të trajtojmë arkitekturën e kishës së Shën Mërisë dhe do të hedhim disa mendime rreth kohës së ndërtimit të saj. Për këtë problem të fundit në literaturë janë shfaqur mendime të ndryshme, duke u nisur përgjithësisht nga afresku që ndodhet në ekzonartek-

Planimetria



Fig. 1

1) C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** Wien 1920, vol. 39. Heuzey L. – Daumet M. – **Mission archéologique de Macèdoine,** Paris 1876, fq. 893.



Fig. 2

sin e kishës [2]), por asnjëherë nuk e kanë lidhur datimin me arkitekturën, domethënë dhe me rindërtimet e ndryshme që ky monument ka pësuar në kohë.

Kisha e Shën Mërisë është një kishë bizantine, mesatare nga madhësia, e tipit kryq i brendashkruar me kupol. Ndryshe nga kishat e tjera bizantine në Shqipëri, që janë të tipit provincial, ky monument dallohet nga to, se ka një hapësirë ndërmjet apsidës dhe krahut lindor të kryqit, shenjë kjo e një influence të qartë kryeqytetase [3]) Kisha përbëhet nga ekzonarteksi, narteksi, naosi dhe ambienti i alltarit (fig. 1), nëpërmjet të cilit lidhet në anën veriore me një skevofilakion (vendi i ruajtjes së enëve të kultit). Pranë kishës, në anën veriore, ngjitur me skevofilakion, është një paraklis i vogël që, sipas një gojëdhëne, i atribuohet Shën Mitrit [4]). Naosi nga forma është paralelogram dhe jo drejtkëndësh si zakonisht. Këndet shmangen nga i drejti në masë të tillë, saqë deformimi mund të përceptohet lehtë. Ky deformim është në tërë kishën deri dhe tek tamburi e kupola që nuk janë rrethorë (fig. 2). Strukturat mbi naos ngrihen mbi 4 kollona dhe dy pilastra pranë ambientit të alltarit. Kollonat dhe bazamentet janë antike. Mbi të katër kollonat kemi kapitele bizantine, që janë dy nga dy të ngjashëm dhe një copshe bashkë me jastëkun kuadratik mbi to (fig. 3,4). Kapitelet janë të thjeshta me sipërfaqen të zbukuruar me gjethe. Gjethet më të mëdha janë në katër qoshet dhe nga majat e tyre varen fruta. Dy ndër kapitelet, me gjethet më të thjeshta, kanë si zbukurim në pjesën e sipërme koka njerzish. Punimi i kapiteleve është i dobët dhe influencon jo mirë në vlerësimin estetik të tyre. Mundet që ndërhyn në këtë edhe guri gëlqeror me një pamje jo të mirë. Menjëherë mbi kapitelet ngrihen nga dy harqe, që përfundojnë në muret anësore ose mbi pilastrat kuadratike (Tab IV, 2). Mbi këtë sistem harqesh ngrihen katër qemerët, që mbulojnë dhe formojnë krahët e kryqit. Këta qemerë cilindrikë përfundojnë në muret anësore duke pasur nga perëndimi, jugu dhe veriu nga një dritare dyshe. Elementet anësore që formohen ndërmjet krahëve të kryqit janë të mbuluara, si gjithnjë në provincë, me qemerë cilindrikë me formuese lindje-perëndim.

Përpara pilastrave ndodhet një ikonostas druri, që ndan naosin nga ambienti i alltarit. Pjesa qendrore e tij mbulohet me një qemer cilindrik në nivel më të ulët se qemeri i krahut lindor të kryqit. Nga pilastrat në muret anësore, kalojnë harqe në nivel më të ulët se harqet e ambienteve anësore të naosit. Këto ambiente brenda atij të alltarit mbulohen me qemer cilindrik

2) A. Aleksudhi, **Sintomos istoriki perigrafi tis jeras Mitropoleos Velegradon,** en Kerkira 1888 fq. 76-80.
Pace B., **Frustuli ilirici** in «Annuario R. scuola archeologica di Atene» vëll. III, 1920, fq. 287-289.
Puzanova V. **«Manastiri sh. Meria e Apollonisë në Pojan»** Buletin i U.SH.T., seria shkencat shoqërore III 1961, fq. 147-153
Puzanova V. Damo D. — **«Nekotorie pamjatniki monumentalnoj zhivopisi** 13.14 **Vekov v Allbanij»** Studia Albania nr. 2 1965 fq. 154-159.
Th. Popa, **Mbishkrimet e kishave të Shqipnisë si burime historike,** «Buletin i U.SH.T. në shkencat shoqërore» nr. 1 1958 fq. 239-240.
Th. Popa, **Materialet epigrafike kishtare të vendit si burime historike për historinë e kulturës së popullit tonë,** në Konferencën Albanologjike Tiranë 1962, fq. 569.
Th. Papa, **Saktësime rreth datimit të kishës së Manastirit të Apollonisë,** në Studime historike nr. 1, 1967, fq. 137-144.
3) G. Millet, **L'école grecque dans l'architecture byzantine Paris** 1916, fq. 57.
4) Th. Popa, **po aty,** fq. 138.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

me formuese lindje-perëndim. Komunikimi i bemës me protezis dhe diakonikon bëhet nëpërmjet hapësirave ndërmjet pilastrave dhe murit lindor. Ambientet anësore, nga madhësia e tyre, duken si shtesa të pjesës qendrore të ambientit të alltarit, bemës, në të dy anët e së cilës ato ndodhen. Në mes të bemës, aty ku zakonisht ndodhet tryeza e alltarit, kemi katër bazamente kollonash të vogla, të vendosura në cepat e një katërkëndëshi. Kollonat mbi të sot mungojnë, por kuptohet se kemi të bëjmë me çka ka mbetur nga tryeza e alltarit mbuluar me baldakin që dikur do të ketë qenë aty. Në fund të apsidës ndodhet një shkallë e ngritur nga dyshemeja rreth 40 cm. që tregon se kisha ka qenë qendër peshkopate. Një nike e formuar prej guri ndodhet në ambientin anësor nga veriu dhe shërben si protezis.

Mbi katër qemerët e krahëve të kryqit, ngrihet nëpërmjet trekëndëshave sferikë, kupola mbi tambur. Përmendëm më lart se për shkak të planimetrisë në formë parelelograml edhe tamburi me kupolën janë mbi bazë të çrregullt, çrregullsi të cilën ndërtuesit as nuk janë preokupuar ta fshehin. Një kornizë e gurtë përshkon tërë naosin në nivelin e kapiteleve. Korniza formohet prej pllakash të nxjerra rreth 30 cm. dhe pak të profiluara. Një kornizë shumë më e vogël kalon në nivelin e fillimit të tamburit. Korniza të vogla guri ndodhen dhe në thembrat e harqeve mbi pilastrat dhe muret anësore. Dyshemeja e naosit është shtruar me pllaka guri drejtëkëndëshe në rreshta paralel me murin perëndimor, prej nga ka filluar edhe shtrimi. Në këtë mënyrë aksi i dyshemesë formon një kënd me aksin e vet naosit. Në mes të dyshemesë nën kupolë, është vizatuar një rozet, me katër unaza koncentrike. Vizatimi brenda rretheve është me pllaka trekëndëshe të vendosura në mënyrë alternative. Me një shkallë të nxjerrë brenda naosit hypet në ambjentin e alltarit, dyshemeja e të cilit është e deformuar, sidomos nga ana jugore. Nga që ikonastasi i drunjtë nuk është në krye të shkallës, nga fërkimi i këmbëve është zhdukur çdo gjurmë që mund të na fliste për qenjen e ndonjë ikonastasi të gurtë. Dyshemeja e narteksit sot është e shtruar me çimento ku ndodhet dhe një fragment pllake me një mbishkrim greqisht, sigurisht nga të Apollonisë antike.

Në skevofilakion, hyhet nëpërmjet një dere nga ana veriore e ambientit anësor verior. Dyshemeja e tij është në nivel më të lartë se e kishës dhe e shtruar me dërrasa. Pa bërë sondazhe, nuk mund të themi në se dyshemeja e sotme është në nivelin e parë. Skevofilakioni ndriçohet nga një dritare në murin verior që dikur ka qenë dy pjesshe, më e ulët dhe më e ngushtë, nga e cila sot ruhet guri i rrafshtë i mbulesës, në të cilën janë gdhendur konkavitete për të dyja pjesët. Zgjerimi i mëvonshëm i dritares është bërë duke hequr gurët e shpatullës lindore dhe një gur të fundit (fig. 7). Narteksi është katërkëndësh, me brinjën veri-jugë më të gjatë dhe mbulohet me një qemer cilindrik me formuese paralel me murin perëndimor. Ekzonarteksi ndodhet në anën perëndimore të kishës dhe është gjysmë i hapur nga perëndimi nëpërmjet një kollonade të shpeshtë, që ngrihet mbi një mur rreth 80 cm. nga toka; në ekzonarteks futesh me dy dyer të vendosura në anët jugore dhe veriore. Ekzonarteksi lidhet me narteksin me një portë të mbuluar me hark të mpreh-



Fig. 5



Fig. 6

të. Kollonat e arkadës në anën perëndimore të ekzonarteksit janë tetë dhe alternohen dy e nga dy me pilastra të gurta, nga të cilat dy janë të përfshira brenda arkadave ndërsa qendrorja dhe anësoret janë jashtë arkadeve (Tab IV, 1). Kollonat janë poligonale dhe kurorëzohen me kapitele, në të cilat janë gdhendur kafshë dhe monstra të ndryshme shpesh me poza groteske që të bëjnë të mendosh për një influencë romanike [5]).

Muratura e kishës së Pojanit është prej dy brezash (Tab. I, 2). Pjesa e poshtme deri në fillimin e kornizave të çatisë është prej gurësh paralelopedikë të marrë, padyshim, nga rrënojat e Apollonisë. Gurët janë në rradhë horizontale dhe me të njejtën trashësi në tërë perimetrin e kishës. Ata lidhen me pak llaç dhe janë të vendosur përsë gjati në murë.

Kështu, ne e shohim me dyshim mundësinë e një lidhje me gurë tërthorë, ndërmjet dy perdeve të murit, duke e pranuar këtë veçse në qoshet e mureve. Gurët e skuadruar paraqesin dhe një veçanti, ata janë jo të rafshtë dhe, kush më shumë e kush më pak, kanë, në konturet horizontale, nga një bordurë të gdhendur më vonë (fig. 5), që të krijon idenë sikur gurët nuk kanë qenë të rrafshtë por pak të thelluar. Pjesa e sipërme e muraturës është ndërtuar me tulla të trasha të suvatuara dhe të lyera me bojë të kuqe. Që pjesa e sipërme e mureve anësore dhe tamburi i kupolës janë me tulla, na e tregojnë një pjesë e murit ku ka rënë suvaja si dhe të çarat që ndjekin fugat e murit dhe që përshkojnë tërë suvanë. Po me tulla janë ndërtuar edhe qemerët që mbulojnë kishën. Në një sipërfaqe të vogël në krahun perëndimor ku është rrëzuar suvaja, duket qartë se qemeri është i ndërtuar me tulla të trasha të vendosura në mënyrë radiale (fig. 6).

Dritaret e kishës, qofshin në tambur, ku janë katër dhe të vendosura 45° ndaj aksit gjatësor, si edhe në naos, janë dy pjesëshe me nga një kollonë në mes. Dritaret janë prej pllakash guri në të cilat janë gdhendur vrima për ndriçim dhe që sot janë, në pjesën më të madhe, të mbyllura me suva. Dritaret janë të mbuluara me hark rrethor, me përjashtim të dritares së absidës, të mbuluar me hark të mprehtë (Tab II, 1, 2)

Në fasadat jugore dhe veriore kemi 6 porta, nga tre për secilën anë dhe që i takojnë naosit, narteksit dhe ekzonarteksit. Nga këto, porta jugore e narteksit është e mbyllur dhe aty është lënë një dritare, që sot ndriçon narteksin. Pranë portave të narteksit dhe të naosit kemi nga një portik mbi dy kollona. Nga kollonat në mur kalojnë gurë horizontalë mbi të cilët ngrihet, mbi një qemer cilindrik, pjesa e sipërme e portikut, e mbuluar me çati dyujse me frontone në fasadat. Portikut të portës veriore të naosit i mungojnë kollonat, por ruhen në pjesën e poshtme bazamentet e tyre dhe dyshemeja me pllaka. Mbulesa me qemer e këtij portiku ruhet sepse gurët, që dalin nga muri qëndrojnë akoma si konsol. Portiku i portës jugore të mbyllur të narteksit mungon, por ruhet guri më nga lindja, mbi të cilin ngrihej dikur qemeri (Tab I, 1) Gjurmët e qemerit ruhen të murosura, që do të thotë se ai ishte ndërtuar më përpara se muri me tulla mbi të.

5) A. Ducellier, Observations sur quelaues monuments d'Albanie në «Revue Archeologique» vëll. II Octobre-Decembre 1965, fq. 189.

DO NOT COPY

Kornizat janë të krijuara duke nxjerrë tullat konsol ndaj murit, në rreshta të drejtë tek kupola dhe në rreshta të alternuar dhëmbë sharre dhe të drejtë në çatitë e tjera. Çatia e mbuluar me tjegulla, që ruan formën e vjetër, është ndryshuar pjesërisht gjatë shtesave që i janë bërë në anën perëndimore (Tab III. 2). Çatia e vjetër ndjek krahët e kryqit të cilët shihen qartë. Ambientet anësore janë më të ulta dhe mbulohen me çati, me pjerrësi njëra nga lindja e tjetra nga perëndimi. Çatitë e pjesëve të ambientit të altarit, që janë më të ulta se të naosit, rrjedhin në veri dhe jugë. E parë nga ana lindore, çatia i jep një gjallëri të madhe kishës duke theksuar formën piramidale të saj (Tab III,1).

Muri mbi arkadën e kolonadës në anën perëndimore të ekzonarteksit përfundon me një kornizë të ulët ujëmbledhëse, që, nëpërmjet pilastrit qendror të arkadës, derdh ujin në një sterë të vendosur nën një pjesë të dyshemesë së ekzonarteksit.

Leximi kronologjik relativ i rindërtimeve të ndryshme të kishës së Pojanit nuk është i vështirë, jo vetëm sepse këto janë shtesa të bëra mbi ndërtimin e parë, por edhe se format dhe materialet e përdorura e lejojnë këtë gjë. Shtesë është paraklisi i Shën Mitrit në anën veriore, shtesë është dhe ekzonarteksi. Në vendtakimin e ekzonarteksit me murin perëndimor të narteksit është një fugë vertikale, si në anën jugore ashtu dhe në atë veriore. Edhe muri i ekzonarteksit është ndërtuar me gurë të skuadruar dhe ka të ndërtuar me tulla vetëm një pjesë të vogël, për dhënjen e pjerrësisë së çatisë. Fuga e narteksit me ekzonarteksin ndërpritet në pjesën e sipërme me një gur që del nga narteksi dhe ngrihet 30 cm në murin e mëvonshëm të ekzonarteksit. Na duket se ky gur duhet të jetë i vjetër, sepse muri që mbaron në buzët e tij në anën veriore mbi të, është muri më i vjetër prej tulle. Nuk mund të pohojmë me siguri në se kemi të bëjmë me një gur kornize që vazhdonte në tërë fasadën perëndimore, sepse në këtë mur, në brendësi të ekzonarteksit, nuk kemi ndonjë vijim të këtij guri.

Gjatë ngritjes në lartësi të çatisë në anën perëndimore, është mbuluar në pjesën më të madhe dritarja dyshe e krahut perëndimor të kryqit. Në murin verior të sotëm, i cili është në pjesën e sipërme me tulla, duken qartë gjurmët e pjesëve të vjetra, nga të cilat kuptojmë se çatitë e dikurëshme të ambienteve anësore kanë qenë të njëjta me ato të anës lindore (Tab V, 1). Në të njëjtën kohë dallohet pjesa e vjetër dhe muret shtesë mbi të, në pjesën që i takon narteksit, të cilat takohen në një vijë të pjerrët, që është vija në të cilën ndodhej dikur çatia njëujëse e narteksit. Në këtë fugë kontakti, rreshtat e para të tullave mbi murin e vjetër janë të pjerrëta. Në këtë mënyrë bëhet e qartë se është shtesë jo vetëm ekzonarteksi, por edhe forma e dikurshme e çatisë së pjesës perëndimore, e cila dallohet vetëm në anën veriore, sepse në anën jugore duket se do të jetë meremetuar në një nivel më të ulët se fuga që folëm më sipër. Gjatë mbushjes së çatisë së anës perëndimore është murosur në murin jugor, në vendin e çatisë së ambientit anësor, një pllakë, në të cilën janë gdhendur në reliev të ulët një shqiponjë dhe një kryq me dy viza horizontale, në trupin e të cilit janë gdhendur nëpërmjet thellimit një sërë kuadrate të vogla (fig. 8). Në një kohë të dytë mbi murin perëndimor të narteksit është ndërtuar një këmbanore.



Fig. 7

Që paraklisi është shtesë e tregon qartë muratura e çrregullt e tij dhe fakti se ai është ngjitur me portikun e portës veriore të naosit. Në shikimin e parë të duket sikur edhe skevofilakioni është shtesë e mëvonshme, sepse rreshtat e gurëve të tij s'janë në një nivel me ato të kishës. Meqenëse gurët janë të njëllojtë, sonduam në vendtakimin e mureve të tij me ato të kishës, dhe na rezultoi se, megjithë ndryshimin në lartësi të rradhëve, gurët e skevofilakionit hyjnë brenda në ato të kishës duke u lidhur në mënyrë të rregullt. Kjo na shpie në përfundimin se kisha dhe skevofilakioni janë të një kohe.

Duke përcaktuar shtesat, që i janë bërë me kohë kishës ne kemi mundësi të bëjmë një rikonstruksion të saj në gjendjen e parë. Ana lindore është po ajo që kemi dhe sot, ndërsa në anën perëndimore ndërron forma e çatisë, duke u ulur në nivelet e vjetra dhe duke pasur të formuar qartë kryqin në çati, nëpërmjet çative të krahëve të kryqit dhe atyre të ambienteve anësore, në kuotë më të ulët. Gjithashtu në një kuotë më të ulët është dhe çatia e narteksit (Tab V, 2).

DO NOT COPY



Fig. 8

Duke pasur katër portikë në fasadat jugore dhe veriore mendojmë se duhet të ketë qenë një e tillë edhe në fasadën perëndimore, në portën që hyhet në narteks. Për një gjë të tillë bindemi edhe nga forma e mbulesës së portës, me hark të njëllojtë me ato të portave ku ka portik. Sigurisht kjo do të sqarohet përfundimisht, po të sondohet nën suvanë që mbulon murin perëndimor të narteksit, ku duhet të ruhen patjetër në mur pjesët e gurëve që mbanin qemerin e portikut.

Për vetë materialin që përdoret, formulimi arkitektonik i kishës së manastirit të Pojanit është i thjeshtë dhe i qartë. Rrafshësia e mureve ndërpritet vetëm nga portikët, të cilët në një sfond të tillë janë mjaft elegantë. Po thjesht është trajtuar dhe fasada lindore me një apsidë të madhe pesë faqëshe, i vetmi zbukurim i të cilës është dritarja dyshe, në fushën mbi vetë dritaren dhe mbulesën me hark është gdhendur në mënyrë mjaft primitive një njeri nga mezi e sipër dhe me krahë hapur. Me gjithë trajtimin e rrafshtë të mureve, pa asnjë dekor, pamja e kishës është mjaft impozante edhe pse pjesa e sipërme e saj është ndërtuar me material tjetër dhe tamburi me kupolën janë mjaft të mëdhenj dhe të dekoruar vetëm me 12 nike.

Interesante është fasada perëndimore, me kollonadën me një ritëm që ndërpritet nga pilastrat dhe që e fragmentojnë në elemente të përsëritshme, duke i hequr mundësinë të duket më e gjatë se ç'është në të vërtetë. Punimi i rregullt i kolonave, modelimi i imët i tyre dhe larmia e skulpturave në kapitelet e bëjnë të dallohet këtë fasadë, megjithë shqetsimin që krijon në pamjen e saj çatia mjaft e gjatë. Hapësira e brendshme e naosit paraqitet me disa ndryshime në krahasim me hapsirat e brendshme të kishave të tjera në formë kryqi të brendashkruar. Këtu nuk e kemi fjalën për deformimin e saj, të cilën ndërtuesit as që janë munduar ta bëjnë më pak të dukshëm, sepse një fenomen i tillë në arkitekturën bizantine nuk është përjashtim, madje edhe në fasadat portiket janë të spostuar ndaj dritareve, sepse efekti arkitektonik arrihet nëpërmjet piktoreskes. Ndryshimi këtu qëndron në faktin se pjesa qendrore, nën kupolë, është mjaft e madhe në krahasim me ambjentet anësore, të cilat duke qenë dhe të ulëta nuk arrijnë të përfshihen tërësisht në hapësirën e pjesës qendrore. Kjo e fundit është tema dominante në formulimin arkitektonik të interierit dhe theksohet më tepër nëpërmjet lartësisë së kupolës. Nëpërmjet hapësirës përpara apsidës së madhe mendojmë se duhej të ndjehej dhe prezenca e një aksi gjatësor, që sot ndërpritet së tepërmi nga që ikonastasi është mjaft i lartë.

Sot mjaft elemente ndihmëse, si ndriçimi dhe afreskat, mungojnë, për shkak të ndryshimeve që ka pësuar me kohë kisha, dhe kjo mundet të influencojë, bashkë me faktorët e tjerë, në krijimin e një hapësire jo dhe aq dinamike.

Në krijimin e një planimetrie jo drejtkëndëshe, deformacioni i së cilës nuk është një shmangie nga këndi i drejtë gjatë ndërtimit, mundet të kenë luajtur rol edhe mbeturina muresh të vjetra, të cilat janë një gjë e zakonshme në këtë vend. Sigurisht që studimet që do të ndërmerren në të ardhmen do të mund të sqarojnë këtë problem, që për nivelin e kërkesave tona nuk mund ta prekim më gjerë. E themi këtë sepse niveli i ndërtimeve të kishës së Pojanit gjithashtu dhe aftësitë teknike e konstruktive të ndërtuesve janë të mira. Ata janë munduar të eliminojnë shtytjet e kupolës që janë të mëdha, aq më tepër kur kollonat janë afër me muret anësore, edhe duke përdorur tiranda të drunjtë, të cilët janë vendosur në dy nivele, në nivelin e kapiteleve të kollonave dhe në mes të lartësisë së qemereve të krahëve të kryqit, duke bërë të ulta kollonat.

Deri tani trajtuam arkitekturën e kishës së Pojanit dhe ndërtimet e ndryshme, që ajo ka pësuar në kohë, detyra e parë, që i kemi vënë vetes në këtë studim. Mbas kësaj mund të kalojmë në problemin e dytë, atë të datimit të saj.

Në literaturën shkencore janë shprehur mendime të ndryshme për këtë problem dhe, si përmendëm më lart, autorët janë nisur gjithnjë nga datimi i afreskave të ekzonarteksit dhe interpretimi i mbishkrimeve me datë, që, të plota ose të pjesshme, ruhen në muret e kishës. Në apsidë ndodhet një mbishkrim nga i cili ruhet sot vetëm data 1250 [6]). Lidhur me këtë mbishkrim

6) Th. Popa, «**Saktësime...**» fq. 142, fig. 1.

DO NOT COPY

Th. Popa mendon se ai është i ngrënë nga fërkimi i këmbëve, dhe murosur në apsidë. Nga kjo datë ai arrin në konkluzionin se kisha duhet të jetë ndërtuar disa vjet mbas vitit 1250. Guri në të cilin është gdhendur ky mbishkrim, për mendimin tonë është nga të murit të apsidës dhe nuk e shohim të ngrënë nga fërkimi. Për këtë na shtyn të mendojmë sipërfaqja e tij e njejtë me të gjithë gurët e tjerë dhe fakti që ai duket në vendin e vet. Pranë këtij guri është një gur i vogël, sepse në ndërtimin e apsidës është e paevitueshme mbetja e boshllëqeve në mes të disa prej gurëve të mëdhenj, të cilat janë mbushur me gurë më të vegjël. Mendojmë se ky mbishkrim, me një grafi të hollë duhet të jetë shkruar aty mbas ndërtimit të kishës, mundet për të treguar vdekjen e ndonjë personi dhe kurrsesi s'mund të jetë prurë aty nga ndonjë vend tjetër, sepse një veprim i tillë nuk është i shpjegueshëm. Për ne, viti 1250 është një terminus ante quem për ndërtimin e kishës.

Th. Popa mendon se kisha duhet të jetë ndërtuar apo rindërtuar brenda periudhës historike 1264-1282, koha në të cilën bashkësundonin Mihaili VIII Paleologu dhe Androniku II Paleologu, që sipas tij janë të pikturuar në skenën e pikturës murale në ekzonarteks [7]). Simbas Puzanovas dhe Dhamos kisha duhet të jetë ndërtuar nga 1282-1328, koha e mbretërimit të Andronikut II Paleologut, të pikturuar në afreskun e mësipërm [8]). Ne nuk kemi për qëllim të përcaktojmë identitetin e personave të pikturuar në këtë afresk, por vetëm deshëm të theksojmë se afresku i mësipërm, që ndodhet jashtë mureve të kishës është bërë kohë mbas ndërtimit të kishës. Për këtë nisemi nga fakti që një person kaq i rëndësishëm si perandori bizantin nuk mund të pikturohej jashtë kishës, veçse kur kisha vetë të qe ndërtuar dhe pikturuar me kohë. Që kemi të bëjmë me një afresk të pikturuar jashtë kishës në formën e saj fillestare e tregon fakti që ky ndodhet i pikturuar në anën e jashtme të murit perëndimor të narteksit. Mendojmë se në një kohë me pikturimin e këtij afresku duhet të jetë ndërtuar dhe ekzonarteksi. Për datimin e ekzonarteksit kemi dy mbishkrime. I pari ndodhet në anën jugore, pranë tokës, i gdhendur në dy gurë. Në gurin më nga perëndimi është gati i tërë mbishkrimi, ndërsa në gurin tjetër vetëm tri gërma në dy rreshta. Mbishkrimi flet për vdekjen e një igumeni të manastirit të Apollonisë me datën 31 Mars 1350. Th. Popa mendon se ky është një gur varri, i cili gjatë ripërdorimit në mur është gdhendur në njerën anë, duke i hequr gërmat që më vonë i shkruan në gurin tjetër [9]). Ky veprim na duket i pamundur dhe mendojmë se mbishkrimi është bërë në gurët e murit egzistues. Për këtë na shtyn të mendojmë dhe grafia e njëjtë e të dy gurëve. Mbishkrimi tjetër është në një nga pilastrat e kollonadës dhe është një gur varri me datën 1380 dhe i vendosur përmbys [10]). Duket se mbas këtij viti ekzonarteksit i janë bërë ndryshime duke i shtuar kollonadën. Një mbishkrim i katërt me datë ndodhet në një fragment pikture me ornamente në murin perëndimor të skevofiliakionit, në pjesën pranë kishës dhe paraklisit të Shën Mitrit [11]). Nga ky mbishkrim ruhen një pjesë e shifrave dhe mund të shkojë nga 1292-në 1391, kohë në të cilën kisha e Shën Mërisë Pojanit dhe paraklisi i Shën Mitrit duhej të ishin ndërtuar. Nga sa thamë më sipër rezulton se kisha është ndërtuar përpara vitit 1250 dhe ekzistonte kur është pikturuar afresku në murin perëndimor të saj. Të dhëna për një datim më të saktë të ndërtimit të saj ne nuk disponojmë, sepse është e pamundur të ndjekim lidhjet e manastirit të Apollonisë me kryeqytetin ose ndikimin e arkitekturës kryeqytetase në këtë zonë, e cila është më në veriperëndim të shtrirjes së ndërtimeve të arkitekturës bizantine në këtë kohë. Mund të shënojmë se në shekullin XIII-XIV kisha të këtij tipi fillojnë të ndërtohen dhe në vendet e tjera të Ballkanit, [12]) sepse në këtë kohë influenca e arkitekturës kryeqytetase përhapet në tërë këto vende. Duhet të pohojmë se, me përjashtim të mbulesës me qemer të ambjenteve anësore, arkitektura e kësaj kishe është e tipit kryeqytetas. Apsida 5 faqëshe dhe kupola 12 faqëshe janë gjithashtu një shenjë e influencës kryeqytetase. Për këtë majfton të shenojmë që përpara shekullit XIV apsidet pesë faqeshe dhe kupolat me më shumë se tetë faqe nuk njiheshin as në Greqi [13]) as edhe në Bullgari [14]). Kjo gjë tregon për një lidhje direkte të arkitekturës së kishës së Pojanit me arkitek-

7) Th. Popa, **«Saktësime....»** fq. 141.
8) V. Puzanova, Dh. Dhamo, **Vep. cit.** fq. 159.
9) Th. Popa, **Po aty,** fq. 143.
10) Th. Popa, **Po aty,** fq. 144.
11) Th. Popa, **Po aty,** fq. 143.
12) K. Mijatev, **Srednevekovna arhitektura v Bellgarija,** Sofie 1965 fq. 152.
13) G. Millet, **vep. cit.** fq. 181.
14) N. Mavrodinov, **Jednokorabnata i krestovidnata cërkva po Bollgarskite zemi do kraja na XIV** v, Sofja 1931, fq. 112.

DOKTORIT

turën e Kostandinopojës, e cila lidhje mund të shpjegohet dhe me largimin e artistave të atjeshëm pas krijimit, më 1204, të perandorisë latine të lindjes.

Duke u nisur nga të gjitha këto, lidhur me datimin e kishës së Pojanit, përfundojmë se ajo duhet të jetë ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XIII, në mos dhe më përpara, duke pasur si terminus ante quem vitin 1250. Sidoqoftë shtimi i kërkimeve do të mund të hedhë dritë në mjaft probleme të arkitekturës dhe datimit të këtij monumenti, një ndër monumentet më të rëndësishme dhe më të mëdha të arkitekturës, që ruhen në vendin tonë.

DO NOT COPY





Pamje nga Jugu

2

DO NOT COPY



1 Pamje nga Lindja



2 Pamje nga Perendimi

DO NOT COPY



1



2 Pamje nga Veriu

DO NOT COPY





2 Premje „giatèsore

DO NOT COPY



1



2 Pamje nga Veriu - Rikonstruksion

DO NOT COPY

DO NOT COPY

A. MEKSI

L'EGLISE DU MONASTERE D'APOLLONIE, SON ARCHITECTURE ET LE PROBLEME DE SA DATATION

RESUME

Le monastère de Sainte-Marie d'Apollonie, se dresse sur une colline qui domine le village de Pojan. A l'intérieur de l'enceinte, se trouvent les bâtiments d'habitation qui, dans leur état actuel, portent les marques de travaux de reconstruction, le réfectoire à trois conques et l'église.

Cette étude traite de l'architecture de l'église et avance quelques suggestions sur sa datation. Des opinions diverses ont été émises à ce sujet. Elles se fondent toutes sur la fresque couvrant le mur de l'exonarthex de l'église, sans toutefois rattacher l'examen de ce problème à l'architecture.

L'église est du type de la croix inscrite à coupole, avec un espace entre l'aile est du transept et l'abside, ce qui dénote une nette influence de la métropole. L'église se compose de la nef, du sanctuaire, du narthex et de l'exonarthex. Par le sanctuaire, elle communique sur son côté nord avec un skevophylakion (lieu où sont conservés les vases du culte). Au nord de l'église se trouve une chapelle latérale accolée au skevophylakion et que les habitants de l'endroit disent consacrée à Saint Dimitri.

La base de l'église est déformée et constitue un parallélogramme. Cette déformation se transmet jusqu'au tambour et à la coupole. Les structures supérieures s'appuient sur quatre colonnes antiques et deux piliers, qui flanquent le sanctuaire. Ceux-ci supportent les voûtes des bras de la croix, dont la forme est ici bien conservée. Les bas-côtés sont surmontés de voûtes cylindriques, particularité de la province.

La maçonnerie se compose de deux bandes superposées, l'inférieure en pierres antiques, la supérieure en briques, qui est aujourd'hui revêtue. Les voûtes également sont construites en briques. Sur les côtés sud et nord subsistent, en partie ou intégralement, quatre porches, deux de chaque côté, qui ont été construits en même temps que l'ensemble de l'édifice.

Au cours des siècles, l'église a subi des transformations, et elle s'est vu ajouter de nouveaux éléments. Tels l'exonarthex et sa colonnade sur le côté ouest, dont le joint de contact avec le narthex se remarque nettement. La toiture de la nef a été surélevée pour permettre la construction de celle de l'exonarthex. Un tel procédé apparaît sur la face nord où l'on distingue l'ancienne ligne de la récente. De même la chapelle latérale sur le côté nord, accolée au skevophylakion, et le porche de la nef sur le même côté sont des adjonctions.

La détermination des adjonctions permet de dégager des conclusions quant à la forme première de l'église. A la suite de ce travail, on en a même tenté une reconstruction hypothétique.

En ce qui concerne la datation de l'église, on s'est fondé jusqu'à ce jour sur la fresque qui couvre le mur extérieur du narthex, aujourd'hui compris dans l'exonarthex. Popa date cette fresque des années 1264-1282, époque du règne de Michel VIII Paléologue et d'Andronique II Paléologue, qui, selon lui, sont représentés sur ces oeuvres. Pusanova et Dhamo en fixent la date à une période allant de 1282 à 1328, règne d'Andronique II Paléologue, qui figure sur la fresque. Pour notre part, quelle que soit la date de la fresque, celle-ci ne peu être prise pour base de la datation de l'église du fait qu'elle se trouve en dehors de ses murs et qu'un personnage aussi important ne pouvait être représenté en un lieu découvert. A notre avis, l'église a dû certainement être construite avant 1250, une inscription grattée sur une pierre du mur de l'abside portant cette date. La peinture de la fresque doit dater de la même époque que la construction de l'exonarthex. Ses murs portent deux inscriptions. L'une, sur le mur sud, fait mention de la mort d'un hygoumène du monastère à la date du 31 mars 1350, et doit avoir été gravée après la construction de l'exonarthex. Contrairement à ce qu'on croyait jusqu'ici, il ne s'agit pas là d'une pierre funéraire utilisée dans cette construction. La deuxième inscription se lit sur une pierre tombale, posée à l'envers, de la colonnade et date de 1380. Il semble que, par la suite, l'exonarthex ait subi des modifications par l'adjonction de la colonnade.

Il est malaisé de retracer les liens du monastère de Pojani avec Constantinople. On peut signaler que des églises de ce genre sont construites aux XIII-XIVe siècles dans d'autres pays des Balkans également. L'abside à cinq faces et la coupole à 12 faces témoignent, elles aussi, d'une influence de la métropole. Qu'il suffise de rappeler qu'avant le XIVe siècle les absides à cinq faces et les coupoles à plus de huit faces n'étaient connues ni en Grèce ni en Bulgarie. Aussi estimons-nous que l'église du monastère d'Apollonie doit avoir été construite dans la première moitié du XIIIe siècle ou même auparavant, et, en tout état de cause, antérieurement à 1250.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Hasan NALIBANI

RRETH KRIJIMTARISË SË PIKTORIT DAVID SELENICASIT

Rreth jetës dhe krijimtarisë artistike të David Selenicasit, deri tani, kemi shumë pak të dhëna. I vetmi burim, i cili hedh dritë mbi këtë figurë të shquar të artit tonë në sh. XVIII, është një mbishkrim që ndodhet në faqen perëndimore të interierit të kishës së shën Kollit në Voskopojë.

Në këtë mbishkrim lexojmë se kishën e pikturoi kryemjeshtri D. Selenicasi, bashkë me dy ndihmësat e tij, Konstandinin dhe Kriston.

Kisha në fjalë është një monument kulture i shek. XVIII, ndërtuar në vitin 1721 dhe pikturuar në vitin 1726. Nga pikëpamja arkitektonike ky monument ruan përmasa që kapin rreth 21,5 m. në shtrirje gjatësore dhe 10,70 m. gjerësi. Pikturat e Davidit mbulojnë krejt fasadat si dhe zonën e altarit.

Procedimi teknik është bërë në dy shtresa llaçi, shtresa e parë me gëlqere dhe kashtë gruri, mandej një shtresë tjetër prej llaçi me gëlqere dhe lesh bagëtie si bazë e pikturës. Të dy shtresat kapin një trashësi deri 2 cm. Llaçi është aplikuar mirë dhe në mjaft zona nuk ka pësuar ndonjë çarje.

Në drejtim të teknologjisë së pikturës, konstatojmë se Davidi ka proceduar jo me kriterin e teknikës purofresko, por ka pikturuar mbi shtresën e njomë të qumështit të gëlqeres me ngjyra që janë konsoliduar në bazë të karbonizimit të gëlqeres. Mbi pikturë nuk ka shtresa të mbivëna në të thatë; drita dhe hija janë arritur relativisht në një kohë kur piktura ka qenë e njomë. Piktori hijen e ka trajtuar me pak ngjyrë dhe me velatura, ndërsa dritën me ngjyra të fuqishme dhe pastoze. Disa ngjyra si ultramarini janë aplikuar mbi një shtresë ngjyre të zezë, në rastin e disa sfondeve, dhe kanë pësuar një degradim gjatë kohës, duke humbur tingullin e tyre bazë.

Mbi krijimtarinë e piktorit D. Selenicasi ka shkruar V. Puzanova [1]) dhe Th. Popa [2]). Autorët e mësipërm i kanë bërë një analizë të përgjithshme dhe të veçantë zgjidhjes ikonografike pikturës, si dhe një vlerësim artistik veprës së Davidit duke theksuar karakterin realist të saj. Por vlera e madhe e krijimtarisë së piktorit David Selenicasi krijon një material të gjerë dhe të pasur për studime të reja dhe figura e këtij artisti të shquar mund të ndriçohet edhe më mirë duke e kapur veprën e tij në aspekte të ndryshme.

Qëllimi i këtij shkrimi është, kryesisht, zbulimi dhe vlerësimi i disa elementeve të reja, që sjell piktori në artin e asaj kohe, si dhe nxjerrja në pah e vlerave artistike të pikturës së Davidit. I udhëhequr nga ky qëllim, jam munduar t'u bëj një analizë vetëm disa skenave dhe portreteve ku elementet në fjalë spikatin më tepër dhe ku autori me një gjuhë të fortë artistike zbulon më mirë forcën dhe talentin e tij si artist. Duke u përqëndruar në këto elemente të reja, ne theksojmë këta faktorë pozitivë të krijimtarisë së piktorit, i cili, duke i bërë një sfidë frymës mistike ireale të artit kishtar, u mundua t'i japë veprës një karakter deri diku realist, element ky që përbën një tipar të rëndësishëm të krijimtarisë së piktorit tonë të shquar.

David Selenicasi na ekspozohet në krijimtarinë e tij si një mjeshtër i madh i pikturës murale. Karakte-

---

1) V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar në sh. XVIII.** Buletini i Shkencave Shoqërore Nr. 1, 1957.
2) Th. Popa, **Piktorët mesjetarë shqiptarë,** Tiranë 1961.

ristikë e tij është prirja për t'ja përshtatur frymën laike të artit kërkesave të pikturës kishtare. Koncepti modern mbi kompozimin, përgjithësimin e formës, duke ruajtur bërthamën racionale të brendisë, aftësia për t'ja përshtatur zgjidhjen dekorative dhe kompozicionale përmasave arkitektonike të interierit, prirja për të depërtuar në botën e brendshme psikologjike, të gjitha këto karakteristika që përshkojnë artin e Davidit janë një notë e re e panjohur për pikturën kishtare të shek. XVIII. Gjithashtu koncepti i avancuar në ndërtimin e gjerë të skemave dhe portreteve, vlerësimi koloristik, interesi për ambientin, materien dhe ndërtimin anatomik të figurave, në masën se si i koncepton dhe realizon Davidi, këto kërkesa janë gjithashtu një hop cilësor i paarritur deri atëhere nga shumë piktorë paraardhës. Në skenën «Gratë mirëprurëse», piktori ndërton një kompozim piramidal. Vendosja e figurës qendrore jo plotësisht në qendër të kompozimit është bërë me koshiencë nga piktori. Të dy figurat anësore përsëritin njëra tjetrën si lëvizje dhe tipe, ndërsa figura qendrore është vizatuar në mënyrë konçize dhe janë ruajtur mirë proporcionet anatomike. Ambienti ka karakter realist. Piktori mundohet të na japë një perspektivë lineare të drejtë pa u interesuar shumë për tonet. Në plan të parë ka plane dhe detaje që i ndihmojnë krijimit të thellësisë së kompozimit dhe e bëjnë skenën bindëse. Tablloja është perceptuar gjerë, në masa të mëdha dekorative. Në drejtim të koloritit, piktori mundohet të eliminojë gjithë disavantazhin që i krijon zgjidhja kompozicionale simetrike, duke i vlerësuar figurat me tone dhe njolla të ndryshme, njërën figurë e mban në njollë gri transparente afër pejsazhit, ndërsa figurën tjetër me njollë të kuqe me ton të plotë, duke krijuar një kontrast të këndshëm koloristik. Ky zbërthim dekorativ i skenës arrin nga ana formale një variacion të theksuar në koloritin e saj. Kompozimi është lakonik dhe i konceptuar si një kuadër realist nga jeta. Piktori prirет drejt formave plastike, duke ruajtur interesin për volumin dhe diferencimin anatomik me bazë realiste. Portretet e grave kanë një bukuri klasike; modelimin e palave, piktori e kërkon në variacionin që i jep çdo figure, duke i ndërtuar, sipas rastit; tek figura e parë thjesht dhe pak kaligrafike, ndërsa tek figura tjetër me tone dhe gjysmë tone piktorike. Figurën qendrore për ta vënë në dukje nga dy të tjerat e kërkon më imët dhe më grafike. Portretet janë modeluar me tone dhe gjysmë tone, me kalime të afërta dhe hije të lehta tek figurat e grave dhe me kontraste dhe forma të thella tek figura qendrore. Davidi është munduar t'i japë çdo skene karakterin e një zhanri jetësor bindës, për këtë qëllim ai ka shfrytëzuar gjithë elementet shprehëse artistike, si grupimin e figurave, krijimin e një ritmi variant dhe elemente të tjera realiste siç vihen re në skenën «Shërimi i të verbërve» (fig. 1). Piktori ka prirje drejt një zgjidhje kompozicionale mjaft të kërkuar në siluetë. Shpërndarja e figurave ndjek një kriter mjaft të avancuar nga ana estetike, grupet e figurave krijojnë një linjë kompozicionale plastike, duke shfrytëzuar me mjeshtëri lëvizjet dinamike të figurave. Ndërtimi dekorativ arrihet jo vetëm me anë të ndërtimit koloristik të gjerë dhe variant të skenës, por dhe nëpërmjet vlerësimit të guximshëm tonal të figurave, duke krijuar një shpërndarje të drejtë të toneve të qarta dhe të errta. Pranë figurës së parë në ton të qartë, Davidi vendos figurën tjetër krejt në ton të errët, që krijon një kontrast të fuqishëm me të parën. Figurat e të verbërve janë plot lëvizje. Piktori i ka ndërtuar ato me forma të mëdha, të përgjithësuara, pa humbur dhe interesin për detajet. Pejsazhi është deridiku konvencional, por nuk mungon kujdesi për një shpërndarje realiste të planeve, të dritës dhe të hijes.

Vihet re se rrethi i figurave dhe tipave të dashuruar nga piktori ka qenë i kufizuar. Kjo shpjegon, për mendimin tim, faktin që disa figura përsëritin njëra-tjetrën dhe që të gjitha ato i përkasin një ambienti të kufizuar. Por është meritë e piktorit që këtë galeri tipash nuk e huan, nuk i referohet ndonjë shabloni të krijuar nga koha. Lidhjen sado të vogël me traditën dhe tipat e figurave kryesore ai di t'i ruajë në masën që e bën veprën e tij të kryejë funksionin didaktik si dhe të shkëlqejë në tërë individualitetin e tij si artist. Ndërsa tregon pak interes për individualizimin e karaktereve, Davidi prirет mjaft nga ana formale duke krijuar tek çdo figurë një ndërtim të veçantë anatomik, kolorit të ndryshëm dhe interes të theksuar për diferencimin e materies. Në figurat e «Skenës së kungimit» që piktori i ka ndërtuar në formë të një frizi në apsidë, vëmë re përsëritje tipash në portretet e figurave, ndërsa raportet koloristike janë mjaft të larmishme dhe njëkohësisht ruajnë në tërësi një gamë unike. Piktori përdor ngjyra të afërta në nuanca, por të ndryshme si njolla. Interesi për vlerësimin material duket qartë në diferencimin tonal dhe në përpunimin që u bën palave në disa figura. Vizatimi i përpiktë dhe modelimi i thellë dhe shumë variante që kanë një pjesë e figurave, na bën të besojmë se në «Skenën e kungimit» jo të gjitha figurat janë të dorës së Davidit. Ky mendim mbështetet në diferencimin e theksuar që kanë figurat e krahut të djathtë me ato të krahut të majtë të skenës (fig. 2-3). Davidi në aplikimin teknologjik të ngjyrës ruan mirë avantazhin e teknikës së afreskut duke mbajtur mjaft raporte transparente dhe me dritë. Shumë piktorë paraardhës shqiptarë, megjithëse mjeshtër, nuk kanë mundur të shfrytëzojnë avantazhet teknike të afreskut. Disa raporte koloristike tek këta piktorë janë të errëta dhe pa transparencë. Ruajtja e transparencës së ngjyrave, mbajtja e tyre

afër teknikës dhe kërkesave të pikturës murale, na bëjnë të besojmë se piktori duhet të jetë njohur me pikturën italiane të protorenesancës dhe renesancës. Kësaj teze i ndihmon dhe mënyra se si piktori e koncepton vizatimin në përgjithësi në krejt pikturën e Shën Kollit. T'u referohemi figurave të profetëve në kupolën e dytë të nefit qendror (fig. 4). Ato janë mbajtur në raporte ngjyrash të qarta dekorative dhe me kontraste tonale, gjë që i bën të lexueshme nga një distancë relativisht e madhe. Figurat kanë lëvizje dhe qendrim dinamik. Forma e madhe zbulohet nëpërmjet sintezës që i bën piktori formës dhe konstruktit të brendshëm të figurave. Në këto figura nuk ka statizëm, ato janë plot lëvizje dinamike që arrihet në një masë të theksuar dhe nga ndërtimi grafik i palave, që është mjaft realist dhe funksional.

Davidi ka ditur të vërë në funksion estetik të kuadrit edhe kaligrafinë e gërmave duke i vlerësuar sipas rastit të qarta në sfondin e errët dhe anasjelltas.

Tipizimi me bazë në jetën dhe rrethin e njerëzve ku ka jetuar e punuar piktori është një tipar tjetër i artit të Davidit. Në portretin e Shën Stefanit (fig. 5), piktori, na ka dhënë një tip të kapshëm që e gjejmë midis nesh. Përgjithësimi dhe stilizimi i formave në portret, duar dhe trup është ruajtur në masën që nuk e ka bërë figurën skematike dhe pa jetë. Përkundrazi, ai është shumë konform kërkesave të pikturës monumentale, e cila kërkon të ruajë vetëm format që janë esenciale, t'i përgjithësojë dhe t'i evidencojë ato. Gjithë interesi i piktorit është ndërtimi i një figure jetësore, duke shfrytëzuar për këtë qëllim koloritin dhe lojën e ngjyrave të ngrohta me ato të ftohta. Hijet dhe gjysmë tonet i mban në ngjyra të ftohta transparente, ndërsa dritën në nuanca të ngrohta të ngjyrës okër dhe aranxhë. Sfondi i errët në blu ndihmon mjaft në vlerësimin e portretit. Në drejtim të shfrytëzimit të anës teknologjike konstatojmë se piktori ngjyrat në dritë i përdorë pastoze, ndërsa në hije më transparente. Anën teknologjike e shfrytëzon edhe në vlerësimin e materies, siç është rasti i përdorimit të ngjyrës pastoze dhe kalimit me velaturë sipër, për të na dhënë një materie të bardhë në të argjentë. Krejt portreti është perceptuar në mënyrë monumentale, ka një vizatim të përpiktë lakonik dhe një kolorit mjaft bindës. Në shpërndarjen



Fig. 1 —

NO COPY



Fig. 2 –



Fig. 3 –

DO NOT COPY

e dritës piktori ruan një burim natyral duke bërë një sintezë të drejtë të dritës në shërbim të formës.

Piktori, D. Selenicasi, është i pari që solli në artin kishëtar portretin realist, me bazë jetën dhe natyrën.

Në figurën e Ktitorit (dhurues i kishës), spikat me tërë forcën talenti dhe aftësia tekniko-profesionale e piktorit. Portreti është ndërtuar afër derës kryesore të faqes nga jugu: ka dimensione natyrale dhe është pikturuar pak i shkëputur nga skenat e tjera. Të gjitha elementet, duke filluar nga përmasat deri tek realizimi artistik, dëshmojnë për një interes të veçantë që i ka kushtuar piktori kësaj vepre. Ai këtu kërkon të flasë me një gjuhë të lirë të shkëputur nga çdo kondicion. Qëllimi i Davidit është ndërtimi i një portreti plotësisht realist si në formë dhe në përmbajtje. Ktitori është një personazh real, një plak voskopojar nga rrethi i klasës së tregëtarëve të qytetit. Portreti është mbajtur në njollë të ngrohët, që anon në aranzhë. Gjithashtu edhe duartë ruajnë këtë gamë, ndërsa veshja është në tone dhe raporte koloristike që lidhen mjaft me sfondin neutral. Veshja është karakteristike e klasës së të pasurve: një xhybe e rëndë dhe në qafë një gëzof të cilin piktori e vlerëson mirë si materie. Ndryshe nga portretet e tjera, në rastin e Ktitorit të gjithë njollën e fytyrës dhe të duarve e ruan të ngrohtë dhe mjaft dekorative. Format dhe detajet nuk i përgjithëson as dhe i thjeshton si në portretet e tjera, por mundohet t'i vlerësojë në masën që të zbulojë qartë dhe me forcë gjithë karakterin e brendshëm të figurës. Detaje të tilla, si vijat e gjishtrinjve apo rrudhat e fytyrës, ai i shfrytëzon po për të njejtin qëllim. Në këtë portret nuk ka as dhe një gjurmë të skematizmit. Piktori është larg çdo shabloni. Vizatimi, koloriti dhe kërkimi i formës mëpërmjet detajeve të marra direkt nga natyra, flasin për një largim të madh të Davidit nga tradita e pikturës kishëtare. Ato janë një pohim i frymës laike të artit të këtij mjeshtri të pikturës, në shek. XVIII.

* * *

Vepra e Davidit shijohet, të emocionon; ajo depërton në botën shpirtërore dhe ruan frymën njerëzore.

Piktorët paraardhës, duke filluar me Onufrin, Nikollën, Konstandin Shpatarakun e të tjerë kanë sjellë, gjithashtu, mjaft elemente realiste, të cilat shërbyen si bazë dhe për piktorët e tjerë duke përfshirë dhe David Selenicasin. Në krijimtarinë e Onufrit dhe të Nikollës ndihet qartë prirja për t'iu referuar natyrës dhe jetës reale. Këto elemente realiste i ndeshim si në skenat kompozicionale ashtu edhe në portretet, që ata kanë pikturuar. Zgjidhja kompozicionale tek ata



Fig. 4

ka disa herë karakterin e një zhanri të vërtetë. Mjaft elemente realiste, si kërkimi në siluetë, grupimi i figurave në tabllo, përpunimi realist i dritë-hijes dhe i formës, gjithashtu janë karakteristika që përshkojnë veprën e Onufrit dhe të Nikollës. Por këto elemente, tek këta piktorë nuk i kanë shndrruar frymën fetare, mistike dhe ireale artit të tyre, në masën që kanë ve-

DO NOT COPY



Fig. 5 –

pruar dhe ndikuar në krijimtarinë e Davidit. Ndërsa piktorët e mëparshëm u mbetën në një farë mase konformë kërkesave të pikturës kishtare dhe artit bizantin, piktori David Selenicasi ngrihet me ndërgjegjen e një artisti mbi konceptin tradicional të zgjidhjes grafike dhe koloristike, duke ndërtuar në mjaft skena një kompozim të kërkuar në silueta, tipe dhe lëvizje.

Ndërsa në pikturën tradicionale kishëtare të kohës, artisti mundohej të krijonte për masën një botë të pakapshme, mistike dhe ireale, duke e zhveshur figurën e njeriut nga perceptimet jetësore të formës, proporcioneve, ngjyrës, volumit dhe elementeve të tjera jetësore, përkundrazi, Davidi mundohet që të gjitha këto elemente të shkëlqejnë sa më tepër në veprën e tij. Ambienti dhe elementet e tjera realiste nga piktorët e tjerë shpreheshin me anë konvencionesh dhe ishin deri atëherë një model stereotip i trashëguar. Ndërsa Davidi interesohet për ambientin, për karakterin e tij, për detajet, planet dhe perspektivën. Zbulimi i formës me anë të dritë-hijes tek piktorët e tjerë kishëtarë bëhej në masën që i shërbente ndërtimit të figurës, pa u interesuar shumë për efektin e vërtetë të natyrshëm të dritës. Davidi e përdor me mjaft mjeshtëri dritën dhe hijen, ai ruan gjithmonë një burim drite të natyrshme, pa e tepruar me hije dhe efekte të rastit. Piktori e thjeshton dritën dhe hijen në masën që të zbulojnë qartë formën dhe njëkohësisht të ruajnë efektin e tyre natyral.

Fryma jetësore e artit të Davidit diktohet nga rrethanat ku ka jetuar dhe punuar piktori. Nuk ka se si të mos merret në konsideratë fakti që shekulli i tij është ai i lëvizjeve të mëdha përparimtare, ideologjike dhe artistike. Këto lëvizje e patën bazën në idetë iluministe të kohës, të cilat patën ndikimin e tyre edhe në kulturën e qytetit të Voskopojës. Këta faktorë pozitivë, bashkë me zhvillimin e gjithanshëm kultural të qytetit në atë kohë, i dhanë shkas talentit të Davidit të transmetojë në veprën e tij tërë këtë frymë përparimtare.

Arti i Davidit i ndikuar nga këta faktorë duhet perceptuar, jo si një fenomen i shkëputur nga baza dhe rrethanat, por si produkt i kësaj baze dhe i këtyre rrethanave, të cilat bënë të mundur një lulëzim të tillë të artit në një kohë kur piktura kishëtare kishte pësuar një rënie të plotë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

H. NALLBANI

DE L'OEUVRE DU PEINTRE DAVID SELENICASI

RESUME

On ne dispose à ce jour que de peu de données sur l'oeuvre de notre éminent peintre du XVIIIe siècle. La seule source qui jette quelque lumière sur ce sujet est une inscription retrouvée sur le parement intérieur du mur ouest de l'église de Shen Kcll (Saint Nicolas) de Voskopojë.

La présente communication traite principalement de la découverte et de l'appréciation de certains nouveaux éléments que ce peintre apporte à l'art de son temps, et en met en relief les valeurs artistiques. S'attachant à ces éléments nouveaux, et s'écartant de l'esprit mystique irréel de l'art ecclésiastique de l'époque, le peintre s'est efforcé de donner à son oeuvre un caractère dans une certaine mesure réaliste, et c'est là un de ses traits essentiels. Il est le premier à avoir introduit dans l'art ecclésiastique le portrait réaliste, qui s'inspire de la vie et de la nature. Ses portraits sont exempts de tout schématisme; le dessin, le coloris et la recherche de la forme par des détails directement empruntés à la nature, y témoignent d'un net éloignement de la tradition de la peinture ecclésiastique, et attestent l'esprit laïque de l'oeuvre de ce maître de la peinture murale du XVIIIe siècle. Ses prédécesseurs, et notamment Onuphre, Nikolla, Kostandin Shpataraku ont, eux aussi, apporté à l'art de l'époque assez d'éléments réalistes, dont se sont inspirés des peintres postérieurs et David Selenicasi en particulier. Tels sont la tendance à puiser les sujets dans la nature et dans la vie réelle, une conception de la composition qui revêt parfois le caractère du genre véritable, la recherche dans les silhouettes, l'assemblement des personnages, l'élaboration réaliste des clairs-obscurs et de la forme, etc. Mais alors que les peintres antérieurs demeuraient tous plus ou moins fidèles aux exigences de la peinture ecclésiastique et à l'art byzantin, David Selenica, avec une conscience de véritable artiste, s'élève au-dessus de la conception traditionnelle du dessin et du coloris, et marque dans la composition une recherche de silhouettes types et du mouvement.

L'art de David Selenicasi est pénétré d'un caractère laique prononcé. Alors que la peinture traditionnelle ecclésiastique de l'époque s'attachait à créer pour la masse, un monde insaisissable, mystique et irréel, dépouillant la figure de l'homme des perceptions propres à la vie, de la forme, de la couleur, du volume et d'autres éléments vitaux, David, au contraire, s'applique à affirmer le plus possible ces éléments dans son oeuvre. Les autres peintres avaient jusque-là représenté le milieu et les autres éléments réalistes par l'emploi de certaines conventions, modèles stéréotypés reçus en héritage. David, au contraire, montre un intérêt particulier pour le cadre et son caractère, pour les détails, les plans et la perspective. Pour rendre la forme, les autres peintres ecclésiastiques avaient recours à la distribution des lumières et des ombres dans la mesure qui favorisait la construction de la figure, sans trop se soucier du naturel des effets de lumière. David, lui,

emploie le clair-obscur avec assez de maîtrise, il crée toujours une source de lumière naturelle, sans abuser des ombres et des effets, simplifie les clartés et les ombres et les limites dans la mesure qui permet de rendre clairement la forme tout en en préservant l'effet naturel.

L'inspiration vitale de l'art de David est déterminée par les circonstances dans lesquelles le peintre a vécu et oeuvré. On ne peut ne pas tenir compte du fait que son siècle est celui des grands mouvements progressistes, idéologiques et artistiques. Cette inspiration a pour fondement les idées avancées du siècle des lumières, qui eurent aussi leur effet sur la culture de la ville de Voskopoje. Ces facteurs positifs en même temps que l'essor culturel de la ville à cette époque, permirent à David Selenicasi de rendre avec talent cet esprit progressiste.

L'art de David, qui est marqué par ces facteurs, doit être compris non pas comme un phénomène détaché de son infrastructure et des circonstances qui l'entourèrent, mais comme le produit même de cette infrastructure et de ces circonstances, qui permirent une telle floraison artistique en un temps où la peinture ecclésiastique était en plein déclin.

DO NOT COPY

Emin RIZA

BANESA E FORTIFIKUAR GJIROKASTRITE

DO NOT COPY

Gjirokastra, në përgjithësi, ka ruajtur në gjendjen e sotme pamjen mesjetare. Elementi kryesor që formon qytetin është banesa, ajo përbën jo vetëm masën e kompozimit, por, me karakterin e saj të fortë monumental, krijon theksime të goditura brenda unitetit të larmishëm të krejt qytetit. Gjirokastra shquhet për një origjinalitet që shprehet si në tipin e banesës, ashtu dhe në pamjen e vetë qytetit. Në këtë punim bëhet një përpjekje për të dhënë karakteristikat e banesës së fortifikuar gjirokastrite, të zhvilluar si tip në kuadrin e banesës qytetare shqiptare.

Banesa e fortifikuar ka qenë dominuese në qytetin e Gjirokastrës deri nga fundi i shek. XIX. Ne do të ndjekim zhvillimin e saj kronologjikisht që prej shek. XVI e deri nga fundi i shek. XIX, kohë në të cilën banesa gjirokastrite humbet karakterin mbrojtës. Për periudhën deri në mesin e shek. XVII, do të përdorim si material kryesisht burimet e shkruara dhe rrugën retrospektive; ndërsa për periudhën e mëvonshme, sidomos për shek. e XIX, ne do të mbështetemi në banesa të shumta gjirokastrite. Ndonjë monografi për arkitekturën e banesës së fortifikuar gjirokastrite nuk është shkruar. Autorë të ndryshëm, kryesisht udhëtarë e studjues të huaj, si Çelebiu, Hani, Pukëvili, Shuflai etj., kanë vënë në dukje karakterin mbrojtës të banesës gjirokastrite, ndërsa Shuflai ka hedhur një tezë edhe mbi gjenezën e saj. Të dhënat e këtyre autorëve sidomos ato të Hanit, kanë vlerë, megjithëse ato duhen shoshitur me kujdes, ndërsa teza e Shuflait është aprioristike.

Gjirokastra si qytet dhe kështjellë përmendet që në fillim të shekullit XIV [1]). Mendojmë se që në fillim të shek. XV ka ekzistuar një lagje e vogël pranë kalasë, dhe pazari atje ku sot shtrihet lagja «Pazari i Vjetër», të cilën edhe Çelebiu, në mesin e shek. XVII, e quan pikërisht po kështu «Pazar i Vjetër» ose «Pazari i Kalasë».

Qyteti në fundin e shek. XVI kishte 380 banesa [2]) ndërsa në mesin e shek. XVII, simbas Çelebiut [3]), 2000 banesa; sado e fryrë të jetë kjo e dhënë, ajo tregon për një rritje të bujshme, që të shtyn të mendosh se kemi të bëjmë me popullimin e qytetit nga fshatarët e zonave malore të afërta. Në lidhje me këtë, të tërheqin vëmëndjen emrat e dy lagjeve që përmënd Çelebiu, Manalat dhe Dunavat, emra që kanë arritur deri në ditët tona. Prof. E. Çabej [4]) i vëren këta emra si gjurmë të jetës së dikurshme fisnore; ata janë shumësa kolektivë. Në Gjirokastër banesat e një gjinie i gjejmë shpesh të ndërtuara njëra pranë tjetrës.

Në gjendjen e sotme Gjirokastra ruan ansamble e madje lagje, që i përkasin periudhës prej fundit të shek. XVII e deri në mbarim të shek. XIX. Shumica e banesave që formojnë këto ansamble kanë tipare të theksuara mbrojtëse, që nuk i gjejmë kaq të spikatura në asnjë qytet tjetër shqiptar gjatë kësaj periudhe. Banesa e fortifikuar gjirokastrite, pavarësisht nga analogjitë me banesën e qyteteve të tjera shqiptare si Berati e Shkodra, ka një rrugë zhvillimi të sajën, prandaj dhe mund të flasim për banesën gjirokastrite në kuptimin e një tipi të veçantë të banesës qytetare.

---

1) **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** Vol. II, Tiranë 1962, dok. 91.
2) **Historia e Shqipërisë,** Vol. I. Tiranë 1959, fq. 344.
3) Evlija Çelebi, **Shqipnia para dy shekujsh,** (përkthim shqip) Tiranë 1930, fq. 33.
4) Eqrem Çabej, **Për gjenezën e Literaturës shqipe,** Shkodër 1939, fq. 22.

Banesën e fortifikuar gjirokastrite e gjejmë në varjante të ndryshme, që shprehin etapa në rrugën e zhvillimit të saj nga format e thjeshta në ato më të ndërlikuarat.

Banesat e vjetra gjirokastrite, që ende qëndrojnë në këmbë, janë të shumta: Në to gjejmë kryesisht banesën e fazave të fundit të evolucionit, por ruhen edhe ekzemplarë të fazave të para të tij, të cilat vërtet janë ndërtuar relativisht vonë, në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX, por përsërisin format e vjetra të trashëguara nga tradita, kështu që gjeneza dhe evolucioni i banesës gjirokastrite nuk është një problem i pazgjidhshëm.

Tipin, nga mendojmë se zuri fill procesi, që çoi në banesën e fortifikuar gjirokastrite të tipit të përkryer, e gjejmë qoftë si banesë të veçantë, më shumë në krye të lagjes Dunavat, popullsia e së cilës qe e lidhur me ekonominë bujqësore e blegtorale, qoftë si «oda jashta» siç quheshin anekset e banesave të mëdha gjirokastrite. (tab I)

Terreni i pjerrët ka influencuar në mënyrë të ndjeshme në kompozimin e banesës gjirokastrite që në tipin primar, i cili është vendosur normal me vijat rrushkulluese. Ky tip, të cilin Ark. G. Strazimiri [5]) e ka quajtur perpendikular, është një banesë e thjeshtë dykatëshe (sipas njehsimit popullor që do të përdorim edhe ne) e ndërtuar krejtësisht me mur guri. Katin e parë e zë katoi e më vonë stera. Nevoja për këtë rezervuar uji, që mbledh ujërat e rreshjevet, ka lindur nga mungesa e burimeve dhe nga pamundësia për të hapur puse. Çelebiu [6]) na informon se në kala çdo banesë kishte sterën e saj, ndërsa për banorët e qytetit thotë se nuk u mjaftonte uji dhe se e bartnin nga Drinosi. Nga kjo mund të mendojmë se stera përdorej në banesat gjirokastrite të paktën që në fillim të shek. XVII. Kati i dytë është shpesh me planimetri më të zgjeruar, mbasi terreni e lejon të shtrihet prapa. Një palë shkallë të jashtme guri të çojnë në katin e dytë, i cili, në fillim, ka qenë një ambient i vetëm, siç e gjejmë akoma sot. Më vonë kati i dytë pësoi transformime; ai u nda nga një rruginë në dy ambiente: në «dimëroren», që ishte ambienti kryesor i banesës e ku ndërtohej oxhaku, zakonisht në faqen fundore; aty gatuhet ushqimi, kalon ditën familja e flejnë pleqtë, dhe ambienti tjetër dhoma e miqve, «odaja e mirë». Ndërsa «dimërorja» merr dritë nga baxhaja, «odaja e mirë» ka zakonisht tri dritare në ballë, e shpesh nga një në dy faqet anësore që mbulohen me qemer guri.

Rrugina ndërlidhëse në faqen kundruall portës kryesore, gjithmonë një flegërshe, të çon në ambientin sanitar, i cili del në formë katërkëndëshi në njërin ball anësor. Çatia është me konstruksion druri dhe mbulohet me rasa guri. Ekzemplarë të këtij varianti ruhen në Gjirokastër (Tab I.). Këtë banesë nuk mund ta emërtojmë akoma banesë qytetare, ajo tregon se ka qenë banesë e fshatarëve të zonave malore të Shqipërisë së Jugut, që merreshin kryesisht me blegtori. Ajo edhe sot është akoma mjaft e përhapur.

Këtë banesë e gjejmë në Krujë [7]), gjithashtu dhe në Berat, sidomos në lagjen Goricë. Ajo shërbeu për formimin e tipit të banesës qytetare me çardak, që arriti përsosjen në shek. XVIII. Mendojmë se kjo banesë ka qenë e rëndomtë gjatë shek. XV dhe XVI, kur qytetet mesjetarë shqiptarë po dilnin jashtë mureve rrethuese dhe kur fshatarët e zonave të afërta malore filluan t'i popullojnë ato. Këta fshatarë prunë dhe banesën e tyre.

Hapi i parë në drejtim të zhvillimit të kësaj banese është ngritja e një kati. Formohet kështu varianti perpendikular trekatësh. Ngritjen e një kati, e diktoi nevoja për shtimin e ambienteve, por ky shtim nuk u bë si në Berat duke u shtrirë horizontalisht, por duke u ngritur në lartësi. Faktori kryesor, që çoi në këtë zgjidhje, mendojmë se qe synimi për ta bërë banesën një strehë të sigurtë mbrojtjeje. Arrijmë kështu në një ndarje të tillë të ambienteve sipas kateve: në të parin kemi sterën dhe katoin, në të dytin zhvillohet jeta e përditshme familjare, ndërsa në të tretin kemi dy dhoma, njëra prej të cilave është ajo e miqve. Ekzemplari i vetëm i këtij varianti gjendet në lagjen Palorto (Tab II). Këtë ndarje funksionale të ambienteve, sipas kateve, ne e vërejmë dhe në kullat e veriut. Kjo banesë, mendojmë, ka qenë e formuar nga fundi i shek. XVI, për këtë bën fjalë edhe një pasazh i Çelebiut, në të cilin shkruhet: «Në lagjen Memi Bej gjenden 150 shtëpi të forta. Qyteti i math shtrihesh mbi 8 lagje dhe lugina, atje ngriheshin me rradhë shtëpi shumëkatëshe me kulla» [8]). Përderisa këto banesa cilësohen shumëkatëshe. mendojmë se ato duhet të kenë qenë trekatëshe. Kemi pra bazë ta shtyjmë formimin e variantit perpendikular trekatësh deri në fundin e shek. XVI. Në pasazhin që cituam, gjejmë termin kullë, të cilin Çelebiu e përdor rëndomë për zonën rreth

5) G. Strazimiri, **Disa tipare të arkitekturës së qytetit të Beratit,** Konferenca e I-rë e studimeve albanologjike, Tiranë 1965, fq. 560.
6) E. Çelebiu, **Vep. cit.** fq. 31, 36.
7) K. Zheku, **Kulla kruetane,** Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, Vol. II, Tiranë, 1969.
8) **Bota Shqiptare,** fq. 515

Gjirokastrës, gjithashtu ai shkruan se në Delvinë çdo banesë kishte kullën e saj si vënd strehimi [9]). Rreth dy shekuj më vonë Hani shkruan: «Të gjitha shtëpijat e mëdha ndër qytete kishin nga përpara kulla të veçanta mu në mes të oborrit» [10]); më poshtë ai na kumton se kullat ndodheshin dhe ngjitur me banesën, e komunikonin me të nga çardaku ose dhoma [11]). Për mendimin tonë këto kulla, që populli i quan «kamerjè», kanë funksionin e mbrojtjes pasive; aty mbyllej familja në rastet e ndonjë rreziku jete, i cili, sigurisht, në një qytet nuk mund të zgjaste shumë. Në Gjirokastër akoma gjejmë dy lloje kamerjesh: të veçuara, dhe një me banesën. Ekzemplari i vetëm i veçuar që ka mbetur në lagjen Palorto (Tab. III), është një ndërtim i vogël dykatësh. Në katin e parë është ambienti i strehimit, që mbulohet me qemer guri; ai ndriçohet ose më saktë ajroset nga një dritare e vogël. Në katin e dytë, ku të çojnë shkallë të jashtme guri, duhet të ketë qenë dhoma e miqve, ashtu siç shkruan Hani: «Oda e miqve është në katin e sipërmë të kullës» [13]). Ekzemplarët e kamerjeve që janë një me banesën janë më të shumtë. Tipike është kamerjeja e banesës që paraqesim në lagjen Palorto (Tab III). Ajo zë vend në ballin e banesës e përbëhet nga dy ambiente me mure masive guri, të mbuluar me qemerë cilindrikë, gjithashtu guri. Këta dy ambiente lidhen, i pari me hajatin dhe i dyti me «nëndivanin», siç e quajnë vendasit ambientin nën çardak. Në katin e tretë kamerjeja mbetet taracë. Këto kamerje me karakter të theksuar të mbrojtjes pasive nuk kanë gjetur përhapje të gjerë në Gjirokastër; kjo shpjegohet me faktin se vetë banesa gjirokastrite është e fortifikuar dhe e aftë për të bërë të mundshme një mbrojtje aktive. Duke u nisur nga pohimi i Çelebiut [12]) mund të themi se kullat për mbrojtje pasive, kamerjetë, janë praktikuar në Gjirokastër të paktën që në fillim të shek. XVII, e kryesisht ato që formonin një njësi me banesën; ndërtimi i tyre, megjithëse ka vazhduar deri në fillim të shek. XIX, nuk duhet konsideruar tipik për banesën e fortifikuar gjirokastrite.

Në Gjirokastër ruhen akoma disa ndërtesa, që datojnë së paku që nga fundi i shek. XVIII e që janë kulla në kuptimin klasik të fjalës, d.m.th. kanë karakter mbrojtës aktiv dhe konfiguracion planimetrik katërkëndësh kënddrejtë. Tipike janë dy banesa të tilla në lagjet Palorto dhe Dunavat (Tab. IV). Këto tri kulla, për të cilat mendojmë se e kanë pasur jo-kryesor funksionin e banesës, nuk dallojnë në thelb nga varianti perpendikular trekatësh.

Që prej variantit perpendikular trekatësh, banesa gjirokastrite bëri një hap të rëndësishëm përpara me futjen e shkallëve brenda, fenomen që duhet spjeguar me forcimin e karakterit mbrojtës. Arrijmë kështu në embrionin e variantit «qoshe». Në këtë variant banesës gjirokastrite i shtohet çardaku, një element i lashtë panballkanik. Ai tashti bëhet i pranueshëm, sepse, duke qenë i mbrojtur anash dhe në lartësi të madhe, nuk cënon karakterin mbrojtës të banesës. Sot ruhen në Gjirokastër vetëm dy ekzemplarë të këtij varianti, njëri në lagjen Palorto (Tab. V) dhe tjetri në lagjen Varosh (Tab. V). Në këto banesa spikat qartë karakteri mbrojtës, planimetria kompakte dhe zhvillimi në lartësi i banesës. Ambientet ndërlidhës, që formohen në këtë variant, e pikërisht hajati, që quhet «nënëdivan»; divani i katit të dytë, që thirret «pati» dhe çardaku, të cilin banorët e emërtojnë «divani i sipërm», kanë funksione të rëndësishme në jetën e familjes, ata shërbejnë gjatë verës si vend qëndrimi, ngrënjeje dhe fjetjeje. Me zhvillimin e mëtejshëm në krahun e shkallëvet shtohen ambiente të tjera duke arritur kështu në variantin «qoshe» të plotë. Ky variant arrin përsosjen e tij në banesën që paraqesim e që ndodhet në lagjen Dunavat (Tab. IX). Varianti qoshe është më i përhapuri i banesës së fortifikuar gjirokastrite. Në Gjirokastër takojmë dhe një lloj tjetër të variantit qoshe, i cili dallon nga dy karakteristika: shkallët vazhdojnë të jenë të jashtme dhe dy krahët e qosheve kanë numur jo të barabartë katesh; krahu ballor, është trekatësh ndërsa tjetri dykatësh. Ekzemplar tipik është një banesë në lagjen Palorto (Tab. VII). Embrioni i variantit qoshe u zhvillua dhe në drejtim tjetër duke na dhënë variantin e thjeshtë divitli, i cili formohet duke i shtuar embrionit të variantit qoshe një krah, që është në fakt varianti perpendikular trekatësh. Varianti i thjeshtë divitli është ndërtuar dhe me shkallë të jashtme, siç e gjejmë në një banesë në lagjen Teqe (Tab. VII); kurse zakonisht ai ndërtohet me shkallë të brendshme. Banesa në lagjen Palorto që paraqesim (Tab. VI), një nga më të goditurat e banesave gjirokastrite, është një fazë e ndërmjetme, që çoi te varianti i përkryer divitli, i cili është më i zhvilluari i banesës së fortifikuar gjirokastrite.

Banesa në lagjen Palorto (Tab. VIII), që sot është kthyer në muze etnografik, është një shembull tipik

9) E. Çelebiu, **Vep. cit,** fq. 22.
10) J.G. Hahn, **Albanesische studien** Jena 1854, vol. I, fq. 170.
11) J. G. Hahn, **Vep. cit.** fq. 170.
12) **Bota Shqiptare,** fq. 515.
13) J.G. Hahn. **Vep. cit.** fq. 170.

BOTIMET SHQIPTARE

i variantit divitli. Mundësitë e jashtëzakonshme që krijonte varianti divitli për zgjidhjen e problemeve të kompozimit planimetriko-hapësinor të banesës, i gjejmë në «sarajet» e Nelo Kabilit, emërtim ky që nuk është ndonjë egzagjerim i madh. Me përmasa të mëdha, me karakterin e theksuar monumental dhe pasurinë e madhe të ornamentikës, sarajet e Nelo Kabilit, ndërtuar rreth vitit 1813, janë fakt bindës i nivelit të lartë, që arriti në zhvillimin e saj banesa gjirokastrite. Duke u bazuar në mjaft banesa të datuara, ne mund të pohojmë se mesi i shek. XVIII është kufiri më pak i shtyrë, në të cilin variantet divitli dhe qoshe janë të formuar.

Ne ndoqëm zhvillimin e banesës gjirokastrite, që prej banesës dykatëshe perpendikulare, të cilën e gjejmë të rëndomtë në zonat malore të Shqipërisë së Jugut; atë e hasim edhe në Shqipërinë e Mesme, ndërsa për Shqipërinë e Veriut nuk mund të themi asgjë të saktë për mungesë materialesh. Kjo banesë fshatare, mbi të cilën me kohë u ndërtuan të gjitha variantet e banesës gjirokastrite, simbas nesh, duhet të ketë ardhur e tillë në Gjirokastër që në shek. e XV dhe XVI. Evolucioni i natyrshëm i saj lindi një banesë qytetare me shumë mbeturina të banesës fshatare, sepse Gjirokastra, më shumë se çdo qytet tjetër shqiptar deri nga mesi i shek. XIX, qe e lidhur me ekonominë bujqësore e blegtorale.

Po japim tashti një përshkrim të banesës së fortifikuar gjirokastrite.

Muret rrethuese. Banesa e fortifikuar gjirokastrite është e rrethuar gjithmonë me mure, por shpesh një ose dy faqe të banesës kufizohen direkt me rrugën. Muret ndërtohen me gur të thatë ose lidhen me llaç, në shumë raste ato forcohen me kontraforte. Porta e hyrjes, dyflegërshe, me lëndë lisi, mbulohet me hark 1/2 rrethor mbi të cilin ndërtohet çatia, që mbulon portën. Pothuajse gjithmonë anash portës ndërtohen frengji për mbrojtjen e hyrjes. Brenda mureve rrethuese shtrihet oborri i banesës; në disa banesa gjejmë dy, kurse në banesën e Zekatëve tri oborre. Këto oborre komunikojnë me dyer me njëri tjetrin. Dhe Hani e ka vërejtur këtë fakt në Gjirokastër [14]). Kjo shfaqje mendojmë se shpjegohet me funksionin mbrojtës të tyre.

Oda jashta (Zapanaja). Është një ndërtim i veçantë nga banesa, që vendoset në oborr. Nëse ka dy të tillë, ajo ndërtohet në oborrin e parë. Oda jashta shërbente, sipas pozitës shoqërore të pronarit të banesës, si vënd qëndrim për trimat, shërbyesit, miqtë e dorës së dytë, etj. Oda jashta në shumë raste pajisej me stallë. Oda jashtat ndërtoheshin një ose dykatëshe.

Nën-divani (hajati). Ky ambient komunikon me oborrin nëpërmjet portës së vetme të banesës, gjithmonë një flegërshe, që sigurohet, qoftë portë e jashtme apo e brendshme me «katarah», element që e gjejmë në mbarë Shqipërinë. Zakonisht në nën-divan ndodhet muslluku i sterës, por ka edhe raste që ai vendoset në muret e jashtme të banesës, ose, të tillë ka brenda e jashtë. Nën-divani ndriçohet nga dritare shumë të vogla në formë frengjie, të vendosura në pjesën e sipërme të tij. Porta e banesës mbrohet me frengji.

Katoi. Ky ambient shërben për depo ushqimesh e lëndësh djegëse, ka ndriçim të pakët dhe paiset shpesh me frengji. Banesa ka deri më tri ambiente të tillë.

Stera. Është një element i zakonshëm i banesës gjirokastrite. Ajo mbulohet gjithmonë me qemer guri dhe suvatohet me llaç të papërshkueshëm nga uji.

Divani i katit të dytë ka kryesisht funksionin ndërlidhës. Ai ndriçohet më mirë se nëndivani.

Oda. Të tilla gjejmë në katin e dytë dhe të tretë. Kur ato ndodhen në katin e dytë quhen «oda e dimërit», «dimërorja» ose «pati», siç thirret zakonisht kati i dytë. Plani i dhomës është këndrejtë. Në fundin e dhomës ndërtohet mafili, i cili krijon një paradhomë që komunikon me ambientet sanitare. Mafili ndërtohet krejtësisht në dru. Ai ndahet në lartësi në dy pjesë: në të poshtmen, «musandranë», të paisur me dollapë dhe në të sipërmen, zakonisht të mbyllur në ballë e që shërben si depo shtrojesh. Oda ka gjithmonë oxhak me vatër «gjirmë» të shtruar me pllaka guri. Në ballin e dhomës zakonisht ndërtohen tre dritare, shpesh në dy faqet anësore ndërtohet edhe nga një ose dy të tilla. Dritaret mbrohen nga kafaze hekuri dhe deri nga fundi i shek. XIX mbylleshin me kanate druri. Oda ka në mure shumë kamare e dollapë.

Çardaku ose divani, siç e quajnë banorët, nuk ka funksionin e dorës së parë që ka në banesën e Beratit, të Shkodrës, të Elbasanit etj. ku shërbente si vend

14) J.G. Hahn, **Vep. cit.,** fq. 41 «Oborrin e rrethojnë mure të lartë dhe të fortë dhe portat e rënda, zakonisht dyfishe, e para të çon në një oborr të vogël, porta e brendëshme është vendosur në mënyrë që nga rruga nuk mund të shihet oborri i dytë».

për përpunimin e produkteve bujqësore dhe të punimeve artizanale. Çardaku, i cili do të ketë hyrë në banesën gjirokastrite nga mesi i shek. XVII, e ndjek atë deri nga gjysma e shek. XIX, kur ai nuk ndërtohet më dhe fillon të mbyllet në banesat ku ekzistonte. Në ballin e çardakut vendosen shtylla druri, shpesh të veshura me dërrasa të holla, që formojnë harqe në çdo hapësirë.

Oda e mirë. Është ambienti më i pasur i banesës. Planimetria e saj nuk dallon nga ajo e dhomave të tjera. Mafili zbukurohet me gdhendje. Ai që prej mesit të shek. XIX fillon të humbasë funksionin e tij dhe ndërtohet me çatma të mbyllur deri në tavan. Në të vendosen zakonisht një kamare e dy dollapë. Oda e mirë, në banesat e mëdha, ndahet në dy pjesë: në kreun e dhomës, me tavan të veçantë dhe dysheme më të ngritur, në ballin prej çatmaje të së cilës ndërtohen tre dritare të mëdha e shpesh mbi to ndërtohen tri të tjera fikse prej një skeleti allçije. Në dy muret anësore, pranë tyre, ndërtohen një ose dy dritare. Pjesa tjetër e dhomës ka gjithashtu tavanin e saj Oxhaku ndërtohet në faqen e djathtë të mafilit. Ai zbukurohet me dekorime të shumta allçije, e nuk funksionon, por është element dekorativ. Sergjenë në nivelin e dritareve të ballit rrethojnë të katër faqet e dhomës. Në disa banesa pjesa e mureve mbi sergjen pikturohet me ornamente florealë. Tavani zbukurohet gjithmonë me gdhëndje e në disa raste dhe pikturohet.

Ambientet sanitare. Çdo dhomë gjumi është e paisur me ambiente sanitare. Zakonisht, çdo njëri nga këta ambiente përmban WC dhe banjën. Ambientet sanitare vendosen ose brenda konturit të mureve anësore të banesës ose dalin në formë pirgu anash tyre, e janë paisur gjithmonë me frengji, ndërsa dritaret mungojnë. Këto frengji nuk duhen shpjeguar vetëm me karakterin mbrojtës por dhe me karakterin e vet këtyre ambienteve.

Sot në Gjirokastër ruhen shumë pak furra të ndërtuara brenda banesës, por më parë ky duhet të ketë qenë një element i rëndomtë i banesës gjirokastrite. Ka të dhëna se ato ndërtoheshin edhe jashtë banesës, në oborr.

Veçantia themelore, që e dallon banesën gjirokastrite nga banesa qytetare e Beratit dhe e Shkodrës, është karakteri i theksuar mbrojtës i saj; ajo është banesë e fortifikuar. Banesat gjirokastrite janë të vendosura veçuar nga njëra tjetra, duke synuar që të zënë vende sa më zotëruese. Pukëvili shkruan «banesat e paisura me frengji, sa më të paarritëshme të jenë, aq më të lartë e kanë çmimin» [15]).

Muret rrethuese të banesës gjirokastrite, që sipas Pukëvilit paiseshin disa herë me bedena dhe kullëza, e sidomos oborret dyfishe, që hasim shpesh, kanë funksione të dallueshme mbrojtëse. Frengjitë i gjejmë sidomos në portat e hyrjes për në oborr, në vetë banesën, në ambientet sanitare ose në katoje si dhe në pjesën e sprasme të banesës. Banesa gjirokastrite tregon qartë se si, duke kaluar nga kati i parë në të tretin, masat siguruese sa vijnë e zbehen, për të kaluar nga frengjitë e dritaret shumë të vogla të katit të parë, në dritaret e mëdha e çardakun e katit të tretë. Në faqen e sprasme të banesës, e cila, duke qenë pranë tokës, për shkak të terrenit të pjerrët, është më e lehtë për t'u sulmuar, zakonisht në vend të dritareve ka vetëm frengji dhe strehë të gurta, për të mënjanuar eventualitetin e vënies së zjarrit. Shkallët e brendshme tregojnë, gjithashtu, se preokupimi për mbrojtje ka qenë arësyeja kryesore e kësaj zgjidhjeje. Nga sa u tha mendojmë se synimi për mbrojtje ka qenë shkaku kryesor, që ka diktuar zhvillimin në lartësi të banesës gjirokastrite ndërsa terreni, faktor i dorës së dytë. Dhe vërtet në Berat, ku terreni është i ngjashëm, banesa nuk e kalon dykatëshin. Gjithashtu dhe kontrasti i theksuar në mes brendësisë së ngrohtë e plot dekore të banesës gjirokastrite dhe pamjes së jashtme të ftohtë, e të ashpër, duhet shpjeguar me karakterin mbrojtës të saj, megjithëse kjo çfaqje është, deri në një farë mase, karakteristike për mbarë banesën qytetare shqiptare.

Ndërtimi krejt me gurë i banesës në të tre katët e bën atë të aftë për t'u rezistuar goditjeve me armë zjarri; e paisur me rezerva ushqimore dhe ujë, ajo mund t'i bëjë ballë rrethimit. Banesa gjirokastrite është banesë qytetare, por ruan edhe disa elemente të banesës fshatare, nga e cila zuri fill. Të bien në sy qemerët gjysëm rrethorë, që mbulojnë dyert e brendshme të katit të parë e të dytë, të cilat ne i shpjegojmë si refleks të tipit fillestar, në të cilin këto dyer ishin të jashtme, shkallët e rënda prej guri, përdorimi i «katarahut» për sigurimin e dyerve të brendshme etj...

Diferencimi i kateve me funksione të përcaktuara qartë dhe trajtimi arkitektonik i tyre, në përputhje me këto funksione, i arritur që në variantin perpendikular trekatësh, mbeti një tipar i rëndësishëm i banesës gjirokastrite. Në zgjidhjet konkrete planimetriko-volumore të banesave gjejmë një liri të gjerë veprimi. Terreni i thyer është shfrytëzuar me mjeshtëri për të shtuar sipërfaqen e banimit në katin e sipërm, duke

15) F.C.H.L. Pouqueville, **Voyage de la Grèce,** Tome I. fq. 339, Paris 1820

ZYRTARE

krijuar konture të ndërlikuara planimetrike e, në disa raste, duke ndërtuar, në të njëjtën banesë, bloqe me diferencë prej një kati. Banesa gjirokastrite, një ndërtim masiv guri, dallohet për volumet e mëdha të ambienteve. Pamja e jashtme shquan për thjeshtësi, lakonizëm dhe monumentalitet. Megjithatë pamja kryesore ka një përpunim më të madh se pamjet anësore, krejt të zhveshura dhe të ashpra. Ajo zakonisht ndahet në dy pjesë nga një kornizë guri në nivelin e dyshemesë së katit të tretë. Pjesa e poshtme formohet nga masa e ftohtë e muraturës së gurtë, që në mënyrë ritmike vjen e thyhet nga dritaret e harkuara, që shtohen e zmadhohen duke ju afruar kornizës. Pjesa e sipërme e suvatuar, ka dritare të shumta e pajante piktoreske, që mbajnë strehët e gjera, këndet e të cilave janë të harkuara. Në disa banesa balli i katit të tretë dhe faqet pranë çardakut janë zbukuruar me piktura murale që paraqesin kafshë ose ornamente florealë.

Gjatë evolucionit të saj tiparet themelore të banesës gjirokastrite: karakteri mbrojtës, diferencimi funksional sipas kateve, zhvillimi në lartësi i banesës e teknika e ndërtimit, mbetën të pandryshuar, pra variantet e saj zhvillohen duke pësuar ndryshime sasiore e jo cilësore. Ky evolucion është një argument i mjaftueshëm për të provuar karakterin kombëtar të këtij tipi banese.

Karakterin mbrojtës të banesës gjirokastrite e kanë vënë re mjaft autorë. Hani [16]) dhe Shuflai [17]) duke qenë të një mendimi e përgjasojnë atë me kështjellat qytetare të kohës së mesme në perëndim. Autori bullgar B. Kolev [18]) shkruan se banesat gjirokastrite duken si kulla mesjetare. Zh. Burkarti [19]) dhe L. Reji [20]) e emërtojnë «kullë», L. Ugolini [21]) «pothuaj fortesëzë», ndërsa Rrok Zojzi [22]) «kullë qytetare». Ne na duket më i saktë emërtimi «kullë qytetare», duke nënkuptuar me këtë banesën e fortifikuar. Ndërsa në Gjirokastër zuri vend kulla qytetare, në Berat, Elbasan e Shkodër, qendra të përmendura zejtaro-tregëtare, jo më vonë se mesi i shek. XVIII formohet tipi i zhvilluar i banesës qytetare me çardak, e cila nuk ka karakter mbrojtës dhe zhvillohet horizontalisht. Me gjithë këto ndryshime themelore, ne vërejmë se tipet e zhvilluara të banesës gjirokastrite kanë afrim në konceptin kompozicional me ato të Beratit e të Shkodrës, por këto analogji duhen parë e shpjeguar me kujdes duke pasur parasysh evolucionin e veçantë të banesave gjirokastrite si dhe të atyre të Beratit e të Shkodrës dhe duke u ruajtur nga konkluzioni i pabazuar se këtu kemi të bëjmë me një tip banese. Në elementët e veçantë arkitektoniko-konstruktivë të banesës gjirokastrite dhe në ata të qyteteve të lartpërmendur gjejmë shumë paralele. Banesa të fortifikuara me kompozicion të zhvilluar ka pasur jo vetëm në Gjirokastër, por edhe në shumë zona të Shqipërisë së Jugut, në Labëri (Kardhiq, Golem), Lunxhëri, Gorë (Moglicë), Libohovë etj. Banesa gjirokastrite mund të quhet stadi më i lartë i banesës mbrojtëse, e cila ndërtohej në të kaluarën në pjesën dërmuese të zonave të banuara nga shqiptarët. Shuflai hodhi tezën se banesat gjirokastrite, që ai i quan kulla, kanë influencë perëndimore dhe se djepi i kullave të Ballkanit ka qenë Shqipëria e Jugut, Epiri i vjetër dhe principata e Ahesë, sepse këtu ato u përhapën prej sundimtarëve latinë [23]). Këtë mendim e pranon edhe Nopça për Shqipërinë e Jugut [24]). Kjo tezë e Shuflait është aprioristike, sepse nuk niset nga analiza konkrete e materialit dhe është e gabuar, sepse mbështetet në teorinë e importimit, si e këtillë ajo nuk u qëndron dot fakteve që parashtruam më sipër, të cilët provojnë se në banesën gjirokastrite kemi një vetëzhvillim të kushtëzuar e të nxitur nga kushtet ekonomiko-shoqërore dhe të realizuar nga mjeshtrit shqiptarë me tradita të lashta ndërtimi.

Shkaqet ekonomiko-shoqërore, që kushtëzuan zhvillimin e banesës së fortifikuar gjirokastrite, duhen kërkuar në këta faktorë: Gjirokastra, ndryshe nga Berati, Elbasani e Shkodra, qendra të njohura zejtaro-tregëtare, pra prodhuese, ishte deri vonë në mesin e shek. XIX qendër administrative dhe shkëmbimi. Në Gjirokastër kishin zënë vend pronarë tokash të kthyera në çifliqe, duke filluar prej fillimit të shek. XVII, kur u duk për herë të parë në Shqipëri sistemi i çiflikut [25]),

16) J.G. Hahn, **Vep. cit.** fq. 41.
17) M. Sufflay. **Stadte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des mittelalters,** Wien und Leipzig 1924, fq. 33
18) B. Kolev, **Za njakoj vrzki na arbanashkata keshça ot minalloto s Allbanaskata arkitekture,** në Izvestia na instituta Po gradoustistvo i arkitektura Kniga X i XI. Sofia 1957, fq. 83-84.
19) Jacques Bourcart, **«L'Albanie et les Albanais»,** Paris 1921, fq. 222.
20) Léon Rey, **Guide de l'Albanie,** Paris 1930, fq. 146-147.
21) L.M. Ugolini, **Albania Antica,** Roma 1927, fq. 122.
22) Rr. Zojzi, **Cikël leksionesh për shoqëruesit e turistave,** Tiranë 1957.
23) M. Šufflay. **Vep. cit.** fq. 33.
24) F. Nopcsa, **Shpia e bulkut në Shqypnie të Veriut,** Rev. «Djalëria» Nr. 6. viti 1920.
25) Stavri Naçe, **Çeshtje të çifligut feudal në Shqipëri në shek. XVII e XVIII,** Buletini U.SH.T. Seria Shkenca Shoqërore Nr. 3, 1960, fq. 99.

BOTIMI I PARË

për t'u bërë mbizotërues në shek. XVIII [26]). Gjithashtu, rrugën e pasurimit, feudalët e vegjël gjirokastritë e gjetën dhe duke marrë në sipërmarrje taksat shtetërore, doganat e monopolet, siç na kumton Hani [27]). Dhe pjesëmarrja në luftrat e shpeshta të perandorisë turke ju siguronte atyre të ardhura. Kjo shtresë feudalësh të vegjël e të mesëm (këtë e provon banesa e tyre, e cila nuk u shkëput aspak nga traditat vendase, por u zhvillua mbi këtë bazë), që përbënte një pjesë të mirë të banorëve të qytetit, kishte, gjithashtu, dhe funksione shtetërore, që i ushtronte në vise të largëta të perandorisë turke [28]).

Anarkia feudale, armiqësitë në mes të feudalëve gjirokastritë, që bazohen në rivalitetin e interesave ekonomike, kishin krijuar një gjendje kaotike e pasigurie në qytet. Për këtë Pukëvili shkruan: «Shtëpitë janë si kala dhe kanë rreth e rrotull mazgalle. Këta njerës rrojnë gjithënjë në luftë» [29]). Ndërsa Hani: «Në kohë grindjesh, kur ziheshin haptas shoq me shoq partitë e qytetit, sejcili ruante shtëpinë me njerzit e tij dhe, mbas mureve të saj, harxhonte kot shumë barot kundër shtëpijave armike» [30]). Sado të ekzagjeruara këto pohime tregojnë për gjendjen e pasigurtë në qytet. Por, megjithë kontradiktat me njëri tjetrin, feudalët gjirokastritë, duke përfituar nga anarkia feudale dhe nga dobësimi i centralizmit të pushtetit turk, kishin fituar një farë pavarësie dhe, kur ishte çështja për ta ruajtur atë, «atëhere luftimet private pushonin, grupet kundërshtare bashkoheshin, kur e kërkonin interesat e qytetit», siç shkruan Hani, i cili, duke vënë në dukje karakterin e veçantë të qytetit të Gjirokastrës, arrin deri në cilësimin e saj (të Gjirokastrës), në një lloj republike aristokratike, feudalët e së cilës i bindeshin deri diku pashait të Delvinës dhe, nëse ai nuk kishte pasuri e zotësi, «nuk çante njeri kokën për të dhe ata jetonin ashtu si u pëlqente» [31]). Që Gjirokastra kishte siguruar vërtet një pozitë të privilegjuar, e provon dhe rezistenca e saj kundër Ali Pashë Tepelenës, i cili vetëm me forcë mundi ta fusë në dorë më 1812.

Në Gjirokastër mungesa e sigurisë vinte jo vetëm nga grindjet e brendshme, por dhe nga bandat e feudalëve ushtarakë të deklasuar [32]). Në kondita të tilla nuk kish sesi të zhvillohej zejtaria e tregëtia, sepse mungonte sigurimi i personit të tregëtarit dhe i pronës së tij, që, siç shkruan Engelsi, është kusht i parë themelor i fitimit borgjez [33]).

Por edhe momenti klasor ka një ndikim të theksuar në karakterin mbrojtës të banesës gjirokastrite. Duke jetuar me shfrytëzimin e fshatarëve dhe të shtresave të varfëra të qytetit, feudalët e Gjirokastrës e ndjenin rrezikun e revoltës popullore. Shumë qartë këtë ne e shohim në kullat e feudalëve gjirokastritë, të ndërtuara në fshatrat çifliqe, ekzemplarë të shumtë të të cilave gjenden akoma në fshatin Goranxi. Lëvizja e gjerë klasore e «hajdutëve» në Shqipërinë e Jugut ishte një kërcënim i përhershëm për Gjirokastrën. Së fundi duhet theksuar dhe ekzistenca e institucionit të gjakmarrjes në qytet. Fakti që Ali Pashë Tepelena u përpoq për heqjen e gjakmarrjes, e cila mbas 1812-tës u pakësua në mënyrë të ndjeshme në Shqipërinë e Jugut [34]), provon se deri në shek. XIX gjakmarrja ishte e përhapur.

Ndërtimet në Gjirokastër janë vepër e mjeshtërve shqiptarë, që e trashëgonin profesionin brez pas brezi. Ata banonin në rrethin e Kolonjës në fshatrat: Panarit, Treskë, Trebickë, Orgockë, Grabockë, Stratobërdh, Luaras, Koblarë, Miçan etj. Këta mjeshtra organizoheshin në grupe, nën udhëheqjen e një kryemjeshtri. Hani, duke folur për ta, shkruan: «Ata që bëjnë mure në Turqinë Evropiane, presin dru ose sharrojnë dërrasa, janë që të gjithë nga Shqipëria» [35]). Autori bullgar M. Biçev [36]) i përmënd gurgdhëndësit shqiptarë, ndërsa autorja greke A. Haxhimihaili [37]), duke folur për mjeshtrit, që ndërtuan banesat e Greqisë së Veriut, përmend edhe ata të rretheve të Korçës. Mjeshtrit e rretheve të Korçës, që ndërtuan Gjirokastrën, janë njohës të thellë të gurit e të drurit. Realizimet e shquara teknike dhe ndjenja e hollë estetike e mjesh-

DOKTORATURA

26) **Po aty,** fq. 111.
27) G. Hahn, **Vep. cit.** fq. 41.
28) **Historia e Shqipërisë,** Vol. I, Tiranë 1959, fq. 431-432.
29) **Bota Shqiptare**
30) G. Hahn, **Vep. cit,** fq. 41
31) G. Hahn, **Vep. cit,** fq. 52
32) A. Buda, **Vëndi i shqiptarëve në historinë europiane të shek. VIII-XVIII.** Studime historike Nr. 1, 1967, fq. 18-19.
33) K. Marks, F. Engels, **Veprat,** vol. XVI, pjesa II, fq. 22.
34) Ismet Elezi, **Sur la vendetta en Albanie** «Studia Albanica», Nr. 1, 1966, fq. 315.
35) G. Hahn, **Vep. cit.,** fq. 43.
36) M. Biçev, **Arkitektura Bollgari** 1961, fq. 75.
37) A. Haxhimihaili, **La maison grecque,** 1949.

tërve kolonjarë, që i gjejmë në ndërtimet e Gjirokastrës, na bindin se ata kishin grumbulluar një përvojë shumëshekullore.

Duke vështruar banesën gjirokastrite në raport me atë të popujve të tjerë të Ballkanit, ne nuk mohojmë influencat reciproke, sepse, siç dihet, popujt japin e marrin. Por, duke qenë se studimet e banesës ballkanike nuk janë shtrirë as thelluar sa duhet, ky problem mbetet mjaft i diskutueshëm. Megjithkëtë ne mund të shprehim disa mendime.

Siç dihet nga trashëgimia e banesës bizantine, pothuaj nuk mbeti asgjë. Ato thërrime, që mblodhi L. Beili [38]), nuk mund të japin një kuadër të qartë të saj. Megjithatë i saktë duhet të jetë mendimi se, në banesën qytetare bizantine, ambientet e banimit vendoseshin rreth një salle qendrore. Pra, në konceptin kompozicional nuk kemi gjë të përbashkët me banesën gjirokastrite. Ndikimet turko-orientale mendojmë se kanë lënë gjurmë kryesisht në orendimin e brendshëm, si dhe në ambientet sanitare për çdo dhomë gjumi, ndërsa, ndarjen karakteristike të banesës turke në haremllëk dhe selamllëk [39]), nuk e gjejmë në Gjirokastër. Nga punimi i autorit grek Orlandos [40]) mbi banesat e Mistrës, vërejmë se në disa elementë arkitektoniko-konstruktivë kemi paralele me banesën gjirokastrite, për shembull: shkallët e jashtme prej guri të mbështetur mbi qemerë 1/2 e 1/4 rrethorë, në harqet 1/2 rrethorë, që mbulojnë dyert e dritaret etj. . Këto paralele i gjejmë dhe në banesën borgjeze të Greqisë së Veriut, të përshkruar nga A. Haxhimihaili [41]). Në një botim të po kësaj autorje [42]) mbi banesën aristokratike të Trikerit shohim paralele të shënuara me banesën gjirokastrite, por edhe dallime të rëndësishme, siç janë ndërtimi në banesat e Trikerit i katit të tretë me skelet druri dhe përdorimi i erkerve. Harqet 1/2 rrethore, të përdorura gjerësisht në Gjirokastër, për të mbuluar dyert e dritaret i gjejmë edhe në fshatin Arbanas në Bullgari [43]). Autori rumun P. Stahl [44]) e përmend funksionin e kullës si vend të sigurtë për ruajtjen e pasurisë dhe si vend strehimi në periudha të turbullta, duke qenë një pjesë ndihmëse e banesës. Ai na kumton se të tilla kulla ka pasur në Vllahi. Këto, për nga funksioni janë, të njëjta me «kamerjetë» e Gjirokastrës. Si konkluzion mund të themi se banesa gjirokastrite zë një pozitë të veçantë në arkitekturën e banesës ballkanike.

Autori grek G. Mega në librin e tij «Banesa greke» [45]) ka bërë një përpjekje për të parë banesën greke në raport me atë të popujve të tjerë ballkanikë. Ky autor trajton në një kapitull të veçantë dhe banesën shqiptare, duke u bazuar kryesisht te Nopça. Ai me qëllim nuk merr në konsiderim punimet e M. Urbanit [46]) mbi vend-banimet e Shqipërisë së Jugut, duke pohuar që në krye se: «Zona në jugë të gjiut të Vlorës deri në kufirin grek është e Vorio-Epirit dhe teknika e ndërtimit thjesht greke». Ky autor arrin në përfundimin se të gjitha banesat e zhvilluara shqiptare, qoftë ato me çardak, qoftë kullat, janë të importuara; bartësit e këtij importimi qenë mjeshtrit epirotë, sipas G. Megas, pa dyshim grekër. Për ta bërë më të besueshëm këtë pohim G. Mega citon një mendim të E. Vlorës [47]), hedhur pa kurrfarë përgjegjësie, nga mosnjohja e materialit, se banesat shqiptare nuk janë origjinale.

Punimi i G. Megas, në pjesët që kanë lidhje me banesën shqiptare, nuk sjell asgjë të re; ai, pothuaj, riprodhon Nopçën ad literam. Por, siç dihet, Nopça njohu vetëm banesën e një zone të Shqipërisë së Veriut dhe punimi i tij nuk mund të quhet sintetizues. Pra G. Mega njeh vetëm një pjesë të vogël të bane-

38) L. de Beylie, **L'Habitation byzantine,** 1902.
39) Ulya Vogt-Goknil, **Architettura Ottomana,** Milano, 1965.
40) A.K. Orlandos, Ta astika tu Mistra Arheion ton Vizantinon mnimion tis Elladhos Tomos 1937, Athinai.
41) A. Hadjimihaili, **Vep. cit.**
42) A. Hadjimihaili, **Art populaire grec,** Athènes 1931.
43) G. Kozhuharov, **Bellgarska Keshça prez pet Stoletija,** Sofia 1967.
44) P.H. Stahl, **Les vieilles maissons à étage de Roumanie,** në Revue des Etudes, Sud-est européennes, tome II, 1964, Nr. 3-4. fq. 545.
45) Georgiu A. Mega, **I Eleniqi Iqia,** Athinë 1949.
46) M. Urban, **Die siedlungen Süd-Albaniens.**
47) Vlora Ek., **Aus Berat und von Tomor,** Sarajevo 1911.

DO NOT COPY

sës shqiptare. Pohimet e tij mbi karakterin grek të ndërtimeve, në të ashtuquajturin Vorio-Epir, duheshin provuar. Teoria e importimit, të cilën ai e vë në bazë të gjykimeve të tij, që as formalisht nuk janë konkluzione, është pa baza. Lindja e një tipi banese nuk mund të bëhet në mënyrë mekanike nëpërmjet një huajtjeje të thjeshtë, sepse banesa, më fort se çdo kategori tjetër e arkitekturës, është pasqyrim kushtesh ekonomiko-shoqërore në rradhë të parë.

Banesa e fortifikuar gjirokastrite, një nga kulmet e banesës mbrojtëse, aq e përhapur në Shqipëri, siç parashtruam, i ka rrënjët në truallin tonë. E realizuar nga shqiptarë për shqiptarët, ajo është një provë më shumë se sa të pa bazuara, metodologjikisht të gabuara, e plot paragjykime, janë sentencat e autorit në fjalë në lidhje me banesën shqiptare.

DO NOT COPY

TAB. I



PAMJE KRYESORE

ODAJASHTA NE LAGJEN MANALAT

Rr. STALINGRAD Nr 52



DO NOT COPY



BANESE NE LAGJEN PALORTO

Rr PERTEF JAUPI Nr 22



BANESE NE LAGJEN PALORTO
Rr SADIK MANE Nr5



PAMJE KRYESORE



KATI I^RE



KATI II^TE



PAMJE NGA LINDJA



KATI III^TE

0 1 2 3 4m

DO NOT COPY

TAB. III

KAMERJE NE LAGJEN PALORTO
Rr PANO XHIXHO Nr6



0 1 2M

PAMJE KRYESORE



KATI IRE



PRERJE AA

0 1 2 3M

BANESE NE LAGJEN PALORTO
Rr MUHAMET BAKIRI Nr4



PAMJE KRYESORE

KATI IITE

0 2 4 6M



DO NOT COPY

BANESE NE LAGJEN PALORTO
Rr PERTEF KOKONA Nr45



PAMJE KRYESORE



KATI I^RE



KATI III^TE



BANESE NE LAGJEN DUNAVAT
Rr JAÇE BRAJA Nr10



PAMJE KRYESORE



KATI II^TE



KATI I^RE



KATI III^TE

DO NOT COPY

TAB. V

BANESË NË LAGJEN PALORTO

Rr. ASTRIT TOTO Nr 20





PAMJE KRYESORE

BANESE NE LAGJEN VAROSH

Rr. KOÇO BACO Nr 17



PAMJE KRYESORE



DO NOT COPY

BANESË E ZEKATEVE NË LAGJEN PALORTO







KATI I RE



KATI III TE



KATI IV TE

0 2 4M

DO NOT COPY

BANESE NE LAGJEN PALORTO
Rr. BUKURIE BOZO Nr 29





RIKONSTRUKSIONI I BANESES NE LAGJEN TEQE
Rr. MYFIT HEBI Nr 46





DO NOT COPY

MUZEU ETNOGRAFIK NE LAGJEN PALORTO



PAMJE KRYESORE



KATI I I^RE



KATI I II^TE





KATI I III^TE

0 4 8 M

DO NOT COPY



BANESE NE LAGJEN DUNAVA
Rr. MYFIT RESO Nr 19



KATI I-rë



KATI II-të



0 2 4 m.

KATI III-të

DO NOT COPY

Emin RIZA

L'HABITATION FORTIFIEE de GJIROKASTËR

RESUME

Cette étude a pour objet de définir les caractéristiques de l habitation fortifiée de Gjirokastër, considérée comme un type particulier dans le cadre de l'habitation urbaine albanaise. Nous allons en suivre chronologiquement le développement depuis le XVIe siècle jusqu'à la fin du XIXe siècle, époque à laquelle la maison-type de Gjirokastër perd son caractère défensif. Divers auteurs, tels Tchelebi, Hahn, Pouqueville, Sufflay, etc. ont mis en évidence ce caractère, et ce dernier chercheur a en outre énoncé une thèse sur la genèse de ce type de maison.

A la fin du XVIe siècle, Gjirokastër comptait 380 maisons, et au XVIIe 2.000, ce qui porte à croire que la ville a été peuplée par des villageois des zones montagneuses avoisinantes. La maison fortifiée de Gjirokastër, type particulier de l'habitation urbaine albanaise, se rencontre sous plusieurs variantes.

Le type primaire, point de départ du processus qui devait conduire à la maison du dernier type, existe encore dans la ville. Ce type, défini perpendiculaire, est une habitation à un étage, entièrement construite en pierre. Le rez-de-chaussée est occupé par l'étable, à laquelle s'est ajoutée, plus tard, la citerne; le premier étage est souvent plus étendu, le terrain en pente permettant son extension vers l'arrière de la maison. Un escalier extérieur en pierre conduit au premier, qui, au début, ne comportait qu'une seule pièce. Par la suite, il fut divisé en deux par un couloir, formant ainsi, la «pièce d'hiver», à cheminée, où l'on préparait à manger, et qui était le lieu de séjour quotidien de la famille, et «la chambre d'amis» ou la «bonne chambre». Ce genre d'habitation que l'on retrouve aussi à Kruje et à Berat était l'habitation caractéristique des paysans des zones montagneuses de l'Albanie du Sud. Nous avons lieu de croire que ce type d'habitation était courant aux XVe et XVIe siècles, lorsque les cités médiévales commençaient à s'accroître de quartiers périphériques et que les paysans des zones montagneuses avoisinantes venaient les peupler.

Le premier pas dans le sens du développement de cette habitation est l'adjonction d'un nouvel étage, formant ainsi la variante perpendiculaire à deux étages. La construction d'un nouvel étage fut dictée par la nécessité d'augmenter le nombre des pièces, mais cette augmentation ne s'est pas faite ici comme à Berat par une extension horizontale, mais par l'adjonction d'un nouvel étage. Le facteur essentiel qui joua en faveur de cette solution fut le souci de faire de la maison un sûr abri défensif. Ce type de maison, nous semble-t-il, devait déjà s'être formé pas plus tard qu'à la fin du XVIe siècle. Tchelebi et Hahn évoquent le terme de «kulla» à Gjirokastër, et à notre sens, ces «kulla» ou «kamerie», comme les appelle la population locale, ont une fonction de défense passive, et la famille s'y abritait en cas de danger. On trouve encore à Gjirokastër deux sortes

DO NOT COPY

de «kamerie»: isolées ou intégrées à l'habitation. Ces «kamerie» ne se sont pas beaucoup propagées à Gjirokastër du fait que l'habitation type de la région était déjà elle-même fortifiée. Sur le témoignage de Tchelebi, ont peut affirmer que les «kamerie» ont été construites à Gjirokastër pas plus tard qu'au début du XVIIe siècle. Il subsiste encore à Gjirokastër certaines maisons qui ne sont pas postérieures à la fin du XVIIIe siècle et qui sont des «kulla» dans le sens classique du terme, c'est-à-dire des habitations à caractère défensif actif.

A partir de la variante perpendiculaire à deux étages, l'habitation de Gjirokastër a accompli un grand pas en avant, en intégrant l'escalier à l'intérieur du corps de bâtiment, pour former ainsi l'embryon de la variante «qoshe» (à angle). Dans cette variante, l'habitation se voit ajouter une galerie, un des plus anciens éléments de l'habitation dans l'ensemble des Balkans. A l'étape succesive, de nouvelles pièces sont ajoutées du côté de l'escalier, aboutissant ainsi à la variante «qoshe» achevée. Celle-ci est la plus répandue de la maison fortifiée de Gjirokastër. L'embryon de la variante «qoshe» s'est également développée dans un autre sens, nous donnant la variante simple «divitli», (en forme d'U), laquelle, se développant encore, conduisit à la variante «divitli» achevée, qui constitua la variante la plus avancée de la maison fortifiée de Gjirokastër.

La particularité essentielle par laquelle la maison – type de Gjirokastër se distingue de la maison citadine à galerie de Berat ou de Shkodër consiste dans son caractère défensif prononcé. Cela se manifeste par le choix de l'emplacement en des sites dominants, par les murs entourant souvent une double cour, par les nombreuses meurtrières généralement ménagées dans les portes d'entrée. Les éléments défensifs vont s'atténuant en passant du rez-de-chaussée au deuxième étage qui est pratiquement à l'abri de tout danger. Le souci de la défense a été le motif essentiel qui dicta le développement en hauteur, alors que les considérations de terrain n'ont joué qu'un rôle secondaire. L'habitation type de Gjirokastër est une habitation citadine qui conserve néanmoins certains éléments de la maison rurale dont elle tire son origine. La différenciation fonctionnelle d'un étage à l'autre et la manière architectonique, conditionnée par ces fonctions, dont chacun des étages est traité dès la variante perpendiculaire à deux étages, sont demeurées des particularités importantes de l'habitation fortifiée de Gjirokastër.

De nombreux auteurs étrangers ont défini la maison fortifiée de Gjirokastër de «kulla», alors que Rr. Zojzi l'appelle «kulla citadine». Cette dernière dénomination nous paraît plus précise. Alors qu'à Gjirokastër s'établit la «kulla citadine», à Berat, Elbasan et Shkodër, centres commerciaux et artisanaux renommés, se forme, vers le milieu du XVIIIe siècle, le type évolué de l'habitation urbaine à galerie. En dépit de différences essentielles, les variantes évoluées des deux types présentent des affinités tant dans la conception compositionnelle qu'en ce qui concerne de nombreux éléments architecturaux et de construction. La maison type de Gjirokastër peut être définie comme le stade le plus évolué des habitations défensives que l'on construisait autrefois dans presque toutes les régions habitées par des Albanais. La thèse de Sufflay selon laquelle les habitations de Gjirokastër qu'il appelle «kulla» révèlent des influences occidentales, et que l'Albanie du Sud l'Ancien Epire et la principauté d'Achée furent le berceau de la «kulla», celle-ci y ayant été prétendument propagée par les dominateurs latins, nous paraît gratuite, car elle ne repose sur aucune analyse des matériaux, et, qui plus est, erronée, car elle se fonde sur la théorie de l'apport extérieur. En tant que telle, elle ne résiste pas à la confrontation des faits que nous venons d'énoncer, et qui démontrent que la maison type de Gjirokastër offre un cas de développement autonome stimulé par les conditions économiques et sociales et réalisé par les maîtres albanais de la construction aux anciennes traditions.

Les conditions économiques et sociales qui déterminèrent le développement de la maison fortifiée de Gjirokastër sont principalement à rechercher dans les facteurs suivants. Gjirokastër n'était pas un centre artisanal et commercial, mais un centre administratif. Des propriétaires fonciers et des fonctionnaires, en rivalité d'intérêts et en hostilité entre eux, s'y étaient établis, et, d'autre part, l'anarchie féodale avait créé des conditions favorables pour une certaine autonomie de la ville. On en a une preuve dans la résistance qui

DO NOT COPY

fut opposée à Ali pacha de Tepelene. L'insécurité que s'établit dans la ville, avait pour motif, outre l'anarchie féodale, le moment particulier dans l'évolution de la lutte de classes; les propriétaires fonciers sentaient en effet peser sur eux la menace de la révolte des classes exploitées. De même, l'institution de la vendetta a certainement favorisé la création d'une situation troublée. Dans ces conditions, à Gjirokastër, la sécurité personnelle du marchand et de ses biens faisait défaut, cette sécurité étant, comme le dit Engels, la première condition du profit bourgeois. Jusqu'à la fin du XIXe siècle, Gjirokastër demeura principalement un centre administratif.

Les constructions de Gjirokastër sont l'oeuvre des maîtres albanais qui héritaient leur protession de génération en génération. Ils habitaient, dans la région de Kolonje, les villages de Panarit, Treskë, Trebickë, Orgockë, Grabockë, Stratoberdhe, Luaras, Koblare, Miçan, etj.

Considérant la maison fortifiée de Gjirokastër en rapport avec celle des autres peuples balkaniques, on peut affirmer notamment que: à en juger par ce qu'on sait de l'habitation urbaine byzantine, celle-ci n'a rien de commun dans sa conception compositionnelle avec l'habitation traitée. Les influences turco-orientales paraissent n'avoir laissé de traces que dans l'ameublement intérieur ainsi que dans les pièces de toilette de chaque chambre à coucher. Certains éléments architecturaux et de construction des maisons de Mistre, décrites par Orlando, présentent des analogies avec les éléments correspondants des maisons de Gjirokastër, et les habitations bourgeoises de la Grèce du Nord en offrent également. On en trouve également de marquantes avec certains éléments de l'habitation aristocratique de Triker, décrite par A. Haxhimihajli. L'auteur roumain, P. Stahl, évoque la fonction de la «kulla» en Valachie, comme lieu de refuge en cas de danger; elles y ont la même fonction que les «kamerie» de Gjirokastër.

Dans un chapitre particulier de son livre sur «l'habitation grecque», l'auteur grec Mega traite aussi de la maison albanaise. Sans arguments à l'appui de sa thèse, il soutient que les habitations albanaises évoluées, aussi bien les «kulla»-s que les maisons à galerie, constituent un apport de l'étranger. Mega se fonde sur l'ouvrage de F. Nopca, lequel, comme on sait, n'a connu que l'habitation d'une partie de l'Albanie du Nord, et ignore, à dessein, l'étude de M. Urban sur les agglomérations de l'Albanie du Sud, en affirmant que «la zone située au sud du la baie de Vlore et qui s'étend jusqu'à la frontière grecque, appartient à l'Epire du Nord et que la technique de la construction y est purement grecque». La maison fortifiée de Gjirokastër, une des réalisations les plus achevées de l'habitation défensive albanaise, a ses racines, comme nous l'avons illustré, dans notre sol. Réalisée par les Albanais pour les Albanais, elle constitue une preuve de plus de l'absence de fondements, des erreurs méthodologiques et des préjugées dont sont empreintes les sentences de l'auteur cité en ce qui concerne l'habitation albanaise.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Burhan STRAZIMIRI – Pirro THOMO

KULLA E MATIT

Krahina e Matit shtrihet gjatë luginës së lumit me të njëjtin emër, duke filluar nga kreshtat e malit me Gropa e deri tek lumi i vogël i Urakës, midis vargmaleve të Dejës e Allamanit, nga njera anë, dhe vargmalit të Skënderbeut, nga ana tjetër. Malet që e rrethojnë dhe relievi i saj i thyer krijojnë një mbrojtje të favorshme natyrale; me krahinat kufitare lidhet vetëm nëpërmjet qafave të maleve. Deri në vitin 1931 kjo krahinë nuk ka pasur rrugë automobilistike, prandaj rrugët e mushkave shërbenin si për komunikim brenda krahinës ashtu dhe për lidhjen me krahinat përreth.

Sapo hyn në luginën e Matit, të bien në sy menjëherë banesa prej guri të vendosura larg njëra tjetrës, të forta e të larta që dallohen për karakterin e tyre të theksuar mbrojtës. Kjo banesë e fortifikuar, që njihet me emrin «kullë», është banesa më karakteristike dhe më e rëndomtë e krahinës së Matit.

Udhëtarë apo studjonjës të huaj si Evlija Çelebiu, Ami Bue, Hani, Nopça etj. na informojnë se banesat e fortifikuara kanë qenë karakteristike edhe për vendet e tjera; qoftë për Shqipërinë e Veriut ashtu dhe për atë të Jugut, por për kullën e Matit si banesë në literaturën e deritanishme nuk është bërë fjalë.

Qëllimi i këtij punimi është të japë një pamje sa më të plotë të arkitekturës së kësaj banese karakteristike dhe njëkohësisht, duke u bazuar në të dhënat historiko-shoqërore të krahinës, të jepen shkaqet të cilat, sipas mendimit tonë, janë më kryesoret për lindjen dhe zhvillimin e kësaj banese. Problemet që nxjerr studimi i kullës në tërësi do të mund të zgjidhen me grumbullimin dhe studimin e një materiali më të plotë, për të gjitha krahinat e veriut, ku kulla është banesë mbizotëruese.



Fig. 1



Fig. 2 —



Fig. 3 —

Punimin e mbështesim në materialin e mbledhur në fshatrat Klos, Dars, Fulqet, Gurrë e Madhe dhe Macukull. Gjithashtu janë patur parasysh dhe materiale nga fshatrat Rrip, Dom, Plan i Bardhë, Gurrë e Vogël, Shulbatër, Kurdari e Shëlli.

Kulla është një banesë e fortifikuar që dallohet për vendosjen në vende dominuese, zhvillimin në lartësi, ekzistencën e elementeve të theksuara mbrojtëse dhe për zgjidhjen funksionalo-utilitare të prirur nga synimi për të rritur aftësitë mbrojtëse të saj.

Relievi i ndryshueshëm i jep mundësi fshatarit që kullën ta vendosë në vende të mbrojtura nga natyra dhe njëkohësisht t'i sigurojë një pamje të lirë dhe dominuese ndaj zonës për rreth (fig. 1). E vendosur në pozitë të tillë dominuese, kulla nxjerr qartë në pah volumin e saj të gurtë kubik, i cili me thjeshtësinë, ashpërsinë dhe lakonizmin e elementeve arkitektonike shpreh karakterin fortesë të banesës. Elementet e vetme, që gjallërojnë pamjen e jashtme, janë çikmatë dhe dyert e punuara me mjeshtëri me gurë të gdhëndur e të zbukuruar me ornamente të marra nga arti popullor. Kulla gjendet e zhveshur nga ndërtimet dhe ambienti përreth. Atë rrallë herë e gjejmë të rrethuar me mure avllije ose me ndërtime ndihmëse për ekonominë bujqësore si koshere etj.; zakonisht ajo ndërtohet pranë tokës së bukës. Zgjidhja kompozicionale e kullës është e thjeshtë dhe logjike, gjë që bëhet në përputhje të plotë me qëllimin kryesor, mbrojtjen aktive. Kullën e gjejmë me dy, tre dhe rrallë me katër kate, me nga një ambient të vendosur në çdo kat.

Kati përdhes, që quhet nga vendasit burg, përdoret kryesisht për strehimin dhe sigurimin e bagëtisë, nuk ka asnjë dritare, veç në raste shumë të rralla mund të ketë frengji. Komunikimi me ambientin e jashtëm bëhet nëpërmjet derës, e cila është hyrja e vetme për në kullë. Në vartësi nga forma planimetrike e kullës, hyrja vendoset në anë ose në mes të faqes së murit; porta zakonisht është njëkanatëshe, e punuar me dru lisi të trashë dhe mbyllet nga brenda me një shul druri, që lëviz horizontalisht nëpër një kanal të hapur në mur. Në këtë kat ndodhen edhe shkallët e komunikimit të këtij ambienti me katet e mësipërme (fig. 2). Vendosja e shkallëve brenda i jep banesës mundësi më të mira për mbrojtje. Për të shfrytëzuar sa më mirë lartësinë e madhe të katit përdhes, shpesh herë në gjysmën e lartësisë së tij ndërtohet një nënkat, i cili përdoret për mbajtjen e ushqimit të bagëtisë.

Kati i dytë, të cilin vendasit e quajnë «podi i poshtëm» në përgjithësi përdoret për shtëpi buke. Në këtë ambient zhvillohet jeta e gjallë e familjes; pregatitet buka dhe njëkohësisht përdoret si dhomë fjetje për pjesëtarët e familjes. Ky është një ambient i thjeshtë, i ulët e me ndriçim të paktë që e merr nga disa dri-

DO NOT COPY

tare të vogla të paisura me kanate druri. Në disa raste ambienti mund të ketë frengji. Për të evituar depërtimin e erërave të këqia, që vijnë nga burgu i bagëtisë, shpesh herë mbi dyshemetë e banesave të vjetra shtrohet një shtresë argjile e ngjeshur. Në njerin prej mureve anësor është vendosur oxhaku, vatra e të cilit lartësohet nga dyshemeja 8-10 cm., shtrohet sipër me dhe të ngjeshur dhe kufizohet nga të tri anët me një kornizë druri. Në muret anësore janë hapur dollape për vendosjen e paisjeve shtëpiake.

Kati i tretë që vendasit e quajnë «oda e miqve», «kulla e miqve» ose «çardak» është ambienti kryesor i kullës dhe shërben për mbrojtjen aktive të banesës si dhe për pritjen e miqve. Elementet më karakteristikë të odës së miqve janë vatra dhe çikmatë. Vatra (fig. 3) si dhe në shtëpinë e bukës, është e ngritur nga dyshemeja rreth 8 cm. dhe e shtruar sipër me dhe, ţymi i zjarrit të vatrës thithet nga një shkorsë (hinkë ose trung piramide) prej gardhi që kufizohet nga një kornizë dërrase. Në të djathtë të vatrës është vendi i ndejës i të zotit të shtëpisë. Pranë tij, në mur, ndërtohet një kamare që hapet e mbyllet me kapak dërrase, të cilën vendasit e quajnë dollapi kafes. Pranë dollapit të kafes një lug guri shërben për derdhjen e ujrave të kafes; ndërsa përpara vatrës, në dysheme është hapur një vrimë e cila quhet «bira e thermekave» që shërben për të derdhur thërrimet e bukës. Për varjen e armëve të miqve në mure janë vendosur gremça druri. Tipari tjetër dallues i këtij ambienti, siç thamë, është mbrojtja, që realizohet nëpërmjet çikmave dhe frengjive. Elementi më i përshtatshëm që jep mundësi për të kontrolluar kullën në të gjithë drejtimet është çikmaja, (fig. 4) e cila zakonisht vendoset mbi portën e hyrjes, dhe në ato pika nga ku mund të vrojtohet lirisht zona përreth. Ky element ngrihet nga dyshemeja rreth 60 cm., del jashtë mureve perimetrale 20-100 cm dhe paiset poshtë, anash dhe përballë me frengji. Në ballë këto paisen me dy ose tre dritare të vogla me kapakë prej druri të trashë lisi, ose guri. Veç kësaj, çikmaja shërben edhe si vend për të ndejtur në kohë të lirë.

Përballë shkallëve, sipër, një portë me qemer guri njëkanatëshe të nxjerr në një ambient jashtë shtëpisë, që mbështetet në ancak druri ose guri dhe që shërben si nyje sanitare. Muret e nyjes sanitare janë të holla me gurë të lehtë porozë ose parete gardhi të suvatuara me baltë. Ato paisen vetëm me nga një dritare, në disa raste kanë edhe frëngji. Shkarkimi i nyjes sanitare kryhet direkt nëpërmjet një trungu druri të biruar në formë tubi ose nëpërmjet një rrase të pjerrët guri. Në mbarim të shkallëve, anash saj, 70 cm. mbi nivelin e dyshemesë, muri thellohet në formë drejtkëndëshi ose sektori rrethi, shtrohet me rrasa guri dhe shërben për larjen e duarve. Vendasit e quajnë



fig. 4

«avdesane». Ujrat e avdesanes shkarkohen nëpërmjet një bire në mur që përfundon jashtë në një lug guri. Avdesanet zakonisht paisen me frengji.

Komunikimi i odës miqve me podin e poshtëm bëhet nëpërmjet shkallëve të drunjta që i ngjiten murit perimetral. Kafazi i shkallëve ndahet nga shtëpia e bukës nëpërmjet një paret gardhi, me qëllim që miku të mos mund të shikojë gratë që ndodhen në shtëpinë e bukës. Kafazi i shkallës gjithashtu kufizohet nga oda e miqve me një paret dërrase ose gardhi. Rrafsh me dyshemenë në këtë paret lihet një hapësirë katërkëndëshe që hapet e mbyllet me kapak dërrase me lëvizje horizontale e cila shërben për futjen e ushqimeve.

Më sipër dhamë një përshkrim të shkurtër të ambienteve të kullës dhe të elementeve të tyre që janë të njëjta për çdo banesë. Megjithatë dallohen skema kompozicionale të ndryshme, ku forma planimetrike apo rritja e kullës në lartësi janë në vartësi të zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Kemi përmendur se kulla mund të jetë dy, tre dhe, rrallë herë, katërkatëshe. Po kështu duke analizuar formën e kullës ne dallojmë atë me bazë katërkëndëshe dhe atë me bazë katërkëndëshe të zgjatur.

Në kullën me bazë katërkëndëshe, dy katshe në fshatin Dars (tab. I) porta e hyrjes është vendosur në

NO COPY



fig. 5 —

anë të faqes më të gjatë, kurse shkallët janë vendosur përballë hyrjes dhe u ngjiten mureve perimetrale. Ajo përbëhet prej dy kthinash të vendosura njëra mbi tjetrën; burgu dhe oda e miqve. Çikmatë që dalin në tre faqe të mureve si dhe frëngjitë e hapura në dollapin dhe avdesanën e faqes së katërtë sigurojnë mbrojtjen e kullës. Kulla trekatëshe me planimetri katërkëndëshe (Tab I, 2) ndodhet në fshatin Macukull. Rritja në lartësi e saj krijon mundësi më të mira mbrojtjeje, gjë që realizohet nga katër çikmatë e dala në katër faqet e mureve. Ambientet e kullës këtu janë burgu i bagëtive, shtëpia e bukës dhe oda e miqve, të vendosura respektivisht në seicilin kat.

Kullat me bazë katërkëndëshe të zgjatur mund të jenë dhe këto me dy (Tab. I, 1) ose me tre kate (Tab. III, 1). Një zgjatje e tillë e planimetrisë krijon mundësi që në të njejtin kat të vendosen dhe dy ambiente të ndara nga njëra tjetra me një paret të hollë gardhi të suvatuar me llaç balte nga të dy anët. Në këto kulla hyrja zakonisht bëhet nga mezi i faqes më të gjatë, por ka raste kur mund të jetë dhe nga ana e faqes më të shkurtër. Në rastin e parë shkallët fillojnë në mes të hapësirës, ndërsa në rastin e dytë fillojnë duke ju ngjitur murit perimetral.

Kulla dykatëshe me bazë katërkëndëshe të zgjatur (Tab. II.) ndodhet në fshatin Dars. Siç shihet në katin e dytë të kësaj kulle oda e miqve nga shtëpia e bukës ndahet me anë pareti. Për të garantuar mbrojtjen e kullës pa prishur funksionin e shtëpisë së bukës vemë re që në qoshen e prapme të këtij ambienti është vendosur një çikma. Pra dy çikmatë e vendosura në qoshet e prapme të kullës si dhe ajo mbi portën e hyrjes, japin mundësi të plotë për të kontrolluar zonën përreth dhe për të mbrojtur kullën.

Në (Tab. III.) kemi paraqitur një kullë trekatëshe me bazë katërkëndëshe të zgjatur, që ndodhet në fshatin Gurrë e Madhe. Në katin e sipërm janë vendosur shtëpia e bukës dhe oda e miqve. Mbrojtja organizohet nga katër çikmatë e dala në të katër faqet e mureve. Kati i dytë (podi i poshtëm) përdoret për fjetje si dhe për ruajtjen e produkteve bujqësore.

Zgjerimi i familjes bëhet shkak dhe për zgjerimin e banesës. Mënyrat e zgjerimit varen nga mundësitë ekonomike si dhe nga kërkesat e familjes për mbrojtje. Kur ekzistojnë mundësitë ekonomike, kurora që ndahet ndërton një kullë më vehte pranë kullës së vjetër dhe brenda tokës së bukës. Në këtë rast mund të takojmë kulla të veçanta të familjes të rrethuara me mure avllije. Kur mundësitë ekonomike kanë qenë të kufizuara dhe kjo ka qenë më e përgjithshme, atëhere zgjerimi bëhej duke i bërë një shtesë kullës ekzistuese. Kur kulla e vjetër nuk plotëson terësisht kërkesat e mbrojtjes, atëhere shtesa e re bëhej një kat më e lartë dhe ngjitur me ekzistuesen (Tab III, 2). Si shembull kemi një kullë në fshatin Gurrë e Madhe (Tab. IV). Në ndërtimin e vjetër mbrojtja realizohej vetëm nga një çikma e vendosur mbi hyrje; lartësia e vogël si dhe mungesa e çikmave në anët e tjera nuk jepte mundësi që të kontrollohej i gjithë territori rreth kullës, rrjedhimisht dhe mbrojtja nuk bëhej e plotë. Shtesa e re, si nevojë e zgjerimit të familjes, një kat më e lartë si dhe paisja në të tri drejtimet me çikma, garantonte plotësisht kërkesat për mbrojtje. Siç vihet re, ndërtimi i ri është katërkatësh, ndërsa i vjetri dy katësh me nënkat. Komunikimi i brendshëm u përgjigjet jo vetëm interesave të mbrojtjes së kullës por edhe nevojave të shërbimit të familjes. Me zgjerimin e kullës me anë të shtesës së re u ndryshua dhe funksioni i ambienteve. Kështu kati i sipërm i kullës ekzistuese tani përdoret për shtëpi buke, oda e miqve vendoset në katin e sipërm të shtesës së re, podi i poshtëm i shtesës përdoret për fjetje, ndërsa ai mbi burg për depozitimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore.

Në rast se kulla ekzistuese u përgjigjej kërkesave të mbrojtjes dhe zgjerimi i familjes nuk kishte kërkesa të mëdha, atëhere shtesa e kullës bëhej një kat më e ulët dhe e ngjitur me të parën (Tab. IV, 1) Një kullë e tillë ndodhet në fshatin Dars (Tab. V.). Shtesa e re që i është bërë kësaj kulle është një kat më e ulët dhe nuk dëmton karakterin mbrojtës. Shtëpia e bukës ka dalë nga podi i poshtëm i kullës tre katëshe dhe është vendosur në një kullë dykatëshe të ndërtuar më vonë, ngjitur me ekzistuesen. Me kohë, si rezultat i zgjerimit të mëtejshëm të familjes shtëpia e bukës doli nga ku-

DO NOT COPY

lla dykatëshe dhe u vendos në një ambient të ri përdhes brenda oborrit të kullës. Kjo shvendosje nuk dëmtonte karakterin mbrojtës, nga që gratë që shërbenin ishin jashtë gjakut. Podi i poshtëm i kullës ekzistuese trekatëshe, me vendosjen e shtëpisë së bukës në kullën dykatëshe, duke u ndarë me parete të holla gardhi në dy ambiente, tani përdoret për odë fjetje. Po kështu dhe kati i sipërm i shtesës, pasi u lirua nga funksioni i shtëpisë së bukës, përdoret për dhomë fjetje. Dritaret e çikmave kanë dimensione më të mëdha se fillestaret, ato janë zmadhuar me detyrim nga Turqit në vitin 1910-1911 për të dobësuar aftësinë mbrojtëse të kësaj banese.

Në këtë krahinë kemi raste kur dy familje i ndërtonin kullat në të njëjtën kohë, në kurriz ose në krah të njëra tjetrës. Një ndërtim si ai i rastit të paré ndodhet në fshatin Klos (Tab. V, 1; Tab. VI), një nga kullat më të vjetra të ndërtuara në këtë zonë. Hyrjet e kullës janë bërë në anët e kundërta. Burgu, shtëpia e bukës dhe oda e miqve janë të përsëritshme sipas kateve për secilën kullë. Mbrojtja e kullës që nuk është e përkryer sigurohet vetëm nga dy çikma dhe disa frengji të hapura në faqet e mureve në katin e sipërm. Teknika e ndërtimit në të ruan të gjitha tiparet e kullës së hershme. Me zgjerimin e mëtejshëm të familjes, ngjitur me kullën e saj ndërtohej një kullë tjetër, duke krijuar në planimetri formën L, e cila takohet në mjaft raste. Shtesa e mëvonshme, sot është e transformuar, pra nuk ruhen tiparet fillestare të ndërtimit. Për rastin e dytë, tipike është kulla në fshatin Fulqet (Tab. V, 2; Tab. VI) që paraqet rastin e ndërtimit të njëkohshëm të dy kullave trekatëshe katërkëndëshe. Të pesë çikmatë e hapura në katin e tretë të dy kullave garantojnë bashkërisht mbrojtjen e kullës. Ambientet janë të njëjta për të dy kullat respektivisht dhe për seicilin kat. Ndarjet e brendshme janë të mëvonshme dhe janë diktuar nga zgjerimi i familjes si dhe nga kushtet e reja të jetesës.

Në përgjithësi këto janë format më kryesoret të ndërtimit të kullës në këtë krahinë.

Materiali i mbledhur tregon se kulla fillon të ndërtohet aty nga mezi i shek. XIX, ndërsa nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX ajo bëhet banesë e zakonshme e shtresave të gjëra fshatare. Kullat e vona nuk ndryshojnë nga ato më të hershmet nga skema e tyre kompozicionale, por dallojnë mjaft njëra nga tjetra nga teknika e ndërtimit dhe nga materialet e përdorura.

Në kullat e hershme (fig. 5) muret perimetrale dhe të brendshme konstruktive kanë trashësi jo më tepër se 80 cm. dhe janë prej guri të lidhur me llaç baltë dhe me breza druri 10x10 cm. të vendosur horizontalisht dhe që përsëriten në lartësinë jo më shumë se



Fig. 6

1 m. Gurët, në faqet e jashtme, dhe në qoshet përgjithësisht janë të papunuar.

Çikmatë, që ndërtoheshin me skelet druri të mbushur me gurë të lehtë porozë, dalin jashtë murit deri 1 m. duke u mbështetur mbi ancakë druri, të formuar prej dy - tre trarësh 14x14 cm., të vendosur njëri mbi tjetrin në distancë horizontale rreth 30 cm. Në faqet anësore dhe në ballë këto paisen me frengji. Dalja e madhe jashtë murit jep mundësi që këto të paisen me dritare të vogla, afërsisht 15 x 35 cm., jo vetëm në ballë por edhe anash. Dritaret e çikmave mund të jenë me seksion katërkëndëshi ose të harkuara në pjesën e sipërme. Çatitë janë të drunjta. Strehët në këto kulla dalin nga muret anësore mbi 60 cm., gjë që diktohet nga nevoja e mbrojtjes së mureve me llaç balte nga rreshjet. Në këto kulla pjesa e sipërme e portave të hyrjes është me hark guri, ndërsa shpatullat e portave formohen prej disa gurësh të punuar me dimensione më të mëdha se ato të vetë muraturës.

Në kullat më të vona teknika e ndërtimit merr forma më të përkryera, të cilat i përgjigjen më mirë karakterit të theksuar mbrojtës të kësaj banese. Në muret perimetrale dhe të brendshme konstruktive tani si material lidhës përdoret llaçi i gëlqeres; brezat e drurit nuk përdoren. Trashësia e mureve nga kati në kat zvoglohet duke krijuar shkallëzime, mbi të cilat mbështeten trarët e dyshemesë. Teknika e punimit të murit dallohet nga një nivel i lartë veçanërisht në qoshet dhe në shpatullat, të cilat punohen me gurë të gdhëndur. Fugaturat ndërmjet gurëve mbushen me llaç gëlqereje dhe rrafshohen në mënyrë të tillë sa që të krijohet përshtypja sikur këto janë të suvatuara. Çikmatë ndërtohen me gurë të gdhëndur në formë bloqesh

DO NOT COPY

të vendosura në rradhë, që mbështeten mbi ancakë guri. Pjesa e sipërme e dritareve të ballit mbulohet me gurë të punuar në formë harku rrethor. Kapakët që hapin e mbyllin këto dritare lëvizin horizontalisht mbi dy rrypa dërrase, të vendosura në faqen e brendshme të murit të çikmasë. Kur këto dritare janë në qoshet atëhere hapja dhe mbyllja e kapakëve të drrasës bëhet vertikalisht. Dalja e vogël e çikmasë nuk jep mundësi që anash tyre të hapen dritare. Në përgjithësi format arkitektonike të çikmasë së kullës së vonë janë po ato të çikmasë së kullës së hershme. I vetmi ndryshim këtu është ai i madhësisë së daljes saj jashtë mureve perimetrale, gjë që bëhet në pajtim të plotë me vetitë fizike të materialeve të përdorura. Ndryshime në kullën e vonë vihen re edhe në ndërtimin e çatisë. Tani ato nuk kanë më shtehë, dhe kufizohen nga një kornizë guri e profiluar në formë çerek rrethi. Porta e hyrjes (fig. 6) mbulohet me hark guri dy rradhësh në formë gjysmë rrethi. Rreshti i parë i qemerit të mbulesës përbëhet prej një, dy ose tre bloqe guri në formë harku rrethor, bashkimi i të cilave formon gjysëm rrethi, ndërsa reshti dytë, që vendoset mbi të parin, formohet prej disa bloqesh guri. Trashësia e harkut të parë i kalon të 24 cm., ndërsa e të dytit të 21 cm. Të dy harqet kanë funksion konstruktiv. Përgjithsisht në harqet e rreshtit të parë të qemerit gjejmë baso-relieve me motive bimore, shtazore ose gjeometrike. Në të dy anët e portës rreth 1½ m. mbi tokë gjenden dy gremça për të lidhur kafshët. Shpatullat e portës përgjithsisht përbëhen prej bazamentit, kollonës së gurit që formohet prej një — deri tre copash dhe një jastëku mbi të cilin mbështeten themrat e harkut. Shpatullat e portës lidhen me murin nëpërmjet njërit prej gurëve të kolonës. Portat e hapura më vonë përgjithsisht kanë formë katërkëndëshi dhe mbulohen prej 1-2 trarësh horizontalë të vendosur njëri mbi tjetrin.

Teknika e ndërtimit në të gjitha elementet e tjera përbërëse të kullës së hershme dhe të kullës së vonë është e njëjtë. Çatitë janë me konstruksion druri të mbuluar me tjegulla në formë lugu ose me rrasa guri. Muret e holla ndarëse ndërtohen me parete gardhi të suvatuar me baltë në të dy anët. Rrallë herë këta mund të jenë edhe me dërrasë. Shkallët janë të drunjta dhe përbëhen prej dy shtyllash dru lisi të lidhura në mes tyre me anë të dërrasave të shkeljes, të cilat mbështeten mbi dy shkallë guri me qëllim që të evitohet kontakti i drurit me lagështirën. Ato fiksohen posht e lart për të evituar çdo lloj rrëshqitjeje. Dyshemetë e kateve janë me dërrasë të latuar, ndërsa ambientet i gjen përgjithësisht të pasuvatuara dhe pa tavan.

Mjeshtrit e ndërtimit janë më shumë nga Kostenja e Çermenikës dhe Prodani e Okshtuni i Dibrës; ata punonin në grupe të organizuar 3-4 vetësh duke marrë përsipër vetëm punën e ndërtimit të kullës, ndërsa për sigurimin dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit interesohej vetë pronari. Fshatari disa kohë përpara fillimit të ndërtimit të kullës priste lëndën e ndërtimit nga pylli i fshatit prodhonte gëlqere si dhe priste dhe piqte tjegullat për mbulesë.

* * *

Historikisht Mati i rezistoi pushtimit turk që nga fillimi i tij e deri në shpalljen e pavarësisë. Në krahinën e Matit ashtu si dhe në disa vise malore të venditurqit nuk mundën të shtrijnë sundimin e tyre të plotë. Në këto rrethana u zhvillua ay proçes regjenerimi e zgjerimi i formave të lashta të organizimit shoqëror juridik [1]) ku, si pasojë, në marrëdhnjet brenda përbrenda shoqërisë u ruajtën e drejta e lashtë zakonore (kanuni i Skënderbeut) dhe mbeturinat e organizimit fisnor patriarkal, të cilat frenuan zhvillimin e marrëdhënjeve feodale në kuptimin e vërtetë të tyre.

Nga shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX në krahinën e Matit u fuqizuan familjet feudale të Zogollajve, Çelajve, Allamanëve, Buzhiqëve dhe Skënderajve. Këto familje kishin arritur të fusnin fshatarët në vartësinë e tyre ekonomike, vetëm për pronën e përbashkët të kullotave e të pyjeve ndërsa, përsa i përket tokës së bukës, fshatarët mbeteshin të lirë, jashtë vartësisë ekonomike të feudalëve. Në marrëdhënjet ekonomike, për Matin ishte karakteristike prona e vogël e tokës. Por feudalët e kësaj krahine, në interes të rritjes së pronës së tyre, shpesh organizonin grabitjen e pasurisë së fshatarëve ose zhdukjen e atyre që kundërshtonin. Për të siguruar një shfrytëzim më të lehtë futënin ose përkrahnin grindjet, përçarjet, vrasjet dhe hakmarrjet në mes të familjeve fshatare duke krijuar kështu një gjendje pasigurie në jetën e familjeve fshatare. Përveç kësaj, ekzistenca për shekuj me rradhë, deri në prag të çlirimit, e marrëdhënjeve patriarkale bëri që të ruhet për një kohë të gjatë institucioni i hakmarrjes [2]). Në kushtet e kërcënimit të vazhdueshëm nga ekspansioni feudal mbi pronën e lirë të tokës, të ekzistencës së mbeturinave patriarkale, dhe, veçanërisht, të institucionit të hakmarrjes, si dhe të detyruar që për çdo padrejtësi e marrje gjaku t'i delnin vet për

1) Aleks Buda. **Vëndi i Shqiptarëve në Historinë Europiane të shekujve VIII-XVIII,** Studime historike, Nr. 1/1967, fq. 15.
2) Ismet Elezi, Buletini U.Sh.T., Seria shkenca shoqërore Nr. 3 1959, fq. 188.

KOPJA

zot vetvetes, për familjet fshatare lindi nevoja e një mbrojtjeje individuale e jetës dhe e pasurisë. Për të plotësuar këtë nevojë jetike filloi të kërkohet ndërtimi i banesave të forta, të sigurta për çdo rast. Në këtë mënyrë, në përputhje me kërkesat e reja të jetës, u ndërtua tip i ri i banesës, kulla ose banesa e fortifikuar e përshkruar më sipër.

Në shembujt e sjellë më sipër jemi munduar të gjurmojmë banesa që pak a shumë ruajnë strukturën e tyre fillestare. Kjo nuk ka qenë një punë e lehtë për shkak të transformimeve të mëvonshme që ka pësuar kulla si pasojë e ndryshimeve të kushteve ekonomiko-shoqërore. Kulla, si banesë e papërshtatshme për mënyrën e sotme të jetesës, është e destinuar të transformohet plotësisht dhe madje shpejt për shkak të ritmeve të larta të zhvillimit të fshatit tonë socialist. Rrjedhimisht, përpara nesh del kërkesa e ngutshme e njohjes dhe e studimit të banesës fshatare në përgjithësi dhe e kullës si pjesë përbërëse e saj.

DO NOT COPY

Tab. I



PAMJE KRYESORE



KULLE NE DARS

KATI I I



PAMJE ANESORE



0 1 2 3M

KATI I II

DO NOT COPY






PAMJE KRYESORE
PAMJE ANESORE
PORTA E HYRJES
0 05 1M


KATI I I
KATI I II
KATI I III
KULLE NE MACUKULL
0 1 2 3 4


PAMJE KRYESORE
BURGU
KATI I I


KULLE NE DARS
PAMJE NGA MBRAPA
ODA E MIQVE
SHTEPI BUKE
KATI I II
0 1 2 3M

DO NOT COPY

KULLE NE GURRE TE MADHE



PAMJE KRYESORE



KATI I I



KATI I II



KATI I III

0 1 2 3





DO NOT COPY

KULLE NE GURRE TE MADHE



PAMJE KRYESORE



PAMJE ANESORE



KATI I I



KATI I II



KATI I III



KATI I IV

0 1 2 3 4M



DO NOT COPY

KULLE NE DARS MAI



PAMJE KRYESORE



KATI I I



KATI I II



KATI I III

0 1 2 3M

DO NOT COPY







PAMJE KRYESORE



PAMJE ANESORE

KULLE NE KLOS



KATI I III

0 1 2 3 4M



KATI I I



KATI I II



KATI I III

KULLE NE SULLQET



PAMJE KRYESORE



PAMJE NGA MBRAPA

0 1 2 3M

DO NOT COPY

DO NOT COPY

B. STRAZIMIRI – P. THOMO

LA «KULLA» DE LA REGION DU MAT

RESUME

L'habitation caractéristique dénommée «kulla», que l'on rencontre souvent dans la région du Mat, a pour particularité marquante son caractère défensif. Aussi se présente-t-elle comme une construction en pierres, assez élevée, close, aux murs percés de rares fenêtres et pourvus de divers éléments défensifs, tels que encorbellements, meurtrières, etc.

La défense de la «kulla» est également facilitée par des conditions de terrain favorables. Elle se dresse toujours sur un point d'où elle peut commander toute la zone environnante. Les «kullas» couronnent généralement le sommet d'une colline, dominent des gorges de cours d'eau ou de torrent, parsèment les versants des monts et des collines, animant le paysage rude et plein de contrastes de la région.

Sur une telle position dominante, la «kulla» découpe sa masse cubique de pierres, qui, par la sobriété, l'âpreté et le laconisme des éléments architectoniques, traduit le caractère de forteresse de l'habitation. Les seuls éléments qui en agrémentent l'aspect extérieur, sont les «cikma» (encorbellements), les portes en pierres sculptées et enrichies de motifs ornementaux populaires.

Cette habitation a vu le jour dans des conditions historiques déterminées.

De même que d'autres régions montagneuses du pays, la région du Mat, où les Turcs ne parvinrent pas établir pleinement leur domination, conserva l'ancien droit coutumier et les vestiges de l'organisation tribale patriarcale, qui freinèrent le développement de véritables rapports féodaux. Aux XVIIIe-XIXe siècles, les familles féodales du Mat, tels les Zogollaj, les Çelaj, les Alleman et d'autres, n'avaient pas réussi à assujettir entièrement les paysans à leur domination économique. La petite propriété terrienne demeurait une caractéristique de cette région. Les paysans, encore libres, n'avaient cependant pour tout bien que la propriété commune des pâturages.

Dans ces conditions, les familles féodales cherchaient par tous les moyens à accroître leurs richesses et, tirant parti de certaines normes du droit coutumier, des dissensions locales – querelles, meurtres, vendetta, – elles s'employaient à mettre les paysans sous leur complète dépendance économique. En outre, la préservation des rapports patriarcaux jusqu'à la veille de la Libération eut pour effet que l'institution de la vendetta subsista un très long temps.

Ces circonstances contraignirent les paysans à défendre eux-mêmes leurs personnes et leurs biens. Devant cette exigence vitale, ils cherchaient maintenant à se construire des demeures solides et sûres pour parer à tous les dangers. L'érection de «kullas» était la meilleure manière de satisfaire à cette nécessité. C'est ainsi que dans cette région, elles commencent à s'élever vers le milieu du XIXe siècle. Vers la fin du XIXe s. et au début du XXe, ce type d'habitation était adopté par les larges couches paysannes.

Le problème de la structure de la «kulla», structure simple et logique, est résolu conformément à sa principale raison d'être – la défense active. Généralement, la «kulla» a une base plus ou moins carrée ou oblongue de pas plus de 7 mètres de côté. Elle est à un, a deux ou, rarement, à trois étages, qui ne comprennent chacun qu'une seule pièce. Les étages successifs communiquent entre eux par un escalier intérieur en bois. Celui-ci permet de circuler plus librement à l'intérieur de la «kulla», et de mieux en assurer la défense.

Le rez-de-chaussée, pièce close et sans fenêtres, s'appelle burg (prison) et sert à abriter le bétail. Le premier étage, que les habitants de l'endroit appellent pode inférieur, sert à la préparation des aliments et est appelé shtëpi buke (salle à manger), alors que le deuxième comprend la chambre d'amis. Cette pièce a pour particularités une cheminée caractéristique et des encorbellements.

L'élargissement de la famille, ainsi que les changements dans les conditions sociales ont eu des incidences sur la forme de la kulla. L'extension de la «kulla» s'est faite généralement par l'adjonction d'une nouvelle «kulla», qui peut être plus haute d'un étage, lorsque la «kulla» existante ne satisfait pas aux exigences de la défense, ou plus basse d'un étage lorsque la première construction y satisfait pleinement.

Les formes nouvelles sont le produit de la jonction de «kullas» séparées qui peuvent être contigues ou se joindre pour former une base en forme d'L. Ces formes sont obtenues par le groupement de deux ou plusieurs «kullas».

En ce qui concerne l'origine de ce type de construction et les influences qu'elle a pu exercer, il serait prématuré de formuler un jugement, l'étude de cette habitation, que l'on rencontre aujourd'hui plus souvent dans certaines régions de l'Albanie du Nord, n'ayant pas été encore menée à terme.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Vili KAMSI

KËSHTJELLA E SHKODRËS DHE RESTAURIMI I SAJ

Kështjella e Shkodrës ngrihet mbi një kodër të vendosur në mes Bunës, Drinit e Kirit, Kodrës së Pashës dhe fushës së Mbishkodrës. Atë e përdorën për herë të parë ilirët, duke ndërtuar atë bërthamë, mbi të cilën u zhvillua më vonë kështjella, ashtu siç është sot. Vetë pozicioni i saj dëshmon se ndërtuesit e kanë zgjedhur me shumë kujdes, ashtu si kanë vepruar kur kanë ngritur qytezat e tyre, në pika strategjike, dominuese, në zona të rëndësishme kalimi, si tokësore ashtu edhe ujore (fig. 1). Gjurmët e ndërtimit ilir janë të dukshme në të hyrë të kështjellës, në vendin e hapur në mes portës së parë dhe të dytë, si dhe në daljen nga porta në krahun e majtë ku ndodhen dy trakte. Blloqet e gurit tek këto dy porta kanë trajta të rregullta, dhe janë të skalitura për të lejuar një puthisje më të mirë njëri me tjetrin. Duket se është mur i ndërtuar në periudhën e fundit ilire, para pushtimit romak. Gjithashtu u atribuohet ilirëve një mur guri pa llaç, me një faqe të dukshme, i mbuluar me dhe në faqen e jashtme të tij dhe që krijon një hendek të madh në krahun VL (fig. 2), pra në pjesën më pak të mbrojtur nga natyra. Për këtë ende nuk mund të thuhet fjala e fundit, mbasi, pa bërë gërmime për të nxjerrë në dritë faqen tjetër të tij, nuk mund të pohohet



Fig. 1

me siguri nëse është mur mbrojtës, pra ilir, apo mur mbajtës për të krijuar një stom dhe hendekun që thamë më sipër (fig. 2). Në këtë rastin e fundit, ndërtimi i tij duhet të datohet, simbas mendimit tonë, në një kohë më të vonë, duke pasur parasysh sistemet e fortifikimit të mesjetës. Vetë natyra e terrenit, vetë relievi, ka kufizuar ndërtimin e tij vetëm në atë pjesë të kodrës që ishte më pak e mbrojtur dhe që mund të sulmohej më lehtë.

Forma, që ka sot kjo kështjellë nuk është më ajo ilire. Këtë duhet ta ketë marrë në shek. XIV dhe e ka



Fig. 2 –

ruajtur deri më sot, me gjithë rrënimet dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë pesëqind vjetëve të sundimit turk.

Trajta e kështjellës është thuajse vezake, ndahet në tri oborre të rrethuara me mure të larta. Vetëm në faqen ku gjendet e vetmja portë hyrjeje, dhe kryesorja, kemi katër kulla mbrojtëse si dhe një hendek të gjerë dhe të thellë, sistem i cili shërben për të siguruar pjesën më të pambrojtur të kështjellës, pjesën VL, që gjëndet përballë Kodrës së Pashës. Kurse në veri kemi tri kulla e në jug vetëm një.

Në kohën e rrethimit të dytë nga turqit (1478-1479) Marin Barleci vërteton se për mbrojtjen e portës së madhe «kishin ndërtuar një pyrg të lartë e të rrumbullaktë. . . ngjitë me atë pyrg ndodhej edhe një kullë tjetër pak më poshtë» [1])

Për daljen nga kështjella dhe për komunikimin me jashtë, përveç portës kryesore, kishte edhe dalje të tjera të fshehta, të nëndheshme. Një prej tyre delte në fund të kodrës, në krahun nga Buna, kurse një tjetër, me hyrje nga kulla që gjendet në jug të kështjellës, nxirrte nga Drini. Ende sot këto dalje shihen, por nuk janë të përshkueshme më, mbasi, pjesërisht, janë të shëmbura dhe paraqesin rrezik. Po ashtu kemi, poshtë portës së dytë kryesore, një dalje të fshehtë brenda hendekut në ballin VL, me drejtim nga veriu, në mënyrë që të mos shihej nga armiku. Duket se kjo dalje komunikonte me sistemin mbrojtës të portës kryesore, në atë pjesë të oborrit të fortifikuar (barbacane) ku gjendej, sipas traditës, shtëpia e familjes së vjetër të Jonimëve. Për të ndërtuar sistemin mbrojtës të portës kryesore, në mes viteve 1403-1416, kjo familje qe shpronësuar [2]).

Gjithashtu, ndërtesat brenda në kështjellë ishin të shumta dhe krijonin një rrjetë të dëndur rrugicash. Barleci shton: «të gjitha lagjet e qytetit, rrugë e rrugica. . . shtëpitë shembeshin; kishët rrafshoheshin» [3]). Nga kjo, rrjedhimisht, kuptojmë se para pushtimit turk aty kishte ndërtesa të ndryshme prej guri. Kur u dorëzua kështjella në vitin 1479, pjesa më e madhe e tyre ishte e shëmbur dhe këto nuk u ngritën më nga pushtuesi, i cili të gjithë kujdesin e kishte drejtuar tek veprat e fortifikimit. Gjetja e një kornize ndërtese, si dhe një kapitel me figura dragonjsh në reliev, që gjendet i ekspozuar në Muzeun popullor të Shkodrës, janë një dëshmi e sigurtë se ndërtesat në kështjellë nuk qenë të gjitha druri, siç mendohej më parë.

Katasti venedikas i Shkodrës, i vitit 1416-1417, ndër të tjera, regjistron: «Një shtëpi pjesërisht me mur e pjesërisht me dërrasa me mbulesë patavrash», «një shtëpi përreth prej guri dhe e mbuluar me patavra», «një shtëpi prej dërrasash e mbuluar me patavra» [4]), etj. Kjo gjendje nuk ndryshon as rreth 60 vjet më vonë, më 1478-79, dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe, madje, për sa i përket mbulesës me patavra, Marin Barleci e thekson në disa raste se të rrethuarit «zgjo-

1) M. Barleci, **Rrethimi i Shkodrës.** Përkthyer prej origjinalit latinisht nga H. Lacaj. Botim i dytë i shtuar. Tiranë, 1967, fq. 71.
2) **Saggio di un Regesto storico dell'Albania.** Scutari, 1937-1940, fq. 29, nr. 697; V. Kamsi, **Kalaja e Shkodrës,** tek «Shkodra», Shkodër, 1961, fq. 82-83.
3) M. Barleci, **Vep. e cit.** fq. 92.
4) **Catasto veneto di Scutari e Registrum Concessionum 1416-1417.** I. Catasto veneto di Scutari. Scutari, 1940, fq. 35- e 36.

DO NOT COPY

dhën disa burra të fortë e të shkathët, të cilët u ngarkuan me detyrë që të zbulonin vetëm ato shtëpi të cilat kishin pullazin druri» [5])

Ndryshim në mbulesë kishin ndërtesat që shërbenin si faltore dhe ndërtesat e fisnikëve; ato mund të kenë qenë të mbuluara me tjegulla, të cilat vinin nga jashtë, ose me pllaka guri. Për këtë bën fjalë vendimi i këshillit të vogël të Raguzës, me anën e të cilit më 20 qershor 1403 lejohet dërgimi në Shkodër i 5000 tjegullave për mbulesën e kishës katedrale të shën Shtjefnit. [6]) Me pllaka guri është mbuluar ndërtesa e kapitanerisë, që gjendet në pjesën më të thellë të kështjellës, kurse me qemerë janë të ndërtuara magazinat, depot, e ambiente të tjera të mbyllura, sterat e ujit të pijshëm (ndërtimi i të cilave, simbas dokumentave, i përket periudhës mbas vitit 1397) [7]) si dhe ai që sot quhet «burgu», pranë faltores, etj.

Ndoshta që në kohën ilire, qyteti filloi të shtrihej në fund të kodrës së kështjellës. Edhe qyteti mesjetar, si kështjella, qe i rrethuar me mure. Edhe sot shihen gjurmët e tyre. Kjo pjesë e Shkodrës qe e banuar deri në vitin 1467. Në këtë vit, mbas një sulmi të një ushtrie të madhe barbarësh, si i quan Barleci turqit, u dogj, dhe shkodranët «u tërhoqën bashkë me familjet e veta brenda kështjellës» dhe «nuk u kujdesën më për rindërtimin dhe rimëkëmbjen e qytetit» duke parë se kështjella ishte vend më i sigurtë [8]). Barleci nuk e përmend vitin e këtij sulmi, por këtë na e japin kronistët turq Tursun e Kemal Pashazade, të dhënat e të cilëve pajtohen me ato të humanistit tonë [9]).

* * *

Për herë të parë punimet e restaurimit në kështjellën e Shkodrës filluan në vitin 1961. Mbas dëmeve që kjo kishte pësuar në periudha të ndryshme të historisë së saj nga dora e njerëzve ose nga fatkeqësi natyrore e aksidentale, ishte e domosdoshme që punimet e restaurimit të kryheshin sipas një rendi, të cilin e ndamë në dy periudha:

1. Restaurim i atyre pjesëve që kishin pësuar më shumë dëme dhe që paraqitnin rrezik shembjeje.

2. Restaurim i mureve perimetrale dhe i ambienteve të brendshme, të cilat kërkonin vetëm plotësimin e ndonjë guri të rënë, etj.



fig. 3 –

DO NOT COPY

5) M. Barleci, **Vep e cit.**, fq. 59
6) **Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia,** Vol. II, Vindebonae, 1918, fq. 224-225, nr. 735.
7) **Po aty,** fq. 167, nr. 595.
8) M. Barleci, **Vep. e cit.** fq. 37.
9) **Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV,** Burime Osmane, Tiranë, 1967, fq. 104 e 204.



fig. 4 —



fig. 5 —

Restaurimet më të rëndësishme, të cilat kërkonin prej nesh një kujdes të veçantë, qenë porta kryesore e hyrjes në kështjellë, një portë anësore, që i përket grupit të oborrit të tretë, si dhe punime që kishin për qëllim forcimin dhe restaurimin e kishës. Punimet e tjera nuk paraqisnin ndonjë vështirësi të madhe mbasi përbëheshin nga punime plotësimi në mure të drejta, pa ndonjë veçanti arkitekturale, që të kërkonte, pikësëpari, një studim më të imtë të karakteristikave të saja, dhe një zgjidhje në konformitet me të.

Punimi tek porta kryesore e kështjellës (fig. 3) ishte i thjeshtë, por, megjithatë, u shfaqën disa vështirësi, sidomos në vendosjen e harkut të qemerit. Shtylla anësore nga perëndimi kishte rënë, dhe më vonë kishte qenë zëvendësuar me bloqe të vogla guri, sa për të mos lejuar shembjen e krejt faqes së murit [10]). Gjetja aty pranë e një bloku guri, që kishte qenë më parë po në atë krah të portës, e lehtësoi punën. U rivendos ku kishte qenë, duke u bërë kështu rindërtimi i plotë dhe i ngjashëm i të dy shtyllave anësore të portës. Për vizatimin, punimin dhe vendosjen e harkut të qemerit ndihmoi shumë gjurma e lënë nga harku që kishte qenë më parë dhe që lejoi llogaritjen e përmasave dhe vizatimin e drejtë të qemerit.

Për restaurimin e pjesëve të shëmbura e të dëmtuara të kishës, na ka prirë qëllimi që të shmanget rreziku i dëmtimit të mëtejshëm të ndërtesës, si dhe sigurimi i atyre pjesëve që mund të shëmbeshin. Punimet që ju bënë kësaj ndërtese qenë më tepër punime konservuese. Mveshja e faqes së jashtme të murit lindor të absides paraqiste vështirësi vetëm përsa i takon gjetjes së gurit të përshtatshëm për të rikrijuar rreshtat e zhdukur. Mveshja u bë deri aty ku kishte shenja të dukshme të ekzistencës së saj (fig. 4). Kjo kishte për qëllim ruajtjen e integritetit të murit. Gërmimi i mbushjes me dhe të absidës, bërë nga turqit, u la për më vonë. Nuk përjashtohet mundësia e gjetjes së ndonjë zbukurimi në faqen e brendshme të këtij muri. Gjurmë të një afresku shihen edhe sot, në fund të kishës, në anën e majtë të murit perëndimor, megjithëse nga gjendja e tyre nuk mund të formohet një ide për figurat e dikurshme.

Faqja e jashtme e murit verior ishte pjesërisht e zhveshur nga gurët e latuar, kurse në krye këta ishin shkoqur nga muri dhe rrezikonin të binin. Materiali këtu ishte kryesisht i shembur dhe gjendej përdhé. Ky material, përsëri, u përdor për mveshje. Këtu, për të marrë drejtimin e rreshtit të parë të gurëve, u desh të bëhej një gërmim i vogël, në krejt gjatësinë e murit. Gjatë gërmimit doli një sasi copash qeramike mes-

10) Shih, për gjendjen para vitit 1907, Th. Ippen, **Skutari und die Nordalbanische Küstenebene**. Sarajevo, 1907. fq. 19.

DO NOT COPY

jetare [11]). Përveç kësaj u zbulua paralel me murin e kishës, në një largësi rreth 50 cm., një mur tjetër guri, ndoshta themel i ndonjë ndërtese që sot është zhdukur.

Muri perëndimor, i cili paraqet një çarje në anën e tij të jashtme, me mungesë gurësh mveshës në pjesën e fundit, megjithëse që në vitin 1936 ishte në këtë gjendje, nuk ka pësuar ndonjë dëmtim më të madh. Dritarja e vogël, me drejtim jugor, që në atë vit ishte e mbyllur me mur guri, nga një tronditje ose për arësye të tjera [12]). Edhe këtu u bë plotësimi me gurë i skajit të murit, duke u bërë i qëndrueshëm kundrejt lëkundjeve të mundshme.

Pjesa që na nxori më tepër punë ishte muri jugor, me një portë në gjendje të mirë dhe me tri dritare të dëmtuara (fig. 5), nga të cilat dy në gjendje shumë të keqe dhe që rrezikonin qëndrueshmërinë e krejt murit. Së pari bëmë puntelimin e tij, pastaj nisëm të marrim masat për të caktuar madhësinë e hapësirës së dritës së dritareve. Për ne këto janë dritare dhe jo dyer, siç ka qenë menduar [13]), dhe kjo, për arësye se nuk kanë praqe, por edhe sikur t'i kishin pasur, do të delnin rreth 20 cm. më lart se praku i portës, që gjendet po në atë mur. Këto dritare duket i hapën turqit më vonë, po ashtu si kanë hapur edhe një dritare në murin lindor të xhamisë [14]) mbasi kanë shembur e modifikuar absidën, për të zhdukur shenjat e përdorimit të parë të saj.

Vështirësitë në restaurimin e kësaj pjese të ndërtesës nuk qëndrojnë në ngritjen e pjesëve të shemburra, se sa të mungesa e shenjave orientuese për këtë qëllim. Ndërsa këto ishin të qarta për dritaren pranë portës, për dy dritaret e tjera nuk dihej gjerësia e tyre. Përveç kësaj edhe përmasat e planimetrisë nuk u përgjigjeshin matjeve në vend [15]). Mbas matjesh të përsëritura e kontrollimesh, u vendos që dritaret, në gjasim të asaj ekzistuese, të kishin hapësirë drite 1,25 m., kurse dy shtyllat në mes tyre, një gjërësi prej 1,34 m.

Kur u bë pastrimi i materialeve të shembura nga muri, u zbulua se njëri gur i anës së dritares më lindore, kishte edhe një dhëmbëz për mbajtjen e kasës së dritares, gjë që nuk e kishin gurët e tjerë. Gjithashtu, brenda kishës, po në atë vend, në një thellësi afro 20 cm., është zbuluar edhe një shtresë tjetër, më e vjetër, me pllaka guri.

Punimet e tjera që u bënë në kështjellë nuk i kishin vështirësitë dhe rëndësinë e atyre që u bënë në murin jugor të kishës. Ndryshe qëndronte puna në pregatitjen e portave për hyrjen kryesore të kështjellës (Fig.3) dhe për ndërtesën e kapitanerisë (fig. 6) në oborrin e tretë. Këto kërkonin një punë paraprake të shoqëruar me konsultimin e literaturës që patëm mundësi të siguronim për t'ja arritur qëllimit që të vizatonim dy porta, të cilat të ishin në harmoni me ambientin dhe njëkohësisht të ruanin karakteristikat e epokës së cilës i përkitnin.



fig. 6

11) Materiali ruhet në Muzeun Popullor të qytetit të Shkodrës.
12) Rev., «Leka», VIII/1936, Nr. 6, fq. 276.
13) **Po aty,** fq. 276.
14) Th. Ippen, **vep. e cit.,** fq. 20. Në fotografinë e botuar shihen muret e ndërtesës në lartësinë e tyre të plotë.
15) Planimetria është botuar te Rev. «Leka» **vep. e cit.** fq. 274.

DO NOT COPY

Gjatë kryerjes së punimeve ka pasur raste që janë zbuluar edhe objekte me vlerë historike. Përveç atyre që i kemi përmendur gjatë kësaj kumtese, është zbuluar edhe një fragment mbishkrimi turqisht, të zbuluar pranë vendit, ku thonë se ka qenë shtëpia e familjes Jonima. Gjithashtu, tek porta e hyrjes në oborrin e kapitanerisë, në disa nga tullat e përdorura për ndërtimin e qemerit të kullës mbrojtëse të kësaj porte, i cili është shembur vetvetiu në nëndor të vitit 1960, kishin të vulosura gërmat G C. D. Tulla të tilla, mendojmë të punimit venecian, me përmasat 23x12x4 cm., paraqesin një brumë të marmuruar shumë të fortë dhe që i qëndron shumë thyerjes. Kurse gjetjet e objekteve metalike janë më të pakta dhe kufizohen në gjyle hekuri masash të ndryshme, ndërsa monedha nuk kemi gjetur fare. Për sa thamë deri këtu, është fjala vetëm për objekte që gjenden në sipërfaqe.

*
* *

Për restaurimin e kështjellës duhej të kishim një dokumentim paraprak. Njoftimet që kemi nga dokumente të shkruara të kohëve të kaluara si dhe nga bashkëkohës të ngjarjeve, nuk janë të mjaftueshme për lokalizimin e të gjitha ndërtimeve që përbënin kompleksin madhështor të ndërtimeve të saja. Mendojmë se do të ishte e gabuar të ndërmerreshin punime në kala pa u mbështetur në një literaturë, që gjykohet si e domosdoshme për këtë qëllim, siç është, përveç përmbledhjes së rëndësishme dokumentare «Acta et Diplomata», «Katasti venedikas i Shkodrës» i vitit 1416-1417, në të cilin, ndonëse për qëllime fiskale, jepen të dhëna të vlefshme e të rëndësishme për lokalizimin e këtyre ndërtimeve. Megjithatë ky lokalizim është shumë i vështirë për t'u bërë mbasi pikat e referimit, që në atë kohë ishin të njohura dhe të qarta, sot nuk dihen. Me vlerë është gjithashtu Rrethimi i Shkodrës» i Marin Barlecit, i cili, si shkodran dhe luftëtar brenda mureve të kështjellës së Shkodrës, jep disa njoftime të çmushme që i vlejnë qëllimit tonë. Një përshkrim të dokumentuar japin gjithashtu edhe Theodor Ippen[16]) dhe Milan Shuflai [17]). Por burimi kryesor, po qe se nuk dalin burime të tjera, të panjohura deri më sot, është dhe mbetet Arkivi i Shtetit i Venedikut, në të cilin, bashkë me dokumentat që u përkasin të «Urtëve të Kolegjit» kemi edhe vizatimet e kështjellave, vizatime që gjenden edhe në fonde të tjera. Këtë njoftim e kemi nga botimi i rëndësishëm bërë nga A. Da Mosto [18]), në të cilin jepet dëftuesi i përgjithshëm, historik, përshkrues dhe analitik i këtij arkivi të njohur. Nuk përjashtojmë mundësinë e gjetjes, në mes tyre, edhe të vizatimeve e të planeve të kështjellës së Shkodrës, të cilat do të ndihmonin për të caktuar vendin e zënë nga ndërtesat e ndryshme që figurojnë në dokumentat, e veçanërisht në katastin e sipërthënë. Një ndër to mund të jetë edhe plani i fortifikimeve, i hartuar më 1458 nga Andrea e Francesco Venier dhe Melchiore da Imola, plan i cili vetëm mbas tri vjetësh qe aprovuar për t'u zbatuar (20 tetor 1461) [19]).

Më në fund, edhe libri i D. Zenoni, i vitit 1573, ka planet e Shkodrës, të Ulqinit, të Durrësit dhe të Vlorës [20]).

NON-COPY

16) Th. Ippen, **Skutari und die nordalbanische K stenebene,** Sarajevo, 1907.
17) M. Sufflay, **Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters**. Wien, 1924.
18) A. da Mosto, **L'Archivio di Stato di Venezia,** Vol. I e II, Roma, 1937.
19) **Saggio di un Regesto. . . ,** vep e cit., fq. 39, Nr. 907.
20) D. Zenoni, **Civitatum aliquot insigniorum et locorum magis munitorum exacta delineatio; cum additione aliquot insularum principalium,** Venezia, 1573 .

DO NOT COPY

V. KAMSI

LA CITADELLE DE SHKODËR ET SA RESTAURATION

RESUME

La citadelle s'élève sur une colline au sud de la ville. Son périmètre est de forme ovale et comprend trois cours, enceintes de hauts murs. Elle n'a qu'une seule entrée principale au nord-est, mais, autrefois, elle communiquait aussi avec l'extérieur par plusieurs passages secrets souterrains. Il en subsiste aujourd'hui certaines parties, que des éboulements ont toutefois rendus impraticables. Au nord-est, qui est le côté le moins bien défendu, les remparts sont flanqués de quatre tours et bordés d'une douve large et profonde. Au nord, ils sont renforcés par trois tours et au sud par une seule.

La colline sur laquelle s'élève la forteresse était déjà utilisée comme centre fortifié par les Illyriens. L'on trouve des traces de ces fortifications sur la gauche de la porte. Par la technique de la construction, ces vestiges semblent appartenir à une époque antérieure à l'occupation romaine. La citadelle qui se dresse aujourd'hui n'est pas entièrement construite sur les anciennes fortifications. C'est au XIVe siècle qu'elle dut revêtir la forme qu'elle présente encore de nos jours.

Avant l'occupation turque (1479), le territoire clos par les murs de la citadelle était rempli de maisons formant entre elles un dense réseau de ruelles. Les maisons n'étaient pas toutes construites en bois, beaucoup l'étaient en pierres. Les toitures se composaient principalement d'échandoles, les constructions servant de temples ou les habitations des nobles étant seules couvertes de tuiles ou de plaques de pierre.

* * *

Les travaux de restauration de la citadelle de Scutari furent entrepris, pour la première fois, en 1961. Cette restauration a comporté deux étapes:

1) La restauration des parties gravement endommagées, menacées d'effondrement.

2) La restauration des pièces intérieures et des parties qui ne requéraient que des réparations peu importantes pour en empêcher la dégradation ultérieure.

Les travaux les plus importants portèrent sur la porte principale, celle introduisant dans la troisième cour, ainsi que sur le restauration de l'église.

A la porte principale de la citadelle, on a relevé la colonne latérale ouest, tombée en ruine, et postérieurement remplacée par de petits blocs de pierre afin d'empêcher l'écroulement de tout le pan de mur.

Pour la restauration de l'église, nous avons été guidés par le désir d'éviter tout risque de dégradation ultérieure de l'édifice et d'affermir les parties menaçant de s'effondrer. Au cours des travaux, il a été découvert à l'intérieur de l'église, à 20 cm. de profondeur sous le pavement existant, un autre dallage de pierres, plus ancien.

Des travaux de restauration ont également été entrepris sur les murs d'enceinte ainsi que sur le bâtiment de la capitainerie (fig. 5).

DO NOT COPY

Genc SAMIMI

DO NOT COPY

DISA TË DHËNA MBI TEKNIKËN E NDËRTIMIT TË BANESËS BERATASE

Qyteti muze i Beratit ruan një numur shumë të madh banesash popullore, të cilat datohen qysh prej fillimit të shek. XIX. Në Berat gjejmë dhe mjaft banesa që, megjithëse janë ndërtuar relativisht vonë, përsërisin tipe të lashtë. Midis tyre dallohet, banesa beratase me çardak, që është formuar të paktën në mezin e shek. XVIII. Ajo është një ndërtesë dykatëshe krejtësisht e gurtë, masive, me çardak. Në fillim të shek. XIX në Berat, ashtu si dhe në qytetet e tjera shqiptare të kohës, vërejmë disa ndryshime në banesë: çardaku mbyllet, ambientet zvogëlohen, fillon përdorimi i gjerë i erkerve dhe rezalitëve. Për mendimin tonë në këtë kohë futet gjerësisht në përdorim teknika e ndërtimit të mureve me skelet druri, e cila, sigurisht, duhet të ketë qenë përdorur edhe më parë. Shpesh gjatë shek. XIX kati i parë ndërtohesh me mur guri, ndërsa kati i dytë tërësisht ose pjesërisht me skelet druri.

Më poshtë po mundohemi të japim, aq sa na ka lejuar materiali i grumbulluar, një paraqitje të shkurtër të teknikës së ndërtimit të disa elementeve konstruktive kryesore, duke u përpjekur, që teknikat e ndryshme t'i rreshtojmë në një kronologji relative. Sigurisht teknikat e ndryshme janë përdorur gjatë gjithë kohës, sepse një teknikë më e përparuar nuk e ka zëvendësuar krejtësisht të vjetrën.

Themelet. Banesat beratase të ndërtuara në lagjet Kala, Mangalem dhe Goricë ngrihen mbi një terren të pjerrët shkëmbor. Themelet mbështeten direkt mbi shkëmb, ose, në rast se ai nuk është në sipërfaqe, themeli ndërtohet, mbasi gjendet tabani, fortësia e të cilit përcaktohet nga mjeshtri. Për arësye të terrenit të pjerrët zakonisht themelet vijnë me shkallëzime. Kur themeli ngrihet direkt mbi shkëmb, ai punohet me llaç baltë ose gëlqereje ndërsa kur themeli ngrihet mbi tokë të fortë, ai ndërtohet me gurë të thatë deri në rrafshin e saj. Gjatë prishjeve këta themele i kemi gjetur të mbushur me baltë si rezultat i lëvizjes së ujërave nëntokësore. Themeli me gur të thatë eliminon dhe transmetimin e lagështirës për shkak të kapilaritetit. Siç e thamë thellësia e tyre varet nga natyra e terrenit, ndërsa gjerësia nga lartësia e godinës. Ata kanë një gjerësi që ndryshon nga 70-120 cm.

Muratura. Nëse bëjmë një klasifikim të muraturës në funksion të materialit lidhës, atëhere do të kemi këto lloje:

a) Muraturë me llaç baltë me breza druri;
b) Muraturë me llaç gëlqereje me breza druri;
c) Muraturë me llaç gëlqereje pa breza druri.

Kjo renditje, për mendimin tonë, është dhe kronologjike. Nga praktika e punimeve restauruese është vërejtur se banesat beratase, në shumicën e rasteve, muraturën e kanë të ndërtuar me llaç baltë dhe breza druri (fig. 1). Muraturë të tillë gjejmë në të gjitha lagjet e Beratit. Faktori kryesor i përdorimit të gjerë të kësaj lloj murature është leverdishmëria ekonomike. Muraturën me llaç baltë dhe breza druri e gjejmë në dy teknika ndërtimi, në funksion të lidhjes së brendshme të murit. Teknika e parë, me lidhje të brendshme, realizohet në muraturën me llaç baltë e breza druri, me anën e kalimit të gurëve tërthori në më tepër se gjysmën e gjërësisë së murit. Ndërsa për muret e gjerë në çdo dy shtresa vendosen një herë dy radhë gurësh e pastaj tre të tilla. Sigurisht një ndihmë të mirë për soliditetin e murit japin dhe brezat e drurit. Në teknikën e dytë, për ndërtimin e muraturës me llaç baltë dhe breza druri, nuk respektohet lidhja e brendshme me anën e gurëve, por ky funksion u ngarkohet vetëm bre-



MUR GURI ME LLAÇ BALTE

fig. 1 –

DO NOT COPY

zave të drurit. Muraturë të tillë gjejmë të ndërtuar nga mjeshtrat oparakë. Ata, siç na ka rezultuar nga vëzhgimet gjatë restaurimeve, mesin e murit e mbushin me gurë të vegjël dhe baltë; vetëkuptohet se me dëmtimin e brezave të drurit në teknikën e dytë shkëputet lidhja e brendshme e murit, pra muri punon në dy pjesë dhe faqja e jashtme dhe e brendshme kanë ngarkesa të ndryshme. Si rezultat muret me teknikën e dytë janë më të dëmtuar. Pamja e jashtme e murit me llaç balte dhe breza druri për të dy teknikat e ndërtimit paraqet rregullaritet; mjeshtrat përpiqen që të ruajnë rreshtat në nivel horizontal dhe që fugat të mos bien mbi njëra tjetrën. Qoshet bëhen me gur të gdhëndur ashpër. Në Berat shpesh gjejmë dhe mure me llaç gëlqereje dhe breza druri, që kanë soliditet të lartë. Muret e gurit me llaç gëlqereje, pa breza druri janë përdorur më vonë, kjo është një teknikë relativisht më e re. Në këta mure respektohet lidhja e brendshme gur me gur, megjithatë dhe këta mbushen në mes me gurë të vegjël. Të gjitha llojet e mureve kanë gjerësi, që varion në funksion të lartësisë së godinës nga 50 deri në 100 cm. Muret, duke kaluar nga kati më i ulët në më të lartin, ngushtohen simbas rastit nga 5-10 cm., dhe nganjëherë deri 20 cm., por gjithmonë duke respektuar vertikalitetin e faqes së jashtme.

Brezat e drurit (fig. 1). Funksioni i tyre është të sigurojnë lidhjen tërthore dhe gjatësore të murit të gurit, por ato luajnë dhe funksionin e brezave antisizmikë. Të gjithë brezat janë prej lisi. Ata përbëhen nga dy binarë që vendosen në faqet anësore të mureve prej guri, ose dhe prej tre binarësh, ku binari i tretë vendoset në mesin e murit. Lidhja e binarëve bëhet me anën e listelave të vendosura tërthorazi çdo 40-50 cm. Listelat janë prej dru dëllinje ose mareje. Binarët e lisit për mure me llaç gëlqereje janë të rrumbullakët me diametër 6-7 cm. dhe të latuar shumë pak. Për mure me llaç balte dhe me gjerësi të madhe brezat i kemi me dimensione 8 x 10 ose 10 x 10 cm. Vihet re se brezat në muret me llaç balte janë gjithmonë të skuadruar. Në kryqëzimet e mureve brezat shkelin sipër njëri-tjetrit. Në katet e poshtme, përveç shkeljeve, lidhen dhe me një binar tërthor, i cili formon një nyje trekëndëshe. Në Berat kemi mjaft raste ku brezat janë të futur brenda në mur. Për mendimin tonë teknika e vendosjes së brezave brenda në mur është relativisht më e vjetër se teknika e vendosjes së brezave në faqet e murit.

Materialet. Në ndërtimin e banesave beratase janë përdorur dy lloj gurësh; gur shkëmbor i bardhë dhe gur lumi. Gurët shkëmborë janë nxjerrë nga sipërfaqja e shkëmbinjve dhe, shpesh herë, pranë vendit ku ndërtohej objekti. Ata përdorën në të gjithë muraturën e godinës. Gurët e lumit përdoren rrallë dhe sidomos në muret e oborreve. Materialet lidhëse janë llaçi i baltës dhe llaçi i gëlqeres. Llaçi i baltës ka përdorim të gjerë, megjithëse terreni shkëmbor vështirëson nxjerrjen e tij.

Gëlqerja ishte materjali i parë që siguronte pronari para fillimit të ndërtimit. Ajo stazhonohej vite me radhë e nuk përdorej pa kaluar minimumi dy vjet. Gjatë prishjeve të mureve me llaç gëlqereje kemi vërejtur se ai është mjaft i fortë.

Skeletet e drurit (çatmatë). Në Berat është përdorur gjerësisht teknika e ndërtimit të mureve me skelet druri. Në funksion të punës që kryejnë skeletet e drurit ndahen në:

a) Skelet druri me funksion mbajtës;
b) Skelet druri me funksion ndarës.

Po përshkruajmë çatmanë me funksion mbajtës (fig. 2). Ndërtimi i këtij konstruksioni prej druri kalon në dy faza. 1) Ndërtimi i skeletit 2) mbushja e skeletit. Në fillim mjeshtri pregatit materialin, e laton dhe e pret në dimensionet e duhura. Vendos shtyllat në një distancë 100-110 cm. dhe poshtë e sipër tyre vendos tabane. Shtylla kontraventohet në hapësirat nën nivelin e dritares. Mbasi vendosen kasat e dritares, fillon faza e dytë, mbushja e skeletit. Skeleti i drurit mbushet nga të dy anët me listela, zvogëlohen hapësirat midis shtyllave dhe, mbasi vjen në plumçe, fillon mbërthimi i paretkave. Mbi skeletin e drurit me funksion mbajtës, në drejtim të shtyllave, mbështeten trarët e çatisë. Gjërësitë e skeletit ndryshojnë nga 18-22 cm. Çatmatë me funksion jo mbajtës ndërtohen mbi dysheme. Konstruksioni i tyre është me binarë të vegjël të bashkuar mbi njëri tjetrin. Këto çatma lëkunden pse nuk kanë kontraventime. Binarët e çatmasë sipër mbërthehen në trarët e çatisë. Distanca midis binarëve lëviz nga 30-40 cm. Gjerësitë e çatmave ndarëse janë nga 12-18 cm.



fig. 2



fig. 3

Llojet e drurëve të përdorura në çatmatë. Lisi është druri kryesor që përdoret në ndërtimin e çatmave. Ai ka gjetur përdorim në shtyllat, tabanet dhe kontraventimet. Druri i lisit përdoret me dimensione 8 x 10, 10 x 10 dhe 10 x 12 cm. Theksojmë që me dru lisi bëhej pjesa konstruktive e çatmasë, ndërsa në mbushjet përdoren gjithë materialet që disponohen: si dru dëllinje, mareje etj.; kasat e dritareve janë prej plepi, ndërsa paretkat janë prej pishe që rritej në malin e Tomorrit. Druri i pishës së Tomorrit shkëputet fletë-fletë me trashësi 0,2-0,4 cm. dhe me gjërësi 3-5 cm. Ky lloj druri ka lehtësuar ndërtimin e çatmasë. Llojet e drurëve të lartpërmendur janë përdorur, pothuajse, në të gjithë banesat e Beratit.

Suvatimi. Kemi dy lloj suvatimesh: suvatim mbi mur guri dhe suvatim mbi çatma. Ndryshimi midis këtyre dy lloj suvatimesh konsiston vetëm në trashësinë e suvasë. Suvatimet në muret e gurit arrijnë trashësinë 2,5-3 cm., ndërsa në çatmatë 1,5-1,8 cm. Suvatimet jepen në dy duar ose në dy shtresa. Dora e parë për mur guri ka trashësi nga 2,1-2,6 cm., ndërsa për çatmatë nga 1,2-1,5 cm. Përzierja e dorës së parë është gëlqere, rërë dhe kashtë e grirë. Kjo dorë hidhet në muraturë me mistri. Dora e dytë ndryshon nga dora e parë, në të përdoret vetëm gëlqere dhe lesh dhije; ajo është një lloj patinimi. Trashësia e shtresës së dytë për mur guri është 0,4-0,6 cm., ndërsa për çatmatë 0,3 cm.

Çatitë. Në Berat përdoren dy tipa konstruksione çatish: a) konstruksion çatije tip stropil; b) konstruksion çatije tip kapriatë me lëndë ndërtimi.

Tipi stropil përdoret gjerësisht në Berat. Në fillim vendosen trarët në funksion të hapësirës që do të mbulohet, mbi to kalojnë urat e poshtme, sipër tyre ngrihen baballëket dhe mbi to kulmet dhe urat e sipërme. Nga kulmet në drejtim të mureve perimetrale vendosen qeprat dhe mbi to patavrat. Lidhjet midis urave dhe baballëkeve bëhen me kllapë dhe gozhdë. Qeprat fiksohen me gozhdë mbi urat e sipërme. Për banesat me hapësirë drite të vogël urat e poshtme nuk përdoren. Konstruksioni i çatisë tip kapriatë (fig 3) përdoret për mbulimin e hapësirave 5-6 m. Elementet e kapriatës që përdoren nga mjeshtrat janë: brezi i poshtëm, brezi i sipërm, dy pajantat dhe një shtyllë. Kapriatet vendosen larg njëra-tjetrës 100-130 cm. e lidhen me arkareçe, mbi të cilat kalojnë mahitë që mbulohen me patavra. Mbulesa, për të dy tipet e çative, është me tjegulla vendi; rrallë herë, dhe kur përdoren rrasa guri, me to mbulohen vetëm strehët.

* * *

DO NOT COPY

DO NOT COPY

G. SAMIMI

INDICATIONS SUR LES PROCEDES DE CONSTRUCTION DE L'HABITATION TYPE DE BERAT

RESUME

Dans la ville musée de Berat, subsistent aujourd'hui encore un grand nombre d'habitations populaires qui datent du début du XIXe siècle. Nous nous sommes efforcés ici, dans la mesure où nous le permettaient les matériaux dont nous disposons, de présenter une analyse des procédés de construction de certains éléments essentiels et de classer les divers procédés dans un ordre chronologique, en rattachant cette étude aux exigences directes de la restauration de ces habitations.

Fondations – *Les fondations reposent sur le roc ou sur le fond du sol, selon la nature de ce dernier. Dans le premier cas, il est fait usage de mortier, dans le second, le massif de fondations est construit en pierres sèches jusqu'au niveau du sol. En raison de la pente du terrain, les fondations s'étendent généralement en étages.*

Maçonnerie *(Tab. I) Classée en fonction du matériau de liaison, la maçonnerie est de trois types:*

a) Maçonnerie à mortier de boue à ceintures de bois;
b) Maçonnerie à mortier de chaux à ceintures de bois;
c) Maçonnerie à mortier de chaux sans ceintures de bois.

L'ordre ci-dessus est, à notre sens, également chronologique. On observe que les ceintures, dans les constructions les plus anciennes, sont fixées à l'intérieur des murs, ou saillent sur un plan parallèle aux parements. Les matériaux employés pour la construction sont les pierres rocheuses ou les gros cailloux roulés recueillis dans le lit du fleuve. Ceux-ci, rarement utilisés, le sont principalement pour les murs des cours. Des divers types de matériau de liaison, le mortier à boue se rencontre plus fréquemment que le mortier à chaux.

Les ossatures (pans) de bois. *On a largement eu recours à la technique de la construction des murs à pans de bois qui, selon leur fonction, se divisent en:*

a) Ossatures de bois à fonction de soutien,
b) Ossatures de bois à fonction de cloisonnage.

La construction de cet élément du bâtiment comporte deux phases; la construction de l'ossature proprement dite et le remplissage de celle-ci.

Revêtements. *On rencontre deux sortes de revêtements: le revêtement des murs et celui des pans de bois. La seule différence entre ces deux types de revêtement consiste dans l'épaisseur du mortier. Les revêtements sont appliqués en deux couches, la première est un mélange de chaux, de sable et de paille hachée la seconde un mélange de chaux et de poils de chèvre.*

Toitures

On trouve à Berat deux types de toitures: a) les toitures à arêtier, b) les toitures à fermes en bois. Dans certains cas, les couvertures sont faites de plaques de pierre.

Petrika LERA

DO NOT COPY

GJURMË TË REJA TË LASHTËSISË NË RRETHIN E KORÇËS

Ashtu si i gjithë vendi ynë edhe Zona e Korçës është e pasur me monumente të lashtësisë. Gjatë një ekspedite informative të organizuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, ne mundëm të zbulojmë një varg qendrash të reja (Tab. 1.), të cilat po i paraqesim sipas rendit kronologjik.

QENDRA PREHISTORIKE

Gorica e Vogël. Është një nga fshatrat që ndodhen buzë liqenit të Prespës së Madhe. Vitin e kaluar peshkatarët nxorrën nga liqeni me rjetë një sasi të madhe materiali arkeologjik që përbëhej nga fragmente enësh të ndryshme e brirë dreri. Materiali i nxjerrë paraqet interes për faktin se ai ka ngjashmëri të madhe me atë të stacionit prehistorik të Maliqit. Simbas të dhënave të peshkatarëve, materiale të tilla janë nxjerrë edhe herë të tjera, por mjerisht ato sot nuk ruhen, me ndonjë përjashtim të vogël. Keramika e gjetur përfaqësohet nga një tog fragmentesh, si buzë, funde, parete enësh, vegja, etj. Nga pikpamja e përdorimit praktik, kjo keramikë mund të ndahet në dy grupe: enë me parete të holla dhe enë me parete të trasha. Enët e grupit të parë janë punuar me kujdes, me një brumë të pastër e të pjekur mirë, me ngjyrë të zezë me shkëlqim të dobët dhe kanë formë elegante. Enët e grupit të dytë janë punuar me një brumë të dobët me ngjyrë kafe të errët me kokrriza rëre dhe guralecë të vegjël. Tek këto enë vihen re edhe zbukurime. Ornamentet e zbukurimit përfaqësohen nga thitha në reliev dhe nga ornamenti i gropëzuar. Ornamenti me thitha takohet shpesh në enët me parete të holla, kurse ornamenti i gropëzuar takohet më tepër tek enët me parete të trasha. Shumica e enëve, por sidomos ato me parete të holla kanë fund sferik e buzë të drejta ose shumë të përveshura nga jashtë.

Fakti që i gjithë ky material u nxuar nga liqeni, nga një thellësi jo shumë e madhe dhe jo shumë larg nga bregu, na shtyn të mendojmë se, materialet e nxjerra mund të jenë të një vendbanimi të tipit lakustër.

Nga pikpamja tipologjike materialet e zbuluara në Goricën e Vogël janë të ngjajshme me materialet e fazës III C të Maliqit dhe datohen në peridhën e mesme të bronxit [1]). Në këtë mënyrë shtohet edhe një vendbanim tjetër prehistorik në hartën arkeologjike të Korçës. Vemë re se vendbanimet e kësaj periudhe janë në vendosur pranë pellgjeve ujore të Prespës (Gorica e Vogël dhe Treni) dhe arterët kryesorë ujorë të fushës së Korçës, Devollit (Maliqi, Dunaveci). Ky lokalizim nuk duhet parë si një rastësi. Vendosja e vendbanimeve pranë ujrave, kushtëzohet nga zhvillimi ekonomiko-shoqëror i asaj periudhe.

Gradishta e Shuecit. Në afërsi të fshatit Shuec buzë liqenit të Prespës së Vogël ngrihet një kodër gëlqerore e veshur me shkurre, në të cilën ruhen gjurmë të një fortifikimi të lashtë. Fortifikimi i kodrës është bërë jo me mur por me një ledh të ndërtuar prej gurësh të dimensioneve relativisht të vegjël e të papunuar. Boshllëqet midis gurëve janë mbushur me çakëll dhe zhavor për të ndaluar lëvizjen ose shkarjen e tyre. Faqja e jashtme e ledhit është më e lartë dhe më e pjerrët, kurse ajo e brendëshmja më e ulët dhe

1) F. Prendi, La civilisation préhistorique de Maliq. Studia Albanica, I, 1966, fq. 266.



Fig. 1

më pak e pjerrët. Në këtë mënyrë dalja nga fortifikimi bëhej më lehtë se sa hyrja në të. Sot gjurmët e ledhit ruhen mirë dhe mund të ndiqen lehtë në të gjithë gjatësinë e tij. Planimetria e fortifikimit është rrethore. Ledhi e qarkon kodrën nga të gjitha drejtimet, me përjashtim të anës lindore ku shpati zbret në mënyrë të thiktë mbi liqenin, duke e bërë kështu të panevojshëm fortifikimin artificial në këtë anë të kodrës. Terreni i kodrës së fortifikuar ka pendencë në drejtim të liqenit dhe është tepër i thyer. Një terren i tillë ka qenë pak i favorshëm për tu zgjedhur si vendbanim në një kohë kur afër kodrës ndodhen terrene të sheshta e më të përshtatëshme për vendbanim. Por me sa duket ndërtuesit e Gradishtës kanë pasur tjetër qëllim. Atëhere lind pyetja: ç'karakter ka pasur dhe kur është ndërtuar Gradishta e Shuecit?

Mungesa e keramikës në Gradishtë si dhe terreni jo fort i përshtatshëm i kodrës na bën të mendojmë se Gradishta e Shuecit përfaqëson më tepër një vend strehimi se sa një vend banimi. Qoftë nga teknika e ndërtimit, qoftë nga karakteri thjesht mbrojtës Gradishta e Shuecit përbën një nga format më të lashta të fortifikimit, një fazë kalimtare nga vendbanimi i hapur në vendbanimin e fortifikuar me mur.

Për mendimin tonë teknika e ndërtimit të ledhit, ashtu sikurse e konstatojmë në Gradishtën e Shuecit, përbën një fazë më të hershme se muret rrethues të periudhës së parë të hekurit të Kalasë së Trenit, e cila nuk ndodhet më larg se 20 minuta nga Gradishta. Nga ana tjetër gjetjet e rastit të ardhura nga territori për rreth Gradishtës: si fragmenta keramike dhe një sëpatë guri, i përkasin të gjitha epokës së bronxit. Kësaj periudhe duhet t'i përkasë dhe fortifikimi i Gradishtës.

Tuma e Kuçit të Zi. Ky monument u zbulua në verë të vitit 1967. Gjatë punimeve bujqësore të vona në sipërfaqen e saj dolën fragmente keramike dhe disa objekte metalikë (Fig. 1). Keramika përfaqësohet prej një numri të madh fragmentesh enësh: buzë, vegje, funde, etj. Ndër to dallohen tre fragmente të pikturuara me një ngjyrë gështenje para pjekjes. Motivet e zbukurimit janë gjeometrike si romba e trekëndëshe të mbushur ose jo. Ndër objektet metalike që u gjetën vlen të përmendim: një byzylyk bonxi, një dorezë shpate në trajtë rombi e zbukuruar në të dy faqet me kokriza të vogla dhe një varëse bronxi, e cila në pjesën e sipërme të saj paraqet një figurë kali të stilizuar, kurse pjesa tjetër e saj është e zbukuruar me katër rradhë sumbulla. Këto materiale i takojnë periudhës së parë të hekurit.

Tumat e Dishnicës. Në të dy anët e rrugës automobilistike që të çon në Bilisht, në afërsi të fshatit Dishnicë lartësohen mbi sipërfaqen e rrafshtë të ara-ve tri tuma. Prej tyre më e madhja njihej që përpara, ndërsa dy më të voglat mundëm t'i fiksojmë gjatë ekspeditës sonë të fundit. Në sipërfaqen e tyre, sidomos në atë të së madhes gjetëm të shpërndara mjaft fragmente keramike, ndër të cilat edhe të pikturuara. Gjetjet i përkasin periudhës së parë të hekurit.

Nikollarë. Gjatë punimeve bujqësore në arat e këtij fshati u gjend një enë balte. Ena është zbukuruar me motive gjeometrike të pikturuara me ngjyrë kafe para pjekjes. Këto zbukurime janë breza vijash horizontalë të mbushura në hapësirën e mesit me një varg rombesh dhe breza vijash vertikale që fillojnë nën brezat horizontalë. Barku i enës në hapësirën midis brezave horizontalë zbukurohet me thitha të vogla. Ena i përket periudhës së parë të hekurit. Simbas të dhënave të fshatarëve ajo dhe objekte të tjera u zbuluan në një pjesë të ngritur të arës që mendojmë se do ketë qenë një tumë.

Kalaja e Bellovodës. Në jugë-lindje të fshatit Bellovodë që gjendet në skajin jugor të fushës së Korçës lartësohet një kodër gëlqerore. Në të ruhen gjurmët e një vendbanimi të fortifikuar, që vendasit e quajnë «Kalaja e Bellovodës». Kodra ku ngrihet vendbanimi

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

(fig. 2) ka një pjerrësi të lehtë dhe në majë përfundon me një terren pak a shumë të rrafshtë të përshtatshëm për tu banuar. Ajo zë një pozitë të përshtatshme: nga veriu syri të sheh gjithë fushën e Korçës, nga jugu lartësohen kodrat e qafës së Qarrit, ndërsa në lindje shtrihet fusha e Kamenicës. Mungesa e mbrojtjes natyrale i ka detyruar ndërtuesit që ta rrethojnë kalanë nga të tëra anët me mure mbrojtës. Prej tyre sot ruhen dy tipe të ndryshme muresh.

Muri më i hershëm (fig. 3) rrethon pjesën lindore të kodrës. Ai përbëhet nga dy parete me lidhje transversale të mbushur në mes me gurë me dimensione të ndryshme. Paretet janë ndërtuar me bloqe gurësh gëlqerorë të papunuar dhe të vendosur në mënyrë të çrregullt pa lidhje llaçi mbi njëri tjetrin. Muri ka gjerësi 3,2-3,4 m., lartësi maksimale të ruajtur 0,9 m. dhe gjatësi 150-160 m. Duke qenë i ngjashëm me muret mbrojtëse të tipit të Gajtanit mendojmë se i përket periudhës së parë të hekurit.

Në perëndim të murit të mësipërm në vazhdim të tij, ruhen rrënojat e një murit të një teknike tjetër, i cili rrethon pjesën tjetër të kodrës. Muri është ndërtuar me gurë me dimensione të vogla të lidhur me llaç shamot. Gjerësia e tij ndryshon nga 2,2-2,8 m. ndërsa gjatësia e përgjithshme është 360 m. Keramika e gjetur në sipërfaqe, vegje në formë gjuhe, kornute horizontalë, funde enësh, buzë kupash, tasash, etj. i përket kohës prej fillimit të mijëvjeçarit të parë deri në fillim të erës sonë. Në afërsi të kalasë së Bellovodës, më në jugë të saj, ngrihet një kodër tjetër gëlqerore e cila mban emrin kodra e Çitamit. Në sipërfaqen e saj ruhen mjaft fragmente keramike të njëjta me ato të gjetura në kalanë e Bellovodës, por gjurmë muri nuk konstatuam. Ka mundësi që ky të ketë qënë një vendbanim i hapur dhe banorët e tij të strehoheshin në rast rreziku në kalanë e Bellovodës.

Kalaja e Bellovodës, bën pjesë në tipin e vendbanimeve të fortifikuara të periudhës së parë të hekurit, të cilat janë vendosur në formën e një unaze në lartësitë që rrethojnë pellgun e Korçës (kalaja e Barçit, Dishnicës, Lumalasit, Hijes së Korbit [2]). Kalimi nga vendbanimet e hapura të periudhës së neolitit, eneolitit dhe bronxit në vendbanimet e mbrojtura me mure gurësh të papunuar është shprehje e një atmosfere të mbushur me rreziqe, kur siç shkruan F. Engelsi — «lufta ishte bërë një funksion normal e shoqëror». Të gjithë vendbanimet e kësaj periudhe janë ndërtuar në majat e kodrave me formacion gëlqeror, duke çfrytëzuar në dobi të mbrojtjes faqet e pjerrta e të thikta që formohen në këta formacione, si dhe materialin e përshtatshëm të ndërtimit.

Kalaja e Bilishtit. Jo më larg se 15 minuta në V.L. të Bilishtit ruhen rrënojat e një fortifikimi të lashtë. Ko-

2) Zh. Andrea, Rezultatet e kërkimeve informative në rrethin e Korçës. Materiale të sesionit arkeologjik, Tiranë, 1968, fq. 129-135.

DO NOT COPY

dra mbi të cilën është ndërtuar fortifikimi ngrihet në formën e një kupole, faqet e së cilës zbresin me një pjerrësi jo shumë të madhe. Ajo është e përbërë kryesisht nga formacione gëlqerore dhe krejtësisht e zhveshur nga bimësia. Kjo kodër njihet nga vendasit me emrin «kodra e kalasë».

Kalaja ndodhet në një vend mjaft të përshtatshëm dhe dominues. Në këmbë të saj shtrihet fusha e Devollit, kurse nga maja e saj syri kontrollon një horizont mjaft të gjerë që shkon, prej Malit të Thatë në veri, në Malet e Moravës në perëndim e deri në Gramoz në jugë. Kodra është përforcuar me mur, i cili rrethon majën e kodrës nga të gjitha anët në formën e një kurore mbrojtëse. Muri është ndërtuar nga blloqe gurësh me dimensione që lëvizin nga 1,30-1,50 m, të gjatë, 0,60-0,90 m, të gjerë, 0,60-0,70 m, të trashë. Gurët e këtij muri janë të palatuar e të vendosur njëri mbi tjetrin në të thatë. Hapësira midis dy faqeve të murit është e mbushur me copa gurësh. Një teknikë e tillë e ndërtimit të murit është analoge me muret mbrojtëse të qytezave ili e të Gajtanit (rrethi i Shkodrës), Trenit, Bellovodës (rrethi i Korçës), që datohen në periudhën e parë të hekurit. Muri në gjendjen e sotme është tepër i dëmtuar, por megjithatë mund të ndiqet linja e tij dhe të vrojtohet teknika e ndërtimit. Përmasat e këtij muri janë këto: i gjerë 3,20-3,50 m. kurse lartësia maksimale e ruajtur nuk shkon më shumë se 1,10-1,30 m. Muri ka një gjatësi të përgjithshme prej 480 hapa. Territori i kodrës brenda murit rrethues ka dhënë mundësi për vendosjen e një vendbanimi. Maja e kodrës përfundon me një terren të rrafshët, kurse në faqen jugore e perëndimore krijohen taraca natyrale të sheshta që mund të shfrytëzoheshin shumë mirë për banesat. Në gjendjen e sotme dallohet vetëm një hyrje në pjesën jugore të kodrës. Fragmentet e shumta të keramikës, që gjenden sot të shpërndara në faqen e kodrës, dëshmojnë për një jetë intensive. Keramika e gjetur në sipërfaqe të kodrës megjithëse e fragmentuar, ruan tipare të qarta të epokës së vet. Këto tipare pasqyrohen më së miri në format e enëve që riprodhojnë fragmentet, si edhe në ornamentet e zbukurimit që mbajnë ato. Ndër format më të rëndomta janë enët me dy vegje vertikale mjaft të zhvilluara që ngrihen mbi buzën e enës, enët me bark të fryrë, me grykë gati cilindrike e me buzë të drejta ose shumë pak të përveshura. Ndër ornamentet që haset më shpesh është ai i shiritit në reliev. Ky ornament paraqitet në dy variante, herë është i gropëzuar dhe herë të tjera i ndërprerë.

Prej një brumi më të pastër e të pjekura më me kujdes janë enët me parete të holla. Enët me parete të trasha kanë brumë me ngjyrë të zezë kurse ato me parete të holla ngjyrë okër ose gri. Që të gjitha enët janë të punuara me dorë. Për prodhimin në vend të kësaj keramike dëshmojnë skarcitetet e gjetura së bashku me fragmentet e enëve gjatë punës për hapjen e një kanali në faqen perëndimore të kalasë. Në kompleks i gjithë materiali arkeologjik i grumbulluar në kala ka tipare të përbashkëta me keramikën ilire të periudhës së parë të hekurit.

QENDRA TË PERIUDHËS QYTETARE ILIRE

Gorica e Madhe. Me këtë emër njihet një nga kodrat që ngrihet në perëndim të arave të kooperativës bujqësore të Trenit. Gjatë punës për teracimin e faqeve të kodrës ndërmjet materialeve arkeologjike që datohen në shek. III-II p.e.sonë u zbuluan dhe katër pitosa, dy prej të cilave të plota. Pitosat janë punuar prej një brumi të pastër e të pjekura shumë mirë. Pitosat e ruajtura kanë përmasa të mëdha dhe zinin 2 kv, -2,5 kv. bereqet. Ato mbajnë në buzë vulën e pronarit të poçarisë, ku lexojmë emrin ΤΙΠΠΑΚΟΥ. Me sa dimë ky emër është i vetmi që është zbuluar në vendin tonë.

QENDRA MESJETARE

Kalaja e Gopeshtit. Në krahun e djathtë të rrjedhjes së Devollit, në VP të lokalitetit të Moglicës lartësohen një varg kodrash flishore. Në majën e kodrës më të lartë ruhen rrënojat e mureve të një kalaje mesjetare, që vendasit e quajnë «Kalaja e Gopeshtit». Kalaja ka qenë e rrethuar me mur mbrojtës nga të gjitha anët. Më mirë muri ruhet në anën perëndimore e veriore, por dhe këtu mjaft i rrënuar. Për shkak të shkarjeve që ka pësuar vendi është mjaft e vështirë ndjekja e drejtimit të tij dhe përcaktimi i planimetrisë së kalasë. Muri me gjerësi maksimale 2 m. është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç shamot. Mungesa e Keramikës dhe sipërfaqja e kufizuar e rrethimit të shpien në përfundimin se kalaja e Gopeshtit ka pasur karakterin e një pike vrojtimi nga ku kontrollohej një pjesë e mirë e luginës.

Shën-Kollasi. Në afërsi të kalasë së Gopeshtit ngrihet një kodër që vendasit e quajnë «kodra e Shën-Kollasit». Në majë të kodrës të shpie një rrugë e ngushtë e shtruar me gurë, e cila kufizohet nga të dy anët me kanale të ngushta prej rasash shtufi. Në pjesën më të lartë të kodrës gjenden rrënojat e një ndërtese, ana lindore e së cilës kufizohet me një mur në formë harku. Ky element si dhe vetë emri i kodrës, mendojmë, dëshmojnë për ekzistencën e një kishe, që duhet të ketë pasur emrin e Shën Kollit.

POTISOM

DO NOT COPY


RRETHI I POGRADECIT
RRETHI I GRAMSHIT
GORICA E VOGËL
LIQENI I PRESPES
PUSTEC
LUMI DEVOLL
MOGLICA
NIKOLLARA
LOZHANI
POJANI
MALIQI
KLOCA
LUMASI
VOSKOPOJA
KORÇA
LAVDARI
KUÇ I ZI
BELORTA
NEVICISHT
DISHNICA
BARÇI
MBORJA
VITHKUQI
BELLOVODA
DARDHE
BOZHIGRADI
RRETHI I PERMETIT
RRETHI I PERMETIT
Legjenda
- VEND BANIMI I FORTIFIKUAR
- TUMË
- GJEJSE RASTI E VEÇANTË
- GJEJSE RASTI ME GRUP
- NEKROPOL
- VEND BANIMI I HAPUR
- GERMADHA BANESASH
- KESHTJELLË MESJETARE
- FURRË
- PALAFIT

P. LERA

NOUVEAUX VESTIGES ANTIQUES DECOUVERTS DANS LA REGION DE KORÇË

RESUME

Au cours d'une mission d'information organisée par l'Institut des Monuments Culturels dans le district de Korçë, il a été mis au jour un certain nombre de nouveaux centres, (Tab I) que nous décrivons ci-dessous dans l'ordre chronologique.

CULTURE ILLYRIENNE

Gorica e Vogël. *Ils s'agit d'un village situé sur les bords du lac de Prespe e Madhe. L'an dernier, des pêcheurs ont tiré du fond du lac une grande quantité d'objets archéologiques consistant en des fragments de vases divers et des cornes de cerf. Les objets recueillis présentent de l'intérêt du fait qu'ils sont très semblables à ceux retrouvés au centre préhistorique de Maliq. Le fait que ces matériaux ont été tirés du lac à une faible profondeur et à proximité de la rive, atteste qu'ils devaient appartenir à une agglomération de type lacustre. Du point de vue typologique, les matériaux découverts à Gorice e Vogël présentent des analogies avec ceux de la phase IIIc de Maliq et datent de la période moyenne du bronze.*

Le tumulus de Kuç i Zi. *Ce monument a été découvert à l'été 1967. Des travaux agricoles postérieurs ont fait apparaître à la surface des fragments de céramique et certains objets métalliques (Tab. II). Les matériaux appartiennent à la première période du fer.*

Les tumuli de Dishnice. *Des matériaux céramiques, et notamment de la céramique peinte, ont été découverts dans trois tumuli situés aux abords du village. Les trouvailles appartiennent à la première période du fer.*

Nikollarë. *Au cours de travaux agricoles il a été trouvé dans un champ de ce village un vase en terre cuite orné de motifs géométriques de couleur brune, peints avant la cuisson. Le vase appartient à la première péricde du fer. Selon les indications recueillies des paysans, ce vase ainsi que d'autres objets auraient été découverts sous un tertre qui a dû être un tumulus.*

La forteresse de Bellovode. *Au sud-est du village de Bellovode, sur une colline calcaire, subsistent les vestiges d'une agglomération fortifiée. (Fig. 1) On distingue dans cette forteresse deux types de murs. Les murs du type le plus ancien (fig. 2) entourent la partie orientale de la colline. Ils sont construits en blocs de pierre non taillés, assemblés sans*

DO NOT COPY

ciment d'aucune sorte, et ils appartiennent à la première période du fer. A l'ouest du mur précité, subsistent les vestiges d'un second mur qui enceint l'autre partie de la colline. Ce mur est construit en pierres de petites dimensions assemblées au mortier chamotte.

CULTURE MEDIEVALE

La forteresse de Gopesht. Elle est construite en murs de 2 mètres d'épaisseur, faits de pierres assemblées au mortier chamotte. L'absence de produits céramiques et la superficie reduite de l'aire close portent à croire que la forteresse doit avoir eu le caractère d'un point d'observation d'où était contrôlée une bonne partie de la vallée.

Shën Kollasi. Aux abords de la forteresse de Gopesht s'élève une colline que les habitants de l'endroit appellent colline de Shën Koll (Saint Nicolas). Dans sa partie supérieure se trouvent les ruines d'une église qui devait être consacrée au saint précité.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tanush FRASHËRI

TË DHËNA TË REJA ARKEOLOGJIKE NGA LUGINA E VJOSËS

DO NOT COPY

Ekspedita informative arkeologjike e Institutit të Monumenteve, që u organizua në muajin gusht të vitit 1969 në rrethin e Vlorës u muar me verifikimin e disa njoftimeve dhe hulumtimin e qendrave të reja.

Ekspedita e jonë i vuri vetes për detyrë të gjurmon te bregun e majtë të rrjedhjes së poshtme të Vjosës, si një vend pak i njohur, ndryshe nga krahu i djathtë i saj.

Si rezultat u gjetën gjurma jete në Treporto, në veri të pjesës së bonifikuar të Nartës, në Cerkovinjë-Skrofotinë, në Mifol-Aliban, Armen e rreth, Trevllezër, Karbunarë, Hadëraj, Dushkarak, Treblovë dhe Vllahinë. Përfundimet e arritura po i shtjellojmë më poshtë kronologjikisht:

I. *Hadëraj:* Diagonalisht me qendrën e naftës në Gorisht përballë Bylisit, ngrihet lartësia 622 m. e kodrës së Hadërajt, nga e cila vrojtohet gjithë pellgu i Vjosës dhe malësitë e Shushicës.

Në kodër u gjetën gërmadhat e një kalaje, sistemi i fortifikimit të sëcilës ruhet pjesërisht. Në faqen JP dhe P hasen gjurmët e një muri rrethues me trashësi 2 m. Muri është ndërtuar me gurë mesatarë gëlqerorë e shtuforë të palatuar dhe të vendosur në të thatë (TAB I, 1); po në këtë faqe duken gjurmë muresh taracimi të ndërtuar me të njejtën teknikë. Veç rrethimit të parë, në pjesën e sipërme të kodrës duken fragmentet e një muri të dytë, i cili, me sa duket, rrethonte pjesën e sipërme të kalasë – akropolin. Në brendësinë e sipërfaqes së rrethuar vihen re gjurmë rruge dhe rrënoja të shumta godinash, të ndërtuara po me teknikën e mësipërme; por gurët në to janë vendosur në mënyrë më të rregullt (TAB I, 2).

Keramika e gjetur në qytezë, me sa mund të gjykojmë, është ëe prodhimit lokal dhe gjendet me pakicë, fakt që na shtyn të mendojmë se kalaja ka patur më tepër funksion strategjik se sa ekonomik. Duke gjykuar nga të dhënat e mësipërme shihet se kemi të bëjmë me një kala ilire, e cila, duke u nisur nga ngjashmëria tipologjike me muret e Gajtanit dhe Dorsit, mendojmë se i përket periudhës së parë të hekurit.

II. *Dushkarak:* Në fshatin Dushkarak, buzë Vjosës, u konstatuan dy varre ilire (TAB. I, 3). Varret ndodheshin në brigjet thikë të lumit, afërsisht 400 m. larg njëri tjetrit, dhe, sipas materialeve të gjetura, i takojnë shek. II-I p.e.s.

III. *Armen:* Gjetjet e rastit në Armen janë të shumta dhe të periudhave të ndryshme.

Në verilindje të fshatit gjendet kodrina e quajtur «Qytezë» 293 m. e lartë (TAB. I, 4). Në këtë kodrinë, në një shtrirje prej 290 m., të bien në sy gjurmë muresh. Gjetjet në qytezë janë tjegulla helenistike dhe romake, fragmente keramike të prodhimit lokal, fragmente enësh me vernik të zi dhe të kuq helenistik, fragmente amforash dhe një kandil helenistik. Veç keramikës, u gjetën edhe 8 monedha të Apollonisë të shek. III-I p.e.s.

Në anën jugore dhe në anën jugperëndimore të qytezës u fiksuan dy nekropole me materiale që i përkasin periudhës së mësipërme.

Në veriperëndim të fshatit, tek «Bregu i kishës», gjetëm mure me gur shtufi dhe tulla lidhur me llaç. Mendojmë se kemi të bëjmë me një kishë të hershme



Fig. 1

bizantine. Kishë tjetër e periudhës bizantine është kisha e Shën Kollit (fig. 1), e cila gjendet në kodrën në hyrje të fshatit, në anën veriore. Kisha është ndërtuar me muraturë guri lidhur me llaç, në të cilën janë murosur dhe fragmente kapitelesh. Nga sa mund të gjykojmë nga krahasimi i saj me kishën e Kamenicës në Dëlvinë [1]) kemi të bëjmë me një kishë të periudhës së vonë bizantine.

Veç këtyre ndërtimeve, në shtëpitë e fshatit u gjendën materiale të ndryshëm mesjetare: një kapitel bizantin (fig. 2); një basoreliev me fytyrë njeriu (TAB I, 5) dhe një fibul mesjetar bronxi.

Të gjitha këto gjetje vërtetojnë se Armeni ka qenë një qendër e banuar qysh në shek. IV-III p.e.r. dhe ka pasur një jetë të gjallë ekonomike deri në mesjetë, siç dëshmohet nga lidhja me Apolloninë dhe objektet e gjetura që i përkasin periudhës helenistike dhe romake.

Vendbanimi bie në dekadencë gjatë periudhës së pushtimit turk, me sa duket pas kryengritjes së vitit 1432 dhe pas sëmundjes së kolerës që ra para dy shekujsh. [2]) Në këtë kohë duhet të ketë ndodhur dhe shvendosja për në vendbanimin e sotëm, që vërtetohet në mënyrë të tërthortë nga një mbishkrim në një portë, që mban datën 1769 (1178).

IV. *Selenica:* Gjurmimet në këtë qendër na dhanë rezultate të cilat po i parashtrojmë më poshtë.

Në faqen lindore të kodrinës së vreshtave u gjet një varr me tjegulla helenistike.

Në anën perëndimore tek moçali i vogël «liqeni i Granit», u gjetën materiale ndërtimi të periudhës romake dhe një fragment tubi prej keramike.

Materiale të periudhës helenistike dhe të periudhës romake u zbuluan gjatë punimeve bujqësore dhe në të majtë të rrugës Selenicë-Vlorë, në veri të qytetit. Këto materiale përbëhen nga tulla dhe tjegulla si dhe fragmente enësh. Nga ana tipologjike materiali i mësipërm datohet në shek. II-I p.e.r. Vlen të shënojmë se po të kësaj periudhe kanë qenë dhe objektet e gjetura në këtë vend nga Ugolini më 1924 [3]). Mendojmë se në Selenicë mund të kërkohen gjurmët e njerit prej nymfeve të përmendur prej autorëve antikë. Aristoteli na përmend dy të tilla, njëra në krahinën e Taulantëve dhe tjetra në Atintani [4]) e cila, sipas tij dhe Skylaksit, ndodhet ndërmjet Orikos, Abanteve dhe Apollonisë [5]); Plini gjithashtu e vendos Nymfeun midis Amantisë e Bylinëve, pozicion në të cilin gjendet Selenica [6]), e cila ka qenë shfrytëzuar si vend-burim bitumi që në kohët e lashta [7]). Përpjekje për të kërkuar Nymfeun në zonën e Selenicës kanë bërë gjithashtu Lik, Ugolini e Baldaçi.

V. *Mifol – Aliban:* Fshati i Mifolit, që gjendet në të djathtë të rrugës Vlorë-Fier është i ndërtuar mbi tri kodrina dhe në hapësirën e përfshirë prej tyre. Në anën JP tek «Bregu i Ristës», në anën VP tek «Bregu i Korjes» dhe tek kodra e kishës u gjetën materiale ndërtimi dhe fragmente keramike, që i përkasin shek. II-I p.e.s. Po kështu, në Aliban, në faqen veriore të kodrës së «Mesisë», gjatë punimeve për hapjen e një rruge u zbulua një nekropol, materialet e të cilit i përkasin shek. II-I p.e.s.

1) L.M. Ugolini, **Albania Antica,** Romë, 1927, fq. 141, 198.
2) H. Inalcik, **Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid,** Ankara, 1954 (përkthim në bibliotekën e Institutit Gjuhë-Histori) 76, 78, 79, 104, 105, 106.
3) L.M. Ugolini, **Albania Antica,** Romë 1927, fq. 108, 193.
4) Aristotel, **De mir. ausc.** 36, 127.
5) Scyl. 26; H. Ceka, **Antitanët,** B.SH.SH. 1956, Nr. 1, fq. 108-109.
6) Plin N.H. 10,15.
7) Holand tek Leake. **Travels in Northern Greece,** London 1858, fq. 377, 378.

DO NOT COPY

Veç objekteve të periudhës antike, në «Bregun e Ristës» u gjetën objekte mesjetare: enë me smalto, fragmente ene me gërshet përreth fytit etj.

Nga sa u tha më sipër mendojmë se kemi të bëjmë me një qendër banimi që zë fill nga shek. II p.e.s.

Jemi dakord me mendimin e J. Adamit se në këtë vend duhen kërkuar gjurmët e stacionit të vjetër Stefana që përmendet në itinerarin e Burdigalës [8]). Disa autorë si Kunc [9]), Kipert [10]) dhe Paç [11]) e indentifikojnë atë me Levanin. Për mendimin tonë stacioni nuk mund të kërkohet në Levan për faktin se vetë distanca që na jep itinerari i Burdigalës prej 12 miljesh, d.m.th. 17,6 km., nuk përkon me distancën Apolloni-Levan prej 7,5 km. Distanca e itinerarit përputhet më tepër me Mifolin, që është 17,5 km. larg Apollonisë. Veç kësaj, distanca e shkurtër midis Apollonisë dhe Levanit e bën praktikisht të panevojshëm një stacion për shkëmbimin e kuajve, siç ishin «mutatio-t romake, dhe e bën më të pranueshëm atë në Mifol. Po kështu është më e arësyeshme që stacionin ta kërkojmë në buzë të Vjosës, shtrati i së cilës në atë kohë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim, me përjashtim të grykëderdhjes. Për këto arësye mendojmë, që Mifoli i sotëm duhet të identifikohet me Stefanën mesjetare.

VI. *Karbunara:* Ndodhet buzë Vjosës, pothuajse përballë Bylisit. Gjatë kërkimeve tona zbuluam materiale arkeologjike që i përkisnin një periudhe të gjatë ekzistence. Gjurmët më të hershme që i përkasin periudhës helenistike dhe romake, u gjendën në «Bregun e Helmit». Këtu, gjatë punimeve bujqësore, dolën materiale ndërtimi dhe fragmente pythosesh, amforash dhe enësh me trup sferik, të lyera me vernik të zi, fragmente enësh pseudoterrasigillata etj.

Në «Bregun e Vorishtës» veç fragmenteve të shumta të keramikës helenistike dhe romake na tërhoqi vëmendjen një sasi e madhe fragmentesh amforash të veshura me pisë, që na krijuan përshtypjen se kemi të bëjmë me një magazinë.

Një periudhë më të vonë i përkasin gjetjet në «Bregun e Kishës». Këto janë gjurmë banesash të periudhës romake, ndërtuar me gurë llaç e tulla.

Në afërsi të kësaj kodre u gjend një nekropol i shkatërruar, me varre prej gurësh lidhur me llaç. Midis këtyre dy pikave gërmimet e sondazhit nxorën në dritë fragmentet e një mozaiku me motive gjeometrike prej gurësh me ngjyrë të bardhë, të zezë, ngjyrë tjegulle dhe hiri. Mozaiku ishte i vendosur mbi një shtresë të trashë llaçi shamot.



Fig. 2

Për periudhën e vonë, jeta dëshmohet nga një fontanë monumentale e ndërtuar më 1858 (TAB I, 6).

Nga sa u tha më lart shihet se kemi të bëjmë me një qendër banimi të themeluar rreth shek. III-I p.e.s., e cila, po të gjykojmë nga numri i madh i fragmenteve keramike, lokale dhe të importit, nga ekzistenca e mozaikut, si dhe nga ndërtimi i fontanës në vitin 1858, ka patur një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe vazhdimësi jete deri afër ditëve tona.

PËRFUNDIM:

Epiri, siç na kumtojnë burimet e lashta letrare, aq edhe gërmimet arkeologjike të kryera këto vitet e fundit, ka qënë një trevë ekonomikisht e zhvilluar. Ky zhvillim ekonomik ka ndikuar padyshim në krijimin e qendrave qytetare, si dhe në lidhjen e tyre me anë rrugësh (TAB. II). Këto rrugë, refleks i lidhjeve tregëtare të shkëmbimit të mallrave midis qendrave të banuara, rrjedhimisht dhe zhvillimit ekonomik përshkonin trualin e Epirit dhe e lidhnin edhe me botën jashtë saj.

Sipas Tabula Peutingerianas, në krahun e djathtë të Vjosës kalonte një rrugë me itinerar Apollonia-Amatria-Hadrianopoli-Ilio, kurse për krahun e majtë të dhënat as që bëjnë fjalë.

8) J.Adami, **Rrugët e Shqipërisë në kohën antike,** B.SH.SH. 1953, Nr. 1, f. 41.
9) O. Cuntz, **Itineraria Romana,** V.I. Lipside 1929, fq. 100.
10) H.Kiepert, **Forma orbis antiqui** XVII, 77, fq. 195.
11) C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** Wien 1904, fq. 76, 77, 195.

DO NOT COPY

Pyetjes që lind se a mund të ketë ekzistuar një rrugë gjatë bregut të majtë të Vjosës, mendojmë se mund t'i përgjigjemi pozitivisht.

Ekspedita gjeti gjatë bregut të Vjosës, pas bashkimit me Shushicën, rrënojat e 12 qendrave të banuara, midis tyre dhe një qendër të fortifikuar. Llogjikisht këto qendra të vendosura në anën e majtë të Vjosës duhet të kenë pasur kontakte rrugore me njëra tjetrën. Për mendimin tonë rruga shkëputej si degë e rrugës Apolloni-Aulon pranë Stefana-Mifolit, vazhdonte në Trevëllezër, në fushën e Shushicës, pasi kalonte lumin, dilte në Armen buzës së Vjosës, prej këtej në Kodrat e Selenicë-Nymfeut, dhe mbrinte në Karbunarë, ku duhet të bashkohej edhe me një degë të rrugës që kalonte në të djathtë të Vjosës e nisur nga Apollonia. Afërsia e Bylisit me Karbunarën që ndaheshin nga njëra tjetra veç prej një vahu të Vjosës, na bën të supozojmë se këtu duhej të shkëputej një degë e rrugës Apolloni-Hadrianopol, për të shkuar në Amanti, rrugë që duhej ta lidhte atë si me viset e brëndshme ashtu edhe me detin.

Fakti i gjetjes së një depozite pythosesh me pisë në Karbunarë tregon, gjithaq, rëndësinë e saj si një nyje e rëndësishme e tregëtisë së brendshme dhe rolin që luante ajo në shpërndarjen e mallrave në gjithë pellgun e Vjosës deri në Amanti. Në këtë kuptim mendojmë se qendra e mësipërme merrte një rëndësi të veçantë në udhëkryqin e lëvizjes së shkëmbimit të mallrave që shkonin e vinin në drejtime të ndryshme.

Për rrugën e dytë Apolloni-Aulon ndoqën vetëm itinerarin e mundshëm, duke ditur nisjen dhe vendmbritjen.

Kjo rrugë që nisej nga Apollonia, kapërxente Vjosën në Stefana-Mifol, shkonte buzë kodrave në afërsi të fshatit Trevëllezër më tej në Cerkovinë prej nga kalonte në Aulon-Pllakë.

Këto të dhëna tregojnë edhe një herë për pasurinë e madhe arkeologjike të zonës së Vjosës dhe besojmë se kemi dhënë një kontribut, sado modest, për hartën arkeologjike të këtij rrethi.

DO NOT COPY













DO NOT COPY

Tab. II



DO NOT COPY

DO NOT COPY

T. FRASHËRI

NOUVELLES DONNEES ARCHEOLOGIQUES SUR LA VALLEE DE LA VJOSE

RESUME

L'expédition d'information de l'Institut des Monuments Culturels, organisée au mois d'août 1969 dans le district de Vlore, s'est attachée à vérifier certains vestiges et indications recueillis dans de nouveaux centres. L'expédition s'était fixé pour tâche de suivre la rive gauche du cours inférieur de la Vjose, zone moins connue que la rive opposée. Des vestiges de vieux habitats ont été découverts à plusieurs endroits:

Hadëraj: *On y a découvert les ruines d'une vieille forteresse. Le mur d'enceinte est bâti en pierres de moyennes dimensiones calcaires et tufières, non taillées, disposées à sec. On y remarque des traces de rues et des ruines de nombreux édifices dont les murs sont formés de pierres assemblées sans mortier. La ressemblance de la technique de construction et des murs de ces vestiges avec ceux des forteresses de Dors et de Gajtan incite à donner pour date d'érection de la forteresse la première période de l'âge du fer.*

Dushkarak. *On y a trouvé deux tombeaux illyriens qui, d'après les matériaux découverts, appartiennent aux IIe et Ier siècles avant l'ère nouvelle.*

Armen. *Au nord-est du village, sur la colline dite «Qytezë» à une altitude de 293 metrés on a relevé des traces de murs. La céramique est de la période hellénistique et romaine. Y ont été trouvées 8 monnaies d'Apollonie des IIIe-Ier siècles avant l'ère nouvelle. A proximité de la «qytezë» (cité fortifiée) se trouvent deux nécropoles contenant des matériaux de cette période, ainsi que deux églises byzantines, l'une ancienne, et l'autre d'une période plus récente.*

Selenice. *Il y a été trouvé un tombeau garni de tuiles hellénistiques, ainsi que d'autres matériaux comprenant des tuiles, briques et fragments de récipients, appartenant à la période des IIe et Ier siècles avant l'ère nouvelle.*

Nous estimons, concordant en cela avec plusieurs hommes d'études étrangers, que c'est à Selenice qu'il convient également de rechercher les traces d'une des nymphées dont font état les auteurs antiques.

Mifol-Aliban. *On y a découvert une nécropole des IIe et Ier siècles avant l'ère nouvelle, ainsi que d'autres matériaux de la même période.*

On a lieu de penser que c'est ici qu'il faut rechercher les vestiges de la station de Stetania dont il est fait mention dans l'itinéraire àde Burdigale, et que Kiepert et C. Patsch identifient avec Levan. La distance de 12 milles figurant sur l'itinéraire de Burdigale correspond pleinement à ce site et non pas à Levan.

Karbunare. *Il y a été mis au jour des matériaux archéologiques appartenant à une période s'étendant du IIIe au Ier siècle avant l'ère nouvelle, des traces de constructions de la période romaine, ainsi que des fragments d'une mosaïques aux motifs géométriques. Il s'agit d'une agglomération fondée approximativement du IIIe au Ier siècle avant l'ère nouvelle, qui a connu un essor économique considérable et où la vie a été continue jusqu'à nos jours.*

CONCLUSION

Bien que les cartes antiques n'indiquent aucune route sur la rive gauche de la vallée de la Vjose, l'existence, sur ce bord, de 12 agglomérations, dont une fortifiée, conduit à la conclusion logique qu'une route parcourait cette région. Cette voie devait partir d'Apollonie, traverser Mifol, Trevëllezër, la plaine de Shushice, Armen, pour aboutir à Karbunare, où elle devait se joindre à un embranchement de la route qui, partant d'Apollonie, longeait la rive droite de la Vjose. De là, la route devait se diriger vers Amantia.

La découverte d'un dépôt de jarres de bitume à Karbunare atteste l'importance de cette localité en tant que centre commercial intérieur et le rôle qu'elle jouait pour l'écoulement des marchandises dans tout le bassin de la Vjose, jusqu'à Amantia.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

ARKITEKTURA E KULLËS SI BANESË

Ndër monumentet e arkitekturës në Shqipëri, një vend të rëndësishëm si për nga numri ashtu edhe nga teritori në të cilin shtrihen zënë banesat popullore. Lidhur me origjinën dhe rrugët e zhvillimit veshtirësitë janë të shumta nga që ato datojnë të shek. XIX e shumë shumë të shek. XVIII. Me gjithë këtë për vetë mënyrën dhe kushtet e jetesës, materialet e ndërtimit, traditës e një sërë shkaqesh të tjera, mund të mendojmë se në to kemi në një masë jo të vogël përsëritje të formave të mëparshme të banesave qytetare e fshatare që ndërtoheshin gjatë tërë mesjetës në Shqipëri.

Është koha që këto probleme duhet të shtrohen për t'u zgjidhur sigurisht mbi bazën e njohjes së banesave në tërë Shqipërinë dhe lidhjeve reciproke me banesat e vendeve Ballkanike e Mesdhetare, bashkësia e elementeve arkitektonike me të cilët në kohë është e qartë dhe larg çdo dyshimi. Nga ana tjetër, edhe pse mbi një bazë të pakët studimesh, mund të krijojmë bindjen se traditat e ndërtimit dhe arkitekturës tek ne janë për t'u patur parasysh.

Lidhur me këto studime që u paraqitën këtu janë një kontribut për t'u shënuar, bëjnë që të kalohen studimet e pakta të deritanishme të autorëve të huaj dhe hedhin një bazë të shëndoshë dhe premtuese.

Paraprakisht do të prekim një të metë që për mendimin tonë haset në studimet e deritanishme. E kemi fjalën për kërkimin që format e ndryshme të banesave brenda objektit të studimit, qoftë ky fshat, qytet apo krahinë, të zhvillohen nga celula elementare e banimit dhe prej saj, brenda kohës dhe objektit në studim, zhvillohet banesa duke haruar lidhjen me zona të tjera, ndërthurjen e tyre dhe shpesh kthimin në tipa të mëparshëm.

Problemi që deshnim të ngrinim këtu është arkitektura e kullës si banesë.

Mendimi tonë është se kulla si banesë në vëndin tonë si dhe në vënde të tjera, njihet që në kohra shumë të vjetra në forma të ndryshme si kulla vrojtimi, kulla si banesa në muret e kalave, si e veçuar brënda saj, kulla si banesë e fortifikuar, kulla brënda mureve të manastirit.

Ndërtimi në sh. e XIX në stil të gjërë në zona të tëra të Shqipërisë së Veriut i kullave si banesë siç është vërejtur vjen si pasojë e nevojës për një banesë të tillë, për shkak të degjenerimit të bashkësive fisnore, kaosit politik, pangopësisë së feudalëve vëndas. Sigurisht që kullë mund të ndërtonte vetëm ai që ishte i zoti t'i dilte zot vehtes, së pakut në fazën e parë, kur ishte forma mbizotëruese zakoni.

Zor se kulla banesë e fortifikuar, si formë arkitekturale të ketë rilindur në këto krahina; më e mundëshme është, të jenë frymëzuar nga banesa të fortifikuara egzistente të cilat në shekujt e XVII-XVIII siç shënojnë udhtarë të huaj, gjëndeshin kudo nëpër Shqipëri si banesa feudalësh e në manastire.

Të tilla akoma dhe sot hasim në Shqipërinë e Jugut, në Korçë ato të Turanit, Malavecit dhe Dishnicës në zona krejtësisht fushore, si edhe në mjaft fshatra të Gjirokastrës etj.

Do të deshnim të sillnim këtu një kontribut sado të vogël për këtë problem duke paraqitur dy kulla të hasura në bregdetin jugor në veri të Sarandës, në manastiret e Kakomes dhe Krorëzit të ndërtuar në mezin e sh. XVII në vënde mjaft të izoluara, që kërkonin banesa të fortifikuara, për tu mbrojtur në rast rreziku. Sot këta manastire i kanë konakët e tyre të rënuar, por sidoqoftë në forma të lexueshme qartë.

Tek manastiri i Kakomesë kulla është trekatëshe duke patur të poshtmin si bodrum, në katin e dytë hyhet nëpërmjet një shkalle dhe një ure të lëvizëshme nga që shkalla është rreth 1,5 m. larg portës së këtij

kati. Dritare të vogla ka vetëm kati i tretë ndërsa dy të parët janë të paisur me frengji nga të katër anët prej të cilave një mbrojtje e veçantë i bëhet shkallëve.

Dyshemetë duhet të kenë qënë të drunjta, po e tillë dhe çatia e cila nga sa kuptohet nga korniza me rasa të nxjerra pak nga muri, nuk ka patur strehë. Pranë saj është dhe një banesë e tipit me çardak.

Në Krorëz një ndër vëndet më të bukura në bregdetin tonë kemi po të njejtën gjë. Pranë kishës gjëndet një kullë po trekatëshe tek e cila po për shkak të diferencës së terenit hyhet dhe pa shkallë drejt e në katin e dytë. Në katin e tretë, mbi portë ka një vënd shikimi, të nxjerur ndaj murit, i cili duket se shërbente dhe për të mbrojtur. Banesa tjetër e tipit me çardak datohet sipas një pllake në mur si e vitit 1740 dhe me sa dimë është banesa më e vjetër që ruan datë tek ne.

Kullat e të dy rasteve meqenëse manastiret janë në vënde të izoluara duhet të jenë të njëkohëshme me kishat ose pak mbas tyre, pra të mezit sh. XVII dhe po të formave primitive për çka na shtyn të mendojmë ura e lëvizëshme. Del se kopjojmë ose zhvillojmë tipe të mëparshëm.

Sigurisht që kulla është një ndër format e banesave të fortifikuara dhe që lind në kushte të caktuara dhe për qëllime të caktuara. Në kushtet e qytetit të Gjirokastrës banesa e fortifikuar e të cilit na u ilustrua këtu është një rezultat origjinal i kushteve specifike të këtij qyteti në të cilin e hasim në forma nga më primitivet në më të përkryerat, të cilat duket se do të kenë bashkëekzistuar jo vetëm në etapat e fundit të saj. Do të deshnim të nënvizonim se pamvarësisht se elementet të veçantë të saj si dhoma, shkallë etj. mund të jenë dhe në tipa të tjera banesash, banesa e fortifikuar e Gjirokastrës përbën një tip të veçantë dhe origjinal të formuar në kushtet konkrete të atij qyteti.

Përsa i përket kullës së Shqipërisë së Veriut ne do të mund ta kuptonim atë si një fenomen arkitektonik origjinal në shtrirjen e saj, variantet e elementa të tjerë formalë dhe jo në tipin.

Sigurisht, që në vitet e ardhëshme studimet e filluara vitet e fundit në fushën e arkitekturës së banesës popullore do të shkojnë akoma më përpara duke prurë një material të tillë mbi bazën e të cilit do të jetë e mundur të bëhen përgjithësime, të nxirret çka është origjinale, çka është marrë nga të tjerët, çka është e përbashkët me ta, përgjithësime për të cilat jo vetëm në këtë fushë, historiografia jonë e re e arkitekturës ka nevojë.

DO NOT COPY

1) Diskutim i mbajtur në sesionin e parë shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës më dt 6.12.1969 mbi kumtesën e Emin Rizës «Banesa e fortifikuar gjirokastrite dhe B. Strazimirit – P. Thomës «Kulla e Matit.



GEN PLANI



Pamje nga jugu



KULLA





KATI III



GODINA ME ÇARDAK

KATI II



MANASTIRI KAKOMESE

DO NOT COPY

Tab. II



GEN PLANI







KULLA

KATI III







0 1 2 3 4 5 6 M

GODINA ME ÇARDAK

MANASTIRI KROREZIT

DO NOT COPY

DO NOT COPY

A. MEKSI

L'ARCHITECTURE DE LA «KULLA» EN TANT QU'HABITATION

RESUME

Les habitations populaires en Albanie occupent une place importante parm' les monuments architecturaux, tant par leur nombre que par le territoire sur lequel elles s'étendent.

Leur étude doit bien entendu se fonder sur celle des habitations de l'ensemble du pays et des éléments architecturaux qu'elles ont en commun avec celles des pays balkaniques et méditerranéens, cette communauté dans le temps étant par ailleurs parfaitement établie. D'autre part, cette étude, encore que peu approfondie, nous persuadera que les traditions de la construction et de l'architecture chez nous ne sont pas à négliger.

Nous estimons, pour notre part, que la «kulla», en tant que type d'habitation, existe dans notre pays comme dans d'autres, depuis les temps anciens et ce, sous diverses formes: tours de guet, donjons habités à l'intérieur des remparts des citadelles, demeures fortifiées comprises dans les enceintes des monastères.

La construction de kullas dans des régions entières de l'Albanie du Nord, phénomène observé sur une large échelle au XIXe siècle, fut rendue nécessaire par la désintégration des communautés tribales, le chaos politique et la cupidité insatiable des seigneurs locaux.

Il est peu probable que la kulla, en tant que conception architecturale, ait son origine dans ces régions; on a plutôt lieu de croire qu'elle a été inspirée par les habitations fortifiées existantes, demeures de seigneurs et monastères, dont l'Albanie des XVIIe et XVIIIe siècles était parsemée.

On en rencontre encore aujourd'hui dans l'Albanie du Sud, à Korçë, notamment à Turan, Malavec et Dishnice, dans des zones essentiellement plates, ainsi que dans de nombreux villages de Gjirokastër.

Cette étude présente deux kullas rencontrées sur la côté méridionale, au nord de Sarande, dans les mon a stères de Kakome et de Krorezi, construits au milieu du XVIIe s. en des sites relativement isolés et où, de ce fait, le besoin de demeures fortifiées se faisait sentir.

Au monastère de Kakome, la kulla comporte deux étages, le rez-de-chaussée étant en partie enfoncé dans le sol. On accède au premier étage par un escalier et un pont-levis, le haut de l'esalier étant distant d'une quinzaine de mètres de la porte d'entrée. Dans le mur au second étage s'ouvrent de petites fenêtres. Quant au rez-de-chaussée et au premier, ils sont percés de meurtrières qui assurent la défense de l'escalier. Les planchers ont dû être en bois et le toit également; le fait que le mur, à son sommet, est bordé de pierres en légère saillie nous induit à croire que le toit ne devait pas comporter d'avancée.

A Krorezi, on rencontre, tout près de l'église, une kulla du même type, où, du fait de la pente, on a directement accès de plain pied au premier étage. Au second, au-dessus de la porte, se trouve une guérite en encorbellement, qui servait apparemment à en assurer la

défense. L'autre habitation, du type à galerie, date, d'après une inscription relevée sur le mur, de 1740; et c'est à notre connaissance, la plus ancienne habitation portant la date de sa construction, dans notre pays.

Les monastères étant situés en des lieux isolés, ces deux kullas doivent avoir été construites à la même époque que les églises attenantes ou peu après, soit au milieu du XVIIIe siècle. En dépit de ce que laisserait entendre l'existence du pont-levis, elle ne constituent pas des formes primitives, mais représentent la copie au le développement de types antérieurs.

La kulla, en tant qu'habitation qui voit le jour dans des conditions et à des fins déterminées, est, à Gjirokastër, le produit original des conditions propres à cette ville. On l'y rencontre sous diverses formes depuis les plus primitives jusqu'aux plus achevées.

Quant à la kulla dans l'Albanie du Nord, elle constitue peut-être un phénomène architectural original par certains éléments de forme, mais non pas par le type.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

PUNA KONSERVUESE RESTAURUESE DHE KËRKIMORE NË INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS GJATË VITIT 1969

Me 5-6 dhjetor 1969 Instituti i Monumenteve të Kulturës organizoi sesionin e parë shkencor të tij, kushtuar 25 vjetorit të çlirimit të Atdheut dhe fitores së revolucionit tonë popullor. Në sesion u mbajtën 27 kumtesa, 7 prej të cilave nga bashkëpuntorë të jashtëm të Institutit. Merrnin pjesë si të ftuar Ministri i Arësimit dhe Kulturës sh. Thoma Deliana; Zv. Ministri i Arësimit dhe Kulturës sh. Mantho Bala; Zv. Rektorja e Universitetit Shtetëror të Tiranës sh. Shpresa Kseno dhe punonjës nga qendra dhe rrethet.

Sesioni u çel me referatin me titull «*Ta vëmë punën tonë mbi baza shkencore*», mbajtur nga sh. Gani Strazimiri, drejtor i Institutit. Pasi analizoi etapat në të cilat u zhvillua puna mbrojtëse, konservuese dhe restauruese me monumentet e kulturës dhe sukseset e arritura në këtë drejtim, ai paraqiti detyrat dhe objektivat e ardhshme të Institutit. (Referati është botuar me disa ndryshime në këtë numur).

Kumtesat që u mbajtën në sesion, duke qenë përgjithësimi i veprimtarisë praktike të Institutit, trajtuan një tematikë të larmishme, për një periudhë të gjerë kohe, që nga antikiteti e deri në ditët e sotme. Disa kumtesa iu kushtuan arkitekturës së qyteteve ilire. S. Islami me kumtesën «*Qyteti ilir i Zgërdheshit*» në bazë të materialit të grumbulluar në punimet konservuese – restauruese në këtë qendër, bëri përgjithësime për zhvillimin e jetës ekonomike dhe të arkitekturës në Zgërdhesh.

F. Prendi dhe Koço Zheku me kumtesën «*Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike*» shqyrtuan problemin e formimit të këtij qyteti ilir duke u mbështetur tek analiza topologjike e mureve dhe në të dhënat e tjera të grumbulluara gjatë ekspeditave restauruese në këtë qendër.

Lidhjet midis qendrave ilire u trajtuan në kumtesën e N. Cekës dhe Ll. Papajanit «*Rrugët antike në luginën e Shkumbinit*».

Bashkëpuntorët e jashtëm sollën të dhëna të reja për monumentet që njiheshin, ose njoftime për monumente të zbuluar rishtas. Një vendbanim ilir i periudhës së parë të hekurit i cili vazhdoi në mesjetë u përshkrua në kumtesën «*Kalaja e Tervolit në rrethin e Gramshit*» të sh. Haxhihysenit. Në kumtesën «*Vrojtime në qytezën ilire të Margëlliçit*», L. Derveni përshkruan një sterë uji të zbuluar në murin rrethues të kësaj qendre antike dhe solli të dhëna të reja për arkitekturën dhe jetën ekonomike të qytezës.

Për një numur qendrash prehistorike dhe antike të panjohura u sollën të dhëna nga P. Lera në kumtesën «*Qendra të reja arkeologjike në rrethin e Korçës*» dhe T. Frashëri në kumtesën «*Të dhëna të reja arkeologjike në luginën e Vjosës*».

Tematika e qytetit u trajtua edhe për periudhat e mëvonëshme. Gj. Karaiskai në kumtesën «*Kalaja e Elbasanit*» solli të dhëna të reja për planimetrinë, teknikën dhe periudhat e ndërtimit të këtij qyteti.

Kumtesa e S. Adhamit «*Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës*» qe një ilustrim material i periudhave të ndryshme të ndërtimit. Kumtesa e A. Baçes «*Qyteti i fortifikuar i Beratit*», trajtoi problemin e qytetit shqiptar gjatë mesjetës. Duke u mbështetur në analizën e fazave të ndryshme të ndërtimit dhe tek të dhënat historike u përcaktuan periudhat kryesore në jetën e qytetit. S. Bejko në kumtesën «*Kalaja e Tepelenës*» përshkroi këtë fortifikim të ndërtuar në fillim të shek. XIX, si hallkë e një sistemi kështjellash të pregatitura për luftë me Portën. A. Meksi në kumtesën «*Kisha e Mesopotamit në Delvinë*» paraqiti rezultatet e punës kërkimore në pregatitje të projektit të restaurimit të këtij monumenti.

Në studim të problemeve të pikturës mesjetare shqiptare Dh. Dhamo paraqiti kumtesën «*Mbi disa vepra të panjohura të piktorit tonë të shekullit XVI, Nikollës*». Kumtuesja argumentoi se disa piktura në fshatin Arbanas në Bullgari i përkasin dorës së piktorit të njohur shqiptar Nikollës së Onufrit. H. Nallbani në kumtesën «Konsiderata rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasi», trajton elementet progresive në punën e këtij piktori.

Problemet e mbrojtjes dhe restaurimit të arkitekturës popullore u trajtuan në disa kumtesa. G. Stra-

zimiri në kumtesën *«Zonifikimi i qytetit-muze të Gjirokastrës»* përcaktoi etapat kryesore të ndërtimit të kështjellës dhe të zhvillimit të qytetit. Duke u bërë diferencimi i vlerave arkitektonike dhe historike të monumenteve të qytetit, u përcaktuan pjesët muze të qytetit që do ruajnë pamjen origjinale dhe pjesët e lira ku qyteti do të zhvillohet sipas kërkesave të një qendre të banuar moderne. Arkitektura dhe evolucioni i banesës popullore të Gjirokastrës trajtohen në kumtesën e E. Rizës *«Banesa e fortifikuar gjirokastrite»*. B. Strazimiri dhe P. Thomo në kumtesën *«Kulla e Matit»* përcaktojnë tipet dhe origjinën e banesës së fortifikuar në krahinën e Matit. Probleme të tipeve dhe evolucionit të banesave popullore u trajtuan edhe në kumtesat *«Banesa tiranase»* e K. Zhekut dhe E. Rizës dhe *«Kontribut mbi banesën e Shkodrës»* të V. Shtyllës. Vrojtimet mbi teknikën e ndërtimit të banesave popullore u paraqitën në kumtesat e Th. Kamberit dhe G. Samimit.

Kumtesa e A. Meksit *«Restaurimi i kishës së Marmiroit»*, K. Zhekut *«Restaurimi i Portës së Luanit në Butrint»*, V. Kamsit *«Vështrim mbi kalanë e Shkodrës»* dhe F. Mirajt *«Muret antike të Persqopit»* sollën përveç njoftimeve mbi metodikën e restaurimit mjaft të dhëna të reja për arkitekturën e monumenteve të restauruara.

Kumtesat u ilustruan me diapozitiva dhe skema, të pregatitura nga punonjësit e laboratorit dhe skicografët e Institutit.

Sesioni përbën një sukses të punonjësve dhe bashkëpuntorëve të jashtëm të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe tregon se ata po vënë në jetë orientimet e partisë. Materialet e këtij sesioni janë një kontribut me vlerë për krijimin e një baze shkencore ku do të mbështeten në të ardhmen punimet mbrojtëse, konservuese dhe restauruese.

Gjatë vitit 1969 Instituti i Monumenteve të Kulturës zhvilloi një aktivitet të gjerë për mbrojtjen, restaurimin, studimin dhe popullarizimin e monumenteve të kulturës.

Puna kërkimore në monumentet antike u përqendrua kryesisht në dy qytetet e mëdha ilire të Lezhës dhe Zgërdheshit.

Në *Lezhë* vazhdoi restaurimi i mureve rrethuese të qytetit të lashtë, i shoqëruar me sondazhe dhe vrojtime për përcaktimin e periudhave të ndërtimit, dhe veçorive teknike dhe arkitektonike të elementeve të veçantë mbrojtës. Në bazë të kësaj u pregatit edhe një studim shkencor.

Në *Zgërdhesh* u kryen punime të gjera pastrimi, të cilat vunë në dukje monumentet me vlerë që ruhen mbi sipërfaqe dhe dhanë mundësi të bëhet dokumentimi i tyre. Gjithashtu në saje të gërmimeve sistematike u fituan të dhëna që vlejnë për të përcaktuar karakterin dhe kronologjinë e këtyre monumenteve. Në bazë të të dhënave të fituara u bë një studim shkencor.

Për të përcaktuar karakterin dhe vlerën e një qendre antike që rrezikohet të çduket nga punimet e guroreve, u ndërmor një ekspeditë kërkimore në *Gradishtën e Belshit*. Në saje të sondazheve u përcaktua shtrirja e vendbanimit dhe karakteri i tij dhe u fituan të dhëna për vlerën e monumentit.

Në *Persqop* u kryen punime pastrimi dhe u bënë vrojtime për punimet e ardhshme konservuese dhe restauruese.

Për mbledhjen e informatave mbi gjëndjen e monumenteve dhe zbulimin e monumenteve të reja një ekspeditë e Institutit përshkoi *luginën e Shkumbinit* duke bërë kërkime mbi rrugët antike që kanë kaluar atje. Ekspedita mblodhi të dhëna të vlefshme për rrugën Egnatia dhe vënien e saj nen mbrojtje si një kompleks: trase, vepra arti, vendbanime. Në bazë të këtyre materialeve u punua një studim shkencor. Po kështu u kryen disa ekspedita nga bashkëpuntorët e jashtëm në *zonën e Dumresë, luginën e Vjosës, fushën e Korçës, etj.* Në bazë të këtij materiali u hartuan disa kumtesa.

Në fushën e arkitekturës së vonë antike dhe asaj mesjetare vazhduan punimet në stacionin romak të *Bradasheshit*.

Në *bazilikën Paleokristiane të Elbasanit* në bashkëpunim me muzeun lokal, u ndërmorën punime pastrimi dhe konservimi. Gjatë punimeve u zbuluan përfundimisht planimetria trenefëshe e bazilikës, ndërtimi i së cilës i përket shek. IV-VI. Vlen për t'u përmendur dyshemeja e zbukuruar me mozaikë shumëngjyrësh dhe ikonostasi i gurtë i gdhendur me motive paleokristiane. Bazilika dëshmon për zhvillimin ekonomiko-social të Elbasanit në këtë periudhë.

Në *Kalanë e Durrësit* u kryen punime sistemimi e konservimi në muret e kalasë nga ana e pjesës qendrore të qytetit duke i evidencuar dhe i bërë ato të vizitueshme.

Në *kishën e Shelcanit* u restaurua çatia nëpërmjet së cilës dolën një sërë afreskash të Onufrit, të cilat nuk shikoheshin nga që ishin mbi nivelin e tavanit; po kështu monumenti u çlirua nga një sërë aneksesh pa vlerë.

Në *kishën e Dhërmiut* u muarën masa pastrimi dhe u bënë një sërë punime konservueso-restauruese në çati dhe në mure.

NOT COPY

Për pregatitjen e projekteve të restaurimit për punimet e vitit të ardhshëm u kryen vrojtime dhe u plotësua dokumentacioni përkatës në *kalanë e Elbasanit*, në qytetin e fortifikuar dhe *kishat bizantine të Beratit* si dhe në *kishën e manastirit të Pojanit dhe Perondisë*.

Një fushë të gjerë ka pasur puna kërkimore, në fushën e arkitekturës popullore. Kështu në *qytetin-muze të Beratit* u kryen punime në tre objekte, u restauruan 55 fasada në lagjen muze të Mangalemit si dhe u konservuan objektet e dëmtuara prej tërmetit. Në qytetin-muze të Gjirokastrës u kryen punime në 16 objekte.

Në *Gjirokastër* u organizua dhe një ekspeditë për grumbullimin e të dhënave të plota për zonifikimin e qytetit-muze të Gjirokastrës. Gjithashtu u punua për sqarimin e disa problemeve lidhur me karakterin, origjinën dhe evolucionin e banesës gjirokastrite. Mbi këto materiale u pregatitën edhe dy studime shkencore. Në *Berat* u bë studimi paraprak i banesës së Xhokaxhiut duke grumbulluar të dhënat e nevojshme për projektin e restaurimit të këtij monumenti. U punua edhe për përgjithësimin e vrojtimeve të bëra mbi teknikën e ndërtimit të banesave. Materiali i mbledhur më parë mbi *banesën e Tiranës* u përpunua dhe në bazë të tij u hartua një studim mbi tipet e banesave popullore të kryeqytetit. Në punën kërkimore në fushën e arkitekturës popullore duhet të përmendim edhe vrojtimet dhe shënimet për projektet e restaurimit të një numuri të madh banesash.

Për studimin e arkitekturës popullore të fshatit, u organizua një ekspeditë kërkimore-informative në *luginën e Matit* për grumbullimin e të dhënave në lidhje me banesën karakteristike të kësaj zone. Në bazë të tyre u pregatit dhe një studim për kullën e Matit. Po kështu u krye një ekspeditë kërkimore në malësitë e zonës së Kurveleshit të sipërmë ku u grumbullua një material karakteristik për banesën e kësaj zone.

Fushë tjetër e rëndësishme e veprimtarisë së Institutit ishte puna restauruese me monumentet që i përkasin historisë së re të vëndit tonë, periudhës së Luftës Nac. Çl. dhe ndërtimit të socializmit. Në këtë drejtim Instituti kreu punime restaurimi në shtëpinë ku u mbajt kongresi i Lushnjes, në sallën e kongresit të Përmetit, në sallën e mbledhjes së Qeverisë Provizore si dhe në selinë e kësaj Qeverije.

Mobilizimi i përgjithshëm dhe puna intensive e kolektivit bënë të mundshëm plotësimin e detyrave që shtronte festimi i vitit jubilar.

FOTOKOPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Shtypur në N.I.Sh. Shtypshkronja «M. DURI»

Tirazhi: 2000 Format: 1/12 70 x 100 Stash: 2204 - 65

DO NOT COPY